LAURA SHUTERIQI MIRELA ISLAMI

# LIBËR PËR MËSUESIN
# GJUHA SHQIPE 2

BOTIME
pegi

# Përmbajtje


- Hyrje
- Çfarë përmban ky libër?
- Qëllimi i fushës "Gjuhët dhe komunikimi"
- Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës
- Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së Gjuhës shqipe (shk.I)
- Lidhja e gjuhës shqipe me temat ndërkurrikulare
- Lidhja e gjuhës shqipe me fushat e tjera të të nxënit
- Kompetencat e fushës dhe përshkrimi i tyre
- Koha mësimore për klasën e dytë
- Qëllimet e shkallës së parë
- Përmbajtja e shkallës së parë
- Rezultatet e të nxënit, njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë.
- Metodologjia e mësimdhënies
- Kriteret që karakterizojnë procesin mësimor
- Puna me nxënësit me nevoja të veçanta, me vështirësi në të nxënë dhe me nxënësit e talentuar
- Leximi i teksteve letrare dhe joletrare
- Vlerësimi i nxënësve/eve
- Materiale dhe burime mësimore
- Planifikimi i kurrikulës
- Modele mësimi

## ❖ Hyrje

Lënda e Gjuhës shqipe bën pjesë në fushën "Gjuhët dhe komunikimi". Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor e letrar, që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve/eve. Më konkretisht, fusha "Gjuhët dhe komunikimi" i aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

Mësimi i Gjuhës shqipe, gjithashtu, zhvillon te nxënësit/et të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë gjuhët dhe kulturën kombëtare e atë botërore.

Fusha "Gjuhët dhe komunikimi" nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve/eve për t'u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkrues të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit/et njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë.

Arritjet gjuhësore të nxënësve/eve janë përcaktuese jo vetëm për lëndët e fushës "Gjuhët dhe komunikimi", por edhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Nëse nxënësit/et nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë mirë, atëherë ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë.

## ❖ Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e Gjuhës shqipe të shkallës së parë (klasa II) të lëndës "Gjuhë shqipe 2", miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2014.
Libri synon të orientojë dhe të ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e dytë, për të përmbushur qëllimet e fushës së kurrikulës "Gjuhët dhe komunikimi" për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe ato kyçe te nxënësit/et e klasës së dytë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës të kësaj lënde, bazuar në dokumentet zyrtare dhe fazat nëpër të cilat kalojnë mësimdhënia dhe të nxënit.
Libri u ofron mësuesve/eve njohuritë për dokumentacionin e ri, si: korniza kurrikulare, kurrikula *bërthamë për klasën*
përgatitore dhe arsimin fillor, programin mësimor dhe vlerësimin, bazuar në nivelet e arritjes së kompetencave. Tri
fazat më të rëndësishme janë përkatësisht:
a) planifikimi i të nxënit;
b) metodologjia e mësimdhënies;
c) vlerësimi i të nxënit, bazuar në qasjen e re me kompetenca.
Libri zbërthen programin në një variant analitik dhe në mësime model, me metoda, teknika e strategji që lehtësojnë të nxënit e nxënësve/eve për veprimtari të larmishme dhe efektive, me procedime metodike të çdo ore mësimore, me forma të ndryshme të konceptimit dhe të zhvillimit të orëve, si dhe me burime informacioni e mjete didaktike e mësimore që janë të domosdoshme dhe të nevojshme.

## ❖ Qëllimet e programit të Gjuhës shqipe

Qëllimet e lëndës së Gjuhës shqipe në arsimin bazë janë:
- Zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues.
- Kërkimi, gjetja, gjykimi në mënyrë kritike dhe përdorimi i informacionit që merret nga mediat dhe interneti.

- Njohja dhe vlerësimi i letërsisë shqipe dhe i letërsisë botërore nëpërmjet studimit të krijimtarisë së shkrimtarëve përfaqësues të periudhave të ndryshme (tekste të përshtatshme për moshën e nxënësve/eve).
- Krijimi i besimit se përmes letërsisë dhe teksteve joletrare zhvillohet mënyra e të menduarit, bota shpirtërore dhe personaliteti i njeriut.
- Zotërimi i njohurive, aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve të duhura rreth sistemit gjuhësor të shqipes.
- Vlerësimi i gjuhës shqipe si vlerë e kulturës sonë kombëtare dhe si mjet komunikimi.

### ❖ Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Realizimi i kompetencave kyçe të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi/ja të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi/ja duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. ***Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.*** Kur nxënësi/ja realizon kompetencat gjuhësore, ai/ajo njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar e për të mësuar, nxënësi/ja përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës ku bën pjesë lënda e Gjuhës shqipe pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.
Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës, mësuesi/ja ndjek këta hapa:
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi/ja në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyçe për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencë kyçe;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e të nxënit, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve/eve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit. Tabela e mëposhtme konkretizon lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës.

| **Kompetencat e fushës** | **Kompetencat kyçe** |
|---|---|
| * Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme<br>* Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar<br>* Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare<br>* Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale<br>* Përdorimi i drejtë i gjuhës | * Komunikimi dhe të shprehurit<br>* Të menduarit<br>* Të mësuarit për të nxënë<br>* Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin<br>* Kompetenca qytetare<br>* Kompetenca personale<br>* Kompetenca digjitale |

## ❖ Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe, që realizohen nëpërmjet lëndës së Gjuhës shqipe gjatë shkallës së parë

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyçe. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së Gjuhës shqipe gjatë shkallës së parë.

| | **SHKALLA I** |
|---|---|
| **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit** | • ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar, përmbajtja e të cilit nuk është më shumë se një faqe teksti;<br>• shpreh me gojë dhe me shkrim për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi apo përralle;<br>• paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup;<br>• lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqeje të palexuar më parë;<br>• shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe për një temë të caktuar);<br>• shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë letrar, përmes njërës nga format shprehëse: të folurit, shkrimit, dramatizimit (lojë me role);<br>• identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame apo filmi dhe luan rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët**;** |
| **Kompetenca e të menduarit** | • sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore; |
| **Kompetenca e të nxënit** | • ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë, që kërkohet;<br>• parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit;<br>• zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;<br>• mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen;<br>• grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës ***së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal;*** |
| **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin** | • përgatit një plan të thjeshtë ditor me shkrim, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës;<br>• gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit duke i diskutuar në grup;<br>• identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në shtëpi; |
| **Kompetenca personale** | • bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj; |
| **Kompetenca qytetare** | • diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e punës në grup;<br>• shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar; |

| | |
|---|---|
| **Kompetenca digjitale** | • ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet audio-vizuale), përmbajtja e të cilit të mos jetë më shumë se një faqe teksti;<br>• realizojnë punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre. |

### ❖ Lidhja e Gjuhës shqipe me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënit, të cilat ndihmojnë nxënësit/et të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në Kornizën Kurrikulare dhe në kurrikulat bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:
- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrja morale
- Mjedisi
- Bashkëjetesa paqësore

Gjuha shqipe, për specifikat dhe hapësirat që ka, (këtu përfshihet edhe sasia e orëve mësimore) lejon krijimin e situatave mësimore, të cilat mundësojnë trajtimin e këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme letrare nga letërsia shqipe dhe botërore zhvillon te nxënësit/et identitetin dhe krenarinë kombëtare, si dhe njohjen e vlerësimin e kulturës botërore. Tema si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup, të cilat zhvillohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar. Mësuesi/ja mund të krijojë edhe situata mësimore, gjatë të cilave nxënësit/et shprehen në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe që zhvillohen në lëndën e Gjuhës shqipe, ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve/eve **për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.**

### ❖ Lidhja e Gjuhës shqipe me fushat e tjera të të nxënit

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë (edhe lëndët e tjera të fushës "Gjuhët dhe komunikimi") mbështet edhe realizimin e kompetencave të fushave të tjera të kurrikulës. Në gjuhën shqipe, nxënësit/et: fitojnë njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar me gojë dhe me shkrim; lexojnë dhe kuptojnë tekste të llojeve të ndryshme; pasurojnë fjalorin dhe botëkuptimin e tyre duke lexuar tekste letrare; mësojnë të shkruajnë tekste të ndryshme (opinione, raporte, udhëzime etj.); mësojnë ta përdorin drejt dhe sipas rregullave gramatikore gjuhën etj. Të gjitha këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime sigurojnë suksesin e nxënësve/eve edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Natyrisht, në këtë lidhje ka marrje dhe dhënie.
Kështu, p.sh., aftësitë e të lexuarit mbështetin kuptimin e ushtrimeve dhe teksteve matematikore, nga ana tjetër, aftësitë për të zgjidhur probleme në matematikë ndikojnë në gjykimin dhe në mendimin kritik të nxënësve/eve.
Kuptimi ose analiza e teksteve të shkencave të natyrës kërkon aftësi të mira leximi. Po kështu, p.sh., leximi i një proze i ndihmon nxënësit/et të marrin njohuri rreth natyrës, siç njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.
Lënda e Gjuhës shqipe (edhe gjuhët e huaja) mbështet nxënësit/et në mësimin e shkencave shoqërore. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon që të kuptohen më mirë ngjarjet dhe figurat historike, marrëdhëniet mes njerëzve dhe vlerat shoqërore.
Mësimi i arteve të ndryshme mbështetet nga letërsia (tekstet letrare që studiohen nga nxënësit), e cila është pjesë e tyre. Kështu, analiza e teksteve letrare i ndihmon nxënësit/et të kuptojnë mjetet e shprehjes artistike; studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme, si p.sh., i reklamave, kërkojnë integrim me artet për elementet pamore të reklamave; ilustrimi i një analize të një teksti letrar me muzikën e një periudhe të caktuar i ndihmon nxënësit/et të kuptojnë efektin emocional të muzikës dhe mjetet e shprehjes së saj artistike. Element i përbashkët mes muzikës dhe gjuhës shqipe janë edhe këngët popullore dhe krijimet e tjera folklorike, studimi i të cilave integron natyrshëm gjuhën dhe artet.
Shembujt e mësipërm janë vetëm një nxitje për të kuptuar se në procesin mësimor krijohen mundësi për integrim mes fushave të të nxënit. Mësuesit/et me pasionin dhe përkushtimin që i karakterizon, mund të realizojnë pafund integrime mes fushave të të nxënit. Ky integrim i lejon nxënësit/et të mos marrin njohuri të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta.
Në diagramin e mëposhtëm janë dhënë aftësitë që Gjuha shqipe u siguron fushave të tjera të të nxënit.

## ❖ Kompetencat e fushës

Fusha "Gjuhët dhe komunikimi" dhe të gjitha lëndët që bëjnë pjesë në këtë fushë realizojnë pesë kompetenca, të cilat janë: të dëgjuarit e teksteve të ndryshme; të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar; të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare; të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale; përdorimi i drejtë i gjuhës.

**Përshkrimi i kompetencave të fushës**

a) **Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme**
Nxënësit/et marrin njohuri, zhvillojnë qëndrime dhe vlera, si dhe zbatojnë aftësi e shkathtësi duke dëgjuar tekste të ndryshme.
Më konkretisht, nxënësit/et kuptojnë se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ata dallojnë disa cilësi të zërit të folësit si: intonacioni, ritmi, theksi, volumi i zërit. Gjithashtu, nxënësit tregojnë brendinë, veçojnë idenë kryesore, dallojnë fjalët ose frazat kyçe, bëjnë konkluzione, krahasojnë ose klasifikojnë, si dhe bëjnë vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjojnë.
b) **Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar**
Nxënësit: përdorin drejt gjuhën standarde gjatë folurit; kuptojnë dhe zbatojnë në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqërojnë të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.
c) **Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare**
Nxënësit/et lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstrojnë kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësve/eve).
d) **Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**
Nxënësit/et shkruajnë për qëllime dhe lexues të ndryshëm. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit/et, gjithashtu, respektojnë strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.
e) **Përdorimi i drejtë i gjuhës**
Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, atëherë ata duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja. Kështu, nxënësit/et dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respektojnë diversitetin gjuhësor; kanë njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.

## ❖ Koha mësimore për klasën e dytë

Gjuha shqipe është lëndë e detyrueshme në arsimin bazë. Ajo zhvillohet përgjatë nëntë viteve të këtij arsimi dhe zë afërsisht 1/4 të kurrikulës. Në lëndën e Gjuhës shqipe, nxënësit/et pothuajse çdo orë flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri e shkathtësi rreth sistemit gjuhësor, megjithatë, theksi vihet në njërën nga këto kompetenca. Ky fakt përcakton edhe orët për këtë kompetencë, p.sh., në klasën e dytë janë sugjeruar rreth 60 orë për kompetencën e të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale. Kjo do të thotë që nxënësit/et do të shkruajnë pothuajse në çdo orë mësimi, por theksi në këto 60 orë do të vihet më shumë te kjo kompetencë.

## ❖ Qëllimet e shkallës së parë

Gjatë shkallës së parë, nxënësit/et:
- komunikojnë në varësi të qëllimit dhe të situatës;
- përmbledhin tekstin që lexojnë ose dëgjojnë dhe e vlerësojnë atë (me gojë ose me shkrim);
- dallojnë llojet kryesore të teksteve dhe tiparet e tyre;
- kuptojnë, interpretojnë dhe analizojnë përmbajtjen e një teksti, marrëdhëniet mes personazheve, ndjenjat dhe vlerat e tyre;
- kuptojnë dhe pranojnë opinionet e ndryshme të të tjerëve rreth teksteve letrare dhe teksteve joletrare;
- krijojnë tekste të thjeshta për qëllime personale ose funksionale;
- përdorin burime të ndryshme për të gjetur informacion (fjalor, enciklopedi ose internet);

- njohin dhe zbatojnë fazat e të shkruarit dhe të përgatitjes së një prezantimi;
- dallojnë dhe përdorin njohuritë themelore të gramatikës së gjuhës shqipe;
- njohin dhe zbatojnë rregullat e përgjithshme të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

### ❖ Përmbajtja e shkallës së parë

Në programin e Gjuhës shqipe për shkallën e parë dhe për shkallën e dytë janë paraqitur rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë. Kompetencat zhvillohen përmes disa ***tematikave.*** Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që realizimi i tyre përgjatë vitit shkollor ose gjatë shkallës përkatëse duhet të zhvillohet i ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në orë mësimi, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre, janë e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit/et dhe autorët/et e teksteve). Më poshtë janë dhënë tematikat për çdo kompetencë.

a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme:
- rregullat e të dëgjuarit;
- të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin.

**b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar:**
- rregullat dhe organizimi i të folurit;
- diskutimi dhe bashkëveprimi në grup.

**c) Të lexuarit e teksteve të ndryshme:**
- të lexuarit fillestar (klasa 1-3);
- të lexuarit për të kuptuar;
- të lexuarit e teksteve letrare;
- të lexuarit e teksteve joletrare.

**d) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale:**
- shkrimi i dorës;
- planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit;
- të shkruarit për qëllime personale;
- të shkruarit për qëllime funksionale.

**e) Përdorimi i drejtë i gjuhës:**
- Sintaksë,
- Morfologji,
- Leksikologji dhe semantikë,
- Drejtshkrim,
- Fonetikë dhe fonologji.

- **Rezultatet e të nxënit, njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë. (Shkalla I/Klasa II)**

**KOMPETENCA: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme**

<table>
<tr><td colspan="2">Përshkrimi i tematikave të kompetencës<br>Nxënësi/ja demonstron sjellje dhe qëndrime të përshtatshme gjatë të dëgjuarit, si: vëmendje, pëlqim dhe interes. Ai/ajo dëgjon dhe kupton një larmi tekstesh të folura, demonstron se i ka kuptuar këto tekste, si dhe shpreh opinionet e tij/saj rreth teksteve që dëgjon.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë<br>Nxënësi/ja:<br>- demonstron të kuptuarit e teksteve që dëgjon në situata të ndryshme;<br>- ritregon me fjalët e tij/saj përmbajtjen ose informacionin kryesor të një bisede, poezie, përralle, tregimi, rregulle praktike ose udhëzimi.</td></tr>
<tr><td>Njohuritë</td><td>Shkathtësitë</td></tr>
<tr><td><br><br>Njohuritë për klasën e dytë<br>Gjatë orëve mësimore të sugjeruara në program, nxënësi/ja dëgjon dhe punon (u përgjigjet pyetjeve, tregon përmbajtjen, ndan në pjesë, jep mendimet e tij/saj, shpreh pëlqimet e veta për ngjarjet, personazhet etj.) me tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij/saj, si: përralla, fabula, biseda, tregime, ndodhi personale, emisione televizive, shfaqje për fëmijë, rregulla praktike, teatër me kukulla etj. Ai/ajo, gjithashtu, përvetëson njohuritë e mëposhtme:<br>- Tregimi i përmbajtjes duke e ilustruar me detaje dhe ilustrime nga teksti.<br>- Dallimi i disa detajeve interesante gjatë të dëgjuarit, si p.sh., muzika që e shoqëron tekstin, zëri i veçantë etj.</td><td>Rregullat e të dëgjuarit<br>Nxënësi/ja:<br>- shfaq sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit, p.sh.:<br>• ndjek me vëmendje tekstin që dëgjon,<br>• nuk e ndërpret tjetrin, kur është duke folur,<br>• e sheh në sy personin gjatë kohës që flet;<br>- shpreh pëlqim dhe interes ndaj tekstit që dëgjon: (Më pëlqen kjo që po dëgjoj).<br>Të dëgjuarit për të kuptuar dhe vlerësuar tekstin<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon njohuritë paraprake që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit që dëgjon;<br>- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;<br>- tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje dhe ilustrime;<br>- ndan tekstin në pjesë dhe i vendos një titull çdo pjese;<br>- shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi, fabule apo përralle;<br>- lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij/saj ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera;<br>- bën gjykime të thjeshta rreth tekstit;<br>- shpreh pëlqimet e tij/saj rreth ngjarjeve ose personazheve të tekstit;<br>- veçon disa detaje interesante (muzika që shoqëron rrëfimin e një përralle, zëri i personazheve etj.) gjatë të dëgjuarit.</td></tr>
</table>

| **Vlerat dhe qëndrimet** |
|---|
| Nxënësi/ja:<br>- vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre;<br>- shfaq vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave;<br>- ka tolerancë dhe respekt për kulturën dhe gjuhën e tjetrit/ës. |

**KOMPETENCA: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar**

<table>
<tr><td colspan="2">Përshkrimi i tematikave të kompetencës<br>Nxënësi/ja shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë. Ai/ajo shpreh saktë dhe kuptueshëm mendimet e tij/saj për një temë ose tekst të përshtatshëm për moshën, shoqëron të folurin edhe me elemente joverbale, bashkëpunon në grup, si dhe merr pjesë në lojë me role.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë<br>Nxënësi/ja:<br>- flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur kur tregon një ngjarje, një përvojë të tijën/sajën ose kur përshkruan diçka;<br>- diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta;<br>- përgatit materiale për organizimin e shfaqjeve dhe të ekspozitave në klasë;<br>- merr pjesë në lojë me role.</td></tr>
<tr><td>Njohuritë</td><td>Shkathtësitë</td></tr>
<tr><td>Njohuritë për klasën e dytë<br>Nëpërmjet bashkëbisedimeve dhe diskutimeve rreth temave të përshtatshme për moshën e nxënësit/et, si: natyra përreth, kafshët shtëpiake, qyteti ose fshati im, ngjarjet interesante në jetë, festat lokale, kompjuteri dhe televizori etj., ai/ajo fiton njohuritë e mëposhtme:<br>- Teknikat e thjeshta të recitimit.<br>- Rregullat e të folurit gjatë punës në grupe të vogla.</td><td>Rregullat dhe organizimi i të folurit<br><br>Nxënësi/ja:<br><br>- shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë;<br>- shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve;<br>- përqendrohet në çështjet kryesore, kur rrëfen një ngjarje ose një përvojë të tijën/sajën para shokëve dhe shoqeve, mësuesve/eve dhe prindërve (p.sh., tregon pse një objekt i sjellë nga shtëpia është shumë i rëndësishëm për të);<br>- reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh;<br>- shpreh emocione dhe ndjesi të ndryshme me anë të pantomimës, ose ndërton histori mbi bazën e ilustrimeve dhe figurave të dhëna.<br>Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup<br>Nxënësi/ja:<br>- merr pjesë në lojë me role (me ndihmën e mësuesit/es ose të një të rrituri) dhe shpreh opinionet e tij/saj rreth interpretimit të shokëve dhe shoqeve të klasës;<br>- përdor gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla, si: fotografi dhe piktura;<br>- pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij/saj, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë (kryesisht brenda klasës).</td></tr>
</table>

| **Vlerat dhe qëndrimet**<br>Nxënësi/ja:<br>- demonstron siguri kur flet në klasë, shkollë, mes shokëve dhe në shtëpi;<br>- përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes);<br>- shoqëron të folurin me shprehjen e duhur të fytyrës dhe me gjestet e përshtatshme;<br>- është aktiv/e në diskutime, në punë në grup ose në veprimtari të tjera të klasës ose të shkollës;<br>- shfaq iniciativë ose nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për tema të ndryshme që kanë lidhje më karakteristikat dhe zhvillimin moshor të tyre. |
|---|

**KOMPETENCA: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare**

| **Përshkrimi i tematikave të kompetencës**<br>Nxënësi/ja lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekste të thjeshta letrare dhe joletrare. Ai/ajo përdor strategji të thjeshta për të kuptuar tekstin, si p.sh.: lidh tekstin me njohuritë e mëparshme, rilexon, pyet rreth paqartësive, mban shënime, bën nënvizime etj. Nxënësi/ja demonstron kuptimin e tekstit duke treguar brendinë dhe ngjarjet kryesore. Nxënësi/ja, gjithashtu, arrin në përfundime të thjeshta dhe jep mendimet e tij/saj rreth tekstit që lexon. |
|---|
| Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë<br>Nxënësi/ja:<br>- përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;<br>- lexon me zë një tekst të shkurtër dhe tregon funksionin e pjesëve plotësuese të tekstit (p.sh., foto,vizatim, pamje etj.);<br>- tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit ose parafrazon tekstin;<br>- jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula) dhe joletrar (si p.sh., kalendar, fjalor i thjeshtë). |

| Njohuritë | Shkathtësitë |
|---|---|
| | **Të lexuarit fillestar**[1]<br>Nxënësi/ja:<br>- emërton shkronjat e alfabetit;<br>- dallon shkronjat e mëdha nga shkronjat e vogla;<br>- dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe;<br>- përdor lidhjen mes shkronjës dhe tingullit për të lexuar dhe kuptuar fjalë të reja;<br>- shqipton drejt tingujt, rrokjet dhe fjalët;<br>- lexon rreth 50-70 fjalë në minutë në klasën e parë dhe 70-90 fjalë në minutë në klasën e dytë;<br>- identifikon tiparet dalluese të një fjalie si: shkronja e madhe në fillim të saj, shenja e pikësimit në fund.<br><br>**Të lexuarit për të kuptuar tekstin**[2]<br>Nxënësi/ja:<br>- parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>- pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të *(Ku? Kur? Pse? Si ndodh kjo? Çfarë do të thotë?*);<br>- rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (kur është e nevojshme);<br>- nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë (me ndihmën e mësuesit/es);<br>- tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar: *duke treguar shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; duke përmendur çështjet kryesore; duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti;*<br>- lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me udhëtime, me përvoja personale (*dalja e një dhëmbi, marrja e një kafshe në shtëpi*) me ngjarje nga jeta e tyre etj. (*A ka ndodhur edhe në jetën tuaj diçka e tillë? Çfarë ju kujton kjo histori?)* ose me tekste të lexuara më parë (*A ka ngjashmëri ky tregim me tregimin... që lexuam javës që shkoi? Çfarë keni të përbashkët ju me personazhin e tregimit? Çfarë ju kujton kjo ngjarje ose ky personazh?*); |
| | |
| Njohuritë për klasën e dytë<br>**Studim tekstesh letrare**: përralla, fabula, tregime, gjëegjëza, poezi.<br>- Njohuri të thjeshta e të përgjithshme për tiparet e:<br>• përrallave,<br>• fabulave,<br>• tregimeve,<br>• gjëegjëzave,<br>• poezive (p.sh., shkruhen në vargje, strofa).<br>- Njohuri për elementet e teksteve, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu.<br>**Studim tekstesh joletrare:** kalendarë të thjeshtë, rregulla praktike, kartolina, letra, fjalorë të thjeshtë, revista për fëmijë.<br>Njohuri të thjeshta për elementet e një kalendari, të një letre drejtuar një të afërmi, të një kartoline (frazat hyrëse, urimin dhe dërguesin e kartolinës etj.). | |

[1] Aftësi dhe shkathtësi për klasën përgatitore, klasën e parë, të dytë dhe të tretë.
[2] Këto aftësi dhe shkathtësi janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe joletrare.

| | |
|---|---|
| | - shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit/es *(Si ndiheni pasi keni lexuar këtë përrallë? A do donit të përfundonte ndryshe? Çfarë do të kishit bërë ju në një rast të tillë?*).<br><br>**Të lexuarit e teksteve letrare**<br>Nxënësi/ja:<br>- lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj.;<br>- përcakton dy-tri tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive;<br>- përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilat janë personazhet e preferuara;<br>- dallon elemente të tekstit, të tilla si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu;<br>- tregon si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>- krahason poezinë me gjëegjëzën, përrallën me tregimin.<br><br>Të lexuarit e teksteve joletrare<br>Nxënësi/ja:<br>- lexon tekste joletrare si: ditar, kalendar i thjeshtë, kartolina, letra, fjalorë të thjeshtë, revista për fëmijë etj.;<br>- veçon disa elemente të teksteve, si: titujt, kapitujt dhe ilustrimet, për shembull, *në një kalendar dallon vitin, muajt, ditët, në një kartolinë dallon frazat hyrëse, urimin dhe dërguesin e kartolinës etj*.;<br>- komenton ilustrimin e një teksti. |

| |
|---|
| **Vlerat dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës**<br>Nxënësi/ja:<br>- mban trupin në një qëndrim të përshtatshëm dhe librin në pozicionin e duhur gjatë kohës që lexon;<br>- tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>- shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;<br>- ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>- - pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. |

**Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale**

| |
|---|
| **Përshkrimi i tematikave të kompetencës**<br>Nxënësi/ja shkruan saktë dhe pa gabime drejtshkrimore tekste të thjeshta. Ai/ajo mbledh informacione nga burime të ndryshme para se të shkruajë kartolina, letra, plane të thjeshta, përshkrime etj. Me ndihmën e mësuesit/es, nxënësi/ja rishikon tekstin e shkruar për të shmangur gabimet drejtshkrimore. |
| Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë<br>Nxënësi/ja:<br>- shkruan për të komunikuar idetë e veta te të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive etj.;<br>- shkruan tekste të thjeshta (urim, letër, kartolinë) sipas modeleve të dhëna. |

| Njohuritë | Shkathtësitë |
|---|---|
| Njohuritë për klasën e dytë<br>- Diktime<br>- Përshkrime të thjeshta të një pikture ose fotografie<br>- Përshkrime të thjeshta të një personazhi<br>- Përshkrime të thjeshta për një njeri të afërm, një shok ose kafshë shtëpiake<br>- Rrëfim i një historie personale (gjysmë faqe)<br>- Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga disa ilustrime.<br>- Shkrimi i një kartoline<br>- Shkrimi i një letre të thjeshtë, drejtuar një shoku ose një shoqeje<br>- Shkrimi i një urimi për një ditëlindje ose me rastin e një feste<br>- Shkrimi i një plani të thjeshtë ditor | **Shkrimi i dorës**<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon dhe shkruan shkronjat e gjuhës shqipe;<br>- tregon me saktësi lidhjen shkronjë-tingull;<br>- respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive;<br>- plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive;<br>- shkruan fjalë me tri-katër rrokje;<br>- kopjon pjesë që kanë dialog, deri në 3-4 fjali;<br>- shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar;<br>- u përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.<br><br>**Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit**<br>- Nxënësi/ja:<br>- pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë;<br>- studion modele të gatshme të punëve me shkrim (p.sh., modele kartolinash, letrash, urimesh);<br>- shkruan për tema të përshtatshme për moshën e tij;<br>- shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe për një temë të caktuar);<br>- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.<br>**Të shkruarit për qëllime personale**<br>Nxënësi/ja:<br>- shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna;<br>- përshkruan me fjalët e tij/saj si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi; |
| | - shkruan hyrje dhe mbyllje të tjera të një tregimi ose përralle;<br>- përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të;<br>- rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: *Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?* |

<table>
<tr><td></td><td>Të shkruarit për qëllime funksionale<br>Nxënësi/ja:<br>- shkruan tekste të shkurtra: urim, kartolinë, letër drejtuar një shoku, duke përdorur një model të thjeshtë;<br>- harton një plan të thjeshtë të regjimit ditor.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerat dhe qëndrimet<br>Nxënësi/ja:<br>- mban gjatë të shkruarit pozicionin e duhur të trupit, dorës, fletores ose fletës ku shkruan;<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td></tr>
</table>

**Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës**

<table>
<tr><td colspan="2">Përshkrimi i tematikave të kompetencës<br>Nxënësi/ja dallon fjalitë në një tekst. Ai zhvendos, shton ose heq fjalë në një fjali pa e prishur kuptimin e saj. Nxënësi/ja dallon fjalitë pyetëse dhe dëftore, pohore dhe mohore, si dhe vendos shenjat e pikësimit në fund të tyre. Ai/ajo nis të dallojë emrin, mbiemrin, foljen, përemrin dhe numërorin. Nxënësi/ja përdor drejt shkronjën e madhe (disa raste të përdorimit të saj), ndan si duhet fjalët në fund të rreshtit, si dhe shkruan saktë numërorët 1-20.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit;<br>- dallon emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh në numrin njëjës dhe në numrin shumës;<br>- zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme, sipas modeleve të dhëna;<br>- dallon mbiemrin si fjalë që tregon cilësi të emrit;<br>- gjen dhe formon fjali me përemra vetorë dhe me numërorë.</td></tr>
<tr><td>Njohuritë</td><td>Shkathtësitë</td></tr>
<tr><td>Njohuritë për klasën e dytë<br>a) Sintaksë<br>- Tiparet e fjalisë.<br>- Fjalia dëftore dhe pyetëse (tregojmë ose pyesim).<br>- Zhvendosje e fjalëve në fjali, pa e prishur kuptimin e saj.<br>- Plotësime ose heqje fjalësh në fjali, pa e prishur kuptimin e saj.<br>b) Morfologji<br>- Njohuri të thjeshta për emrin.<br>- Gjinia e emrit (në mënyrë intuitive).<br>- Numri i emrit (në mënyrë intuitive).<br>Folja<br>- Njohuri të thjeshta për foljen.<br>- Koha e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti kohë: dje-sot-nesër.<br>- Zgjedhimi i foljeve kam dhe jam në kohën e tashme.<br>- Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme sipas modeleve të dhëna.</td><td>a) Sintaksë<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon fjalitë në një tekst;<br>- dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore dhe pyetëse, duke respektuar shenjat e pikësimit;<br>- zhvendos fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;<br>- shton dhe heq fjalë në një fjali të thjeshtë pa prishur kuptimin e saj.<br>b) Morfologji<br>Nxënësi/ja:</td></tr>
</table>

<table>
<tr>
<td>
Mbiemri<br>
- Njohuri të thjeshta për mbiemrin, si fjalë që tregon cilësi të emrave.<br><br>
Përemri<br>
- Përemri vetor.<br><br>
Numërori<br>
- Numërori.<br>
c) Drejtshkrim<br>
- Përdorimi i shenjave të pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë).<br>
- Përdorimi i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë.<br>
- Përdorimi i shkronjës së madhe për emrat e njerëzve, vendeve (qyteteve, fshatrave, shteteve) dhe kafshësh.<br>
- Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit.<br>
- Shkrimi i numërorëve 1-20.
</td>
<td>
Emri<br>
- dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh;<br>
- dallon emrat e gjinisë femërore nga ata të gjinisë mashkullore (në mënyrë intuitive);<br>
- dallon emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës (në mënyrë intuitive);<br><br>
Folja<br>
- dallon fjalët që tregojnë veprim (me ndihmën e mësuesit/es);<br>
- dallon kohën e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti kohë: dje-sot-nesër;<br>
- zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme sipas modeleve të dhëna;<br>
- zgjedhon foljet kam dhe jam në kohën e tashme;
</td>
</tr>
<tr>
<td>
d) Leksikologji dhe semantikë<br>
- Sinonimet (fjalë me kuptim të afërt ose të njëjtë).<br>
- Antonimet (fjalë me kuptim të kundërt).
</td>
<td>
Mbiemri<br>
- dallon fjalët që tregojnë cilësi të emrit (me ndihmën e mësuesit/es);
</td>
</tr>
<tr>
<td></td>
<td>
Përemri<br>
- dallon përemrat vetorë: unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato;<br>
- gjen në fjali përemrat vetorë;<br>
- ndërton fjali me përemra vetorë;<br><br>
Numërori<br>
- dallon numërorët 1-20 si fjalë që tregojnë sasi;<br>
- formon fjali me numërorë.<br>
c) Drejtshkrim<br><br>
Nxënësi/ja:<br>
- përdor drejt pikën dhe pikëpyetjen në fund të fjalisë;<br>
- përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë;<br>
- përdor drejt shkronjën e madhe për emra njerëzish, vendesh dhe kafshësh;<br>
- ndan si duhet fjalët në fund të rreshtit;<br>
- shkruan me fjalë numërorët 1-20.
</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | d) **Leksikologji dhe semantikë**<br><br>Nxënësi/ja:<br>- gjen fjalë sinonimike për një grup fjalësh të dhëna (*gjeni fjalë me kuptim të afërt ose të njëjtë*);<br>- zëvendëson në një tekst disa fjalë me sinonimet e tyre (të dhëna);<br>- gjen fjalë antonimike për një grup *fjalësh të dhëna (gjeni fjalë me* kuptim të kundërt). |
| Vlerat dhe qëndrimet<br>Nxënësi/ja:<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij;<br>- demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | |

## ❖ Udhëzime metodologjike

Metodat e të nxënit janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një proces mësimor efektiv. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor dhe letrar të nxënësve/eve. Mësuesit/et duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies, me qëllim që të zhvillojnë te nxënësit/et dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, kubimi, diagrami piramidal, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënit, pyetja sjell pyetjen, stuhi mendimi* etj., shërbejnë si nxitje për nxënësit/et në procesin e të nxënit dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënit. Gjithashtu, është e rëndësishme që **nxënësi/ja të punojë me situata të nxëni** ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si: "Pse...?", "A është gjithmonë e vërtetë...?", "Çfarë ndodh kur...?" etj. Në këtë mënyrë, ai/ajo inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij/saj dhe të ndërmarrë situata të reja. Përmes situatave të të nxënit, nxënësi/ja eksploron, zbaton dhe integron njohuritë e aftësitë gjuhësore, fiton aftësi intelektuale të nevojshme për të zhvilluar të menduarit krijues dhe kritik.

## ❖ Procesi mësimor duhet të karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

**a) Mësimdhënie me në qendër nxënësin/en**

Nxënësit/et do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve/eve. Nxënësit/et e një klase janë të ndryshëm për sa i përket mënyrës se si ata/ato nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/es, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lëndët e fushës "Gjuhët dhe komunikimi" kërkojnë që nxënësit/et të nxënë konceptet, të zhvillojnë shkathtësitë dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Këto diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të të nxënit, të cilat përshtaten me objektin e të nxënit dhe nevojat e nxënësve/eve.

## ❖ Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit/et do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve/eve. Ata/ato do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Nxënësit/et gjatë orëve të Gjuhës shqipe shpesh do të nxiten të punojnë së bashku. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve/eve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri/a-tjetrin/ën. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

## ❖ Puna me nxënësit/et me nevoja të veçanta, me vështirësi në të nxënë dhe me nxënësit/et e talentuar/a

a) **Nxënësit/et me nevoja të veçanta**
Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave (*në fusha të nxëni, në shkallë*) dhe me fokus integrimin, i krijon mësuesit/es hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësit/es dhe për të personalizuar të nxënit e tij/saj. Mësuesi/ja duhet të marrë parasysh faktin se nxënësit/et janë të ndryshëm/e, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesi/ja mund të zgjerojë zhvillimin e kompetencave kyçe sipas nevojave individuale të nxënësve/eve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.
b) **Nxënësit/et me vështirësi në të nxënë**
Shumë nxënës me vështirësi në të nxënë arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.
Në rastin e nxënësve/eve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë/a, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit/et. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve/eve.
c) **Nxënësit/et me vështirësi në gjuhën shqipe**
Nxënësit/et që vijnë kryesisht nga emigracioni, e zotërojnë gjuhën shqipe në nivele të ndryshme. Meqenëse programi është për të gjithë nxënësit/et, ata/ato me vështirësi në gjuhën shqipe duhet të arrijnë rezultatet e të nxënit si të gjithë nxënësit/et e tjerë/a. Këtyre nxënësve/eve duhet t'u jepet mbështetje në formën e kohës shtesë, aq sa u duhet për të mësuar mirë gjuhën shqipe ose t'u ofrohen kurse formale nga shkolla përgjatë vitit shkollor ose gjatë pushimeve verore.
d) **Nxënësit e talentuar**
Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve/eve të talentuar. Mësuesit/et duhet t'u krijojnë nxënësve/eve kushte dhe situata të tilla që të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe të zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

## ❖ Udhëzime për leximin e teksteve letrare dhe teksteve joletrare

Gjatë mësimit të gjuhës shqipe nga klasa e parë deri në klasën e pestë, nxënësit/et do të lexojnë tekste letrare dhe joletrare.
Për sa i përket përfaqësimit të teksteve letrare dhe teksteve joletrare, gjatë dy shkallëve të para këshillohet të respektohen afërsisht raportet **70% me 30%.**
Për leximet e teksteve letrare këshillohet të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe letërsia botërore, në përshtatje me moshën dhe zhvillimin e fëmijëve. Këto tekste duhet të plotësojnë kriteret artistike dhe didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe të qartësisë së gjuhës.
Këshillohet që nxënësit/et të lexojnë fragmente dhe vepra nga periudha të ndryshme letrare, nga letërsia antike deri tek ajo bashkëkohore, përfshirë këtu edhe krijimtarinë gojore folklorike.

### Leximet jashtë klase

Këshillohet që përgjatë një viti shkollor të zhvillohen 3-4 vepra ose pjesë për lexime jashtë klase. Orët e leximeve jashtë klase, mësuesit/et duhet t'i vendosin në planin e tyre mësimor, kur të bëjnë zbërthimin analitik të programit. Është e rëndësishme që gjatë këtyre orëve, nxënësve/eve t'u krijohet mundësia të zgjedhin edhe vepra që janë të pëlqyera e të preferuara për ta.
Veprat e rekomanduara për lexime jashtë klase duhet të jenë:
- nga letërsia shqipe dhe letërsia botërore;
- nga autorë të periudhave të ndryshme;
- nga gjini dhe lloje të ndryshme letrare.

Përzgjedhja e leximeve jashtë klase nga autorë të ndryshëm, nga periudha të ndryshme dhe nga gjini e lloje të ndryshme letrare, krijon mundësi për pasurimin e përvojës letrare të nxënësve/eve.

## ❖ Udhëzime për vlerësimin

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit/et të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve/eve në procesin e të nxënit dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien. Vlerësimi i nxënësve/eve për fushën "Gjuhët dhe komunikimi" ka për synim matjen e kompetencave të fushës, të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënit.

**Llojet e vlerësimit**

**Vlerësimi diagnostikues** zakonisht kryhet në fillim të shkallës, vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit/et rreth asaj për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikat e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënit e nxënësve/eve në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

**Vlerësimi i vazhdueshëm** është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon nxënësit/et e mësuesit/et mbi progresin e nxënësve/eve. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të të nxënit. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësit/es.

| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe *për* gjërat *që i duken interesante;*<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;<br>• bën parashikime për vazhdimin e ngjarjes sipas imagjinatës;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | **Situata e të nxënit**<br>Si jeni ndier ditën e parë të shkollës?<br>- Duke ndërvepruar me tekstin, nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit në lidhje me emocionet që sjell dita e parë e shkollës;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, fotografi;<br>- mjete shkollore (lapsa, fletore, vizore, etj.). | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- teknologjia dhe TIK-u;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare:**<br>- të drejtat e njeriut. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- diskutim për njohuritë paraprake;
- lexim dhe mendim i drejtuar,

- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- *Diskutim për njohuritë paraprake.* Mësuesi/ja drejton pyetjen: - *Si jeni ndier një ditë para fillimit të shkollës?*

Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe ndajnë ndjenjat dhe emocionet e tyre me shokun/shoqen dhe gjithë klasën.

- *Lexim dhe mendim i drejtuar*. Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe drejton nxënësit/et për të plotësuar ushtrimin në krye të faqes. Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit të ndarë në pjesë (2-3 pjesë) Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante në secilën pjesë. Mësuesi/ja gjatë diskutimit me nxënësit/et punon fjalorin për çdo pjesë, pyetjet rreth përmbajtjes dhe bën parashikime për pjesën në vazhdim. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të shpjegojnë parashikimin e bërë, duke treguar si e sa ndikojnë ilustrimet në të.
- Në përfundim të punimit të të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë. Gjatë rileximit, nxënësit/et do të nënvizojnë emrat e sendeve që vajza futi në çantën e shkollës dhe do të plotësojnë ushtrimet në rubrikën “Shkruaj”.

Këtë detyrë nxënësit/et mund ta përfundojnë edhe në shtëpi.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe *për* gjërat që u duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- parashikimet për vazhdimin e ngjarjes sipas imagjinatës, si dhe për shpjegimin e argumentuar të parashikimit të bërë;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

<table>
<tr><td>Fusha:<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda:<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Nesër në shkollë (ora II)</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- dita para fillimit të shkollës;<br>- emocion;<br>- mjete shkollore;<br>- çantë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin;<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin, nxënësit/et diskutojnë për emocionet që sjell dita e parë e shkollës.</td></tr>
</table>

| **Burimet dhe materialet didaktike:** | **Lidhja me fushat e tjera:** |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, fotografi;<br>- mjete shkollore (lapsa, fletore, vizore etj.). | - artet;<br>- teknologjia dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare:**<br>- të drejtat e njeriut. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- lexo, përmblidh në dyshe;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësimi fillon me një bisedë me gjithë klasën, ku nxënësit/et shprehin me 2-3 fjali përshtypjet e tyre për ditën e parë të shkollës. Më pas, ata/ato do të flasin për Jehonën, personazhin e kësaj pjese, për cilësitë e saj, veprimet që ajo bën.
- Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir. Vazhdohet me punën në çift "Lexo, përmblidh në dyshe", ku nxënësit/et lexojnë çdo paragraf të përcaktuar nga mësuesi/ja, duke e përmbledhur me 1-2 fjali.
- Nxënësit/et do të tregojnë ngjarjen dhe do të japin përshtypjet e veta në lidhje me tekstin (u pëlqen apo jo; cila pjesë u duket më interesante dhe pse; sa lidhet pjesa me jetën e tyre etj.).

**Vlerësimi bëhet për:**
- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit;
- leximin rrjedhshëm dhe me intonacion **të tekstit**;
- ndarjen e përvojave rreth leximit
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit;
- mendimet që jep secili rreth tekstit.

| **Fusha:**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda:**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore:**<br>Orkestra gazmore | **Fjalët kyçe:**<br>- orkestër;<br>- vegël muzikore;<br>- klasë;<br>- provë;<br>- kitarë, violinë, piano, violonçel, trombë, klarinetë;<br>- artistë. |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>**Nxënësi/ja:**<br>• tregon elementet e vjershës, si strofa dhe vargu;<br>• parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, tek ilustrimet dhe te fjalët kyçe të tekstit; | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin, nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë poezinë;<br>- rreth interpretimeve të tyre në lidhje me argëtimin dhe kënaqësinë e lojës me vegla muzikore; |

| | |
|---|---|
| • lexon dhe interpreton vjershën;<br>• tregon që e ka kuptuar vjershën duke plotësuar fjalitë rreth brendisë së saj;<br>• shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth vjershës. | - rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi te nxënësit/et.<br><br>Orkestër me vegla muzikore. |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>– teksti mësimor;<br>– informacione nga interneti, fotografi, instrumente muzikore, lodra muzikore. | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- teknologjia dhe TIK-u;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare:**<br>- identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia**: parashikim me terma paraprakë, lexim zinxhir "Ruaje fjalën e fundit për mua", diskutim, bisedë, punë individuale, punë në çift, punë në grup**,** punë me gjithë klasën, rishikim në dyshe.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët kyçe: orkestër, vegël muzikore, klasë, provë. Nxënësit/et shohin figurën , lexojnë titullin e fjalët kyçe dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e vjershës duke punuar në çift. I shkruajnë parashikimet e tyre në fletë. Nxënësit/et lexojnë parashikimet e tyre. Lexohet vjersha në heshtje. Nxënësit/et tregojnë ndryshimet e përmbajtjes së vjershës dhe parashikimit që i kanë bërë.
- Lexohet vjersha zinxhir, sipas vargjeve dhe stofave .
- Punohet rubrika "Fjalë të reja". Shpjegohet kuptimi i fjalës *orkestër* dhe i çdo fjale tjetër të re për ta. Për këtë përdoret fjalori i dhënë në libër ose shpjegimet që vetë nxënësit/et bëjnë për këto fjalë.
- Rishikim në dyshe: punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Individualisht, nxënësit/et bëjnë nënvizimet e emrave të veglave muzikore. Plotësojnë fjalitë e paplota dhe në çift shkëmbejnë librat për të vlerësuar njëri-tjetrin.
- Nëpërmjet metodës "Ruaje fjalën e fundit për mua", ngrihet pyetja: Cila vegël muzikore ju pëlqen më shumë dhe pse? Të ndarë në grupe të vogla me 4-5 anëtarë/e, nxënësit/et përzgjedhin një vegël muzikore që u pëlqen më shumë . Shkruajnë emrin e saj në një fletë dhe nga ana tjetër e fletës shkruhet arsyeja përse e pëlqejnë. Një nga nxënësit/et lexon emrin e veglës muzikore që ka zgjedhur dhe kërkon nga shokët/shoqet e grupit të japin komentin e tyre për të. Ai/ajo vetë lexon i/e fundit komentin e tij/saj dhe të gjithë bien dakord me arsyet e zgjedhjes së tij/saj. Kjo është dhe fjala e fundit, pas së cilës vazhdohet në të njëjtën mënyrë me të gjithë anëtarët/et e grupit.
- Nxënësit/et ngjyrosin veglat muzikore dhe shkruajnë emrat e tyre në rubrikën "Shkruaj". Kjo detyrë punohet individualisht dhe nxënësit/et shkëmbejnë librat për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**
- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;
- tregimin e elementeve të vjershës, si strofa dhe vargu;
- parashikimin rreth përmbajtjes së vjershës duke u mbështetur te titulli, tek ilustrimet dhe te fjalët kyçe të tekstit.
- leximin dhe interpretimin e vjershës;
- plotësimin e fjalive rreth brendisë së vjershës;
- shprehjen e ndjenjave dhe të mendimeve personale rreth vjershës.

**Detyrë shtëpie:**

Vizato një vegël muzikore popullore dhe shkruaj emrin e saj.

| **Fusha:** Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda:** **Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore:**
**Alfabeti i gjuhës shqipe**

**Fjalët kyçe:**
alfabet, shkronjë, rend alfabetik.

**Rezultatet e të nxënit**
**Nxënësi/ja:**
- shkruan shkronjat e alfabetit sipas rendit të tyre;
- rendit dhe shkruan fjalë sipas rendit alfabetik;
- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerëson punët e të tjerëve;
- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

**Situata e të nxënit**
Renditja e shkronjave, e fjalëve, e emrave të shokëve/shoqeve sipas alfabetit.

**Burimet dhe materialet didaktike:**
- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;
- teksti mësimor;
- informacione nga interneti, fjalorë të ndryshëm, mjete shkrimi, fletë në formatin A4.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- artet;
- teknologji dhe TIK.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, rishikim në dyshe, tryezë e rrumbullakët, diskutim, bisedë, punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me të gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Stuhi mendimesh - Alfabeti i gjuhës shqipe. Ftohen nxënësit/et të tregojnë çfarë dinë për alfabetin e gjuhës shqipe. Mësuesi/ja shkruan mendimet e nxënësve/eve në tabelë.
- Rishikim në dyshe. Nxënësit/et plotësojnë individualisht në libër shkronjat që mungojnë në ushtrimin 1. Pasi përfundojnë, shkëmbejnë librat dhe kontrollojnë njëri -tjetrin nëse i kanë shkruar saktë.
- Lexim zinxhir (ushtrimi 2). Lexohet zinxhir nga e gjithë klasa alfabeti i gjuhës shqipe, të cilin e plotësuan në ushtrimin 1.
- Tryezë e rrumbullakët. Të organizuar në grup, nxënësit/et shkruajnë fjalët e dhëna në ushtrimin 3 sipas rendit alfabetik. Grupet shkëmbejnë punët me njëri- tjetrin dhe bëjnë vlerësime. I shkruajnë në fletore individualisht fjalët e renditura (ananas, bukë, domate, dritë, grurë,kompjuter, libër, misër, mollë, shkronjë, tavolinë, vazo).
- Rishikim në dyshe. Plotësohet individualisht nga nxënësit/et ushtrimi 4. Në këtë ushtrim renditen fjalët që fillojnë me të njëjtën shkronjë, kështu që mësuesi/ja kujdeset që nxënësit/et të nisen nga shkronja e dytë për të bërë renditjen (bar, besë, birrë...). Shkëmbehen librat në çift e kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.
- Të ndarë në grupe, nxënësit/et përgatitin etiketa me emrat e tyre. I renditin etiketat e emrave sipas rendit alfabetik. Kontrollojnë punën e grupit që kanë më afër dhe shohin si e kanë realizuar punën.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;
- shkrimin e shkronjave dhe fjalëve sipas rendit alfabetik;
- renditjen e fjalëve sipas rendit alfabetik;
- drejtshkrimin e fjalëve.

**Detyrë shtëpie:** Ushtrimi 5. Nxënësit/et shkruajnë alfabetin dhe nga një fjalë për secilën shkronjë.

<table>
<tr><th>Fusha:<br>Gjuhët dhe komuni-<br>kimi</th><th>Lënda:<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Një shok i ri (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>shok i ri, prezantoj, emigrimi, i veçantë, element i tekstit, tipar i tregimit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- lexon tregimin duke mbajtur shënim fjalët e reja dhe shprehjet që i pëlqejnë më shumë;<br>- tregon elementet e tekstit, si p.sh., paragrafi;<br>- pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>- dallon që e ka kuptuar tekstin e lexuar, duke gjetur alternativën e duhur në lidhje me brendinë e pjesës;<br>- përcakton dy-tri tipare të tregimeve;<br>- shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin, nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata/ato e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit në lidhje me dashamirësinë e ndihmën që duhet t'u japin shokëve/shoqeve të rinj/reja në klasë;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, fotografi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- artet, teknologjia dhe TIK-u, shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- të drejtat e njeriut;<br>- bashkëjetesa paqësore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia: imagjinatë e drejtuar, lexim zinxhir, diskutim, rishikim në dyshe, punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Imagjinatë e drejtuar. Nxënësit/et ftohen në diskutim rreth një situate të imagjinuar:<br>- Nëse do t'ju duhet të ndërronit shkollë, si do të ndiheshit dhe pse?<br>- Si do të donit të silleshin shokët/shoqet e rinj/reja të klasës dhe mësuesi/ja me ju?<br>• Paraqitet titulli i pjesës së leximit. Lexohet në heshtje pjesa nga nxënësit/et dhe nxiten të nënvizojnë fjalët e reja dhe shprehjet që u pëlqejnë më shumë.<br>• Punë në çift: Nxiten nxënësit/et të bëjnë pyetje rreth fjalëve të reja për ta dhe thonë fjalët, të cilat u kanë pëlqyer më shumë duke ndërvepruar në çift. Lexojnë në rubrikën e "Fjalë të reja" shpjegimin e fjalës emigrim dhe diskutojnë me gjithë klasën si e njohin ata këtë fenomen shoqëror (nëse kanë të afërm në emigrim, kanë shkuar me familjet e tyre etj.).<br>• Lexohet pjesa zinxhir nga nxënësit/et sipas paragrafëve.<br>• Diskutohet për llojin e pjesës dhe karakteristikat e saj (është tregim , trajtohen ngjarje që kanë ndodhur apo mund të ndodhin në jetën reale).<br>• Rishikim në dyshe: Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Nxënësit/et shënojnë me shenjat përkatëse nëse fjalitë janë të sakta apo të gabuara referuar pjesës . Shkëmbejë librat me njëri-tjetrin për të vlerësuar punën e njëri -tjetrit.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;<br>- njohjen e elementeve të tekstit (paragrafi);<br>- leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që u pëlqejnë më shumë;<br>- pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>- përcaktimin e dy-tri tipareve të tregimeve<br>- shfaqjen e besimit dhe të vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Një shok i ri (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>shok i ri, prezantoj, emigrimi, i veçantë, element i tekstit, tipar i tregimit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br><br>- Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit<br>- Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara; luan me role pjesën.<br>Ndërton vazhdimin e tregimit sipas imagjinatës së tij<br>- Shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;<br>- Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>- Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin, nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata/ato e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit në lidhje me dashamirësinë e ndihmën që duhet t'u japin shokëve/shoqeve të rinj/reja në klasë;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Harta e personazheve, Lojë me role, Diskutim, Bisedë, Punë individuale, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën<br><br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Harta e personazheve: Në grup nxënësit/et shkruajnë cilësitë e personazhit të pjesës. Ata për çdo cilësi tregojnë/lexojnë pjesën në tekst ku ajo del në pah.<br>• Diskutim: Së bashku me të gjithë klasën diskutohet për nxënësit/et e rinj që mund të kenë ardhur në klasën e tyre, për mënyrën se si i kanë pritur dhe si janë sjellë me këta nxënës. Gjithashtu diskutojnë se çfarë do të ndryshonin në sjelljen e tyre nëse do të kishte diçka për të përmirësuar.<br>• Punë në dyshe: Nxënësit/et në dyshe punojnë për të bërë vazhdimin e këtij tregimi. Mund të shkruhet me 2-3 fjali në një fletë. Lexohen disa prej punëve dhe i diskutojnë së bashku me gjithë klasën.<br>• Lojë më role: Nxënësit/et sipas grupeve luajnë me role pjesën duke shtuar dhe vazhdimin e tregimit që përgatitën në veprimtarinë e mësipërme.<br>• Grupet e nxënësve vlerësojnë njëri-tjerin për lojën me role si dhe mesazhin që përcollën .<br>• Nxënësit/et vlerësojnë njëri- tjetrin për bashkëpunimin dhe pranimin e ideve të të tjerëve.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;<br>- shprehjen e ndjenjave dhe të mendimeve personale rreth pjesës që lexon;<br>- përshkrimin e personazheve, lojën me role, vazhdimin e tregimit sipas imagjinatës;<br>- ndarjen e përvojave të tij me të tjerët.</td></tr>
</table>

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | Lënda<br>**Gjuha shqipe** | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Nga fjala tek fjalia (ora e parë)** | **Fjalë kyçe**<br>fjala, fjalia, lidhje kuptimore, rendit |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon tiparet e fjalisë;<br>- rendit fjalët për të ndërtuar fjali me kuptim.<br>- dallon fjalitë e ndërtuara drejt;<br>- përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, si dhe pikën në fund të saj;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | **Situata e të nxënit**<br>Renditja dhe lidhja me njëra me tjetrën e fjalëve për të ndërtuar fjali të kuptimta. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- fisha me fjalë, lapustila, stilolaps, shirita. letre | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** diskutim, rishikim në dyshe, punë individuale, punë në çift, punë në grup**,** Punë me gjithë klasën**.**

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Veprimtari në dyshe: Mësuesi/ja ka përgatitur fisha me fjalë, të cilat duke u renditur drejt formojnë një fjali. Nxënësit/et punojnë së bashku në dyshe për të ndërtuar fjalinë e rregullt. Lexohen fjalitë e ndërtuara dhe nxënësit/et e tjerë/a gjykojnë nëse janë fjali të kuptimta.
- Diskutim: Pasi diskutojnë në grupe tregojnë se çfarë është një fjali duke iu referuar veprimtarisë së mësipërme dhe përpjekjeve për të ndërtuar një fjali të kuptimtë.
- Rishikim në dyshe: Nxënësit/et punojnë individualisht për ushtrimin 1. Ata/ato shohin figurat dhe thonë titujt e përrallave që tregojnë ilustrimet. Renditin fjalët dhe i shkruajnë fjalitë që formuan poshtë figurës. Shkëmbejnë librat ndërmjet tyre dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Punë në grup: Nxënësit/et shkruajnë me lapustila në një tabak A3 të gjitha mënyrat se si i kanë renditur fjalët e ushtrimit 1 për të krijuar fjali të kuptimta. Nxënësve/eve u kërkohet që shkronja e madhe në fillim të saj dhe shenja e pikës te shkruhen me lapustila të tjera për t'u dalluar.
- Grupet vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;
- tregimin e tipareve të fjalisë;
- renditjen e fjalëve për të ndërtuar fjali me kuptim;
- dallimin e fjalive të ndërtuara drejt
- përdorimin e drejtë të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë;
- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Nga fjala tek fjalia (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- fjala;<br>- fjalia;<br>- lidhje kuptimore;<br>- rendit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br><br>- tregon tiparet e fjalisë;<br>- rendit fjalët për të ndërtuar fjali me kuptim;<br>- dallon fjalitë e ndërtuara drejt;<br>- përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, si dhe pikën në fund të saj;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Renditja dhe lidhja e fjalëve me njëra me tjetrën, për të ndërtuar fjali të kuptimta.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- fisha me fjalë, lapustila, stilolaps, shirita letre.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>- shkëmbe një problemë;<br>- tryezë e rrumbullakët;<br>- diskutim;<br>- punë individuale;<br>- punë në çift;<br>- punë në grup;<br>- punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Shkëmbe një problem: Nxënësit/et, sipas grupeve, përgatitin etiketa me fjalë, të cilat, po të renditen si duhet, formojnë një fjali. Këto etiketa i shkëmbejnë me grupin fqinj. Secili grup përpiqet që të ndërtojë fjalinë me etiketat e fjalëve që ka përgatitur grupi fqinj. Lexohen fjalitë e formuara dhe grupet vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br><br>• Nxënësit/et vëzhgojnë poshtë ushtrimit 1 figurat, pyetjet dhe fjalët që i korrespondojnë secilës pyetje. nxënësit/et diskutojnë në çift dhe për fjalë të tjera që mund t'i shtohen kësaj fjalie, p.sh një fjalë për t'iu përgjigjur pyetjes: Kur?<br>• Rishikim në dyshe:Ushtrimin e dytë nxënësit/et e plotësojnë individualisht. Shkruajnë fjalët dhe më pas fjalinë. Shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin për të kontrolluar shokun/shoqen dhe veten.<br>• Tryezë e rrumbullakët: Nxënësit/et, të ndarë me nga 5 individë, sipas grupeve, vendosen në formë rrethore. Secili i përgjigjet njërës prej pyetjeve të ushtrimit 2. Pasi përfundojnë të gjithë, nxënësit/et hapin fletën e lexojnë fjalinë. Pasi e përfundojnë punën, shkëmbejnë fletën me grupin që kanë afër dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.<br>• Individualisht punojnë për ushtrimin 3.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- tregimin e tipareve të fjalisë;<br>- renditjen e fjalëve për të ndërtuar fjali me kuptim;</td></tr>
</table>

| |
|---|
| - dallimin e fjalive të ndërtuara drejt;<br>- përdorimin e drejtë të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë;<br>- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;<br>- respektimin dhe vlerësimin që tregon për përpjekjet individuale dhe në grup të shokëve. |

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Me se shkruajmë (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>komunikim, figura objektesh, figura kafshësh, papirus, pergamen, pendë, letra, penë boje, laps, stilograf, stilolaps, kompjuter</td></tr>
<tr><td colspan="2">- Rezultatet e të nxënit<br>- Nxënësi/ja:<br>- lexon tekstin joletrar, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>- pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>- rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë pjesën;<br>- lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tij;<br>- tregon interes dhe dëshirë për të lexuar.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit/et diskutojnë për :<br>- mënyrën se si ata/ato bëjnë lidhjen e pjesës me përdorimin e mjeteve të ndryshme të shkrimit në jetën e përditshme;<br>- interpretimin e tyre në lidhje me faktet që sjell pjesa, me informacionet, kuriozitetet e sjella nga vetë ata/ato për mjetet e shkrimit;<br>- parashikimet për zhvillimin e teknologjisë në lidhje me mjetet e shkrimit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor, informacione nga interneti, foto, enciklopedi;<br>- letër A4, mjete shkrimi (lapsa, stilolapsa, stilograf, pendë shkrimi, penë etj.).</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- lëviz, ndalo, krijo dyshe;
- role të specializuara në diskutim;
- diskutim,bisedë;
- punë individuale;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Nxënësit/et janë porositur më parë që të kërkojnë e të gjejnë informacione, kuriozitete për mjetet e shkrimit që kanë përdorur njerëzit gjatë gjithë historisë së tyre.

- *Lëviz, ndalo, krijo dyshe*: Kjo veprimtari bëhet me gjithë klasën. Mësuesi/ja ka përgatitur pyetjen :
  - Cilat janë mjetet e shkrimit që janë përdorur në kohë të ndryshme të zhvillimit të njerëzimit? Nxënësit/et lëvizin lirshëm nëpër klasë, derisa marrin komandën "ndalo". Ata/ato qëndrojnë në vend dhe krijojnë dyshe me personin më të afërt dhe tregojnë së bashku mjetet e shkrimit që njohin.
- Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit.
- Nxënësit/et lihen që të lexojnë pjesën (me paragrafë) në heshtje. Ata/ato nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë, si dhe informacionet që u duken më interesante. Pas leximit të çdo paragrafi diskutojnë me mësuesen për fjalët e reja, si dhe për informacionet që u bënë përshtypje. Atyre u lihet kohë ta rilexojnë pjesën, për ta kuptuar më mirë atë.

- *Role të specializuara në diskutim*: Nxënësit/et marrin nga një rol, të cilin e përcakton mësuesi/ja:
  - *Gjetësi i citimeve*: duhet të zgjedhë pjesë të caktuara nga teksti.
  - *Hulumtuesi*: ka për detyrë të japë informacion paraprak për mjetet e shkrimit.
  - *Bërësi i pyetjeve*: duhet të shkruajë pyetje që dëshiron t'i diskutojë me të tjerët.
  - *Gjetësi i fjalëve*: duhet të gjejë fjalë të rëndësishme për të diskutuar.
  - *Ilustruesi*: duhet të bëjë ilustrimin e mjeteve të ndryshme të shkrimit.

*Gjurmuesi*: ka për detyrë të gjejë në hartë vendet e lashta ku janë përdorur mjetet e para të shkrimit. Grupet paraqesin materialet, të cilat i kanë punuar në grup.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit joletrar, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- tregimin e interesit dhe të dëshirës për të lexuar tekstin;
- pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- nënvizimin e pjesëve më të rëndësishme ose pjesëve që i pëlqejnë më shumë;
- lidhjen e pjesës që lexon me përvoja nga jeta e tij/saj.

**Detyrë shtëpie:**

Gjeni dhe sillni kuriozitete për mjetet e të shkruarit.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Me se shkruajmë (ora e dytë)** | **Fjalë kyçe:**<br>- komunikim;<br>- figura objektesh;<br>- figura kafshësh;<br>- papirus;<br>- pergamenë;<br>- pendë; letra, penë boje, laps, stilograf, stilolaps;<br>- kompjuter. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- lexon tekstin joletrar;<br>- tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>- pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>- lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tij etj.;<br>- ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve që kanë të tjerët rreth tekstit. | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin, nxënësit/et diskutojnë për:<br>- mënyrën se si ata/ato e bëjnë lidhjen e pjesës me përdorimin e mjeteve të ndryshme të shkrimit në jetën e përditshme;<br>- interpretimin e tyre në lidhje me faktet që sjell pjesa dhe informacionet, kuriozitetet e sjella nga vetë ata/ato;<br>- parashikimet për zhvillimin e teknologjisë në lidhje me mjetet e shkrimit. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor, informacione nga interneti, foto, enciklopedi;<br>- letër A4, mjete shkrimi(lapsa, stilolapsa, stilograf, pendë shkrimi, penë etj.). | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia**:
- lexo, përmblidh në dyshe;
- diskutim, bisedë, rrjetë diskutimi;
- punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- *Lexo përmblidh në dyshe*: Nxënësit/et lexojnë në dyshe çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ata konfirmojnë ato që kanë mësuar një orë më parë, si dhe kanë mundësi të përdorin lloje të ndryshme të të menduarit.
- *Punohet për rubrikën"Reflektoj"*: Nxënësit/et u përgjigjen dy pyetjeve të para dhe japin parapëlqimet e tyre se me çfarë u pëlqen të shkruajnë. Ata/ato japin mendimet e tyre në lidhje me kompjuterin si një mjet që i ka konkurruar të gjitha mjetet e tjera.
- *Për pyetjen e tretë përdoret "Rrjetë diskutimi"*: Çdo dyshe shkruan të paktën një argument për secilën anë. Lexohen argumentet dhe dilet në një qëndrim të përbashkët.
- Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit joletrar;
- interesin dhe dëshirën për të lexuar pjesën;
- pranimin e ideve të të tjerëve për tekstin;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre .

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shkruaj një letër (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- letër;<br>- fjalët hyrëse të letrës;<br>- përmbajtje e letrës;<br>- fjalët që mbyllin letrën;<br>- postë elektronike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon pjesët e një letre;<br>- përcakton karakteristikat për secilën pjesë të letrës;<br>- shkruan letër për një shok/shoqe, duke përdorur një model të thjeshtë;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Shkrimi i një letre për një shok.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nx-ënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, enciklopedi;<br>- letërA4, mjete shkrimi, lapustila.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- të drejtat e njeriut;<br>- bashkëjetesa paqësore.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**<br><br>**Metodologjia:**<br>- rishikim në dyshe;<br>- hartë konceptesh;<br>- diskutim, bisedë;<br>- punë individuale;<br>- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>**Veprimtaritë e nxënësve**<br>• *Hartë konceptesh*: Nxënësit/et bëjnë në dyshe një hartë konceptesh për letrën (llojet e letrës, pjesët e letrës, mënyrat e dërgimit të letrës etj.).<br>• Mësuesi/ja bën një hartë konceptesh në tabelë, duke u mbështetur tek ajo që nxënësit/et kanë bërë në dyshe dhe e plotëson, duke dëgjuar punët e tyre.<br>• *Lexohet situata e dhënë në libër* dhe nxënësit/et sjellin përvoja të ngjashme nga jeta e tyre. Ata/ato tregojnë tri pjesët e letrës, pasi e lexojnë me vëmendje atë. Mësuesi/ja, gjatë diskutimit thekson, karakteristikat për secilën pjesë të letrës.<br>• *Punë në grup*: Nxënësit/et përcaktojnë karakteristikat për secilën pjesë të letrës: Hyrja e letrës fillon me fjalët..., vendoset presje në fund të saj... Renditen në tabelë këto karakteristika pasi dëgjohet puna e bërë në grupe.<br>• *Rishikim në dyshe*: Shkruajnë përgjigjen e letrës individualisht . Ngjyrosin pjesët e letrës me ngjyra të ndryshme në përfundim të shkrimit të letrës. Shkëmbehen letrat midis dysheve për të vlerësuar nëse është shkruar sipas modelit dhe nëse janë përcaktuar saktë pjesët e letrës me ngjyrosje.<br><br>**Vlerësimi bëhet për:**<br>- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;<br>- shkrimin e një letre drejtuar një shoku/shoqeje, duke përdorur një model të thjeshtë;<br>- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br><br>**Detyrë shtëpie:**<br>Shkruaj një letër për një shok/shoqe. |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Shkruaj një letër (ora e dytë)** | | **Fjalë kyçe:**<br><br>- letër;<br>- fjalët hyrëse të letrës;<br>- përmbajtja e letrës;<br>- fjalët që mbyllin letrën;<br>- postë elektronike. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon pjesët e një letre;<br>- përcakton karakteristikat për secilën pjesë të saj;<br>- shkruan një letër drejtuar një shoku/shoqeje, duke përdorur një model të thjeshtë;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- shfaq shpirtin krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një letre për një shok/shoqe. | |

| **Burimet dhe materialet didaktike:** | **Lidhja me fushat e tjera:** |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, enciklopedi;<br>- letër A4, mjete shkrimi, lapustila. | - artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare:**<br>- të drejtat e njeriut;<br>- bashkëjetesa paqësore. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- imagjinatë e drejtuar;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- *Imagjinatë e drejtuar:* Në sfond vendoset muzikë dhe nxënësit/et mbyllin sytë. Mësuesi/ja flet, duke i vendosur nëpërmjet imagjinatës nxënësit/et në një ishull të mrekullueshëm e të largët. Ata dëshirojnë të komunikojnë me miqtë e tyre, por kanë mundësi të shkruajnë vetëm letër.
- Nxënësit/et, nisur nga kjo imagjinatë, shkruajnë letër për një shok/shoqe sipas dëshirës së tyre.
- Këtë letër mund ta shkruajnë dhe në kompjuter, pasi mësuesi/ja i orienton për mënyrën se si të shkruajnë dhe të dërgojnë një letër me postë elektronike.

  *Diskutim*: Lexohen letrat nga nxënësit/et. Diskutohet me ta rreth brendisë së letrës dhe përcaktimit të pjesëve, si dhe karakteristikave të secilës prej tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit;
- shkrimin e një letre drejtuar një shoku/shoqeje, duke përdorur një model të thjeshtë;
- shfaqjen e besimit, të vullnetit dhe të shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punëve të të tjerëve.

**Detyrë shtëpie:**

Shkruaj një letër për shokun e dërgoje në postë elektronike.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Kompjuteri (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- kompjuter;<br>- llogaritje;<br>- pjesë;<br>- tastierë, mi i kompjuterit, njësi qendrore;<br>- ekran, printer.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përdorimi i kompjuterit.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| • pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• komenton ilustrimin e tekstit;<br>• i përgjigjet pyetjeve në lidhje me brendinë e pjesës;<br>• tregon interes dhe dëshirë për të lexuar. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, foto, enciklopedi;<br>- kompjuter. | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- hartë konceptesh;
- veprimtari e leximit të drejtuar (VLM);
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Nxënësit/et janë porositur më parë që të sjellin informacione dhe kuriozitete për kompjuterin.

- *Hartë konceptesh*: Nxënësit/et ndërtojnë, sipas grupeve, një hartë konceptesh për kompjuterin: pjesët e kompjuterit, veprimet me kompjuter etj. dhe lexojnë punët që kanë bërë në grup.
- *Veprimtaria e leximit të drejtuar (VLM )*: Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit/et të lexojnë pjesën të ndarë sipas paragrafëve. Ata/ato i nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët interesante për ta. Për secilin paragraf sqarohen fjalët e reja që nxënësit/et kanë nënvizuar. Mësuesi/ja bën pyetje për brendinë në secilin prej paragrafëve.
- Nxënësit/et shkruajnë individualisht në fletore veprime, të cilat mund t'i bëjnë me kompjuter.
- Ata/ato diskutojnë rreth rregullave që ndjekin kur bëjnë këto veprime me kompjuter dhe mbajnë qëndrime.

**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin dhe për mbajtjen e shënimeve *për fjalë e fakte interesante për ta*;
- pyetjet që bëjnë për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura.
- komentimin e ilustrimit të tekstit.
- interesin dhe dëshirën qe tregon për të lexuar.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe dhe vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit. .

**Detyrë shtëpie:**

Bëj një vizatim me kompjuter

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br><br>Kompjuteri (ora e dytë). | | **Fjalë kyçe:**<br>- kompjuter;<br>- llogaritje;<br>- pjesë;<br>- tastierë;<br>- mi i kompjuterit, njësi qendrore, ekran;<br>- printer. | |

| **Rezultatet e të nxënit** | **Situata e të nxënit** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br>- tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>- ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>- lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>- tregon brendinë, duke respektuar strukturën e tekstit;<br>- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | Përdorimi i kompjuterit |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, foto, enciklopedi;<br>- kompjuter. | **Lidhja me fushat e tjera:**<br><br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- Lexim, përmbledhje në dyshe
- Tryezë e rrumbullakët
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

- *Lexim, përmbledhje në dyshe*: lexohet pjesa sipas paragrafëve nga njëri/a nxënës/e dhe përmblidhet nga tjetri/a me 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafin në vazhdim.
- Tregohet në dyshe përmbajtja e pjesës.
- *Bisedë, rubrika "Reflektoj"*: Nxënësit/et zhvillojnë bisedë për përdorimet që ka kompjuteri në jetën e tyre të përditshme, si dhe nëse u pëlqen të merren me të.
- *Tryezë e rrumbullakët*: Nxënësit/et, të vendosur në formë rrethore, sipas grupeve, shkruajnë emrin e një loje që luajnë në kompjuter. Letra paloset në formë fizarmonike dhe hapet pasi përfundojnë të gjithë. Ata/ato flasin rreth këtyre lojërave.
- *Punë në dyshe*: Nxënësit/et rendisin disa rregulla për përdorimin e kompjuterit që u kanë thënë të rriturit. Japin mendimet e tyre rreth këtyre rregullave duke i argumentuar ato.
- Punë në dyshe, grup (sipas numrit të kompjuterëve që kanë). Udhëzohen nxënësit/et të bëjnë njërën prej veprimtarive me kompjuter (gjetjen e informacione, lojëra, shkrime të thjeshta, dërgim letre me postë elektronike etj)

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe dhe vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- interesin dhe dëshirën që shfaq për të lexuar;
- leximin rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit;
- tregimin e brendisë, duke respektuar strukturën e tekstit;
- ndarjen e përvojave të tij/saj rreth leximit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie:**

Shkruaj një tekst të shkurtër me kompjuter ( 3-4 fjali).

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Fjalia(ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>Fjalia, lidhje kuptimore, fjalë, shkronjë e madhe, pikë, pikëpyetje, pikëçuditje | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon tiparet e fjalisë;<br>- dallon fjalitë nga jofjalitë;<br>- **përdor** shenjat e pikësimit (pikën) në fund të fjalisë;<br>- përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | | **Situata e të nxënit**<br>Ndërtimi i fjalive, duke renditur fjalët sipas kuptimit. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A3, mjete shkrimi**,** fisha me fjalë, lapustila, shirita letre. | | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:**
**-** Hartë konceptesh
- Shkëmbe një problemë
- diskutim;
- bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

*Veprimtari në dyshe*. Mësuesi/ja ka përgatitur fisha me fjalë, të cilat duke u renditur drejt formojnë një fjali. Nxënësit/et në dyshe punojnë së bashku për të ndërtuar fjalinë e rregullt. Lexohen fjalitë e ndërtuara dhe nxënësit/et e tjerë/a gjykojnë nëse janë fjali të kuptimta.
*Hartë konceptesh për fjalinë*. Nxënësit në dyshe bëjnë një hartë konceptesh për tiparet e fjalisë.

- Lexojnë fjalitë e dhëna në ushtrimin 1 në libër dhe dallojnë fjalinë që ka kuptim.
- Individualisht nxënësit/et punojnë për ushtrimin 2. Vendosin çdo fjalë të fjalisë në vagonët e trenit.
- Shkëmbejnë librat me njëri- tjetrin e vlerësojnë punën e tyre.
- Ushtrimi 2 punohet individualisht nga nxënësit. Duhet të vendosin shenjat përkatëse te fjalitë dhe tek ato që nuk janë fjali.
- Shkëmbejnë librat me njëri- tjetrin dhe vlerësojnë punën e tyre.

*Shkëmbe një problemë*: Duke bashkëvepruar në grup në një tabak A3 nxënësit/et shkruajnë me lapustila fjali dhe jofjali. Shkëmbehen fletët me grupet fqinje. Nxënësit/et gjejnë fjalitë dhe jofjalitë. Grupet vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- tregimin e tipareve të fjalisë;
- dallimin e fjalive nga jo fjalitë;
- përdorimin e shenjave të pikësimit (pikën) në fund të fjalisë;
- përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë;
- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

**Detyrë shtëpie:**

Vizato një tren dhe vendos në secilin vagon fjalët e një fjalie.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore**<br>Fjalia (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>- fjalia;<br>- lidhje kuptimore;<br>- fjalë, shkronjë e madhe;<br>- pikë, pikëpyetje, pikëçuditje. |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br><br>Nxënësi/ja:<br>- tregon tiparet e fjalisë;<br>- dallon fjalitë nga jo fjalitë;<br>- ndërton fjali nga fjalët apo grupet e fjalëve të dhëna;<br>- **përdor** shenjat e pikësimit (pikën) në fund të fjalisë.<br>- përdor shkronjën së madhe në fillim të fjalisë;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | **Situata e të nxënit**<br>Ndërtimi i fjalive, duke renditur fjalët sipas kuptimit. |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br><br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A3, mjete shkrimi**,** fisha me fjalë, lapustila, shirita letre. | **Lidhja me fushat e tjera:**<br><br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

**Mendo, puno në dyshe, diskuto.**
- mendo, puno në dyshe, diskuto
- shkëmbe një problemë
- diskutim;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- *Veprimtari në dyshe*: Mësuesi/ja ka përgatitur fisha me fjalë, të cilat duke u renditur drejt formojnë një fjali. Nxënësit/et punojnë në dyshe së bashku për të ndërtuar fjalinë e rregullt. Lexohen fjalitë e ndërtuara dhe nxënësit/et e tjerë gjykojnë nëse janë fjali të kuptimta.

*Mendo, puno në dyshe, diskuto*. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të tregojnë tiparet e fjalisë. Për këtë gjë ata/ato punojnë në dyshe dhe e shkruajnë përgjigjen në fletë. Diskutojnë për çka që kanë shkruar dhe dalin në një përfundim të përbashkët.
- Nxënësit/et punojnë individualisht për ushtrimin 3. Ata/ato lidhin 2 pjesët e fjalisë me shigjetë. Fjalitë e formuara i shkruajnë në të djathtë. Tregohet kujdes për përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe pikës në fund të saj. Nxënësit/et shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë punën e tyre.
- Ushtrimi 4 gjithashtu, punohet individualisht prej tyre. Ata/ato duhet të ndërtojnë fjali me grupet e fjalëve të dhëna. Në përfundim të punës nxënësit/et shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin në çifte dhe vlerësojnë punën e tyre.

*Shkëmbe një problemë*. Duke bashkëvepruar në grup nxënësit/et shkruajnë me lapustila fjalët e një fjalie në etiketa. Fletët shkëmbehen me grupet fqinje. Nxënësit/et gjejnë fjalitë, duke i renditur etiketat në mënyrën e duhur. Grupet vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që bëjnë nxënësit/et ndërmjet tyre;
- tregimin e tipareve të fjalisë;
- ndërtimin e fjalive nga fjalët apo grupet e fjalëve të dhëna;
- dallimin e fjalive nga jo fjalitë;
- përdorimin e shenjave të pikësimit (pikën) në fund të fjalisë;
- përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë;
- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe të atyre në grup.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br><br>Gjergji i madh (ora e parë) | | **Fjalë kyçe:**<br>- shok;<br>- shtatlartë;<br>- shet mend;<br>- gazmor;<br>- vullkan;<br>- projekt;<br>- delikate;<br>- violinë;<br>- flaut;<br>- klarinetë;<br>- llupëse. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• parashikon rreth përmbajtjes së teksti, duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar, duke plotë-suar fjalitë për personazhet e pjesës;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>Shokët e klasës sipas këndvështrimit të gjithsecilit. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4, mjete shkrimi. | | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare:**<br>- bashkëjetesa paqësore. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**<br>**Metodologjia:**<br>- LMD;<br>- diskutim;<br>- bisedë;<br>- ditari dypjesësh;<br>- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën. | | | |

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Mësuesi/ja fton nxënësit/et të mendojnë rreth shokëve/shoqeve të klasës dhe të thonë mendimin e tyre për shokë të veçantë sipas këndvështrimit që kanë.

- Mësuesi/ja shkruan titullin e pjesës "Gjergji i madh" . Nxënësit/et tregojnë se si do të jetë përmbajtja e tregimit sipas parashikimit të tyre.
- Lexohet pjesa nga nxënësit/et me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit/et nënvizojnë fjalët e reja. Ata/ato i diskutojnë këto fjalë pas çdo paragrafi, bashkë me pjesët që u pëlqejnë më shumë dhe të cilat i kanë nënvizuar. Në vijim tregohet ndryshimi nga parashikimi që ata/ato kanë bërë në fillim.
- Punohet me fjalorin për të kuptuar të gjitha fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Nxënësit/et rilexojnë edhe njëherë pjesën dhe nënvizojnë fjalët që tregojnë pamjen e jashtme, cilësitë e karakterit dhe fjalët që tregojnë çfarë i pëlqen Gjergjit dhe Miriamit.

*Ditari dypjesësh*. Nxënësit/et kopjojnë në njërën anë një pjesë që u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje dhe të cilën e kanë nënvizuar. Nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit, duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;
- komentin mbi ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;
- përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;
- lidhjen e pjesës që lexon me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie:**

Shkruaj emrat e shokëve/shoqeve që ngjajnë me personazhet e pjesës.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br><br>Gjergji i madh(ora e dytë) | | **Fjalë kyçe:**<br>- shok;<br>- shtatlartë;<br>- shet mend;<br>- gazmor;<br>- vullkan;<br>- projekte;<br>- delikate;<br>- violinë;<br>- flaut;<br>- klarinetë;<br>- llupëse. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>• tregon brendinë, duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep mendime rreth tekstit, duke i argumentuar ato;<br>• lidh pjesën me përvoja personale. | | **Situata e të nxënit**<br><br>Shokët/shoqet e klasës sipas këndvështrimit të gjithsecilit. | |

<table>
<tr><td>Burimet dhe materialet didaktike:<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4, mjete shkrimi.</td><td>Lidhja me fushat e tjera:<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- bashkëjetesa paqësore.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**

- lexo, përmblidh në dyshe;
- diskutim, bisedë;
- "Kubimi" punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Nxënësit/et tregojnë për shokët/shoqet e klasës së tyre që mund të ngjajnë me personazhet e pjesës ose flasin për shokë/shoqe të tjerë.

- Nëpërmjet leximit zinxhir, lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et. Vazhdohet me punë në dyshe: "Lexo, përmblidh në dyshe" ku nxënësit/et në dyshe lexojnë çdo paragraf të përcaktuar nga mësuesi/ja dhe e përmbledhin me 1-2 fjali.
- *Punë në grup. Kubimi*. Nxënësit/et sipas grupit zgjedhin njërin prej personazheve të pjesës dhe punojnë duke ndarë detyrat për:
  - përshkrimin e tij;
  - krahasimin e tij me personazhe të tjerë;
  - shoqërimin që i bëjnë figurës së tij me shokët/shoqet e klasës;
  - përcaktimin e qëndrimit të tyre rreth këtij personazhi nëse do ta kishin në klasë.

- Punët e tyre i ngjitin në faqet e kubit dhe secili nga grupet paraqet punën e tij.
- Vlerësojnë punët e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit;
- leximin rrjedhshëm dhe me intonacion të tekstit;
- ndarjen e përvojave rreth leximit me të tjerët;
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit;
- mendimet që jep rreth tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie:** Përshkruani një nga shokët ose shoqet tuaja.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br><br>Përshkruaj një shok/shoqe (ora e parë).</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- përshkruaj;<br>- person;<br>- kush është?<br>- si është?<br>- si sillet?<br>- çfarë i pëlqen?</td></tr>
</table>

| **Rezultatet e të nxënit** | **Situata e të nxënit** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br>- studion modelin e gatshëm të punës me shkrim;<br>- pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë;<br>- bën përshkrim të thjeshtë për një njeri duke plotësuar modelin gjysmë të gatshëm;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;<br>- vlerëson punët e të tjerëve. | Përshkrimi i një personi (njeri i afërm apo shok). |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor.<br>- foto , letër A4, mjete shkrimi | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- bashkëjetesa paqësore. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Metodologjia:**

- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Zhvillohet një bisedë me gjithë klasën për personat që ata/ato do të donin të tregonin. Nxënësit/et argumentojnë zgjedhjet e tyre me 2-3 fjali.
Ata/ato lexojnë përshkrimin e një personi në ushtrimin 1, në libër dhe lejohen të bëjnë pyetje e të diskutojnë me shokun/shoqen e bankës rreth modelit të dhënë. Më pas mësuesi/ja drejton pyetje për të kuptuar nëse nxënësit/et janë të qartë rreth përshkrimit të një personi, duke u ndalur në elementet që plotësojnë përshkrimin e një personi (të dhëna personale, cilësi fizike, çfarë i pëlqen të bëjë, cilësi të karakterit etj.).

- Ushtrimi 2 plotësohet në libër nga nxënësit/et. Ata/ato shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë shokun/shoqen. Korrigjimet drejtshkrimore, nëse ka, bëhen me ndihmën e mësuesit/es.
Përcaktohen elementet e një përshkrimi duke diskutuar me gjithë klasën. Mësuesi/ja rendit në tabelë elementet që nxirren nga diskutimi (të dhëna personale, cilësi fizike, çfarë i pëlqen të bëjë, cilësi të karakterit etj.).

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- studimin e modelit të gatshëm të punës me shkrim;
- pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë;
- bërjen e përshkrimit të thjeshtë për një njeri duke plotësuar modelin gjysmë të gatshëm;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.

**Detyrë shtëpie:**

Shkruaj për shokun/shoqen tënd/e të ngushtë.

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | Lënda<br>**Gjuha shqipe** | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore**
Përshkruaj një shok/shoqe (ora e dytë)

**Fjalë kyçe:**
- përshkruaj;
- person;
- kush është?
- si është?
- si sillet?
- çfarë i pëlqen?

**Rezultatet e të nxënit**
Nxënësi/ja:
- bën përshkrim të thjeshtë për një njeri të afërm ose shok/shoqe, duke e shoqëruar me vizatim;
- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;
- vlerëson punët e të tjerëve.

**Situata e të nxënit**
Përshkrimi i një personi (njeri i afërm apo shok/shoqe).

**Burimet dhe materialet didaktike:**
- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;
- teksti mësimor;
- foto, letër A4, mjete shkrimi.

**Lidhja me fushat e tjera:**
- artet;
- shoqëria dhe mjedisi.

**Lidhja me temat ndërkurrikulare**
- bashkëjetesa paqësore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- imagjinatë e drejtuar;
- diskutim;
- punë individuale, punë në çift, punë në grup.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- *Imagjinatë e drejtuar*: Vendoset muzikë në sfond dhe nxënësit/et mbyllin sytë. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të sjellin në mendje një person të veçantë për ta që mund të jetë i afërm ose shok/shoqe. Të imagjinojnë sikur e kanë pranë e po bisedojnë me të.
    - Cili është ky person?
    - Ç'pamje ka?
    - Çfarë i pëlqen të bëjë?
    - Si sillet me ty dhe më të tjerët?
  - Nxënësit/et hapin sytë dhe bëjnë përshkrimin e personit në libër. E shoqërojnë përshkrimin e tyre me vizatim.
  - Ata/ato shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin për të kontrolluar strukturën e përshkrimit dhe gabimet drejtshkrimore. Këto të fundit korrigjohen me ndihmën e mësuesit/es.

**Vlerësimi bëhet për:**
- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- bërjen e përshkrimit të thjeshtë për një të afërm ose shok/shoqe;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.

**Detyrë shtëpie:**
Përshkruaj shokun/shoqen tënd/e.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dita, drita dhe dituria (ora e parë).</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- dita;<br>- drita;<br>- dituria;<br>- libër.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• bën parashikime për ngjarjen sipas imagjinatës;<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• komenton ilustrimin e tekstit<br>• tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar duke gjetur alternativën e duhur për pyetjet rreth përmbajtjes.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Lexim fragmentesh nga libra të parapëlqyer.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>• teksti mësimor;<br>• enciklopedi dhe libra të tjerë, letër A4, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**

- parashikim me terma paraprakë;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale,
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Parashikim me terma paraprakë: Mësuesi/sja i fton nxënësit/et të lexojnë për pak minuta një pjesë nga libri i tyre i parapëlqyer. Gjërat e reja që mësohen nga ky lexim diskutohen me shokun/shoqen e bankës.

- Mësuesi/sja shkruan në tabelë: **dita, drita, dituria, libër.**
- Pastaj kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë në dyshe një histori të shkurtër (4 fjali), duke përdorur fjalët e dhëna, ilustrimin dhe titullin e pjesës.
- Mësuesi/sja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën. Ata/ato në dyshe, e më pas me gjithë klasën bëjnë komentin rreth saj.
- Nxënësit/et udhëzohen për leximin e tekstit në heshtje. Ata/ato bëjnë krahasimin e pjesës me krijimin e tyre.
- Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante dhe më të rëndësishme, pastaj dhe diskutojnë rreth tyre.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve të tekstit. Punohet fjalori.
- Punojnë në libër për plotësimin e rubrikës "Lexoj dhe kuptoj". Shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin e vlerësojnë shokun/shoqen.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- parashikimet që bëjnë për ngjarjen sipas imagjinatës;
- leximin e tekstit, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;
- komentimin e ilustrimeve të tekstit;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes.

**Detyrë shtëpie:**

Vizato librin tënd të parapëlqyer.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Dita, drita dhe dituria.<br>(ora e dytë) | | **Fjalë kyçe:**<br>- dita;<br>- drita;<br>- dituria;<br>- libër. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin sipas roleve;<br>• tregon brendinë, duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin;<br>• jep mendimin e vet në lidhje me diturinë që marrin nga librat. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit/et diskutojnë rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën, rreth interpretimit që i bëjnë mesazhit të pjesës, rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nx-ënësit/es;<br>• teksti mësimor;<br>• enciklopedi dhe libra të tjerë, letër A4, mjete shkrimi. | | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare:**<br>- të drejtat e njeriut. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

- ditari dypjesësh, diskutim, lojë me role, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
- Mësuesi/ja i fton nxënësit/et në çift t'i drejtojnë njëri-tjetrit pyetje rreth përmbajtjes.
- *Lojë me role*. Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të ndajnë rolet brenda grupit dhe të bëjnë leximin me role:
- Disa nxënës/e tregojnë përmbajtjen e pjesës.
- Punohen në mënyrë të pavarur ushtrimet në rubrikën"Reflektoj" dhe"Shkruaj", të cilat diskutohen me gjithë klasën pas plotësimit në tekst.
- *Ditari dypjesësh*. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të shkruajnë nga njëra anë e ditarit thënien "Të mësosh nuk është kurrë vonë" dhe nga ana tjetër shkruajnë se si e kuptojnë këtë thënie.

| CITATI/THËNIA/FJALIA | KOMENTI |
|---|---|
| | |

Nxënësit/et lexojnë punët e njëri-tjetrit dhe i vlerësojnë ato.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit sipas roleve;
- tregimin e brendisë, duke respektuar strukturën e tekstit;
- lidhjen e pjesës që lexon me përvoja nga jeta e vet;
- mendimet në lidhje me problemin që trajton pjesa.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Shkronja e madhe dhe pika. | **Fjalë kyçe:**<br>- shkronjë e madhe;<br>- pika;<br>- fjalia;<br>- fillim fjalie. |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë;<br>• vendos pikën në fund të fjalisë;<br>• ndërton fjali nga fjalë apo grupe fjalësh të dhëna, duke përdorur drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve. | **Situata e të nxënit**<br>Përdorimi i saktë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe pikës në fund të saj. |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- teksti Gjuha shqipe.<br>**Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4, mjete shkrimi. | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- diskutim për njohuritë paraprake, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Paraqitet tema e mësimit. Ftohen nxënësit/et të flasin për fjalinë dhe drejtshkrimin e saj.
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të shkruajnë një fjali dhe të qarkojnë fillimin dhe fundin e saj. Ai/ajo ndalet në rastet e përdorimit të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe të pikës në fund të saj.
*Ushtrimin 1,* nxënësit/et e punojnë individualisht, qarkojnë shkronjën e madhe dhe pikën në fund të fjalisë. Shkëmbehen librat në dyshe.
Ushtrimi 2. Nxënësit/et vendosin shkronjën e madhe në fillim dhe pikën në fund të fjalive.
Ushtrimi 3. Nxënësit/et vendosin pikën dhe shkronjën e madhe aty ku duhet . Diskutohet me gjithë klasën nëse janë vendosur saktë për të pasur fjali të kuptimta.
Ushtrimi 4. Me grupet e fjalëve nxënësit/et ndërtojnë fjali, duke përdorur si duhet shkronjën e madhe dhe pikën në fund të saj. Edhe ky ushtrim diskutohet me gjithë klasën, sepse renditja e fjalëve mund të jetë bërë në mënyra të ndryshme nga nxënësit/et. Theksohet që fjalitë e ndërtuara të jenë të kuptimta.
*Korrigjo gabimin.* Të ndarë në dyshe nxënësit/et shkruajnë fjali që fillojnë me shkronjë të vogël dhe pa shenjën e pikësimit në fund. Shkëmbehen fjalitë me shokun e bankës dhe korrigjohen.

**Vlerësimi bëhet për:**
- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- përdorimin e shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe të pikës në fund të saj;
- ndërtimin e fjalive nga fjalë apo grupe fjalësh të dhëna, duke përdorur drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe pikën në fund të saj.

**Detyrë shtëpie:**
Shkruaj tri fjali.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>- Një shfaqje e këndshme<br>- (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- shoqe;<br>- lexuese;<br>- e zellshme;<br>- bibliotekë;<br>- aromë letre;<br>- shije;<br>- rregullore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;<br>• komenton ilustrimin e tekstit;<br>• tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar, duke iu përgjigjur pyetjeve rreth përmbajtjes;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Marrja e librave në bibliotekë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4, mjete shkrimi, libra të ndryshëm.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- të drejtat e njeriut;<br>- vendimmarrja morale;<br>- bashkëjetesa paqësore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>• hartë konceptesh;<br>• lexim zinxhir;<br>• bisedë;<br>• punë individuale;<br>• punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br><br>• Nxënësit/et shkojnë në bibliotekën e shkollës. Dy-tre prej tyre marrin libra nga biblioteka, kurse të tjerët shohin bibliotekën (kjo gjë mund të improvizohet edhe në klasë).<br>• Hartë konceptesh. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të bëjnë një kllaster për bibliotekën. Ata/ato e shkruajnë këtë fjalë në qendër të fletës dhe ndërtojnë hartën e koncepteve (pajisjet, mënyra e funksionimit, rregullorja, njerëzit që shkojnë etj.).<br>• Çdo grup paraqet punën e tij dhe mësuesi/ja bën në tabelë një hartë konceptesh, e cila mbështetet te puna e gjithë klasës.<br>• Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të komentojnë figurën e librit.<br>• Ata/ato lexojnë pjesën në heshtje, duke nënvizuar fjalët e reja për ta, fjalët e shprehjet e bukura dhe gjërat që u duken interesante.<br>• Pjesa lexohet zinxhir sipas paragrafëve. Punohet me fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet e bukura. Mësuesi/ja ndalet te shprehjet: “heshtjen e ngrohtë”, “mbyll njërin sy“. Kuptimi i tyre shpjegohet me ndihmën e mësueses.<br>• Diskutohet me gjithë klasën për llojin e pjesës dhe karakteristikat e saj (tregim, ngjarje që mund të ndodhin në jetën reale, personazhe reale etj.).<br>• Punohet me gjithë klasën për rubrikën”Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve dhe diskutojnë për mendimet që japin në lidhje me to.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që duken interesante;
- komentimin e ilustrimeve të tekstit;
- përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes;
- lidhjen e pjesën me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie:** Regjistrohu në një bibliotekë dhe tërhiq një libër sipas dëshirës.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Një shfaqje e këndshme<br>(ora e dytë) | | **Fjalë kyçe:**<br>- shoqe;<br>- lexuese;<br>- e zellshme;<br>- bibliotekë;<br>- aromë letre;<br>- shije;<br>- rregullore. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>**Nxënësi/ja:**<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit/et diskutojnë rreth mënyrës se si ata/ato e kuptojnë pjesën, rreth interpretimit që u bëjnë veprimeve të vajzave në bibliotekë, rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4, mjete shkrimi, libra të ndryshëm. | | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare:**<br>- të drejtat e njeriut;<br>- vendimmarrja morale;<br>- bashkëjetesa paqësore. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- lexim, përmbledhje në dyshe;
- harta e personazheve;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të ndërtojnë pyetje rreth përmbajtjes së pjesës dhe ia drejtojnë shokëve/shoqeve.

- Punë në çift. Lexim, përmbledhje në dyshe. Njëri/a nga nxënësit/et lexon paragrafin dhe tjetri/a bën përmbledhje me 1-2 fjali. Rolet ndërrohen në paragrafin pasardhës.
- Tregohet përmbajtja e pjesës.
- Punë në grup. Harta e personazheve. Secili grup zgjedh nga një personazh për të cilin shkruhen dy cilësi. Për secilën cilësi shkëputet një pjesë ilustruese nga teksti.




- Punohen në mënyrë të pavarur ushtrimet në rubrikën "Reflektoj".
- Diskutohen me gjithë klasën pas plotësimit në tekst. Nxënësit/et sjellin përvojën personale dhe e ndajnë me shokët atë. Ata/ato u rekomandojnë shokëve libra që kanë lexuar.
- Planifikojnë veprimtari të ndryshme pasi i diskutojnë në klasë në lidhje më javën e të lexuarit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- përshkrimin e personazheve me fjalë të thjeshta;
- leximin e tekstit rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur;
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvojat e veta.

**Detyrë shtëpie:** Përgatit paraqitjen e një libri që ke lexuar së fundi.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Fjalitë janë të ndryshme<br>(ora e parë) | | **Fjalë kyçe:**<br>- fjali;<br>- të ndryshme;<br>- tregojmë;<br>- pyesim;<br>- shenja pikësimi;<br>- pikë;<br>- pikëpyetje. | |

| **Rezultatet e të nxënit** | **Situata e të nxënit** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br>- dallon fjali të thjeshta dëftore;<br>- dallon fjali të thjeshta pyetëse;<br>- demonstron respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.<br>- besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | Dallimi i fjalive që tregojnë e që pyesin. |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- teksi *Gjuha shqipe*;<br>- letër A4, mjete shkrimi;<br>- fisha me fjali, fisha me shenja pikësimi;<br>- libra jashtë klase.<br><br>**Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, foto, enciklopedi. | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- lojë në role;
- diskutim;
- punë individuale;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Nxënësi/e:
- Mësuesi/ja paraqet një tekst të shkurtër me 3-4 fjali (dëftore dhe pyetëse). Nxënësit/et e lexojnë. Pastaj, atyre u kërkohet të bëjnë dallimin midis fjalive në tekst. Diskutohet me nxënësit/et rreth kumtimit të secilës fjali dhe shenjave të pikësimit të përdorura në çdo rast.
- Mësuesi/ja paraqit me fisha fjalitë e dhëna në fillim të mësimit. Nxënësit/et në çift diskutojnë se çfarë kumtojnë këto fjali dhe cila është shenja e pikësimit që përdoret për çdo rast.
- Ushtrimi 1-Plotësohet tabela individualisht pasi lexohen fjalitë. Nxënësit/et shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë shokun. Argumentojnë plotësimin e tabelës për përcaktimin e fjalive.
- Ushtrimi 2-Edhe ky ushtrim punohet individualisht . Shkëmbehen librat me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Nxënësit, në librat jashtë klase që kanë sjellë, nënvizojnë me të kuqe 3 fjali që tregojnë dhe 3 që pyesin.
- Lojë në role: Në dyshe, në formë loje njëri nxënës ndërton fjali pyetës dhe tjetri përgjigjet me fjali dëftore.

**Vlerësimi bëhet për:**
- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- dallimin e fjalive të thjeshta dëftore dhe pyetëse;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe ato në grup.

**Detyrë shtëpie:**
Shkruaj një fjali me të cilën tregojmë dhe një fjali me të cilën pyesim.

| **Fusha** | **Lënda** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| Gjuhët dhe komunikimi | Gjuha shqipe | | |

<table>
<tr>
<td>Tema mësimore<br>Fjalitë janë të ndryshme<br>(ora e dytë)</td>
<td>Fjalë kyçe:<br>- fjali;<br>- të ndryshme;<br>- tregojmë;<br>- pyesim;<br>- shenja pikësimi;<br>- pikë;<br>- pikëpyetje.</td>
</tr>
<tr>
<td>Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• formon fjali të thjeshta dëftore duke vendosur pikën në fund të saj;<br>• formon fjali të thjeshta pyetëse, duke vendosur pikë pyetjen në fund të saj;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td>
<td>Situata e të nxënit<br>Ndërtimi i fjalive që tregojnë e që pyesin. Përdorimi i këtyre fjalive dhe vendosja e shenjave të pikësimit në fund të tyre.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4, mjete shkrimi;<br>- fisha me fjali, fisha me shenja pikësimi;<br>- libra jashtë klase.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera:<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>- diskutim, bisedë;<br>- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Nxënësit/et kanë përgatitur më parë fisha me fjali që pyesin dhe fjali që tregojnë (nga ato që kanë nënvizuar në librin jashtë klase). Ata/ato, në çift, shkëmbejnë fishat mes tyre dhe diskutojnë se çfarë kumtojnë këto fjali dhe cila është shenja e pikësimit që përdoret për çdo rast.<br>• Ushtrimi 3. Ky ushtrim punohet individualisht. Në fund të çdo fjalie nxënësit/et vendosin shenjën e pikësimit që duhet. I lexojnë fjalitë me intonacionin përkatës.<br>• Ushtrimi 4. Edhe ky ushtrim punohet individualisht. Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve me shkrim duke parë figurat e dhëna. Shkëmbejnë librat mes tyre dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br>• Nxënësit/et, nënvizojnë në librat jashtë klase që kanë sjellë, me të kuqe fjali që tregojnë dhe me blu fjalitë pyetëse.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- bashkëpunimin në grupe;<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetri;<br>- dallimin e fjalive të thjeshta dëftore dhe të fjalive pyetëse;<br>- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve.<br><br>Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5.</td>
</tr>
</table>

| Fusha | Lënda | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|
| Gjuhët dhe komunikimi | Gjuha shqipe | | |

<table>
<tr><td>Tema mësimore<br>Pika<br>(ora e parë)</td><td>Fjalë kyçe:<br>- vizatoj;<br>- mësuesi/ja;<br>- pikë;<br>- firmos;<br>- tablo;<br>- e shtangur;<br>- pika shumëngjyrëshe;<br>- ekspozitë;<br>- korr sukses.</td></tr>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• parashikon vazhdimin e ngjarjes sipas imagjinatës;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</td><td>Situata e të nxënit<br>Bërja e një “vepre arti”</td></tr>
<tr><td>Burimet dhe materialet didaktike:<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4, mjete shkrimi, bojëra.</td><td>Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- të drejtat e njeriut;<br>- vendimmarrja morale.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br><br>Metodologjia:<br>- parashikim me terma paraprakë;<br>- lexim dhe mendim i drejtuar;<br>- diskutim, bisedë;<br>- punë individuale;<br>- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të realizojnë një “vepër arti“. Ai/ajo shfaq gjithmonë besim në punën e tyre. Situatat konkrete që do të krijohen diskutohen.<br>• Parashikim me terma paraprakë: Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët: vizatoj, pikë, tablo, korr sukses.<br>• Nxënësit/et krijojnë një tregim me katër fjali sipas imagjinatës së tyre.<br>• Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe nxënësit/et komentojnë figurën e tekstit.<br>• Lexim dhe mendim i drejtuar: Ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit të ndarë në pjesë.(3 pjesë: pjesa e parë-…di ta bëj firmën time,pjesa e dytë-…pika të mëdha, pjesa e tretë-…Tani…firmose) Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante në secilën pjesë. Mësuesi/ja gjatë diskutimit me nxënësit/et punon fjalorin për çdo pjesë, pyetjet rreth përmbajtjes dhe bën parashikime për pjesën në vazhdim. Ai/ajo kërkon të argumentojë parashikimin e bërë.<br>• Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, u lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë.<br>• Nxënësit/et nënvizojnë në tekst dhe shkruajnë në fletore fjalitë me të cilat pyesim.<br>• Ata/ato shkëmbejnë fletoret për të vlerësuar njëri-tjetrin.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- parashikimin për vazhdimin e ngjarjes sipas imagjinatës si dhe për shpjegimin e argumentuar të këtij parashikimit të bërë;
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për to;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Pika (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>vizatoj;<br>mësuesi/ja<br>pikë, firmos, tablo, e shtangur, pika shumëngjyrëshe, ekspozitë, korri sukses</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin;<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep mendime rreth tekstit, duke i argumentuar ato;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit/et diskutojnë rreth mënyrës se si ata/ato e kuptojnë pjesën, rreth interpretimit të tyre në lidhje me besimin dhe inkurajimin që duhet t’u japin shokëve/shoqeve, rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4, mjete shkrimi, bojëra.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- të drejtat e njeriut;<br>- vendimmarrja morale.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia:<br>- lexo, përmblidh në dyshe;<br>- harta e personazheve;<br>- diskutim, bisedë;<br>- punë individuale;<br>- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Mësimi fillon me pyetje rreth përmbajtjes, pyetje të cilat nxënësit/et mund t’ia drejtojnë njëri-tjetrit.<br>• Nëpërmjet leximit zinxhir lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et.<br>• Vazhdohet me “Lexo, përmblidh në dyshe” ku nxënësit/et në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafët në vazhdim. Tregohet përmbajtja nga disa nxënës/e.<br>• Harta e personazheve. Nxënësit/et shkruajnë për personazhin kryesor dy cilësi. Për secilën cilësi shkëputet një pjesë ilustruese nga teksti.</td></tr>
</table>

personazhi

| cilësi | cilësi |
|---|---|

| ilustrim nga teksti | ilustrim nga teksti |
|---|---|

- Punohet rubrika "Reflektoj"në të cilën ata/ato japin përshtypjet e veta në lidhje me tekstin, sa lidhet pjesa me jetën e tyre etj.
- Ndahen rolet sipas grupeve dhe luhet pjesa. Nxënësit/et vlerësojnë interpretimin e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin e personazhit me fjalë të thjeshta;
- leximin rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit;
- ndarjen e përvojave rreth leximit, me të tjerët.
- tregimin e brendisë, duke respektuar strukturën e tekstit;
- mendimet që jep rreth tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shkruajmë një tregim me figura<br>(ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- tregim;<br>- figura;<br>- ilustrim;<br>- imagjinatë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- përshkruan me fjalët e tij/saj si i kupton figurat;<br>- ndërton një tregim të thjeshtë nisur nga figurat e dhëna;<br>- rendit sipas radhës ngjarjet në tregim;<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga figurat e dhëna.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
</table>

| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- libra me figura, foto, etiketa;<br>- letër A4, mjete shkrimi. | |
|---|---|

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Mbulohet me një fletë të bardhë teksti i ndarë në paragrafë në të djathtë të figurave.
- Nxënësit/et nxiten të diskutojnë në dyshe rreth figurës së parë, duke u përqendruar tek elementët e hyrjes. Në fillim duhet t'u vendosin emra personazheve, të tregojnë vendin dhe kohën e ngjarjes. Gjatë diskutimeve mësuesi/ja nxit përdorimin e një fjalori sa më të pasur dhe nxënësit/et duhet të shkëpusin nga ky diskutim fjalë e shprehje, të cilat u pëlqejnë më shumë.
- Nxënësve/eve u lihet pak kohë që t'i shkruajnë këto fjalë në etiketa. Mësuesi/ja i mbledh etiketat dhe i lë në një vend të veçantë.
- Diskutimi bëhet për figurën e dytë në të cilën renditin ngjarjet njëra pas tjetrës. Si në rastin e parë, nxënësve/eve u lihet kohë që të shkruajnë në etiketa fjalë e grupe fjalësh që u kanë pëlqyer më shumë nga kjo veprimtari.
- Në figurën e tretë nxënësit/et diskutojnë për mbylljen e ngjarjes. Përsëritet veprimtaria me shkrimin në etiketa të fjalëve dhe të grupeve të fjalëve që ata/ato kanë shkëputur nga diskutimi.
- Disa nxënës/e e thonë tregimin e krijuar nga fillimi në fund. Ata/ato mund të mbështeten te fondi i fjalëve që kanë zgjedhur e shkruar shokët/shoqet.
- Zbulohet teksti në të djathtë të figurave i ndarë në paragrafë. Lexohet në heshtje nga nxënësit/et. Ata/ato bëjnë lidhjen e secilës figurë me secilin paragraf, duke i renditur sipas radhës. Bëjnë krahasimin me tregimin e ndërtuar nga vetë ata në fillim të mësimit.
- Shkruajnë tregimin në fletore. Kjo detyrë mund të përfundojë në shtëpi.
- Vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përshkrimin me fjalët e tij/saj se si i kupton figurat;
- shkrimin e fjalëve për një tregim të thjeshtë nisur nga figurat e dhëna;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punëve të të tjerëve;
- bashkëpunimit në grupe.

**Detyrë shtëpie:** Bëj tri vizatime për një tregim që ke lexuar.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Shkruajmë një tregim me figura<br>(ora e dytë) | | **Fjalë kyçe:**<br>- tregim;<br>- figura;<br>- ilustrim;<br>- imagjinatë. | |

| **Rezultatet e të nxënit** | **Situata e të nxënit** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br>- shkruan një tregim të thjeshtë nisur nga figurat e dhëna;<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve. | Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga figurat. |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto, libra me figura;<br>- letër A4, mjete shkrimi. | **Lidhja me fushat e tjera:**<br>- artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

- diskutim;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën;
- hartë konceptesh.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

***Hartë konceptesh.*** Pjesët e një tregimi (hyrja, zhvillimi i ngjarjes, mbyllja). Nxënësit/et punojnë në grupe për hartën e koncepteve. Paraqiten punët e grupeve dhe mësuesi/ja bën plotësimin e hartës së saj të koncepteve në tabelë, duke u mbështetur te puna e nxënësve/eve.

Mësuesi/ja shpërndan tri figura për çdo grup. Ai/ajo kërkon nga nxënësit/et t'i vëzhgojnë me kujdes ato, me qëllim që të ndërtojnë një tregim. Nxënësit/et diskutojnë mes tyre rreth figurave, i renditin sipas radhës së ngjarjes, shkruajnë në etiketa fjalë e grupe fjalësh që u kanë pëlqyer.

- Nxënësit/et udhëzohen të shkruajnë një tregim, duke u mbështetur te figurat e dhëna nga mësuesi/ja dhe diskutimet e bëra në grup. Ata/ato do të përdorin edhe fjalët që kanë përzgjedhur dhe kanë shkruar në etiketa.
- Në përfundim, nxënësit/et lexojnë tregimet e tyre dhe shkëmbejnë fletoret me shokun/shoqen e bankës dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.
- Me ndihmën e mësuesit/es bëjnë qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grup;
- vlerësimin e punëve të të tjerëve;
- shkrimin e fjalëve për një tregim të thjeshtë nisur nga figurat e dhëna;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>*Festa e Abetares* | | **Fjalë kyçe:**<br>- Festa e Abetares;<br>- foto;<br>- video;<br>- shfaqje;<br>- vjersha;<br>- këngë;<br>- valle. | |

**Rezultatet e të nxënit**
Nxënësi/ja:
- tregon për *Festën e Abetares*;
- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës së dëgjuar;
- shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të kësaj shfaqjeje;
- lidh informacionin e dëgjuar me përvojën e tij në *Festën e Abetares;*
- shpreh pëlqimet e tij/saj rreth kësaj shfaqjeje;
- veçon disa detaje interesante (muzika e këngëve gjatë të dëgjuarit, interpretimin, veshjet, skena etj.).

**Situata e të nxënit**
Shfaqja në video e *Festës së Abetares*.

**Burimet dhe materialet didaktike:**
- teksti *Gjuha shqipe*;
- foto, informacione nga interneti, enciklopedi;
- letër A4, mjete shkrimi.

**Lidhja me fushat e tjera**
- artet;
- teknologji dhe Tik;
- shoqëria dhe mjedisi.

**Burimet dhe materialet didaktike:**
- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;
- teksti mësimor;
- foto, video-projektor.

**Lidhja me temat ndërkurrikulare:**
- të drejtat e njeriut.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Mësuesi/ja fton nxënësit/et në bisedë për festat/shfaqjet e fëmijëve. Ata/ato tregojnë rreth mbresave dhe emocioneve që kanë përjetuar në to.
- Mësuesi/ja fton sërish nxënësit/et të ndjekin me shumë kujdes videon që do të shfaqet në monitor.
- Pas saj i lë për 2-3 minuta në qetësi që të sjellin sërish në mendje atë që sapo panë. Orienton nxënësit/et të kujtojnë muzikën, interpretimin e fëmijëve, veshjet e tyre, atmosferën e krijuar dhe elemente të tjera (skena, të ftuarit).
- Nis diskutimi duke punuar ushtrimin 1. Ata/ato diskutojnë në dyshe për shfaqjen që sapo panë.
- Nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve në ushtrimet 2,3,4 ata/ato sjellin përvojën, emocionet, mendimet, dëshirat e tyre për *Festën e Abetares* që kanë bërë në klasë të parë.
- Në ushtrimin 6 shprehin dëshirat për shfaqjet ku duan të marrin pjesë.
- Mësuesi/ja nxit nisma për të organizuar shfaqje të ndryshme.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës së dëgjuar;
- shprehjet e përjetimeve dhe *të* emocioneve që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të kësaj shfaqjeje;
- lidhjen e informacionit të dëgjuar me përvojën e tij/saj në *Festën e Abetares;*
- shprehjen e pëlqimit të tij/saj rreth kësaj shfaqjeje;
- veçimin e disa detajeve interesante (muzika e këngëve) gjatë të dëgjuarit etj.;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br><br>Pranë dhjetës<br>(ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- shkollë;<br>- i gëzuar;<br>- hare;<br>- nëna;<br>- afër dhjetës;<br>- çokollata;<br>- shoku i bankës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• bën parashikime për vazhdimin e ngjarjes sipas imagjinatës;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Libri “Aventurat e Çapaçulit”.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- libri “Aventurat e Çapaçulit”;<br>- lapsa me ngjyra, mjete shkrimi, fletëA4.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br><br>Metodologjia:<br>- parashikim me terma paraprakë;<br>- lexim dhe mendim i drejtuar;<br>- diskutim;<br>- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br><br>Mësuesi/ja ka orientuar nxënësit/et të lexojnë fragmente nga libri”Aventurat e Çapaçulit”<br>Diskutohet rreth librit.<br>Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët: i gëzuar, Çapaçuli, afër dhjetës, shoku i bankës.<br>• Parashikim me terma paraprakë: Nxënësit/et krijojnë sipas imagjinatës një tregim me katër fjali.<br>• Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe nxënësit/et komentojnë figurën e tekstit.<br>• Lexim dhe mendim i drejtuar: Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit të ndarë në pjesë (pjesa e parë: ...sa fort i gëzuar jam sot; pjesa e dytë: ...e mos më mundo; pjesa e tretë: ...shoku im i bankës). Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante në secilën pjesë. Mësuesi/ja gjatë diskutimit me nxënësit/et punon me fjalorin për çdo pjesë, me pyetjet rreth përmbajtjes dhe bën parashikime për pjesën në vazhdim. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të argumentojnë parashikimin e bërë.<br>• Në përfundim të punimit të të gjithë tekstit, atyre u lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë.<br>• Nxënësit/et punojnë në rubrikën“Lexoj e kuptoj“ (Plotëso me _ përgjigjen e saktë).<br>• Ata/ato shkëmbejnë librat për të vlerësuar njëri-tjetrin.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që u duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- parashikimet për vazhdimin e ngjarjes sipas imagjinatës si dhe për shpjegimin e argumentuar të parashikimit të bërë;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta.

**Detyrë shtëpie:** Vizato Çapaçulin.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Pranë dhjetës<br>(ora e dytë) | | **Fjalë kyçe:**<br>- shkollë;<br>- i gëzuar;<br>- hare;<br>- nëna;<br>- afër dhjetës;<br>- çokollata;<br>- shoku i bankës. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin;<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato;<br>• ndan me të tjerët/at përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit/et diskutojnë rreth mënyrës se si ata/ato e kuptojnë pjesën, rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa, rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- libri "Aventurat e Çapaçulit";<br>- letër A4, mjete shkrimi, lapsa me ngjyra. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- lexo përmblidh në dyshe;
- harta e personazheve;
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësimi fillon me pyetje rreth përmbajtjes, pyetje, të cilat nxënësit/et mund t'ia drejtojnë njëri-tjetrit.
- Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir.

- Vazhdohet me "Lexo, përmblidh në dyshe" ku nxënësit/et në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Tregohet përmbajtja nga disa nxënës/e.
- *Punë në grup. Harta e personazheve*. Nxënësit/et shkruajnë për personazhin kryesor dy cilësi. Për secilën cilësi shkëputet një pjesë ilustruese nga teksti.




- Punohet rubrika"Reflektoj" në të cilën nxënësit/et nënvizojnë veprimet e Çapaçulit dhe gjykojnë këto veprime.
- Nxënësit/et shkruajnë një këshillë për Çapaçulin.
- Nxitet diskutimi për librin "Aventurat e Çapaçulit". Nxënësit/et mund të tregojnë aventura të tjera që mund të kenë lexuar nga ky libër.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit;
- leximin rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit;
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit;
- mendimet që jep rreth tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Në shkollë është Thërrimja<br>(ora e parë) | | **Fjalë kyçe:**<br>- kotele;<br>- mjaullimë;<br>- ndjell;<br>- thërrime. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>Kujdesi për kafshët shtëpiake | |

| **Burimet dhe materialet didaktike:** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>– teksti mësimor;<br>– informacione nga interneti, foto;<br>– kafshë shtëpiake;<br>– letër A4, mjete shkrimi. | - artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- hartë konceptesh;
- procedura: *Pyet sërish*;
- bisedë;
- punë në çift, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve:**
- Në klasë janë sjellë foto kafshësh të ndryshme shtëpiake.
- *Hartë konceptesh*. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të bëjnë hartë konceptesh për kafshët shtëpiake (llojet e tyre, kujdesi që kërkojnë, përse mbahen etj.).
- Harta e koncepteve plotësohet nga mësuesi/ja në tabelë, duke u mbështetur në punët e nxënësve/eve.
- Nxënësit/et shohin ilustrimin e pjesës dhe komentojnë rreth saj.
- *Procedura: Pyet sërish. Punë në dyshe.* Ndahet pjesa sipas paragrafëve. Njëri nga nxënësit/et në dyshe lexon paragrafin, kurse tjetri bën pyetje për këtë pjesë. Të dy nxënësit/et duhet të bien dakord për përgjigjet. Në paragrafin në vazhdim ndërrohen rolet.
- Punohet rubrika "Fjalor" në libër. Nxënësit/et vendosin shenjën te kuptimet e sakta të fjalëve.

**Vlerësimi bëhet për:**
- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- komentimin e figurës së librit;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj për kafshën që do të doje të kishe.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore**<br>Në shkollë është Thërrimja<br>(ora e dytë) | **Fjalë kyçe:**<br>- kotele;<br>- mjaullimë;<br>- ndjell;<br>- thërrime. |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>• tregon brendinë, duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• bën një zgjedhje për mbylljen e tregimit ose gjen një mbyllje tjetër;<br>• përshkruan macen ose ndonjë kafshë tjetër që do të donte të kishte;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit/et diskutojnë rreth mënyrës se si ata/ato e kuptojnë pjesën, rreth interpretimit të tyre në lidhje me kujdesin për kafshët, rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |

| **Burimet dhe materialet didaktike:** | **Lidhja me fushat e tjera:** |
| --- | --- |
| – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>– teksti mësimor;<br>– informacione nga interneti, enciklopedi, foto;<br>– kafshë shtëpiake;<br>– letër A4, mjete shkrimi. | - artet;<br>- teknologji dhe Tik;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia**:
- lexo, përmblidh në dyshe:
- imagjinatë e drejtuar;
- tryezë e rrumbullakët;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- *Imagjinatë e drejtuar*. Mësuesi/ja vendos muzikë në sfond dhe mbyll perdet. Nxënësit/et mbyllin sytë. Mësuesi/ja i fton ta imagjinojnë veten duke luajtur me kafshën e parapëlqyer. Nxënësit/et flasin rreth kësaj situate.
- Nëpërmjet leximit zinxhir, lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et.
- Vazhdohet me "Lexo, përmblidh në dyshe" ku nxënësit/et në dyshe lexojnë çdo paragraf të përcaktuar nga mësuesi/ja dhe e përmbledhin me 1-2 fjali.
- Tregohet përmbajtja e pjesës nga disa nxënës/e.
- Punohet rubrika "Reflektoj" në të cilën nxënësit/et pëlqejnë një nga mbylljet e dhëna ose gjejnë një mbyllje tjetër.
- *Tryezë e rrumbullakë.* Punojnë me radhë duke shkruar secili/a nga një fjali për macen që do të donin të kishin. Lexohen punët e nxënësve/eve sipas grupeve dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.
- Punohet në libër rubrika "Shkruajnë" në të cilën nxënësit/et ngjyrosin shiritin sipas vlerësimit që nxënësit/et i bëjnë veprimit të fëmijëve dhe i vendosin një emër maces së tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit;
- leximin rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit;
- ndarjen me të tjerët të përvojave rreth leximit;
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit;
- mendimet që jep rreth tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie:**
Vizato një kafshë që të pëlqen.

## MODULI 2

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Kush urdhëron<br>(ora I) | **Fjalë kyçe:**<br>- kush urdhëron;<br>- familje;<br>- respekt;<br>- ndihmë;<br>- memec. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;<br>• mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata/ato e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto;<br>- albume të familjeve të nxënësve/eve. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

- parashikim me terma paraprakë;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Parashikim me terma paraprakë: Mësuesi/ja shkruan në tabelë: *një vajzë, familje, respektojnë njëri-tjetrin, ndihmojnë njëri-tjetrin*. Kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë një histori të shkurtër (4 fjali) duke përdorur fjalët e dhëna.
- Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën në të djathtë të faqes. Nxënësit/et në dyshe, e më pas të gjithë së bashku diskutojnë rreth saj.
- Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit në heshtje. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante, më të rëndësishme. Mësuesi/ja gjatë diskutimit me nxënësit/et punon fjalorin, pyetjet rreth përmbajtjes dhe personazheve.
- Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta lexojnë sërish për ta kuptuar më mirë. Gjatë rileximit nxënësit/et nënvizojnë pyetjet që i moshuari i bën vajzës me blu dhe përgjigjet e vajzës me të kuqe.
- Mësuesi/ja tërheq vëmendjen te përgjigjja e fundit e vajzës dhe nxit nxënësit/et të diskutojnë në dyshe rreth saj. Nxënësit/et japin mendimet e tyre në lidhje me vajzën dhe përgjigjen e saj duke mbajtur një qëndrim pro ose kundër.

**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;

| |
|---|
| - lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;<br>- vlerësimin që u bën të tjerëve. |

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Kush urdhëron<br>(ora II)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- kush urdhëron;<br>- familje;<br>- respekt;<br>- ndihmë;<br>- memec.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• tregon se cilët janë personazhet e parapëlqyera duke argumentuar zgjedhjen;<br>• lexon tekstin sipas roleve;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto;<br>- albume të familjeve të nxënësve/eve</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>• lexim me role;<br>• rrjet diskutimi;<br>• diskutim, bisedë;<br>• punë individuale;<br>• punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Mësuesi/ja drejton pyetje rreth përmbajtjes dhe ndalet te personazhet. Ai/ajo kërkon nga nxënësit/et të gjejnë dy cilësi për secilin personazh, duke treguar në tekst pjesën që i demonstron ato (vajza-e zgjuar-fjalia e fundit në tekst; burri- këmbëngulës-pyetjet e njëpasnjëshme).<br>• Ai/ajo kërkon nga nxënësit/et të lexojnë fjalët e zotërisë dhe të vajzës. Më pas nxënësit/et në dyshe ushtrohen në lexim sipas roleve. Më pas nxënësit/et tregojnë pjesën.<br>• Ushtrimet në rubrikën “Reflektoj” dhe “Shkruaj” punohen në mënyrë të pavarur. Diskutohen me gjithë klasën pas plotësimit në tekst.<br>• Rrjet diskutimi: Mësuesi/ja ngre pyetjen “A duhet të urdhërojë dikush në familje?“ dhe nxit nxënësit/et të diskutojnë në grup rreth saj. Nxënësit/et japin mendimet e tyre në lidhje me pyetjen duke mbajtur një qëndrim të argumentuar pro ose kundër derisa arrijnë në përfundimin se në familje duhet të respektojmë njëri-tjetrin, të ndajmë detyrat dhe përgjegjësitë;të duam njëri tjetrin.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit sipas roleve;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit dhe tregimit të ngjarjes;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Të rriturit mendojnë për ne<br>(ora I) | **Fjalë kyçe**<br>- Të Drejtat e Fëmijëve;<br>- Organizata e Kombeve të Bashkuara;<br>- dokument;<br>- udhëheqës;<br>- anëtar. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon tekstin joletrar, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Ndërton pyetje rreth fakteve që jepen në tekst.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të reja për të.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të shokëve/shoqeve për tekstin. | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë për:<br>- mënyrën se si ata e bëjnë lidhjen e pjesës me jetën e tyre të përditshme;<br>- interpretimin e tyre në lidhje me faktet që sjell pjesa;<br>- informacionet dhe kuriozitetet e sjella nga nxënësit/et për të drejtat e fëmijëve. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto;<br>- karta e të drejtave të fëmijëve. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

- diskutim për njohuritë paraprakë;
- pyet sërish;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesi/ja shkruan në tabelë: "Të drejtat e fëmijëve". Ai/ajo fton nxënësit/et të diskutojnë në grup rreth njohurive që kanë për të drejtat e fëmijëve. Më pas diskutimi vazhdon me gjithë klasën.
- Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit. Ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit me paragrafë. Ata/ato nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme. Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth fakteve në paragrafin e parë dhe nxënësi/ja tjetër do i përgjigjet pyetjeve. (Për çdo paragraf të ri nxënësit/et ndërrojnë rolet.)
- Në përfundim të përmbledhjes së paragrafit, mësuesi/ja diskuton me nxënësit/et, punon fjalorin, pyetjet rreth fakteve që jepen në tekst.
- Nxënësit/et rilexojnë tekstin për ta kuptuar më mirë.
- Nxënësit/et plotësojnë rubrikën "Reflektoj" në tekst dhe diskutojnë me grupin dhe klasën pasi e kanë plotësuar.

**Vlerësimi bëhet për:**

Leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
Ndërtimin e pyetjeve dhe të përgjigjeve të tyre rreth fakteve që jepen në tekst.
Lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.
Mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
Vlerësimin që u bën të tjerëve.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Të rriturit mendojnë për ne<br>(ora II)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- Të Drejtat e Fëmijëve;<br>- Organizata e Kombeve të Bashkuara;<br>- dokument;<br>- udhëheqës;<br>- anëtar.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin;<br>• jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa;<br>• nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë;<br>• tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë për:<br>- mënyrën se si ata e bëjnë lidhjen e pjesës me jetën e tyre të përditshme;<br>- për interpretimin e tyre në lidhje me faktet që sjell pjesa;<br>- për informacionet dhe kuriozitetet e sjella nga nxënësit/et për të drejtat e fëmijëve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto;<br>- karta e të drejtave të fëmijëve.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

- ditari dypjesësh;
- lexim zinxhir;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të lexojnë pjesën nëpërmjet leximit zinxhir. Më pas ata/ato lexojnë gjithë pjesën.
- Diskutohet me nxënësit/et rreth pyetjeve në rubrikën "lexoj dhe kuptoj".
- Nxënësit/et kryejnë një veprimtari. Secili shkruan në një fishë një nga të drejtat e fëmijëve që i duket më e rëndësishmja. Në një fishë tjetër do të shkruajë arsyen pse i duket ajo e drejtë më e rëndësishmja. Fishat do t'i ngjisin në tabelën:

| Të drejtat e fëmijëve | Pse është e rëndësishme? |
|---|---|
| | |

Çdo përfaqësues grupi del para klasës për të paraqitur punën.
Diskutohet rreth informacioneve qe kanë sjellë fëmijët për të drejtat e fëmijëve.

**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin rrjedhshëm të tekstit;
- shkrimin e të drejtave dhe argumentimin pse ato janë të rëndësishme;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- ndarja e fjalëve në fund të rreshtit;<br>- rrokje;<br>- një shkronjë e vetme;<br>- shkronja dyshe.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• Tregon rregullat e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit.<br>• Dallon ndarjen e saktë të fjalëve në fund të rreshtit.<br>• Ndan si duhet fjalët në fund të rreshtit<br>• Paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>- Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit.<br>- Shqyrtimi i rasteve të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4;<br>- mjete shkrimi;<br>- fisha.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- diskutim për njohuritë paraprake;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Diskutim për njohuritë paraprake. Mësuesi/ja diskuton me nxënësit/et dhe i fton që ata të kujtojnë rregullat e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit.
- Mësuesi/ja ka përgatitur fisha me fjalët: bojë, shiu, kurrë, ngre. I fton nxënësit/et që duke punuar në grupe të diskutojnë e të ndajnë fjalët siç ndahen në fund të rreshtit. Shkëmbehen punët ndërmjet grupeve fqinjë. Shkruhen në tabelë rregulla të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit të cilat kanë dalë gjatë kësaj veprimtarie.
- Nxënësit/et lexojnë tekstin në ushtrimin 1 dhe qarkojnë fjalët e ndara gabim në fund të rreshtit.
- Punohet individualisht ushtrimi 2. Nxënësit/et shkëmbejnë librat e kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.
- Për secilën fjalë të ndarë gabim në fund të rreshtit nxënësit/et tregojnë rregullën përkatëse.
- Fjalët e ndara gabim shkruhen saktë në fletore.

**Vlerësimi bëhet për:**
- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- tregimin e rregullave të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit;
- dallimin e ndarjes së saktë të fjalëve në fund të rreshtit;
- ndarjen si duhet të fjalëve në fund të rreshtit;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij/saj;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

**Detyrë shtëpie:** Kopjo tri fjali nga pjesa "Kush urdhëron". (Kujdes ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit.)

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit<br>(ora II) | **Fjalë kyçe:**<br>- ndarja e fjalëve në fund të rreshtit;<br>- rrokje;<br>- në shkronjë e vetme;<br>- shkronja dyshe. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• tregon rregullat e ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit;<br>• dallon ndarjen e saktë të fjalëve në fund të rreshtit;<br>• ndan si duhet fjalët në fund të rreshtit;<br>• paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | **Situata e të nxënit**<br>- Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit.<br>- Shqyrtimi i rasteve të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit. |

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- letër A4;<br>- mjete shkrimi;<br>- fisha. | - shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

- tryezë e rrumbullakët;
- diskutim;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesi/ja paraqet në tabelë fjalë të ndara saktë dhe gabim, në fund të rreshtit. Diskutohet me nxënësit/et për të gjetur ndarjet e sakta e të gabuara dhe për të bërë lidhjen me rregullat përkatëse.
- Vazhdohet me "Tryezë e rrumbullakët". Nxënësit/et të vendosur me radhë në formë rrethore sipas grupeve shkruajnë rregulla dhe shembuj të ndarjeve të fjalëve në fund të rreshtit.
- Lexohen rregullat nga të gjitha grupet dhe plotësojnë ato rregulla që nuk i kanë shkruar. Vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Punohet individualisht ushtrimi 3. Nxënësit/et grupojnë në dy grupe fjalët e dhëna. Në njërin grup fjalët që mund të ndahen në fund të rreshtit dhe në një grup tjetër fjalët që nuk mund të ndahen në fund të rreshtit. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Për secilën fjalë tregojnë rregullën përkatëse të ndarjes apo të mosndarjes në fund të rreshtit.
- Ushtrimi 4. Nxënësit/et gjejnë 3 fjalë në tregimin "Pranë dhjetës" dhe shkruajnë mënyrat e mundshme të ndarjes së këtyre fjalëve (p.sh. për-para ose përpa-ra).

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëhet njëri-tjetrit;
- tregimin e rregullave të ndarjes së fjalëve në fund të rreshtit;
- dallimin e ndarjes së saktë të fjalëve në fund të rreshtit;
- ndarjen si duhet të fjalëve në fund të rreshtit;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij/saj;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe në grup.

**Detyrë shtëpie:** Gjej 2 fjalë 4-rrokëshe e shkruaj mënyrat e ndarjes në fund të rreshtit.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore** | **Fjalë kyçe** |
|---|---|
| Sa shumë jam rritur!<br>(ora I) | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të; | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme, të cilat lidhen me temën. |

| | |
|---|---|
| • i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të reja për të;<br>• tregon se cili është personazhi i parapëlqyer dhe e përshkruan atë;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto;<br>- albume të nxënësve/eve | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- parashikim me terma paraprakë;
- procedura: pyet sërish;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Parashikim me terma paraprakë: Mësuesi/ja shkruan në tabelë këto fjalët: *mami, album fotografish, kujtime*. Ajo kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë në dyshe një histori të shkurtër me 4 fjali duke përdorur këto fjalë. Disa nga dyshet lexojnë historinë e tyre para klasës.
- Mësuesi/ja ka porositur më parë nxënësit/et të sjellin albume fotografish që i takojnë moshave të ndryshme të tyre. I fton t'i shfletojnë dhe t'i shikojnë me shokun/shoqen që kanë pranë. Ata/ato diskutojnë dhe komentojnë fotot së bashku.
- Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën në të majtë të faqes. Nxënësit/et në dyshe, e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth saj, duke treguar si i ndihmon ajo për të kuptuar më mirë tekstin.
- Ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit me paragrafë. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme. Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe nxënësi/ja tjetër u përgjigjet pyetjeve. (Për çdo paragraf të ri nxënësit/et, ndërrojnë rolet.)
- Në përfundim të punimit të të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë. Mësuesi/ja diskuton me nxënësit/et, punon fjalorin dhe pyetjet rreth brendisë së tekstit.
- Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit/et të përzgjedhin personazhin që u pëlqen më shumë në këtë tekst dhe ta përshkruajnë atë.
- Diskutohet rreth pyetjes së parë në rubrikën "Reflektoj".
  **Detyrë:** Nënvizo me të kuqe fjalët e vajzës dhe me blu fjalët e mamit.

**Vlerësimi bëhet për:**
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- ndërtimin e pyetjeve dhe përgjigjet e tyre rreth brendisë së tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Sa shumë jam rritur! (ora II) | | **Fjalë kyçe** | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon tekstin sipas roleve.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>- Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën e vlerësojnë personazhet, | |

| | |
|---|---|
| • Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa. | - rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa,<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>Teksti Gjuha shqipe, foto, albume të fëmijërisë së nxënësve/eve | **Lidhja me fushat e tjera**<br>artet;<br>teknologji dhe TIK;<br>shoqëria dhe mjedisi. |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**<br>• **Metodologjia:** " Lexim me role", "rrjet diskutimi"diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve/eve**<br>• Lexim me role: Mësuesi/ja organizon klasën në grupe treshe. Ajo ndan rolet në çdo grup (Erla, mami, autori) dhe kërkon nga nxënësit/et të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit/et të ndarë në treshe ushtrohen në lexim me zë sipas roleve.<br>• Punohet ushtrimi në rubrikën "Lexoj dhe kuptoj" .<br>• Rrjet diskutimi: Diskutohet me gjithë klasën rreth pyetjes së dytë në rubrikën "Reflektoj", pasi e kanë diskutuar më parë me shokun/shoqen pranë.<br>**Vlerësimi bëhet për:**<br>Leximin e tekstit sipas roleve.<br>Tregimin e ngjarjes duke respektuar strukturën e tekstit.<br>Lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.<br>Mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>Vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit . | |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Unë jam | | **Fjalë kyçe**<br>- quhem;<br>- kam lindur;<br>- jetoj;<br>- i gjatë;<br>- i shkurtër;<br>- i shëndoshë;<br>- i dobët;<br>- kaçurrela;<br>- të shkurtra;<br>- kafe;<br>- të zinj;<br>- pëlqej;<br>- sjellja;<br>- parapëlqej. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- bën përshkrimin e vetes;<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit; | | **Situata e të nxënit**<br>Përshkrimi i vetes | |

| | |
|---|---|
| - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et;<br>- teksti mësimor;<br>- fletë A4;<br>- mjete shkrimi. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**

- stuhi mendimesh;
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën;
- lojë në role;
- imagjinatë e drejtuar.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- *Lojë në role*. Improvizohen situata të ndryshme në të cilat nxënësve/eve u duhet të paraqesin veten (njohja me një shok/shoqe të ri/re).
- *Stuhi mendimesh*. Nxënësit/et të grupuar në grupe thonë elementet e një përshkrimi të vetvetes që bëjnë në jetën e përditshme kur u nevojitet. Mendimet e nxënësve/eve plotësohen nga mësuesi/ja (të dhëna personale, cilësi fizike, çfarë i pëlqen të bëjë, cilësi të karakterit etj.).
- Orientohen nxënësit/et të punojnë ushtrimet në tekst.
- Nxënësit/et punojnë individualisht për plotësimin e ushtrimit të parë në libër. Në këtë ushtrim jepen pyetje, të cilave ata i përgjigjen me fjali të plota.
- Ushtrimi 2 punohet individualisht për plotësimin e fjalive me fjalët ndihmëse që janë dhënë në libër apo dhe me fjalë të tjera. Nxënësit/et pasi përfundojnë ushtrimin shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin. Edhe ushtrimi 3 punohet individualisht. Në këtë ushtrim plotësojnë fjalitë e paplota . Shkruajnë parapëlqimet e tyre për ngjyrat, kafshët, ushqimetetj. Shkëmbejnë fletoret në dyshe dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Ushtrimin 4. Imagjinatë e drejtuar. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të mbyllin sytë, pasi ka krijuar një mjedis të errët dhe me muzikë në sfond. Ai/ajo i orienton nxënësit/et të imagjinojnë sikur janë pas 15 vitesh dhe i lë në qetësi për pak minuta. Punohet individualisht për shkrimin e tri fjalive sipas imagjinatës. Lexohen në dyshe fjalitë e krijuara. Nxënësit/et vlerësojnë njëri-tjetrin për shpirtin krijues, ndërtimin e fjalive dhe drejtshkrimin e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- përshkrimin e vetes;
- shfaqjen e besimit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie:**

Shkruaj për veten sipas modelit të ushtrimit 3.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Diktim</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- quhem;<br>- kam lindur;<br>- jetoj;<br>- i gjatë;<br>- i shkurtër;<br>- i shëndoshë;<br>- i dobët;<br>- kaçurrela;<br>- të shkurtra;<br>- kafe;<br>- të zinj;<br>- pëlqej;<br>- sjellja;<br>- parapëlqej.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• Shkruan një tekst me të diktuar.<br>• Përdor shenjat e pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë).<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe për emra njerëzish, vendesh.<br>• Ndan saktë fjalët në fund të rreshtit.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Shkrimi i një teksti me të diktuar.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et;<br>- fletore ;<br>- mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia: Stuhi mendimesh,Diskutim, Punë individuale,<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Stuhi mendimesh. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të tregojnë rregullat drejtshkrimore që dinë (ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalisë,shkronja e madhe për emrat e njerëzve, vendeve etj.).<br>• Mësuesi/ja dikton pjesën.<br>• Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësuesit/es.<br>• Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar saktë përsëri.<br><br>Detyrë shtëpie: Mësoni 2 fjali përmendësh nga pjesa “të drejtat e fëmijëve” dhe bëjeni vetëdiktim.</td></tr>
</table>

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore**
Pyetje për mamin
(ora I)

**Fjalë kyçe:**
- lule;
- flutur;
- hënë;
- diell;
- zemër.

**Rezultatet e të nxënit**
Nxënësi/ja:
- Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.
- Lexon tekstin sipas roleve.
- Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.
- Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.
- Jep mendimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa.

**Situata e të nxënit**
Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:
- rreth mënyrës se si e kuptojnë vjershën;
- rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton vjersha;
- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.

**Burimet dhe materialet didaktike**
- teksti *Gjuha shqipe*;
- foto;
- fletë A4;
- lapsa me ngjyra etj.

**Lidhja me fushat e tjera**
- artet;
- teknologji dhe TIK;
- shoqëria dhe mjedisi.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- lexim me role;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Mësuesi/ja paraqet në video (foto) fëmijë me nënat e tyre, duke shëtitur, duke luajtur, duke u përqafuar. Nxënësit/et nxiten të diskutojnë rreth tyre.
- Paraqitet tema e mësimit. Nxënësit/et lexojnë vjershën në heshtje. Fjalët e reja veçohen dhe punohen bashkë me mësuesen. Ata/ato rilexojnë vargjet dhe shënojnë me të kuq pyetjet e vajzës dhe me blu përgjigjet e nënës. Diskutohet rreth personazheve, cilësive të tyre dhe përmbajtjes së vargjeve.
- Nxënësit/et punojnë në grup për të plotësuar tabelën:

| Strofa | Me çfarë e krahason veten vajza? | Çfarë është vajza për mamin e saj? |
|---|---|---|
| II | | |
| III | | |
| | | |

Lexohet vjersha në role.
- Punohen kërkesat e rubrikës “Reflektoj” dhe “Shkruaj”. Detyra e fundit mund të kryhet në shtëpi.

**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit sipas roleve;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit dhe cilësive të personazheve;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit .

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Pyes dhe përgjigjem<br>(ora I) | **Fjalë kyçe**<br>- pyes;<br>- përgjigjem;<br>- shkruaj. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- shkruan pyetje për përgjigjet e dhëna ose për figurat e dhëna;<br>- u përgjigjet pyetjeve me shkrim ;<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | **Situata e të nxënit**<br>- improvizimi i një interviste. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nx-ënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- foto;<br>- letër A4;<br>- mjete shkrimi. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- Lojë me role;
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Punë në dyshe. Lojë me role. Improvizohet një situatë ku nxënësit/et në dyshe intervistojnë njëri-tjetrin në rolin e gazetarit dhe të intervistuarit. Tema e intervistës është e lirë.
- Bëhet komenti i figurës duke diskutuar në grupe dhe individualisht nxënësit/et plotësojnë me pyetje e përgjigje tabelën e dhënë, duke u mbështetur te vjersha "Pyetje për mamin".
- Shkëmbejnë librat mes tyre dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit për strukturimin e pyetjeve dhe të përgjigjeve, si dhe drejtshkrimin e tyre.
- Ushtrimi i dytë punohet individualisht. Nxënësit/et në fillim lidhin pyetjet me fillimet e duhura të fjalive dhe pastaj plotësojnë fjalitë e paplota. Lexohen nga disa nxënës përgjigjet e pyetjeve.

**Vlerësimi bëhet për:**
- shkrimin e pyetjeve;
- përgjigjet e pyetjeve me shkrim;
- shfaqjen e besimit dhe të vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punëve të të tjerëve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 5 pyetje që do të doje t'ia drejtoje një shoku/shoqes tënd/e.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Pyes dhe përgjigjem<br>(ora II) | | **Fjalë kyçe**<br>- pyes;<br>- përgjigjem;<br>- shkruaj. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• shkruan pyetje për përgjigje e dhëna ose për figurat e dhëna;<br>• u përgjigjet pyetjeve me shkrim;<br>• shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>- improvizimi i një interviste. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti;<br>- foto;<br>- fleta A4. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**

- tabela e pyetjeve;
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Punë me gjithë klasën. Tabela e pyetjeve. Në një vend të posaçëm nxënësit/et shkruajnë pyetje të ndryshme që u vijnë në mend.

- Nxënësit/et lexojnë pyetjet që kanë shkruar shokët/shoqet dhe u përgjigjen atyre. Mësuesi/ja kujdeset që nxënësit/et të përgjigjen me fjali të plota.
- Nxënësit/et punojnë individualisht për ushtrimin 3 në të cilin nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve më shkrim ose shkruajnë përgjigjet për pyetjet e dhëna, pasi i plotësojnë këto të fundit. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit .
- Ushtrimi 4 në fillim diskutohet. Nxënësit/et përshkruajnë secilën figurë. Punohet individualisht për shkrimin e tri pyetjeve rreth figurës së parë dhe shkrimin e përgjigjeve përkatëse. pyetjet dhe përgjigjet e tyre lexohen e diskutohen.
- Figura e dytë mund të jepet detyrë shtëpie.

**Vlerësohen situata për:**

- shkrimin e pyetjeve;
- përgjigjet e pyetjeve me shkrim;
- shfaqjen e besimit dhe vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punëve të të tjerëve;
- bashkëpunimin në grup në kryerjen e një detyre.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Babushi im<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- babush;<br>- gatuajmë;<br>- ndihmoj;<br>- kampion;<br>- mbuloj;<br>- më i miri.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Diskutimi rreth kohës së lirë që kalojnë së bashku me babain.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>- diskutim, bisedë;<br>- ditari dypjesësh;<br>- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja fton nxënësit/et të mendojnë dhe të diskutojnë për babanë dhe kohën e lirë që kalojnë së bashku. Ajo paraqet temën. Nxënësit/et japin mendime e bëjnë parashikime rreth përmbajtjes së saj.<br>Ata/ato shohin figurën e tekstit. E përshkruajnë dhe e komentojnë në dyshe atë. Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit/et nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë.<br>• Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.<br>• Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.<br>• Nxënësit/et upërgjigjen pyetjeve të rubrikës “Lexoj dhe kuptoj”.<br>• Ditari dypjesësh. Nxënësit/et kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën që u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje dhe në anën tjetër shkruajnë komentin e tyre .<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;<br>- komentin për ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>- përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;<br>- lidhjen e pjesës që lexon me përvoja nga jeta e vet.<br>Detyrë shtëpie: Vizato veten tënde dhe babanë gjatë kohës së lirë.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Babush im<br>(ora II)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- babush;<br>- gatuajmë;<br>- ndihmoj;<br>- kampion;<br>- mbulon;<br>- më i miri.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin.<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Interpretimi që i bëjnë marrëdhënies që kanë personazhet në këtë pjesë, si dhe vlerësimi i marrëdhënieve që kanë me babanë e tyre .</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>lexo, përmblidh në dyshe;<br>diskutim, bisedë;<br>punë individuale;<br>punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Mësimi fillon me një bisedë me gjithë klasën të drejtuar nga mësuesi/ja ku nxënësit/et flasin për marrëdhëniet e tyre më babanë.<br>• Më pas përshkruajnë babanë e djalit, personazhit të kësaj pjese.<br>• Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir.<br>• Lexo, përmblidh në dyshe. Njëri/a nxënës/e lexon një paragraf dhe tjetri/a e përmbledh me 1-2 fjali. Për paragrafin në vazhdim ndërrohen rolet.<br>• Nxënësit/et tregojnë brendinë e pjesës me fjalët e tyre.<br>• Punohet rubrika “Reflektoj”, e cila zhvillohet si bisedë ndërmjet nxënësve/eve.<br>Vlerësimi bëhet për:<br>- bashkëpunimin në grupe;<br>- vlerësimin e njëri-tjetrit;<br>- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit;<br>- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të tekstit;<br>- ndarjen me të tjerët të përvojave rreth leximit;<br>- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>- mendimet që jep rreth tekstit;<br>- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.<br>Detyrë shtëpie: Rubrika “Shkruaj”.</td></tr>
</table>

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Pika dhe pikëpyetja | **Fjalë kyçe**<br>pikë;<br>pikëpyetje;<br>shenjë pikësimi;<br>fjali pyetëse;<br>fjali që tregojnë. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• përdor drejt pikën dhe pikëpyetjen në fund të fjalisë;<br>• përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë;<br>• demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | **Situata e të nxënit**<br>Shqyrtimi i fjalive pyetëse dhe treguese.<br>Vendosja e shenjave të pikësimit në fund të fjalive që tregojnë dhe që pyesin**.** |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe 2*;<br>letër A4;<br>mjete shkrimi. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- shoqëria dhe mjedisi;<br>- artet. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**

- hartë konceptesh;
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Punë në grup. Hartë konceptesh. Nxënësit/et, sipas grupeve, ndërtojnë një hartë konceptesh për shenjat e pikësimit që njohin (cilat janë, ku përdoren, në cilat raste përdoren etj.). Ata/ato tregojnë punët e tyre para klasës, kurse mësuesi/ja plotëson hartën e saj të koncepteve të paraqitur në tabelë. Mësuesi/ja ndalet te pika dhe pikëpyetja dhe paraqet temën e mësimit dhe përqendrohet te lidhja e llojit të fjalisë me shenjën e pikësimit në fund.
- Punë individuale. Ushtrimi 1. Në këtë ushtrim nxënësit/et vendosin shenjën e pikësimit dhe shkëmbejnë librat në dyshe për të vlerësuar njëri-tjetrin. Bëhet leximi i fjalive dhe tërhiqet vëmendja për intonacionin pyetës që marrin fjalitë që mbarojnë me pikëpyetje.
- Punë individuale. Ushtrimi 2. Ky ushtrim punohet individualisht. Duke u nisur nga ana kuptimore e fjalive vendosen shenjat e pikësimit dhe shënohen fjalitë me të cilat tregojmë. Nxënësit/et shkëmbejnë librat në dyshe dhe diskutojnë ushtrimin .
- Punë individuale. Ushtrimi 3. Në këtë ushtrim nxënësit/et vendosin shenjat e pikës e të pikëpyetjes, si dhe shkronjën e madhe në fillim të fjalive. Ushtrimi i përfunduar diskutohet nga gjithë klasa.
- Ushtrimi 4 mund të jepet detyrë shtëpie. Në këtë ushtrim nxënësit/et, pasi përshkruajnë figurën, ndërtojnë tri fjali që pyesin dhe tri fjali qe tregojnë.

**Vlerësimi bëhet për:**

- **përdorimin** drejt të pikës dhe pikëpyetjes në fund të fjalisë;
- përdorimin drejt të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- Vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Ç'ke harruar moj Valbonë? | **Fjalë kyçe:**<br>shkoj;<br>shkollë;<br>kthehem;<br>shtëpi;<br>harroj;<br>nxitoj;<br>gjyshe;<br>përqafoj. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• tregon elementet e vjershës si: strofa, vargu;<br>• parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• lexon vjershën;<br>• shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth vjershës;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin e vjershës;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet. | **Situata e të nxënit**<br><br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë poezinë; rreth interpretimeve të tyre në lidhje me poezinë;<br>rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi tek ata/ato vetë. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe*;<br>foto. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
harta e personazheve;
lexo, përmblidh në dyshe;
diskutim, bisedë;
lojë në role;
punë në çift, punë në grup;
punë individuale.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të shohin figurën, të lexojnë titullin dhe të bëjnë parashikimin për përmbajtjen e vjershës, duke punuar në dyshe. Ata/ato shkruajnë parashikimet e tyre në fletë dhe pastaj i lexojnë ato.
Lexohet vjersha në heshtje. Nxënësit/et tregojnë ndryshimet midis përmbajtjes së vjershës dhe parashikimit që i kanë bërë.
Punë në dyshe. Nxënësit/et duke punuar në dyshe lexojnë dhe e përmbledhin çdo strofë me 1-2 fjali. Njëri prej nxënësve/eve lexon dhe tjetri/a përmbledh. Pas çdo strofe ndërrohen rolet.

Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj".
Gjetjen e alternativës së duhur nxënësit/et e bëjnë individualisht.
Punë në dyshe. Harta e personazheve. Për personazhin e vjershës gjenden dy cilësi dhe ilustrohen me vargje nga vjersha.
Punohet rubrika "Reflektoj".
Pyetjen e tretë të kësaj rubrike nxënësit/et e konkretizojnë me lojë në role.
Nxënësit/et qarkojnë rrokjet e fundit të secilit varg në strofën e fundit dhe tregojnë që këto rrokje janë të njëjta, gjë e cila përbën dhe rimën e saj.

**Vlerësimi bëhet për:**

- diskutimet rreth mënyrës se si ata e kuptojnë poezinë;
- rreth interpretimeve të tyre në lidhje me poezinë;
- rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Në supermarket<br>(ora I) | | **Fjalë kyçe**<br>supermarket;<br>vitrinë;<br>det njerëzish;<br>përlotur;<br>vendi ku paguhej;<br>altoparlant;<br>i shqetësuar. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;<br>• mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të situatave që kanë lidhje me humbjen e njerëzve që na shoqërojnë në mjedise të ndryshme publike;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me këtë temë. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- lexim, mendim i drejtuar;
- diskutim;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Mësuesi/ja paraqet temën dhe fton nxënësit/et të bëjnë parashikime rreth përmbajtjes së pjesës.
- Më pas, nxënësit/et të vërejnë figurën në të djathtë të faqes. Ata/ato diskutojnë rreth saj, të ndarë në dyshe, e më pas të gjithë si klasë.
- Teksti lexohet me paragrafë, punohet fjalori dhe përmbajtja për çdo paragraf, bëhen parashikime për vazhdimin dhe mbylljen e ngjarjes.
- Nxënësit/et lexojnë në heshtje tekstin dhe në dyshe diskutojnë për ndryshimin e ngjarjes me parashikimin e bërë nga ta në fillim të orës.
- Nxënësit/et individualisht punojnë rubrikën“Lexoj dhe kuptoj“ në të cilën shënohen alternativat e duhura.

**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Në supermarket<br>(ora II) | | **Fjalë kyçe**<br>supermarket;<br>vitrinë;<br>det njerëzish;<br>përlotur;<br>vendi ku paguhej;<br>altoparlant;<br>i shqetësuar. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon tekstin sipas roleve.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa. | | 1.1.1<br>**Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të situatave që kanë lidhje me humbjen e njerëzve që na shoqërojnë në mjedise të ndryshme publike;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me këtë temë. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>Teksti Gjuha shqipe, foto | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**

- lexim me role;
- diskutim;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesi/ja organizon klasën në grupe treshe. Ai/ajo ndan rolet në çdo grup dhe kërkon nga nxënësit/et të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit/et të ndarë në treshe ushtrohen në lexim me zë sipas roleve.
- Punohet rubrika "Reflektoj". Diskutohet rreth pyetjeve dhe detyrave në këtë rubrikë. Nxënësit/et sjellin përvojat e tyre të ngjashme me atë të tregimit.
- Në pyetjen e dytë zgjedhin alternativën që mendojnë dhe japin argumentet e tyre për zgjedhjen e bërë.
- Në figurat e dhëna vendosin numrat sipas rendit të duhur dhe shkëmbejnë librat në dyshe për të vlerësuar njëri-tjetrin.
- Përmbajtjen e pjesës e ritregojnë, duke u mbështetur te figurat.

**Vlerësimi bëhet për:**

Leximin e tekstit sipas roleve.
Tregimin e ngjarjes duke respektuar strukturën e tekstit.
Lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.
Mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
Vlerësimin që u bën të tjerëve.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Zhvendosja e fjalëve në fjali<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>zhvendosje;<br>fjalë;<br>fjali;<br>ruaj kuptimin.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- zhvendos fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">1.1.2<br>Situata e të nxënit<br>Shqyrtim i fjalive dhe i grupeve të fjalëve të lëvizshme në fjali.<br>Zhvendosja e fjalëve në fjali pa prishur kuptimin e fjalisë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto;<br>- letër A4;<br>- mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- shoqëria dhe mjedisi;<br>- artet.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**

- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Punë në grup. Mësuesi/ja i shpërndan çdo grupi etiketat ku janë shkruar fjalët apo grupet e fjalëve: "çdo të diel, Ermali, shkon, në kinema" . Nxënësit/et i vendosin etiketat sipas radhës, duke formuar fjalinë e mësipërme.
- Mësuesi/ja i fton nxënësit/et e një grupi të dalin para klasës, duke mbajtur etiketat në duar. Ai/ajo kërkon që nxënësit/et të ndryshojnë vendin e tyre bashkë me etiketat, të cilat i mbajnë në mënyrë të tillë që të lexohen nga klasa. Fjalitë e formuara lexohen dhe diskutohen me klasën nëse janë formuar fjali të kuptimta në çdo rast. E njëjta veprimtari bëhet dhe për fjalinë: "Entela lexon libra në kohën e lirë" dhe fjali të tjera që ndërtojnë nxënësit/et ose i paraqet mësuesi/ja. Pasi diskutohet me të gjithë klasën kjo fjali plotësohet në libër.
- Punë në dyshe. Nxënësit/et paraprakisht kanë përgatitur etiketa për çdo fjali të dhënë në tabelën e ushtrimit 1. Provojnë duke i renditur etiketat në disa mënyra dhe shkruajnë njërën prej fjalive të kuptimta në tabelë. Diskutohet me gjithë klasën ky ushtrim dhe vlerësojnë punën që kanë bërë në dyshe.

**Vlerësimi bëhet për:**

- zhvendosjen e fjalëve në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Zhvendosja e fjalëve në fjali<br>(ora II)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>zhvendosje;<br>fjalë;<br>fjali;<br>ruaj kuptimin.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- zhvendos fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>- Shqyrtim i fjalive dhe i grupeve të fjalëve të lëvizshme në fjali.<br>- Zhvendosja e fjalëve në fjali pa prishur kuptimin e fjalisë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto;<br>- letër A4;<br>- mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- shoqëria dhe mjedisi;<br>- artet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>diskutim, bisedë;<br>punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja paraqet një foto/ video të shkurtër. Ai/ajo kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë rreth saj 1-2 fjali, të cilat i shkruan në tabelë. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et për të shkruar etiketa me fjalët/grupet e fjalëve të këtyre fjalive. Çdo grup zgjedh një prej këtyre fjalive dhe i rendit etiketat në mënyra të ndryshme, duke i vendosur dhe i zhvendosur për të formuar fjali të kuptimshme.<br>Punë në dyshe. Ushtrimi 2. Nxënësit/et paraprakisht kanë përgatitur etiketa për çdo grup fjalësh të shkruara në petalet e luleve. Ata/ato provojnë t'i rendisin etiketat në disa mënyra dhe shkruajnë dy prej fjalive të kuptimta poshtë lules. Ky ushtrim diskutohet me gjithë klasën. Vlerësohet puna e bërë në dyshe.<br>Punë individuale. Ushtrimi 3. Nxënësit/et përshkruajnë e komentojnë foton e dhënë në këtë ushtrim. Shkruajnë një fjali dhe ndërrojnë vendin e fjalëve pa ia prishur kuptimin fjalisë. Shkëmbejnë librat, diskutojnë dhe vlerësojnë në dyshe punën e njëri-tjetrit.<br>Vlerësimi bëhet për:<br>• zhvendosjen e fjalëve në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;<br>• paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;<br>• demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;<br>• respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;<br>• mënyrën e bashkëpunimit në grup;<br>• vlerësimin që u bën të tjerëve.<br><br>Detyrë shtëpie:<br>Ndërto edhe një fjali tjetër për figurën dhe ndërro vendin e fjalëve pa e prishur kuptimin e fjalisë.</td></tr>
</table>

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | Lënda<br>Gjuha shqipe | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Më solli mami dy bebe** | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë poezinë;<br>- rreth interpretimeve të tyre në lidhje me poezinë;<br>- rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi tek nxënësit/et. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon elementet e vjershës si: strofa, vargu;<br>- parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>- shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth vjershës;<br>- përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin e vjershës;<br>- lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet. | **Fjalë kyçe:**<br>- shtëpia e lindjes;<br>- dy bebe;<br>- motër;<br>- vëlla;<br>- çelin sytë;<br>- doçkat;<br>- faqet;<br>- puth. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe;*<br>foto. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- lexo, përmblidh në dyshe;
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup;
- punë individuale.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e vjershës.

Nxënësit/et shohin figurën, lexojnë titullin dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e vjershës duke punuar në dyshe. Parashikimet e tyre i shkruajnë në fletë dhe i lexojnë.

Lexohet vjersha në heshtje. Nxënësit/et tregojnë ndryshimet mes përmbajtjes së vjershës dhe parashikimit që bënë.

Punë në dyshe. Nxënësit/et duke punuar në dyshe lexojnë dhe e përmbledhin çdo strofë me 1-2 fjali. Njëri prej nxënësve/eve lexon dhe tjetri përmbledh. Pas çdo strofe ndërrohen rolet.

Punohet rubrika”Lexoj dhe kuptoj”.

Nxënësit/et bëjnë individualisht gjetjen e alternativës së duhur.

Punohet rubrika “Reflektoj”.

Duke u nisur nga përvojat vetjake nxënësit/et thonë si mund të ndihet një fëmijë kur bëhet me vëlla apo motër.

Nxënësit/et shkruajnë emra të cilët do të donin t’ia vendosnin binjakëve të vjershës.

Individualisht plotësojnë tabelën tek rubrika”Shkruaj”.

**Vlerësimi bëhet për:**
- diskutimet rreth mënyrës se si ata e kuptojnë poezinë;
- rreth interpretimeve të tyre në lidhje me poezinë;
- rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj me të kopjuar strofën që të pëlqen më shumë.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shkruaj për mamin dhe babin<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- quhet;<br>- flokët;<br>- sytë;<br>- i gjatë;<br>- i shkurtër;<br>- i shëndoshë;<br>- i dobët;<br>- kaçurrela;<br>- të shkurtra;<br>- kafe;<br>- të zinj;<br>- pëlqej;<br>- sjellja;<br>- parapëlqej;<br>- rrobat.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• bën përshkrimin e prindërve;<br>• shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>- Përshkrimi i prindërve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et;<br>- teksti mësimor;<br>- foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>stuhi mendimesh;<br>diskutim, bisedë;<br>shkrim i lirë;<br>punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Punë me gjithë klasën. Stuhi mendimesh. Nxënësit/et nën drejtimin e mësueses japin mendime dhe kujtojnë elementët e përshkrimit të një personi. Mësuesi/ja/si rendit në tabelë elementet që dalin nga diskutimi (të dhëna personale, cilësi fizike, çfarë i pëlqen të bëjë, cilësi të karakterit etj.).<br>• Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe më pas me gjithë klasën për prindërit e tyre.<br>• Punë individuale. Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 1, në të cilin plotësojnë tabelën e dhënë. Argumentojnë me gojë plotësimin e tabelës.<br>• Ushtrimi 2, plotësohet individualisht nga nxënësit/et (njëra skedë). Vëmendja tërhiqet te elementet e përshkrimit. Më pas ngjyroset figura.<br>• Shkrim i lirë. Nxënësve/eve u kërkohet të shkruajnë për nënën e tyre. U lihet një kohë 5-10 minuta. Lexohen shkrimet në dyshe. Japin mendim për punët e shokëve/shoqeve.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
- plotësimin e ushtrimeve dhe drejtshkrimin.
- përshkrimin e prindërve;
- shfaqjen e besimit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shkruaj për mamin dhe babin<br>(ora II)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- quhet;<br>- flokët;<br>- sytë,;<br>- i gjatë;<br>- i shkurtër;<br>- i shëndoshë;<br>- i dobët;<br>- kaçurrela;<br>- të shkurtra;<br>- kafe;<br>- të zinj;<br>- pëlqej;<br>- sjellja;<br>- parapëlqen;<br>- rrobat.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• bën përshkrimin e prindërve;<br>• shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përshkrimi i prindërve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nx-ënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br><br>Metodologjia:<br>• diskutim, bisedë;<br>• shkrim i lirë;<br>• punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Shkrim i shpejtë. Nxënësit/et shkruajnë një shkrim të shpejtë për njërin nga prindërit e tyre. Disa prej tyre i lexojnë ato.</td></tr>
</table>

- Punë individuale. Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 3 në të cilin plotësojnë skedën e dhënë (atë që nuk e plotësuan orën e parë). Vëmendja tërhiqet edhe një herë te elementët e përshkrimit duke i kujtuar ato. Ngjyrosin figurën e dhënë.
- Ushtrimi 4 plotësohet individualisht nga nxënësit/et. Në këtë ushtrim ata/ato shkruajnë nga dy fjali për mamin dhe babin e tyre. Shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë punën e shokut/shoqes.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin e prindërve;
- shfaqjen e besimit, gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punës së të tjerëve.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shtojmë dhe heqim fjalë në fjali<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- heq;<br>- shtoj;<br>- fjalë;<br>- fjali;<br>- ruaj kuptimin.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- shton fjalë në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;<br>- heq fjalë nga një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>- Manipulime me grupe fjalësh brenda fjalisë.<br>- Shtimi dhe heqja e fjalëve në fjali pa prishur kuptimin e fjalisë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto;<br>- informacione nga interneti;<br>- letër A4;<br>- mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- shoqëria dhe mjedisi;<br>- arte.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br><br>Metodologjia:<br>• diskutim, bisedë;<br>• punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Punë në grup. Mësuesi/ja i shpërndan çdo grupi etiketat: Eni, luan, pasditeve, në breg të detit, me top. Me orientimin e mësuesit/es nxënësit/et shkruajnë fjalinë e vogël dhe ai/ajo drejton pyetjet: Kur? Ku?Me çfarë? dhe nxënësit/et shtojnë nga një etiketë.<br>• Nxënësit/et i shtojnë etiketat sipas radhës duke formuar fjalinë: Eni luan pasditeve në breg të detit me top. Kjo situatë konkretizohet me ilustrimet në tekst.</td></tr>
</table>

- Punë individuale. Ushtrimi 1. Nxënësit/et punojnë individualisht . Lexojnë pyetjet dhe plotësojnë fjalinë me etiketën që i përgjigjet kësaj pyetjeje. Shkëmbejnë fletoret me shokun e bankës dhe lexojnë fjalitë për t'i diskutuar me gjithë klasën.
- Punë individuale. Ushtrimi 2. Në këtë ushtrim nxënësit/et shtojnë nga një fjali në secilin rast. Shkëmbejnë librat dhe e diskutojnë plotësimin e ushtrimit me gjithë klasën.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shtimin e e fjalëve në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shtojmë dhe heqim fjalë në fjali<br>(ora II)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- heq;<br>- shtoj;<br>- fjalë;<br>- fjali;<br>- ruaj kuptimin.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- shton fjalë në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;<br>- heq fjalë nga një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>- Shtimi dhe heqja e fjalëve në fjali pa prishur kuptimin e fjalisë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>teksti Gjuha shqipe;<br>foto;<br>letër A4;<br>mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- shoqëria dhe mjedisi;<br>- arte.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- diskutim, bisedë;
- punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Punë në grup**.** Mësuesi/ja i shpërndan çdo grupi etiketat, të cilat i ka përgatitur më parë dhe nxënësit/et, duke punuar në grupe, formojnë fjali me to.
- Me orientimin e mësuesit/es nxënësit/et shtojnë ose heqin etiketa në fjalitë e ndërruara.
- Punë në dyshe. Ushtrimi 3. Nxënësit/et punojnë në dyshe, diskutojnë heqjen etiketave dhe përdorin e pyetjeve ndihmëse. Pastaj e plotësojnë individualisht librin. Fjalitë i lexojnë dhe i diskutojnë me gjithë klasën.

- Punë individuale. Ushtrimi 4. Në këtë ushtrim nxënësit/et vendosin kryq te fjalët që mund të heqin nga fjalitë në secilin rast. Shkëmbejnë librat dhe e diskutojnë kryerjen e ushtrimit së bashku.
- Shkruajnë fjalitë e vogla në ushtrimin e mësipërm në fletore individualisht.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shtimin e fjalëve në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimeve të tij/saj;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

**Detyrë shtëpie:**

Shkruaj 2 fjali. Në njërën shto fjalë, kurse në tjetrën hiq fjalë, pa e prishur kuptimin e tyre.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Pipi feston ditëlindjen<br>(ora I)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën;<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me festimin e ditëlindjeve me miqtë dhe shokët e shoqet e tyre;<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që i pëlqejnë më shumë. Pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>Përcakton dy-tri tipare të tregimeve.<br>Shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit. Dallon elementet e tekstit paragrafin, rreshtin.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>- festë;<br>- vishem bukur;<br>- dhuratë;<br>- paketuar;<br>- vend i ndriçuar;<br>- urime;<br>- lodër muzikore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>teksti Gjuha shqipe;<br>informacione nga interneti,<br>libri “Pipi Çorapegjata”</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>parashikim me terma paraprakë;<br>procedura: pyet sërish;<br>diskutim, bisedë;<br>punë individuale;<br>punë në dyshe, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja shkruan në tabelë këto fjalë: Pipi, ditëlindje, festë, vishem bukur, dhuratë. Ai/ajo kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë në dyshe një histori të shkurtër me 4-5 fjali, duke përdorur fjalët e dhëna. Disa nga dyshet lexojnë historinë e tyre para klasës.<br><br>• Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën. Nxënësit/et në dyshe, e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth saj, duke treguar si ndihmon ajo për të kuptuar më mirë tekstin.</td></tr>
</table>

- Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit me paragrafë. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante e më të rëndësishme. Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe nxënësi/ja tjetër i përgjigjet pyetjeve. (Nxënësit/et, ndërrojnë rolet për çdo paragraf të ri.)
- Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë. Mësuesi/ja diskuton me nxënësit/et, punon fjalorin dhe rubrikën "Lexoj e kuptoj". Nxënësit/et vendosin shenjën tek alternativa e saktë. Diskutojnë rreth tyre me të gjithë klasën.

**Vlerësimi bëhet për:**

njohjen e elementeve të tekstit( paragrafi, rreshti);
leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që i pëlqejnë më shumë;
pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
shfaqjen e besimit dhe të vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;
vlerësimin që u bën të tjerëve;
mënyrën e bashkëpunimit në grupe.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Pipi feston ditëlindjen<br>(ora II)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me festimin e ditëlindjeve me miqtë dhe shokët e shoqet e tyre;<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit;<br>- përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e parapëlqyera;<br>- lexon me role pjesën;<br>- luan me role pjesën;<br>- ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- festë;<br>- vishem bukur;<br>- dhuratë;<br>- paketuar;<br>- vend i ndriçuar;<br>- urime;<br>- lodër muzikore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>teksti Gjuha shqipe;<br>foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
harta e personazheve
diskutim, bisedë;
lojë me role;
punë në çift, punë në grup.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Punë në grup. Harta e personazheve. Mësuesi/ja drejton pyetje rreth përmbajtjes dhe ndalet te personazhet. Kërkon nga nxënësit/et të gjejnë dy cilësi për secilin personazh duke treguar në tekst pjesën që i tregon këto cilësi.




Nxënësit/et lexojnë pjesën me lexim zinxhir.

- Punohet ushtrimi i parë në rubrikën "Reflektoj" dhe shkëmbehen librat. Për ushtrimin e tretë në këtë rubrikë bëhet një bisedë rreth përgatitjeve që bëjnë kur shkojnë te ditëlindjet e miqve të tyre.
- Mësuesi/ja organizon klasën në grupe me nga 4 anëtarë për të improvizuar një lojë me role. Nxënësit/et interpretojnë situatën e paraqitur në tekst. Ata /ato vlerësojnë lojën e secilit grup.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth pjesës që lexon;
- përshkrimin e personazheve;
- lojës me role;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij/saj;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Urime për ditëlindje<br>(ora I) | | **Fjalë kyçe:**<br>- ditëlindje;<br>- urim;<br>- dhuratë;<br>- festë | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- studion modele të gatshme të urimeve për ditëlindje;<br>- shkruan një urim për një ditëlindje;<br>- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i urimeve për ditëlindje. | |

<table>
<tr>
<td>Burimet dhe materialet didaktike<br>teksti Gjuha shqipe;<br>foto;<br>informacione nga interneti;<br>kartolina;<br>letër A4;<br>mjete shkrimi.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>diskutim, bisedë;<br>tryezë e rrumbullakët;<br>punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja orienton klasën të diskutojë në grupe të vogla për festimet e ditëlindjeve të tyre (urimet që marrin, dhuratat që u sjellin, miqtë që ftojnë, ambientet ku i organizojnë etj.). Biseda ndalet në strukturën e urimeve dhe në drejtshkrimin e tyre (fjali të shkurtra që duan pikëçuditje në fund).<br>Ushtrimi 2, punë individuale. Nxënësit/et u përgjigjen me shkrim pyetjeve rreth organizimit të ditëlindjes dhe dhuratave që duan të marrin. Shkëmbejnë fletoret mes tyre dhe diskutojnë e komentojnë punimet e njëri-tjetrit.<br>Ushtrimi 3. Tryezë e rrumbullakët. Nxënësit/et të vendosur në mënyrë rrethore shkruajnë nga një urim për ditëlindje. Lexohen urimet sipas grupeve.<br>Vlerësimi bëhet për:<br>- shkrimin e një urimi për një ditëlindje;<br>- studimin e modeleve të gatshme të urimeve për ditëlindje;<br>- bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;<br>- shfaqjen e besimit të vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerësimin e punëve të të tjerëve;<br>- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grup;<br>- vlerësimin që u bën të tjerëve.</td>
</tr>
</table>

<table>
<tr>
<td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td>
<td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td>
<td>Klasa 2</td>
<td>Data</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Tema mësimore<br>Urime për ditëlindje<br>(ora II)</td>
<td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- ditëlindje;<br>- urim;<br>- dhuratë;<br>- festë.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- studion modele të gatshme të urimeve për ditëlindje;<br>- shkruan një urim për një ditëlindje;<br>- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td>
<td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Shkrimi i urimeve për ditëlindje.</td>
</tr>
</table>

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| teksti *Gjuha shqipe*;<br>foto;<br>letër A4;<br>mjete shkrimi. | - artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
diskutim, bisedë;
tryezë e rrumbullakët;
punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Diskutojnë në grupe të vogla për festimet e ditëlindjeve të tyre (urimet që marrin, dhuratat që u sjellin, miqtë që ftojnë , ambientet ku i organizojnë etj.).
Ushtrimi 4. Punë në dyshe. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe për urimin që do t'i bënin Pipit. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të kujtojnë karakterin e Pipit që urimi t'i përshtatet karakterit të saj. Shkruajnë urimin në fletore dhe shkëmbejnë fletoret mes tyre. Ata japin vlerësim për shkrimin e urimit dhe gabimet drejtshkrimore.
Ushtrimi 4. Nxënësit/et shkruajnë 5 nga urimet që u kanë pëlqyer më tepër . Lexohen disa prej tyre, pasi janë shkëmbyer fletoret në dyshe.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shkrimin e një urimi për një ditëlindje;
- studimin e modeleve të gatshme të urimeve për ditëlindje;
- bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses
- shfaqjen e besimit të vullnetit dhe të shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punëve të të tjerëve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

**Detyrë shtëpie:**

Shkruaj dy prej urimeve që të pëlqyen më shumë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore** | **Situata e të nxënit** |
|---|---|
| Fjalori, shtëpia e fjalëve<br>(ora I) | Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë për:<br>- mënyrën se si e bëjnë lidhjen e pjesës me jetën e tyre të përditshme;<br>- përdorimin e një fjalori;<br>- interpretimin e tyre në lidhje me faktet që sjell pjesa;<br>- informacionet dhe kuriozitetet e sjella nga vetë ato/ata. |

| **Rezultatet e të nxënit** | **Fjalë kyçe** |
|---|---|
| Nxënësi/ja:<br>- lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra qe i duken interesante;<br>- tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>- ndan me të tjerët përvojat rreth leximit;<br>- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë;<br>- pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>- rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë pjesën;<br>- nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë;<br>- lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tyre etj. | - fjalori;<br>- shtëpia e fjalëve;<br>- libër;<br>- fjalë;<br>- shpjegim;<br>- radhitje sipas alfabetit, |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe*;<br>foto;<br>letër A4;<br>fjalorë. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
role të specializuara në diskutim;
hartë konceptesh;
diskutim, bisedë;
punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Nxënësit/et janë porositur me parë që të kërkojnë e të gjejnë materiale, kuriozitete për fjalorët. Ndërtohet një hartë konceptesh për fjalorët duke punuar me gjithë klasën.

Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit.

- Lihen nxënësit/et që të lexojnë pjesën në heshtje. U lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë. Nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe pjesët që u duken më interesante.
- Punë në grup. Role të specializuara në diskutim.

  Nxënësit/et marrin nga një rol, të cilin e përcakton mësuesi/ja.
  - Gjetësi i citimeve duhet të zgjedhë pjesë të caktuara nga teksti (i cakton mësuesi/ja).
  - Hulumtuesi, i cili ka për detyrë të japë informacion paraprak për fjalorët.
  - Bërësi i pyetjeve, i cili duhet të shkruajë pyetje që dëshiron t'i diskutojë me të tjerët.
  - Gjetësi i fjalëve, i cili duhet të gjeje fjalë të rëndësishme për të diskutuar.
  - Ilustruesi duhet të bëjë ilustrimin e fjalorëve të ndryshëm.
  - Gjurmuesi, ka për detyrë të gjejë vendet ku janë përdorur fjalorët e parë.

Grupet mund të bëjnë ndonjë paraqitje të materialeve më interesante që kanë punuar në grup.

**Vlerësimi bëhet për:**

- Leximin e tekstit joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra q*ë i* duken interesante.
- Tregimin e interesit dhe të dëshirës për të lexuar tekstin.
- Ndarjen me të tjerët të përvojave rreth leximit.
- Respektin ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexohen.
- Pyetjet qe bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- Nënvizimin gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë.

| |
|---|
| - Lidhjen e pjesës që lexon me përvoja nga jeta e tij/saj etj.<br>- Mënyrën e bashkëpunimit në grup.<br>- Vlerësimin që u bën të tjerëve. |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Fjalori, shtëpia e fjalëve<br>(ora II) | | **Situata e të nxënit**<br>- Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë për:<br>- mënyrën se si e bëjnë lidhjen e pjesës me jetën e tyre të përditshme;<br>- përdorimin e një fjalori;<br>- interpretimin e tyre në lidhje me faktet që sjell pjesa;<br>- informacionet dhe kuriozitetet të sjella nga vetë ata/ato. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- Lexon tekstin joletrar.<br>- Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar.<br>- Ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit.<br>- Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.<br>- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>- Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tij/saj etj. | | **Fjalë kyçe:**<br>- fjalori;<br>- shtëpia e fjalëve;<br>- libër;<br>- fjalë;<br>- shpjegim;<br>- radhitje sipas alfabetit. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto;<br>- letër A4;<br>- fjalorë. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**<br><br>**Metodologjia:**<br>• lexo përmblidh në dyshe;<br>• diskutim, bisedë;<br>• punë në çift, punë në grup.<br><br>**Veprimtaritë e nxënësve/eve**<br>• Punë në çift. Lexo përmblidh në dyshe. Nxënësit/et në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ata/ato konfirmojnë ato që kanë mësuar një orë më parë dhe kanë mundësi të përdorin lloje të ndryshme të të menduarit.<br>• Punohet rreth rubrikës "Reflektoj". Nxënësit/et punojnë në grupe të vegjël (kjo varet nga numri i fjalorëve që janë sjellë në kasë) për të gjetur kuptimin e fjalëve të reja për ta/to.<br>•<br>• Në grupe përsëri, punojnë për ndërtimin e një fjalori të thjeshtë, duke ndjekur këto hapa: *gjetja e fjalëve, shpjegimi i tyre, renditja e fjalëve sipas rendit alfabetik në fjalor*. Paraqesin punët e tyre te grupet e tjera dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.<br>Detyra për të shkruar emrat e shokëve/shoqeve sipas rendit alfabetik niset në klasë me ndihmën e mësuesit/es dhe mund të përfundohet në shtëpi. | | | |

**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstin joletrar;
- interesin dhe dëshirën për të lexuar pjesën;
- pranimin e ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>- Flasim për festat | | **Fjalë kyçe:**<br>- festa;<br>- familje;<br>- ditëlindje;<br>- Dita e Librit;<br>- Dita e Karnavaleve;<br>- Dita e Verës;<br>- Dita e Luleve;<br>- Dita e Mjedisit;<br>- 1 Qershori. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- diskuton në grupe të vogla për temën e festimit të festave;<br>- respekton rregullat e të folurit gjatë punës në grupe të vogla;<br>- shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota kur u përgjigjet pyetjeve;<br>- pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij;<br>- demonstron siguri kur flet në klasë;<br>- përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit;<br>- shoqëron të folurin me shprehjen e duhur të fytyrës dhe gjestet e përshtatshme;<br>- është aktiv në diskutime, në punë në grup ose në veprimtari të tjera të klasës, ose të shkollës;<br>- merr nismë dhe nxit të tjerët të bashkëbisedojnë. | | **Situata e të nxënit**<br>Biseda, diskutime, planifikime për festat që festojnë . | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe*;<br>foto;<br>letër A4;<br>mjete shkrimi. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**<br>**Metodologjia:**<br>stuhi mendimesh;<br>diskutim, bisedë;<br>punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve/eve**<br>Mësuesi/ja fton nxënësit/et të japin mendime në lidhje me festat; stuhi mendimesh. | | | |

Punë në dyshe. Ushtrimi 1. Nxënësit/et në dyshe shohin fotot dhe diskutojnë rreth tyre. I tregojnë njëri-tjetrit se si festohen këto festa në familjet e tyre duke treguar dhe foto të sjella nga albumi i familjes.
Ushtrimi 2, zhvillohet si një bisedë dhe nxënësit/et flasin për festat e tyre të parapëlqyera .
Ushtrimi 3, në ketë ushtrim nxënësit/et diskutojnë për zgjidhjet që mendojnë t'i japin situatës. Argumentojnë këto zgjidhje.
Ushtrimi 4 bëhet individualisht. Në këtë ushtrim nxënësit/et shkruajnë veprimtaritë që do të bëjnë çdo muaj në vazhdim, duke u mbështetur te festat përkatëse. Ata/ato bëjnë propozime konkrete për organizimin e këtyre festave. Për këtë gjë punojnë në grupe. Çdo grup punon për mënyrën e organizimit dhe të festimit të saj.

**Vlerësimi bëhet për:**

- respektimin e rregullave të të folurit gjatë punës në grupe të vogla;
- shprehjen saktë e kuptueshëm dhe me fjali të plota kur u përgjigjet pyetjeve;
- pyetjet, përgjigjet, shprehjet e mendimit, ndjenjave dhe emocioneve të tij/saj;
- diskutimin në grupe të vogla për temën e festimit të festave;
- demonstrimin e sigurisë, kur flet në klasë;
- përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit;
- të qenët aktiv në diskutime, në punë në grup ose në veprimtari të tjera të klasës ose shkollës;
- marrjen e nismës dhe nxitjen e të tjerëve në bashkëbisedim;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br><br>Biskota dhe pulla poste<br>(ora I) | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me ngatërresa që bëhen për mungesën e vëmendjes apo hutimit në gjëra të tjera;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- Dallon elementet e tekstit si paragrafi.<br>- Lexon tregimin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që u pëlqejnë më shumë.<br>- Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>- Shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit. | **Fjalë kyçe**<br>- postë;<br>- pullë;<br>- biskota;<br>- zarf;<br>- lojë. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe*;<br>informacione nga interneti;<br>pulla poste. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

- parashikim me terma paraprakë;
- procedura: pyet sërish;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë këto fjalë: *postë, pullë, biskota, zarf, lojë*. Ai/ajo kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë në dyshe një histori të shkurtër me 4-5 fjali, duke përdorur këto fjalë. Disa prej tyre lexojnë historinë e tyre para klasës.

- Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën. Nxënësit/et në dyshe, e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth saj, duke treguar si ndihmon ajo për të kuptuar më mirë tekstin.
- Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit me paragrafë. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante, më të rëndësishme. Pas leximit të çdo paragrafi, nxënësit/et diskutojnë në dyshe: njëri/a prej tyre ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri/a i përgjigjet pyetjeve. (Për çdo paragraf të ri nxënësit/et, ndërrojnë rolet.)
- Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë. Mësuesi/ja diskuton me nxënësit/et, punon fjalorin dhe rubrikën: "Lexoj e kuptoj". Nxënësit/et vendosin shenjën tek alternativa e saktë dhe diskutojnë rreth tyre me të gjithë klasën.

**Vlerësimi bëhet për:**

- njohjen e elementeve të tekstit (paragrafi, rreshti);
- leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që u pëlqejnë;
- pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- shfaqjen e besimit dhe të vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Biskota dhe pulla poste<br>(ora II)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me ngatërresa që bëhen për mungesën e vëmendjes apo hutimit në gjëra të tjera;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit/es;<br>- përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë preferuarat parapëlqyerit;<br>- luan me role pjesën;<br>- ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>- postë;<br>- pullë;<br>- biskota;<br>- zarf;<br>- lojë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto;<br>- informacione nga interneti.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:**
- harta e personazheve;
- diskutim, bisedë;
- lojë me role;
- punë në çift, punë në grup.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Mësuesi/ja organizon klasën në grupe katërshe. Ai/ajo ndan rolet në çdo grup (babi, mami, autori, vogëlushi) dhe kërkon nga nxënësit/et të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit/et ushtrohen në lexim me zë sipas roleve.
- Punë në grup. Harta e personazheve. Nxënësit/et shkruajnë për personazhin kryesor dy cilësi. Për secilën cilësi shkëputet një pjesë ilustruese nga teksti.




- Në rubrikën "Reflektoj" nxënësit/et tregojnë dhe diskutojnë rreth historive të ngjashme që mund t'u kenë ndodhur.
- Diskutojnë në dyshe për mbyllje të tjera dhe i tregojnë ato.

**Vlerësimi bëhet për:**
- shprehjen e ndjenjave dhe të mendimeve personale rreth pjesës që lexon;
- përshkrimin e personazheve;
- lojën me role;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të veta;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një mbyllje tjetër.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Gazmore për fëmijë | | **Fjalë kyçe**<br>- gazmore;<br>- e qeshura;<br>- buzëqeshje;<br>- argëtim. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së gazmoreve;<br>- tregon shkurtimisht përmbajtjen e gazmoreve duke e ilustruar me detaje; | | **Situata e të nxënit**<br>Dëgjimi dhe tregimi i gazmoreve.<br>Shqyrtimi i situatave gazmore. | |

| | |
|---|---|
| - shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të gazmoreve;<br>- veçon detaje interesante gjatë të dëgjuarit tyre;<br>- shfaq vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe*;<br>foto;<br>libra humoristikë;<br>letër A4;<br>mjete shkrimi. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Metodologjia:**
- stuhi mendimesh;
- dëgjim;
- lojë më role;
- diskutim, bisedë, punë në çift,punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Veprimtari me gjithë klasën. Mësuesi/ja fton nxënësit/et për të bërë stuhi mendimesh për gazmoret. Nxënësit/et thonë ç'dinë për gazmoret .
- Bëhet dëgjimi i gazmoreve për fëmijë një e nga një. Diskutohet rreth përmbajtjes së tyre dhe atmosferës së gëzueshme që ato përcjellin.
- Hapen librat dhe nxënësit/et lexojnë në heshtje gazmoret dhe me shokun/shoqen e bankës zgjedhin njërën prej tyre për ta luajtur me role. Këto biseda të gëzueshme i interpretojnë para klasës. Vlerësojnë njëri-tjetrin për këtë veprimtari.
- Punohet ushtrimet në tekst. Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve dhe diskutojnë rreth tyre.
- Në ushtrimin 2, nxënësit/et vlerësojnë gazmoret e dëgjuara, duke shkëputur atë që u ka pëlqyer më shumë dhe e tregojnë me fjalët e tyre. Tregojnë dhe gazmore të tjera.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së gazmoreve;
- tregimin shkurtimisht të përmbajtjes së gazmoreve, duke e ilustruar me detaje;
- shprehjen e përjetimeve dhe emocioneve që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të gazmoreve;
- veçimin e detajeve interesante gjatë të dëgjuarit tyre;
- shfaqjen e vullnetit dhe besimit gjatë kryerjes së detyrave;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

# Moduli 3

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Dy shokët dhe një ari<br>(ora I) | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën,<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa, se shokët nuk braktisen asnjëherë;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon elementet e tekstit paragrafin, rreshtin;<br>- lexon fabulën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që u pëlqejnë më shumë; | **Fjalë kyçe:**<br>- shok;<br>- sa çel e mbyll sytë;<br>- ari; |

<table>
<tr><td>- pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>- përcakton dy-tre tipare të fabulave;<br>- shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit.</td><td>- u shtri përdhe;<br>- të vdekurit;<br>- pemë;<br>- mbath.</td></tr>
<tr><td>Burimet dhe materialet didaktike<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- informacione nga interneti.</td><td>Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**

- parashikim me terma paraprakë;
- lexim dhe mendim i drejtuar;
- diskutim, bisedë;
- imagjinatë e drejtuar;
- punë në çift, punë në grup, punë individuale.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët:
- shok;
- sa çel e mbyll sytë;
- ari;
- u shtri përdhe;
- pemë.

Ai/ajo kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë në dyshe një histori të shkurtër me 4-5 fjali, duke përdorur këto fjalë. Disa nga dyshet lexojnë historinë e tyre para klasës.
Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit të ndarë në pjesë (pjesa e parë: ...u shtir si i vdekur; pjesa e dytë: ...kur ariu u largua; pjesa e tretë: ...ia mbathi në rast rreziku). Në secilën pjesë nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante. Mësuesi/ja gjatë diskutimit me nxënësit/et punon fjalorin për çdo pjesë dhe pyetjet rreth përmbajtjes, së bashku bëjnë parashikime për pjesën në vazhdim. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit/et të argumentojnë parashikimin e bërë.
Në përfundim të punimit të të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta lexojnë sërish për ta kuptuar më mirë.
Nxënësit/et punojnë në rubrikën “Lexoj e kuptoj” .
Shkëmbejnë librat për të vlerësuar njëri-tjetrin.
Diskutohet për llojin e pjesës dhe karakteristikat e saj (është fabul, në fund jepet morali saj etj).

**Vlerësimi bëhet për:**

- njohjen e elementeve të tekstit (paragrafi, rreshti);
- leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që u pëlqejnë më shumë;
- pyetjet që bën për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- përcaktimin e dy-tri tipare të tregimeve;
- shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dy shokët dhe një ari<br>(ora II)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa, se shokët nuk braktisen asnjëherë;</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | - rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit/es;<br>- përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e parapëlqyer;<br>- luan me role pjesën;<br>- ndan me të tjerët/at përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | **Fjalë kyçe:**<br>- shok;<br>- sa çel e mbyll sytë;<br>- ari;<br>- u shtri përdhe;<br>- të vdekurit;<br>- pemë;<br>- mbath. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- informacione nga interneti. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** lojë me role, harta e personazheve, diskutim, bisedë, Diagrama e Venit, punë në çift, punë në grup, punë individuale.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Mësuesi/ja organizon klasën në grupe treshe. Ai/ajo ndan rolet në çdo grup (shokët, autori) dhe kërkon nga nxënësit/et të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit/et të ndarë në treshe do të ushtrohen në lexim me zë sipas roleve.

Përmbajtja e fabulës tregohet në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.

Punë në dyshe: "Diagrami i Venit" . Nxënësit/et shkruajnë cilësitë e përbashkëta dhe të veçanta për personazhet e fabulës.

Paraqesin punët e tyre dhe i diskutojnë me gjithë klasën.

Në rubrikën "Reflektoj" nxënësit/et diskutojnë rreth thënies që mbyll fabulën. Këtë thënie e lidhin me përvojat e veta, duke treguar ngjarje nga jeta e tyre.

Individualisht kopjojnë dialogun ndërmjet dy shokëve.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shprehjen e ndjenjave dhe të mendimeve personale rreth pjesës që lexon;
- përshkrimin e personazheve;
  lojën me role;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij/saj;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- besimin dhe vullnetin që shfaq në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një mbyllje tjetër për pjesën.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Emri<br>(ora I) | | **Situata e të nxënit**<br>Gjetja dhe përdorimi i emrave të llojeve të ndryshme në fjali e tekste.<br>Dallimi i emrave të llojeve të ndryshme. | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh, vendesh;<br>- gjen emrat në një tekst;<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;<br>- demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.. | **Fjalë kyçe:**<br>emër, emra njerëzish, emra kafshësh, emra sendesh, emra vendesh. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- etiketa me emra, A4. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** hartë konceptesh, diskutim, bisedë, lojë me role, punë në çift, punë në grup.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Nxënësit/et punojnë në grupe për të ndërtuar hartë konceptesh për emrin. Mësuesi/ja plotëson një hartë konceptesh në tabelë, duke u mbështetur te puna në grupe e nxënësve/eve (emra njerëzish, kafshësh, njerëzish, sendesh etj., si dhe shembuj për secilin rast). Ai/ajo ndalet në faktin që emrat janë fjalë që tregojnë edhe dukuri, edhe pjesë të trupit të njeriut apo kafshës, edhe ndjenjë etj., duke bërë edhe konkretizimin me shembuj.

Lexohet rubrika "Mbaj mend" dhe mësuesi/ja bën sqarimet për pyetje që nxënësit/et mund të kenë.

Punë individuale. Ushtrimi 1. Në këtë ushtrim nxënësit/et pasi lexojnë tekstin, vendosin fjalët e nënvizuara në tabelën e dhënë. Shkëmbejnë librat për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 2 punohet individualisht. Plotësohet ushtrimi 2 në libër. Diskutohet me gjithë klasën për llojet e emrave që kanë përdorur për të plotësuar tekstin.

**Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e fjalëve që tregojnë emra njerëzish, sendesh, kafshësh, vendesh;
- gjetjen e emrave në një tekst;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij/saj;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Emri<br>(ora II) | | **Situata e të nxënit**<br>Gjetja e përdorimi i emrave të llojeve të ndryshme në fjali e tekste. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon fjalët që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh, vendesh;<br>- gjen emrat në një tekst;<br>- përdor emra të llojeve të ndryshëm në fjali;<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj; | | **Fjalë kyçe:**<br>emër, emra njerëzish, emra kafshësh, emra sendesh, emra vendesh. | |

| | |
|---|---|
| - demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- etiketa me emra, A4. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** tryezë e rrumbullakët; diskutim, bisedë; punë në çift, punë në grup,

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Nxënësit/et punojnë në grupe –Tryezë e rrumbullakët. Nxënësit/et të vendosur në formë rrethore me radhë shkruajnë emra të ndryshëm në një fletë. E palosin fletën në formën e firzamonikës. Në fund e hapin atë dhe prezantojnë punën e tyre. Bëjnë përcaktimin e llojeve të emrave.(emra njerëzish, kafshësh, sendesh , vendesh etj )

Punë individuale-Ushtrimi 3 Në këtë ushtrim nxënësit/et nënvizojnë me ngjyra të ndryshme emra të njerëzve, kafshëve dhe sendeve. Mësuesi/ja u tregon nxënësve/eve se fjalë të tilla si shpejtësi janë emra. Shkëmbejnë librat për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 4 punohet individualisht . Nxënësit/et gjejnë emra që tregojnë njeri, kafshë, send, vend. Ndërtojnë nga një fjali me këto emra. Diskutohet me gjithë klasën puna e bërë e vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e fjalëve që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh, vendesh
- gjetjen e emrave në një tekst.
- përdorimin e emrave në fjali
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Ndihmojmë së bashku<br>(ora I) | | **Fjalë kyçe:**<br>shok, i sëmurë, ndihmonim, kurajë, punë të përbashkë-ta, skuadër, forcuam shoqërinë. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>- Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto, albume të familjeve të nxënësve/eve. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** Parashikim me terma paraprakë; diskutim, bisedë; punë individuale; punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesi/ja shkruan në tabelë: shok, u sëmur, ndihmoj, skuadër, forcoj shoqërinë. Në vijim kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë një histori të shkurtër (4-5 fjali) duke përdorur fjalët e dhëna.
- Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën në të djathtë të faqes. Nxënësit/et në dyshe, e më pas të gjithë së bashku diskutojnë rreth saj.
- Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit në heshtje të ndarë në paragrafë. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante dhe më të rëndësishme.
- Mësuesi/ja fton në diskutim nxënësit/et për punimin e fjalorit dhe të pyetjeve rreth përmbajtjes.
- Lexohet pjesa zinxhir.
- Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta rilexojnë pjesën.
- Në rubrikën "Lexoj dhe kuptoj" radhitin fjalitë e dhëna sipas radhës së kryerjes së veprimeve. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe lexojnë radhitjen e bërë.

**Vlerësimi bëhet për:**

Leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
Përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
Lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.
Mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
Vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Ndihmojmë së bashku<br>(ora II) | **Fjalë kyçe:**<br>shok, i sëmurë, ndihmonim, kurajë, punë të përbashkëta, skuadër, forcuam shoqërinë. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të tjerëve për tekstin.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa. | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë: rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me problemin që trajton pjesa;<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto, albume të familjeve të nxënësve/eve. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Metodologjia:** Tryezë e rrumbullakët; diskutim, bisedë; punë individuale; punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesi/ja fton nxënësit/et t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës dhe më pas të tregojnë pjesën, duke u mbështetur te fjalitë e radhitura në rubrikën "Lexoj dhe kuptoj".
- Diskutohet me gjithë klasën për mënyrën si e kuptojnë shprehjen "çdo grup kishte një përgjegjësi". Konkretizojnë me shembuj nga jeta e tyre në klasë.
- Tryezë e rrumbullakët. Punohet në grup rubrika "Shkruaj". Të vendosur në mënyrë rrethore nxënësit/et shkruajnë njëri pas tjetrit tri gjëra që do të bënin për të ndihmuar një shok/shoqe në një letër të palosur në formë fizarmonike. Paraqiten punët e secilit grup dhe diskutohet rreth tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

Përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit dhe tregimit të ngjarjes.
Lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.
Mënyrën e bashkëpunimit në grupe.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Ndodhi personale<br>(ora I) | | **Fjalë kyçe:**<br>ndodhi personale;<br>fjalë ndihmëse;<br>hyrje;<br>zhvillim;<br>mbyllje. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- plotëson nj*ë tekst me fjalë mungesore*<br>- dallon pjesët e një tregimi (hyrja, zhvillimi, mbyllja);<br>- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i ngjarjeve që kanë lidhje me jetën e tyre. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe*;<br>foto;<br>letër A4;<br>mjete shkrimi. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** diskutim, bisedë; punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Diskutim me gjithë klasën. Nxënësit/et shohin figurat dhe i komentojnë ato.
Punë individuale. Ushtrimi 1. Nxënësit/et plotësojnë individualisht tregimin e dhënë me fjalët ndihmëse. Tregimi është ndarë në tri pjesë. Pas plotësimit të secilës pjesë, nxënësit/et lexojnë pjesën e plotësuar dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
Pas plotësimit të tij me fjalët ndihmëse tregimi lexohet i plotë. Theksohet fakti që tregimi është një histori që mund t'i ndodhë kujtdo (histori personale) .
Diskutojnë për karakteristikat që ka hyrja, zhvillimi dhe mbyllja e tregimeve.
Hyrja na paraqet personazhet , vendin, kohën e zhvillimit të ngjarjes.
Zhvillimi tregon se çfarë ndodh, problemin që del.
Mbyllja tregon zgjidhjen e këtij problemi.
Të gjitha këto karakteristika të secilës pjesë dalin nga analiza qe i bëhet pjesëve të tregimit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shkrimin një teksti *të shkurtër* me histori personale duke plotësuar me fjalë ndihmëse;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;
- shfaqjen e besimit, të vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punëve të të tjerëve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Ndodhi personale<br>(ora II) | **Fjalë kyçe:**<br>ndodhi personale, fjalë ndihmëse, hyrje, zhvillim, mbyllje. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- shkruan një tekst të shkurtër për histori e përvoja personale;<br>- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.<br>- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i ngjarjeve që kanë lidhje me jetën e tyre. |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>teksti *Gjuha shqipe*, foto, letër A4, mjete shkrimi. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** lexim, përmbledhje në dyshe; diskutim, bisedë; punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Lexim, përmbledhje në dyshe. Ushtrimi 2. Nxënësit/et lexojnë secilën pjesë të tregimit dhe e përmbledhin në një fjali, pasi e diskutojnë në dyshe me shokun/shoqen.

Pasi e përfundojnë këtë veprimtari, nxënësit/et i shkruajnë fjalitë përmbledhëse në fletore. Fjalitë e shkruara lexohen e diskutohen me gjithë klasën.

Punë individuale. Ushtrimi 3. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të mendojnë për historinë personale që do të shkruajnë. Diskutojnë në dyshe me shokun/shoqen pse zgjedhin pikërisht këtë ngjarje. Pastaj punojnë individualisht në fletore për shkrimin e saj duke pasur parasysh pjesët e tregimit të diskutuara orën e kaluar. Shkëmbejnë fletoret dhe bëjnë vlerësimin e punës së njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shkrimin një teksti të shkurtër me histori personale;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerësimin e punëve të të tjerëve;
- bashkëpunimin në grup për kryerjen e një detyre;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Si kuptohen fëmijët</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si e kuptojnë poezinë;<br>rreth interpretimeve të tyre në lidhje me faktin që të qenët fëmijë, është e njëjtë për të gjithë fëmijët mbarë botës;<br>rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi tek ata/ato.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon elementet e vjershës, si: strofa, vargu;<br>- parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>- lexon vjershën;<br>- shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth vjershës.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>fëmijë, kuptohen, gjuha e vet, qeshin, fëmijërisht.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike:<br>teksti Gjuha shqipe, foto, instrumente muzikore, lodra muzikore.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia: diskutim, bisedë; ruaje fjalën e fundit për mua; punë në çift, punë në grup; punë individuale.<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e vjershës.<br>Nxënësit/et shohin figurën, lexojnë titullin dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e vjershës duke punuar në dyshe. Parashikimet e tyre i shkruajnë në një fletë dhe më pas i lexojnë.<br>Lexohet vjersha në heshtje. Nxënësit/et tregojnë ndryshimet mes përmbajtjes së vjershës dhe parashikimit që kanë bërë.<br>Lexohet vjersha zinxhir sipas vargjeve dhe stofave.<br>Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.<br>Përdoret metoda Ruaje fjalën e fundit për mua. Nxënësit/et përzgjedhin dy vargje nga secila strofë që u pëlqejnë më shumë dhe shkruajnë një koment për to. Njëri prej nxënësve/eve lexon vargjet që ka zgjedhur dhe u kërkon të gjithë nxënësve/eve që kanë zgjedhur po këto vargje, të lexojnë komentin e tyre. Nxënësi i/e parë lexon dhe arsyet e zgjedhjes dhe kjo është fjala e fundit.</td></tr>
</table>

Rubrika “Reflektoj “ zhvillohet si një diskutim rreth pyetjeve që janë në këtë rubrikë.
Nxënësit/et në rubrikën ”Shkruaj” shkruajnë shkronjat e fundit të secilit varg në strofën e parë dhe tregojnë atë që venë re dhe emërtohet rimë.

**Vlerësimi bëhet për:**

- diskutimet rreth mënyrës se si e kuptojnë poezinë;
- interpretimet në lidhje me poezinë;
- gjykimet e dhëna për atë që përcjell kjo poezi;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Emra të përgjithshëm dhe të përveçëm<br>(ora I) | | **Situata e të nxënit**<br>Shqyrtimi i emrave për të dalluar emrat e përgjithshëm nga ata të përveçëm.<br>Përdorimi i tyre në fjali e tekste. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon emrat e përgjithshëm nga ata të përveçëm.<br>- gjen emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>- demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | | **Fjalë kyçe**<br>emër, emër i përgjithshëm , emër i përveçëm, emra njerëzish, emra kafshësh, emra sendesh, emra vendesh. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe*;<br>etiketa me emra, A4. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** hartë konceptesh; diskutim, bisedë; lojë me role, punë në çift, punë në grup,

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Nxënësit/et punojnë në grupe për të ndërtuar një hartë konceptesh për emrin. Mësuesi/ja plotëson një hartë konceptesh në tabelë, duke u mbështetur te puna e nxënësve/eve në grupe (emra njerëzish, kafshësh, njerëzish, sendesh, emra të përgjithshëm e të përveçëm dhe shembuj për secilin rast).
Mësuesi/ja tregon se për çdo emër njeriu, kafshe, sendi apo vendi mund të kemi një emër të veçantë. Konkretizohet me shembuj.
Lexohet rubrika “Mbaj mend” dhe mësuesi/ja bën sqarimet për pyetje që nxënësit/et mund të kenë.
Punë individuale. Ushtrimi 1. Në këtë ushtrim nxënësit/et pasi lexojnë emrat i vendosin ato në tabelën e dhënë. Shkëmbejnë librat për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit.
Ushtrimi 2 punohet individualisht dhe plotësohet në libër. Lexohen në dyshe emrat që kanë përdorur .

**Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e fjalëve që tregojnë emra e përgjithshëm e të përveçëm;
- gjetjen e emrave e përgjithshëm e të përveçëm;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij/saj;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe në veprime;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Emra të përgjithshëm dhe të përveçëm<br>(ora II) | | **Situata e të nxënit**<br>Gjetja dhe përdorimi i emrave të përgjithshëm e të përveçëm në fjali e tekste. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon emrat e përgjithshëm nga ata të përveçëm;<br>- gjen emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm;<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm e saktë mendimet e tij/saj;<br>- demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | | **Fjalë kyçe:**<br>emër, emër i përgjithshëm , emër i përveçëm, emra njerëzish, emra kafshësh, emra sendesh, emra vendesh. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike:**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- etiketa me emra, A4. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** diskutim, bisedë; punë në çift, punë në grup,
**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
Mësuesi/ja kërkon mendimet e nxënësve/eve për të plotësuar organizuesit grafikë për emrat e përgjithshëm e të përveçëm.
Nxënësit/et punojnë në grupe. Ata/ato gjejnë emrat në fjalitë që mësuesi/ja u shpërndan në fisha dhe tregojnë llojin e tyre.
Punë individuale. Ushtrimi 3. Në këtë ushtrim nxënësit/et gjejnë emra të përgjithshëm që tregojnë njerëz, kafshë, sende, vende dhe i përdorin në fjali. Shkëmbejnë librat për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit.
Ushtrimi 4. Në këtë ushtrim nxënësit/et gjejnë emra të përveçëm që tregojnë njerëz, kafshë, sende, vende dhe i përdorin në fjali. Shkëmbejnë librat për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e fjalëve që tregojnë emra të përgjithshëm e të përveçëm;
- gjetjen e emrave e përgjithshëm e të përveçëm;
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij/saj;

- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Botë miqsh<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>fëmijë i vetmuar;<br>i trishtuar;<br>lëndinë;<br>çiltërsi;<br>fëmijë;<br>miq;<br>botë e bukur.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me të pasurit sa më shumë miq për të qenë të lumtur;<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto, albume të familjeve të nxënësve/eve</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia:<br>• parashikim me terma paraprakë;<br>• diskutim, bisedë;<br>• punë individuale;<br>• punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Mësuesi/ja shkruan në tabelë: i trishtuar, lëndinë, fëmijë, miq dhe kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë me to një histori të shkurtër (4-5 fjali).<br>• Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën. Nxënësit/et në dyshe, e më pas si klasë diskutojnë rreth saj.<br>• Ai/ajo i udhëzon nxënësit/et që ta lexojnë tekstin me paragrafë dhe në heshtje. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante, më të rëndësishme.<br>• Mësuesi/ja fton në diskutim nxënësit/et për punimin e fjalorit dhe pyetjet rreth përmbajtjes.<br>• Lexohet pjesa zinxhir.<br>• Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta rilexojnë pjesën.<br>• Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj“ gjejnë alternativën e duhur. Gjithë klasa diskuton për detyrën e bërë.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;<br>- vlerësimin që u bën të tjerëve;</td></tr>
</table>

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | Lënda<br>Gjuha shqipe | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Botë miqsh<br>(ora II) | **Fjalë kyçe**<br>fëmijë i vetmuar, i trishtuar, lëndinë, çiltërsi, fëmijë, miq, botë e bukur. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;<br>• mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa. | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën,<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me të paturit sa më shumë miq për të qenë sa më të lumtur,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>teksti *Gjuha shqipe*;<br>foto, albume të familjeve të nxënësve/eve. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi., |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:**
- harta e personazheve;
- ditari dypjesësh;
- lexo, përmblidh në dyshe;
- diskutim, bisedë;
- punë individuale;
- punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Punë në çift. Lexo përmblidh në dyshe. Mësuesi/ja fton nxënësit/et te punojnë në dyshe. Njëri/a prej nxënësve/eve lexon paragrafin, tjetri e përmbledh atë. Në paragrafin në vazhdim ndërrohen rolet. Në fund tregohet e gjithë përmbajtja e pjesës.

Duke punuar në dyshe nxënësit/et bëjnë hartën e personazhit të pjesës.

| personazhi | |
|---|---|
| cilësi | cilësi |
| ilustrim nga teksti | ilustrim nga teksti |

Ditari dypjesësh. Nxënësit/et punojnë individualisht në fletore. Shkruajnë në njërën anë të fletës pjesën që u pëlqen më shumë dhe nga ana tjetër komentin e tyre për të.

Rubrika “Reflektoj” zhvillohet në formë diskutimi. Nxënësit/et sjellin përvojat e tyre në lidhje me temën.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit dhe tregimit të ngjarjes;

- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.

## Projekti 1 (4 orë)

| PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Titulli i projektit** | Të drejtat e fëmijëve | Kohëzgjatja | | 1 orë<br>gjuhë shqipe<br>(të folurit) |
| | | | | 1 orë<br>gjuhë shqipe<br>(të lexuarit) |
| Lënda: Gjuha shqipe | | Mësuesi: | | 1 orë<br>gjuhë shqipe<br>(të lexuarit) |
| | | | 1orë<br>gjuhë shqipe<br>(të dëgjuarit) | |
| Lidhja me fushat e tjera: | - artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. | Klasa: | E dytë | |
| | | | | |
| Ideja e projektit | Fëmijët i njohin të drejtat e tyre, por jo gjithmonë këto të drejta respektohen. Në këtë projekt nxënësit/et përdorin aftësitë hulumtuese, për të gjetur dhe për të lexuar dokumente që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre, aftësi krijuese për të përgatitur postera, fletëpalosje, aftësi interpretuese për vjersha, tregime, lojë me role, gjëza etj. | | | |
| Ngjarjet hyrëse që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve/eve | Ngjarje të ndryshme nga jeta e përditshme ku nxënësit/et vërejnë mosrespektimin e të drejtave të tyre shfrytëzohen si nxitje për angazhimin e tyre për zotërimin e disa kompetencave. | | | |
| Kompetencat kyçe që zhvillohen | Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit | x | Kompetenca personale | x |
| | Kompetenca e te menduarit | x | Kompetenca qytetare | x |
| | Kompetenca e të nxënit | x | Kompetenca digjitale | x |
| | Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin | x | | |
| Temat e njohurive kryesore lëndore, të cilat do të rimerren në saje të projektit. | Të rriturit mendojnë për ne. | x | | |
| | Unë jam | x | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Rezultatet e të nxënit | Nxënësi/ja:<br>• pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja personale;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>• shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, u përgjigjet pyetjeve;<br>• pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij/saj;<br>• diskuton në grupe për temën e të drejtave të fëmijëve;<br>• demonstron siguri kur flet në klasë;<br>• përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit;<br>• mbledh informacion nga burime të ndryshme;<br>• paraqet duke e shoqëruar me mjete pamore filmime, foto etj.;<br>• rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth të drejtave të fëmijëve;<br>• paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij/saj;<br>• demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup;<br>• mbledh informacion nga burime të ndryshme;<br>• rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth të drejtave të fëmijëve;<br>• demonstron besim në forcat e veta, respekt e tolerancë brenda grupit. | | | | | | |
| Metodologjia | (Individuale, në grup ose e gjithë klasa) | | Diskutim | x | Hulumtim | x |
| | | Bisedë | x | Hetim | x | |
| | | Punë në grup | x | | | |
| | | Lojë me role | x | | | |
| | | Tryeza rrethore | x | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| Burimet e nevojshme | Njerëzit e përfshirë | mësuesi, nxënësit/et, prindërit, përfaqësues të organizatave për mbrojtjen e fëmijëve, përfaqësues të pushtetit vendor e lokal | | | | |
| | Mjetet: | aparat fotografik, bllok shënimesh, foto video-projektor, karton letër, lapustila | | | | |
| | Materiale dhe burime | Konventa për të drejtat e fëmijëve, materiale të ndryshme nga interneti, foto dhe CD | | | | |
| | | | | | | |
| Pyetja kërkimore | Si dhe sa respektohen të drejtat e fëmijëve?<br>Si të mundësojmë respektimin e të drejtat të fëmijëve?<br>Çfarë mund dhe duhet të bëjnë fëmijët për të mbrojtur të drejtat e tyre? | | | | | |
| Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit. | Mësuesi/ja i ka udhëzuar nxënësit/et të marrin informacione në lidhje me të drejtat e fëmijëve, foto/video nga aktivitete e përditshme të tyre, foto/video nga realitete në të cilat nuk respektohen të drejtat e fëmijëve etj. (vendet e pazhvilluara, vendet në konflikte).<br><br>**Gjuhë shqipe**<br>• Mësuesi/ja lexon pjesë nga "Konventa për të drejtat e fëmijëve". Pasi mësuesi/ja mbaron leximin, shpërndan fisha letre ku janë shkruar pjesë nga kjo konventë (neni 2ç *e drejta për strehim*; neni 28, 29 *e drejta për edukim*; neni 24 *e drejta për përkujdesje shëndetësore* etj). Për secilin grup jepet nga një fishë. Grupet diskutojnë rreth tyre duke u mbështetur te pikat e mëposhtme: | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - si e kuptojnë këtë të drejtë;<br>- lidhjen e kësaj të drejte me përvojat e tyre personale;<br>- si e vlerësojnë këtë të drejtë.<br>• Pasi përfundojnë diskutimet në grup një përfaqësues/e i/e grupit u paraqet përfundimet e këtij diskutimi shokëve/shoqeve të klasës. Kjo, shoqërohet me foto dhe video të marra nga interneti që lidhen me këtë të drejtë (materiale që i kanë përgatitur më parë me udhëzimin e mësuesit/es në të cilat pasqyrohen të drejtat e mohuara të fëmijëve në vendet e pazhvilluara apo që janë në luftë.)<br>• Nxënësit/et e grupeve të tjera bëjnë komentet e tyre rreth videove, fotove dhe gjithashtu sjellin përvojat e tyre në lidhje me të drejtën që po diskutohet.<br>• Paraprakisht mësuesja me ndihmën e nxënësve/eve ka përgatitur për secilin grup një lule me petale prej kartoni (aq petale sa janë fëmijë në grup). Nxënësit/et vendosen në formë rrethore. Secili/a prej nxënësve/eve shkruan nga një kërkesë që lidhet me të drejtat e tyre. Pasi e shkruan kërkesën petalin e palos që të mos e shohë shoku/shoqja. Lulja kalon te secili/a nxënës/e me radhë. Në fund hapen petalet e lules dhe lexohen kërkesat e tyre.<br>• Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et të luajnë me role situata të improvizuara, të cilat kanë lidhje me të drejtat. Secili pjesëtar/e i/e grupit do të ketë nga një rol. Nëpërmjet këtyre situatave nxënësit/et u drejtohen prindërve, mësuesve/eve, shokëve/shoqeve, institucioneve vendore e lokale, avokatit të popullit etj. për respektimin e të drejtave të tyre.<br>• Nisur nga dy veprimtaritë e fundit mësuesi/ja i fton fëmijët të zgjedhin mënyrat për të realizuar paraqitjen e kërkesave, ankesave, apo falënderimeve të tyre drejtuar prindërve, mësuesve/eve, shokëve/shoqeve, institucioneve vendore e lokale, avokatit të popullit etj. (në mënyrë të drejtpërdrejtë, me shkrim, me postë të thjeshtë, me postë elektronike etj.).<br>• Mësuesi/ja ndihmon në mundësimin e dërgimit të tyre. | | | | | | |
| | | | | | | | |
| Produktet kryesore | Në grup: | Ndërgjegjësimi i vetes dhe i të gjithë përgjegjësve për respektimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet fotove, videove, diskutimeve, lojës me role. | | | | | |
| | Individualisht: | Kërkesa, falënderime, ankesa për individë e institucione në lidhje me respektimin e mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. | | | | | |
| Vendi dhe pjesëmarrësit në paraqitje | | x | | | | | |
| | Klasë | x | | | | | |
| | | | | | | | |
| Vlerësimet | Vlerësimet formuese (gjatë projektit) | Vlerësimi bëhet për;<br>– demonstrimin e të kuptuarit të temës;<br>– gjykimin, argumentet, idetë dhe informacionin rreth temës;<br>– përcaktimin e qëllimit të të folurit;<br>– shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit;<br>– bashkëpunimin në grup. | | | | | |
| | Vlerësime përmbledhëse (në fund të projektit) | Paraqitja e punëve | | | | | |
| | | | | | Vlerësim i prindërve | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Buxheti | Buxheti i detajuar<br>Përse?<br>Nga kush? | | Në bashkëpunim me prindërit mund të shpenzohet një fond prej 200 lekësh për blerjen e materialeve të ndryshme dhe letrave, tabakëve dhe lapustilave me ngjyra. | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Diktim | | **Fjalë kyçe:**<br>diktim, rregulla drejtshkrimore, qortim. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• shkruan një tekst me të diktuar;<br>• përdor shenjat e pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë);<br>• përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë;<br>• përdor drejt shkronjën e madhe për emra të përveçëm;<br>• bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es. | | 1.1.1<br>**Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një teksti me të diktuar | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- fletore, mjete shkrimi. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Shoqëria dhe mjedisi | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** stuhi mendimesh, diskutim, punë individuale.
**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Stuhi mendimesh. Mësuesi/ja fton nxënësit/et për të treguar rregullat drejtshkrimore që kanë mësuar (fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalisë, shkronja e madhe për emrat e njerëzve, vendeve etj.).
- Mësuesi/ja dikton pjesën.
- Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësuesit/es.
- Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar saktë përsëri.

**Detyrë shtëpie:** Mësoni tri fjali përmendësh nga pjesa "Botë miqsh" dhe bëjeni vetëdiktim.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Lexim jashtë klase<br>(sipas zgjedhjes së mësuesit/es)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj.<br>• (sipas pjesës që zgjedh mësuesi/ja).<br>• Përcakton dy-tri tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive<br>• (sipas pjesës që zgjedh mësuesi/ja).<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e parapëlqyera.<br>• Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar.<br>• Shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit.<br>• Ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br><br>Leximi i librave jashtë klase</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- libra jashtë klase.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>1.1.2<br>1.1.3<br>1.1.4<br>1.1.5</td></tr>
<tr><td colspan="4">1.1.6<br>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br><br>Metodologjia: diskutim, bisedë; punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Paraqitja e titullit të librit dhe e autorit.<br>• Leximi i pjesës.<br>• Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj.<br>• Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.<br>• Tregimi i brendisë së pjesës.<br>• Personazhet dhe cilësitë e tyre.<br>• Mesazhi që përcjell pjesa.<br>• Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.<br>• Ilustrim i pjesës me vizatim.<br>Vlerësimi bëhet për rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.<br><br>Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do të zgjedhë mësuesi/ja për të punuar.</td></tr>
</table>

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | Lënda<br>Gjuha shqipe | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Lexim jashtë klase<br>**(sipas zgjedhjes së mësuesit/es)** | | **Fjalë kyçe** | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj**.**<br>• (sipas pjesës që zgjedh mësuesi/ja).<br>• Përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive.<br>• (sipas pjesës që zgjedh mësuesi/ja).<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e parapëlqyera.<br>• Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar.<br>• Shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit.<br>• Ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. | | **Situata e të nxënit**<br><br>Leximi i librave jashtë klase | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- libra jashtë klase. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>**1.1.7**<br>**1.1.8**<br>**1.1.9**<br>**1.1.10** | |

1.1.11

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** diskutim, bisedë; punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Paraqitja e titullit të librit dhe e autorit.
- Leximi i pjesës.
- Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj.
- Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.
- Tregimi i brendisë së pjesës.
- Personazhet dhe cilësitë e tyre.
- Mesazhi që përcjell pjesa.
- Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.
- Ilustrim i pjesës me vizatim.

Vlerësimi bëhet për rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.

Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do të zgjedhë mësuesi/ja për të punuar.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Vlerësim njohurish 1</td><td colspan="2">Fjalë  kyçe:<br>vlerësim njohurish 1, test, rendit, shkruaj, gjej.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- Plotëson kërkesat e ushtrimeve në tekst. Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>- Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Vlerësim njohurish 1</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- fletët e testit, mjetet e shkrimit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br><br>Metodologjia: bisedë, punë individuale e pavarur.<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Mësuesi/ja shpërndan fletët e vlerësimit të njohurive. Fton nxënësit/et të lexojnë kërkesat dhe të pyesin për paqartësitë. Udhëzon për punë të pavarur.<br>• Në përfundim të testit, mblidhen fletët dhe bëhet zgjidhja e tij në tabelë duke diskutuar me nxënësit/et.</td></tr>
</table>

## TEST 1 (NË FUND TË TREMUJORIT TË PARË)

### Një pellg për bretkosën

Në një pellg të vogël jetonte një bretkosë e mirë. Erdhi një verë e nxehtë dhe pellgu dita-ditës zvogëlohej. Bretkosa e kuptoi se pas pak kohësh aty s'do të mbetej më ndonjë pikë ujë dhe u pikëllua. Si mund të jetonte ajo pa pellgun?

Një ditë, një pëllumb që pinte ngaherë ujë në pellg, shtangu nga trishtimi i bretkosës. Ajo i tregoi për fatin e keq që e priste.

Pëllumbi u largua pa thënë asnjë fjalë. Pak më vonë ai u kthye bashkë me një mikun e tij të afërt, lejlekun sqepgjatë. Bretkosa e mori me mend se kishin ardhur ta ndihmonin.

Lejleku e mori bretkosën me sqepin e tij dhe bashkë me pëllumbin zemërmirë fluturuan gjatë. Ata qëndruan buzë një pellgu të madh mes pyjesh. Bretkosa ndihej e lumtur që miqtë iu gjendën në çastin më të vështirë dhe jeta iu duk më e bukur.

1. Pjesa e mësipërme është: a) tregim; b) përrallë; c) fabul. (1 pikë)
2. Bretkosa u pikëllua sepse: a) donte të shkonte te një pellg më i madh; b) erdhi vera; c) pellgu po thahej. (1 pikë)
3. Bretkosa i tregoi për brengën e saj: a) pëllumbit; b) lejlekut; c) pëllumbit dhe lejlekut. (1 pikë)
4. Bretkosën e ndihmoi: a) lejleku; b) pëllumbi; c) pëllumbi edhe lejleku. (1 pikë)
5. Rendit fjalitë sipas radhës:

   ___ Lejleku dhe pëllumbi e çuan bretkosën te një pellg i madh në mes të pyllit.

   ___ Bretkosa ia tregoi brengën pëllumbit.

   ___ Pëllumbi u kthye me lejlekun për të ndihmuar bretkosën.

   ___ Bretkosa u pikëllua, sepse pellgu ku jetonte do të thahej. (4 pikë)
6. Shkruaj nga një cilësi për secilin personazh:

   Pëllumbi _________

   Lejleku ________

   Bretkosa ___________ (3 pikë)
7. Vendosi nga një emer bretkosës dhe pëllumbit.

   bretkosa _________ ____________ _________ (3 pikë)
8. Përgjigju me shkrim pyetjeve:

   Si ndihesh kur lexon përrallën?

   ________________________________________________________

   Si e ke ndihmuar shokun/shoqen tënde?

   _____________________________________________________ (2 pikë)

9. Shkruaj një pyetje për përgjigjen:

Bretkosa ndihej e lumtur që miqtë iu gjendën në çastin më të vështirë. (1 pikë)

10. Gjej në tekstin e mësipërm :

Një fjali me të cilën pyesim: ____________________________________________

Një fjali me të cilën tregojmë: ____________________________________________ (2 pikë)

11. Gjej 2 emra trerrokësh në tekstin e mësipërm dhe ndaji në fund të rreshtit.

___________________ ______________________

__________________ _____________________ (4 pikë)

12. Ndërroi vendin fjalëve në fjalinë e mëposhtme pa ia prishur kuptimin.
Pellgu dita-ditës zvogëlohej.

_________________________________ (1 pikë)

13. Hiq fjalë në fjalinë e mëposhtme pa ia prishur kuptimin.

Ata qëndruan buzë një pellgu të madh mes pyjesh.

_______________________________________________ (1 pikë)

14. Shto fjalë në fjalinë e mëposhtme pa ia prishur kuptimin.

Bretkosa u pikëllua.

15. Nëse do t'i duhej t'i uronte për ditëlindje miqtë e saj, si do ta bënte urimin bretkosa?

_____________________________________________________________ (1 pikë)

16. Ndihmojeni bretkosën për t'i shkruar një letër lejlekut apo pëllumbit.

I dashur_______________

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

_______________________________________________________________________

(4 pikë)

| Vlerësimi | AP | ANP | AK | ASHK | ASH |
|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 0-7 | 8-15 | 16-23 | 24-28 | 29-31 |

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shokë, shokë<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:<br>lepur, karotë, mëz, qengj, dre, çoj, uri.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• përcakton dy-tri tipare të përrallave;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me kujdesin që duhet treguar për shokët/shoqet;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- teksti Gjuha shqipe;<br>- foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia: parashikim me terma paraprakë; diskutim, bisedë; punë individuale; punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Mësuesi/ja shkruan në tabelë: lepur, karotë, mëz, çoj, uri dhe kërkon nga nxënësit/et të ndërtojnë me to një histori të shkurtër (4-5 fjali).<br>• Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit dhe fton nxënësit/et të vërejnë figurën. Nxënësit/et diskutojnë rreth saj në dyshe, e më pas si klasë.<br>• Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit në paragrafë dhe në heshtje. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante, më të rëndësishme.<br>• Mësuesi/ja fton në diskutim nxënësit/et për punimin e fjalorit dhe të pyetjeve rreth përmbajtjes.<br>• Lexohet pjesa zinxhir.<br>• Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, nxënësve/eve u lihet kohë ta rilexojnë pjesën dhe të tregojnë se është përrallë, duke e argumentuar me 2-3 tipare të përrallave (personazhe joreale, fund i lumtur etj.).<br>• Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” u përgjigjen pyetjeve rreth saj.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>• Leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>Përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>Tregimin e tipareve të përrallës.<br>Lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.<br>Mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>Vlerësimin që u bën të tjerëve.</td></tr>
</table>

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Shokë, shokë<br>(ora II) | **Fjalë kyçe:**<br>lepur, karotë, mëz, qengj, dre, çoj, uri. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa. | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>- rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën;<br>- rreth interpretimit të tyre në lidhje me kujdesin që duhet të tregojmë për shokët/shoqet;<br>- rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto të nxënësve/eve. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** diskutim, bisedë; punë individuale; punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesi/ja fton nxënësit/et t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës.
- Rubrika "Shkruaj" plotësohet individualisht nga nxënësit/et. Për secilën pjesë nxënësit/et shkruajnë një fjali përmbledhëse.
- Më pas tregojnë përmbajtjen e pjesës duke u mbështetur te fjalitë e shkruara.
- Për mesazhin e kësaj pjesë diskutohet si klasë. Konkretizojnë me shembuj nga jeta e tyre në klasë.
- Rrugën që bëri karota nga lepuri te lepuri e vizatojnë individualisht. Vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit dhe tregimit të ngjarjes;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komuni-kimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Shkrimi i emrave të përgjithshëm e të përveçëm | **Fjalë kyçe:**<br>shkronjë e madhe, shkronjë e vogël, emër i përveçëm, emër i përgjithshëm. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- përdor drejt shkronjën e madhe për emra të përveçëm njerëzish, vendesh dhe kafshësh;<br>- korrigjon emrat e përveçëm të shkruar gabim; | **Situata e të nxënit**<br>Shqyrtimi i emrave të përveçëm dhe të përgjithshëm.<br>Shkrimi drejt i tyre. |

| | |
|---|---|
| - demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- teksti *Gjuha shqipe*;<br>- foto;<br>- informacione nga interneti, enciklopedi;<br>- letër A4, mjete shkrimi. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** diskutim, bisedë; punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesi/ja paraqet në foto ose video një situatë nga jeta e fëmijëve. Kërkohet të shkruajnë dy fjali rreth saj. I lexojnë fjalitë. Mësuesi/ja përzgjedh dhe shkruan në tabelë dy prej tyre. Kërkohet nga nxënësit/et të gjejnë emrat në këto fjali. Merren në shqyrtim emrat dhe vërehet shkronja e parë e tyre. Bëhet dallimi midis drejtshkrimit të emrave të përveçëm dhe atyre të përgjithshëm.
- Nxënësit/et punojnë individualisht ushtrimin 1. Në këtë ushtrim nxënësit/et nënvizojnë emrat dhe qarkojnë shkronjën e madhe tek emrat e përveçëm.
- Shkëmbejnë fletoret në dyshe. Diskutojnë kryerjen e ushtrimit me gjithë klasën. Nxjerrin rregullën e shkrimit të emrave të përveçëm.
- Plotësohet skeda në ushtrimin 2. Shkëmbejnë librat dhe vëzhgojnë nëse i kanë shkruar emrat e përveçëm me shkronjë të madhe.
- Në ushtrimin 3 nxënësit/et gjejnë dhe shkruajnë emra të përveçëm pranë emrave të përgjithshëm. Diskutohet kryerja e këtij ushtrimi me gjithë klasën.
- Tek ushtrimi 4nxënësit/et korrigjojnë emrat e përveçëm që janë shkruar me shkronjë të vogël. Shkëmbejnë librat për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përdorimin drejt të shkronjës së madhe për emrat e njerëzve, të vendeve dhe të kafshëve;
- korrigjimin e emrave e përveçëm të shkruar gabim;
- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup;
- mënyrën e bashkëpunimit në grup;
- vlerësimin që u bën të tjerëve.

**Detyrë shtëpie:**

Jepet si detyrë ushtrimi 5, në të cilin shkruhen fjali, duke përdorur emra të përveçëm.

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | | Lënda<br>Gjuha shqipe | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br><br>Si të mbash një ditar sekret<br>(ora I) | | | **Fjalë kyçe:**<br><br>ditar, personal, kujtime, përjetime, ndjenja, aktivitete. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë pjesën;<br>• nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë;<br>• tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar duke iu përgjigjur pyetjeve;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet etj.;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. | | | **Situata e të nxënit**<br><br>- Duke punuar me tekstin nxënësit/et/et diskutojnë për:<br>- mënyrën se si e bëjnë lidhjen e pjesës me jetën e tyre të përditshme;<br>- për interpretimin e tyre në lidhje me mbajtjen e një ditari personal;<br>- për informacionet dhe kuriozitetet e sjella nga vetë ata/ato për ditarët. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et/es;<br>– teksti mësimor;<br>– mjete shkrimi, ditar personal. | | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>të drejtat e njeriut;<br>vendimmarrja morale. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve/eve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, diskutim, bisedë; punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Nxënësit/et/et janë porositur që më parë që të sjellin fletore ditari.
- Stuhi mendimesh. Ditari. Nxënësit/et punojnë në grupe dhe shkruajnë në fletë për ditarin. Grupet paraqesin punën e tyre.
- Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë (me dëshirë) një pjesë nga ditari i tyre.
- Mësuesi/ja paraqet temën e mësimit.
- Nxënësit/et lihen që të lexojnë me paragrafë pjesën. Nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe pjesët që u duken më interesante. Diskutojnë me njëri-tjetrin rreth informacionit që lexojnë në çdo paragraf. Fjalët e reja sqarohen nëpërmjet fjalorit.
- U lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë.
- Lexohet pjesa zinxhir nga nxënësit/et sipas paragrafëve.
- Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve oseplotësojnë me gojë fjalitë rreth brendisë së pjesës.
- Nxënësit/et nisin të shkruajnë një fletë ditari . Këtë punë mund ta përfundojnë edhe në shtëpi.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u b bën të tjerëve;
- leximin e tekstit joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- përgjigjet e pyetjeve mbi përmbajtjen;
- nënvizimin e pjesëve më të rëndësishme ose të pjesëve që i pëlqejnë më shumë;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tij/saj.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br><br>Si të mbash një ditar sekret<br>(ora II) | | **Fjalë kyçe:**<br>ditar, personal, kujtime; përjetime, ndjenja, aktivitete. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin joletrar;<br>• tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. | | **Situata e të nxënit**<br>Mbajtja e një ditari personal | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et;<br>- teksti mësimor;<br>- mjete shkrimi, ditar personal. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- të drejtat e njeriut;<br>- vendimmarrja morale. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** diskutim, bisedë, rrjetë diskutimi, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësimi nis me leximin e detyrës me shkrim që u dha në orën e mëparshme (leximi bëhet me dëshirë).
- Punë në çift. Lexo përmblidh në dyshe. Nxënësit/et në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ata/ato jo vetëm konfirmojnë ato që kanë mësuar një orë më parë, por edhe kanë mundësi të përdorin lloje të ndryshme të të menduarit.
- Punohet rreth rubrikës "Reflektoj". Nxënësit/et u përgjigjen pyetjeve dhe japin parapëlqimet e tyre në lidhje me personalizimin e ditarit të tyre.
- Punë në dyshe. Për pyetjen e dytë tek kjo rubrikë përdoret "Rrjetë diskutimi". Çdo dyshe shkruan të paktën një argument për secilën anë. Lexohen argumentet dhe dilet në një qëndrim.
- Nxënësit/et vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Nxënësit/et nisin të shkruajnë një fletë ditari. Kjo punë mund të përfundojë në shtëpi.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- leximin e tekstit joletrar;
- interesin dhe dëshirën për të lexuar pjesën;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | Lënda<br>Gjuha shqipe | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Katër shoqe<br>(ora I) | **Fjalë kyçe:**<br>shoqe, dhembje fyti (bajamet), shtatlartë, gështenjë, biondë, bishtalec, i ndrojtur, flokëkuqe, e përsosur, e fortë. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | **Situata e të nxënit**<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si e kuptojnë pjesën dhe përshkruajnë shokët/shoqet;<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me kujdesin që duhet të tregojmë për shokët/shoqet;<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- foto të shokëve dhe shoqeve. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- bashkëjetesa paqësore. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** shkrim i shpejtë, ditari dypjesësh**,** diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Ata/ato janë udhëzuar të sjellin foto në të cilat kanë dalë me shokët ose shoqet.
- Shkrim i shpejtë. Mësuesja fton nxënësit/et të mendojnë për shokët/shoqet e tyre. Shkruajnë vetëm dy fjali për një prej shokëve/shoqeve. Lexohen shkrimet e disa prej nxënësve/eve.
- Shohin figurën e tekstit, përshkruajnë dhe komentojnë në dyshe. Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit/et nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë.
- Diskutohet për llojin e tekstit (tregim ) dhe 2-3 karakteristika të tij (personazhe realë, ngjarje që mund të ndodhin në jetën e përditshme etj.)
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Shënojnë më shenjat e vërtetë, e gabuar fjalitë te rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Shkëmbejnë librat dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Ditari dypjesësh. Nxënësit/et kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën që u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje dhe nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura;
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet;
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.

**Detyrë shtëpie:** Vizato një nga shoqet/shokët e tu/tua.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Katër shoqe<br>(ora II) | **Fjalë kyçe**<br>shoqe, dhembje fyti (bajamet), shtatlartë, gështenjë, biondë, bishtalec, ndrojtur, flokëkuqe, e përsosur, e fortë. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;<br>• jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | **Situata e të nxënit**<br>Lojë: Gjej shokun/shoqen nga përshkrimi. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et<br>- teksti mësimor<br>- foto të shokëve/ shoqëve, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- të drejtat e njeriut;<br>- bashkëjetesa paqësore. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** lojë, lexo përmblidh në dyshe, diskutim, bisedë, Diagram Veni, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Lojë në dyshe. Nxënësit/et zgjedhin njërin/njërën prej shokëve/shoqeve të klasës për ta përshkruar, por pa thënë emrin. Shoku/shoqja tjetër mundohet të gjejë se për cilin/cilën bëhet fjalë. Ndërrohen rolet.
- Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit/et nëpërmjet leximit zinxhir.
- Lexo, përmblidh në dyshe: Njëri/njëra nxënës/e lexon një paragraf dhe tjetri e përmbledh me 1-2 fjali. Për paragrafin në vazhdim ndërrohen rolet.
- Nxënësit/et tregojnë brendinë e pjesës me fjalët e tyre.
- Punohet rubrika "Reflektoj", e cila zhvillohet si bisedë ndërmjet nxënësve/eve për pyetjen e parë.
- Diagram Veni: Nxënësit/et zgjedhin dy prej vajzave të tregimit dhe shkruajnë të përbashkëtat dhe të veçantat. Diskutohet për punën e bërë.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacion të tekstit;
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit;
- tregimin e brendisë, duke respektuar strukturën e tekstit;
- mendimet që jep rreth tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

**Vlerësimi bëhet për:** Bëj një pesëvargësh për shokun/shoqen tënde.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Përshkruajmë shokun/shoqen<br>(ora I) | **Fjalë kyçe:**<br>përshkruaj, shok/shoqja, pamja e jashtme, cilësi të karakterit, sjellja, pëlqej. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• studion modele të gatshme të punëve me shkrim (përshkrime personash);<br>• përshkruan shokë/shoqe, miq/mike;<br>• bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;<br>• shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | **Situata e të nxënit**<br>Personazhet e tregimit "Katër shoqe". |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- foto të shokëve /shoqeve. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- të drejtat e njeriut;<br>- bashkëjetesa paqësore. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, punë individuale, diskutim, bisedë, pema e mendjes, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

Stuhi mendimesh. Nxënësit/et nën drejtimin e mësuesit/es japin mendime dhe kujtojnë elementet e përshkrimit të një personi. Mësuesja/si rendit në tabelë elementet që nxirren nga diskutimi (të dhëna personale, cilësi fizike, çfarë i pëlqen të bëjë, cilësi të karakterit etj.).

Zhvillohet bisedë për gjërat që u kanë ngelur në mendje nga përshkrimi i personazheve te pjesa "Katër shoqe".

Punë individuale. Punohet për plotësimin e ushtrimit të parë. Nxënësit/et lexojnë përshkrimet e shkëputura nga pjesa "Katër shoqe" dhe shkruajnë emrin e njërës prej vajzave. Bëjnë nënvizimet e fjalëve që tregojnë pamjen e jashtme dhe cilësitë e karakterit. Diskutojnë për punën e bërë me gjithë klasën.

Rishikim në dyshe. Plotësohet ushtrimi 2 me fjalët e nënvizuara në ushtrimin e mësipërm. Pasi përfundojnë punën shkëmbejnë librat më njëri-tjetrin në dyshe dhe vlerësojnë punën e tyre.

Pema e mendjes. Sipas grupeve nxënësit/et shkruajnë fjalë që lidhen me përshkrimin e shokut/shoqes (pamja e jashtme, cilësi të karakterit).

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit;
- përshkrimin e shokut/shoqes;
- studimin e modeleve të përshkrimeve.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 10 prej fjalëve që të pëlqyen nga përshkrimet e vajzave në tregim.

| Fusha | Lënda | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|
| Gjuhët dhe komunikimi | Gjuha shqipe | | |

**Tema mësimore**
Përshkruajmë shokun/shoqen
(ora II)

**Fjalë kyçe**
përshkruaj, shok/shoqja, pamja e jashtme, cilësi të karakterit, sjellja, pëlqej.

**Rezultatet e të nxënit**
Nxënësi/ja:

- studion modele të gatshme për përshkrimin e shokëve/shoqeve;
- përshkruan shokë/shoqe, miq/mike;
- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;
- shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerëson punët e të tjerëve;
- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

**Situata e të nxënit**
Përshkrimi i shokut/shoqes.

**Burimet dhe materialet didaktike**

- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et;
- teksti mësimor;
- foto të shokëve /shoqeve;
- fisha.

**Lidhja me fushat e tjera**
artet;
shoqëria dhe mjedisi.

**Lidhja me temat ndërkurrikulare**
të drejtat e njeriut;
bashkëjetesa paqësore.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** diskutim, bisedë, punë në çift, punë individuale, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Punë me gjithë klasën. Mësuesi/ja fton nxënësit/et të mendojnë për shokun/shoqen e tyre dhe ta përshkruajnë vetëm me një fjalë, të cilën e shkruajnë në etiketë. Mësuesi/ja i vendos të gjitha etiketat në një tabelë**. (**Këto fjalë shfrytëzohen në ushtrimet e mëposhtme.)
- Punë individuale. Punohet për plotësimin e ushtrimit të tretë. Nxënësit/et shkruajnë me nga një fjali se çfarë u pëlqen më shumë te vajzat e pjesës "Katër shoqe". Diskutojnë për punën e bërë të gjithë si klasë.
- Rishikim në dyshe: Punohet ushtrimi 2. Nxënësit/et përshkruajnë shokun shoqen e ngushtë. Shfrytëzohen fjalët që nxënësit/et i shkruan në fillim të orës. Pasi përfundojnë punën shkëmbejnë librat më njëri-tjetrin në dyshe dhe vlerësojnë punën e tyre.
- Bëjnë qortimin e gabimeve me ndihmën e mësueses.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit
- studimin e modeleve të përshkrimeve
- përshkrimin e shokëve /shoqeve
- bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

**Detyrë shtëpie:** Përshkruaj një shok/shoqe që mund ta kesh njohur gjatë pushimeve.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Libri magjik (ora I)** | | **Fjalë kyçe**<br>mackë, e ëma, lexoj, libër, errësirë, ide, drita e hënës | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit.<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Tregon llojin e pjesës dhe 2-3 tipare të saj.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të reja për të.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet | | **Situata e të nxënit**<br><br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë rreth mënyrës se si ata e kuptojnë tekstin,<br>rreth interpretimeve të tyre në lidhje me leximin e librave,<br>rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo pjesë tek nxënësit/et. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et<br>- teksti mësimor<br>- libra jashtë klase, mjete shkrimi, | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

- **Metodologjia:** diskutim, lexim dhe mendim i drejtuar, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Nxënësit/et kanë sjellë libra të ndryshëm jashtë klase dhe bisedojnë në grupe të vegjël për titullin, autorin, ilustrimet, përmbajtjen etj.
- Mësuesi/ja fton nxënësit/et të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit, duke u mbështetur te titulli dhe ilustrimet e tekstit.
- Lexim dhe mendim i drejtuar. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit të ndarë në pjesë (pjesa e parë: ...as zhurmë e çuditshme; pjesa e dytë: ...-kam një ide!; pjesa e tretë: ...pa histori sonte) . Për secilën prej tyre, nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, punojnë me fjalorin, u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes dhe bëjnë parashikime për pjesën në vazhdim. Mësuesi/ja kërkon të argumentohet parashikimi i bërë.
- Diskutohet për llojin e pjesës dhe karakteristikat e saj (përrallë, personazhe kafshë, fund i lumtur).
- Në grupe bisedojnë rreth ngjarjeve të ngjashme nga jeta e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që i pëlqejnë më shumë;
- pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- përcaktimin e dy-tri tipareve të përrallave;
- shfaqjen e besimit dhe të vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë.

**Detyrë shtëpie:** Kopjo pjesën që të pëlqen dhe komentoje.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Libri magjik i Sashës<br>(ora II) | | **Fjalë kyçe**<br>mackë, e ëma, lexoj, libër, errësirë, ide, drita e hënës. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit/es;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e parapëlqyer;<br>• luan me role pjesën;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij/saj rreth leximit;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | | **Situata e të nxënit**<br>- Përse të pëlqen të lexosh? | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et<br>- teksti mësimor<br>- libra jashtëklase, mjete shkrimi, | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriu | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, diskutim, harta e personazheve, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Stuhi mendimesh me gjithë klasën. Më pëlqen të lexoj, sepse... Mësuesja shkruan në tabelë mendimet e nxënësve/eve.
- Lexohen detyrat e shtëpisë në të cilat janë kopjuar fragmente nga pjesa dhe nxënësit/et bëjnë komentet e tyre.
- Mësuesja organizon klasën në grupe treshe. Ajo ndan rolet në çdo grup (macka, Sasha, e ëma, autori) dhe kërkon nga nxënësit/et të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit/et në treshe luajnë sipas roleve.
- Tregohet përmbajtja e përrallës në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Punë në dyshe. “Harta e personazheve”. Nxënësit/et shkruajnë nga dy cilësi për 2 personazhet e pjesës dhe pjesët ilustruese nga teksti për secilën cilësi.
- Paraqesin punët e tyre dhe i diskutojnë me gjithë klasën.
- Diskutojnë pyetjet e rubrikës “Reflektoj” dhe ndajnë mes tyre përvojat rreth leximit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- tregimin e përmbajtjes;
- përshkrimin e personazheve;
- lojën me role;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij/saj.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një mbyllje tjetër për historinë e Sashës.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Gjinia e emrit<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>gjinia e emrit, gjinia femërore, gjinia mashkullore, shkronja/t e fundit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• Tregon gjininë e emrit në mënyrë intuitive.<br>• Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore.<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Manipulim me fjalë-emra për të përcaktuar gjininë e emrave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/e;<br>- teksti mësimor;<br>- fisha me emra njerëzish, fletëA4, mjete shkrimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>të drejtat e njeriut.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Metodologjia: diskutim, rishikim në dyshe, shkëmbe një problemë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>• Mësuesja ka përgatitur fisha me emra njerëzish: vajza, djali, mjeku, mjekja</td></tr>
</table>

| |
|---|
| • Nxënësit/et punojnë në dyshe për t'i grupuar në dy grupe sipas gjinisë në mënyrë intuitive.<br>• Diskutohet rasti i dhënë në libër. Nxirret rregulli për përcaktimin e gjinisë së emrave, i cili lexohet dhe në libër.<br>• Rishikim në dyshe. Ushtrimi i parë punohet individualisht. Qarkohen shkronjat e fundit te fjalët dhe grupohen fjalët sipas gjinisë. Shkëmbehen në dyshe librat me shokët/shoqet. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br>• Rishikim në dyshe. Punohet individualisht ushtrimi 2. Nxënësit/et shkruajnë fjalët dhe lidhin secilën fjalë me gjininë përkatëse. Shkëmbehen librat me shokët/shoqet në dyshe. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br>• Shkëmbe një problemë. Për këtë ushtrim nxënësit/et punojnë në grupe. Secili/a nga anëtarët/et e grupit shkruan në një etiketë nga një emër. Etiketat shkëmbehen me grupin fqinj, i cili ka për detyrë t'i grupojë etiketat në dy grupe (emra të gjinisë femërorë dhe emra të gjinisë mashkullore). Brenda grupit diskutohen rastet kur emrat nuk janë në formën e shquar. Mësuesi/ja ndihmon për t'i shquar emrat.<br>• Paraqitet puna dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.<br><br>**Vlerësimi bëhet për:**<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;<br>- vlerësimin që u bën të tjerëve;<br>- tregimin e gjinisë së emrit në mënyrë intuitive;<br>- dallimin e emrave të gjinisë femërore nga ata të gjinisë mashkullore;<br>- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;<br>- demonstrimin e besimit dhe të vullnetit në arritjen e rezultateve.<br><br>**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 5 emra të gjinisë femërore dhe 5 emra të gjinisë mashkullore |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Gjinia e emrit<br>(ora II) | | **Fjalë kyçe:**<br>gjinia e emrit, gjinia femërore, gjinia mashkullore, shkronja/t e fundit | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore.<br>• Kthen emra të caktuar nga gjinia femërore në mashkullore dhe anasjelltas.<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | | **Situata e të nxënit**<br>Manipulim me fjalë-emra për të grupuar emrat sipas gjinisë. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- fisha me emra njerëzish, fletëA4, mjete shkrimi. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>të drejtat e njeriut. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**<br><br>**Metodologjia:** diskutim, rishikim në dyshe, dil rrotull - fol rrotull, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |

- Mësuesja i fton nxënësit/et të gjejnë gjininë e disa emrave (të trajtës së pashquar): *anë, byrek, iriq, shami* dhe i lë të mendojnë për pak minuta. Nxënësit/et ngrihen në këmbë dhe ecin në një vend të hapur në klasë derisa mësuesi/ja përplas duart. Ndalojnë e flasin me shokun/shoqen që kanë ngjitur për gjininë e emrave të mësipërm. Pasi ulen disa prej tyre i tregojnë klasës emrat dhe gjininë e tyre.
- Rishikim në dyshe. Punohet individualisht ushtrimi 3,4,5. Nxënësit/et shkruajnë emrat në tabela sipas kërkesave përkatëse. Shkëmbehen në dyshe librat me shokët/shoqet. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Punë në grup. Nxënësit/et shkruajnë në etiketa të veçanta nga dy emra te sendeve dhe objekteve që gjenden në klasë. I vendosin duke i ngjitur etiketat në një tabelë kartoni të përgatitur më parë sipas modelit:

Emra të gjinisë femërore
Emra të gjinisë mashkullore

- Mësuesja orienton e nxit diskutimin për përcaktimin e gjinisë të emrave që nuk janë në trajtën e shquar. Çdo grup prezanton punën e tij. Vlerësojnë punën e njëri-tjetrit
- Prezantohet puna dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit
- tregimin e gjinisë të emrit në mënyrë intuitive.
- dallimin e emrave të gjinisë femërore nga ata mashkullore.
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime.
- demonstrtrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

**Detyrë shtëpie:** Jepet ushtrimi 6 detyrë shtëpie.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shkruaj një tregim<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>tregim, hyrje, zhvillim, mbyllje.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>- Shkruan tregime të thjeshta nisur nga disa ilustrime.<br>- Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es.<br>- Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.<br>- Respekton rregullat drejtshkrimore. gjatë të shkruarit;<br>- Vlerëson punët e të tjerëve.<br>- Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Shqyrtimi i figurave për të shkruar një tregim mbështetur në to.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>artet;<br>shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>të drejtat e njeriut;<br>vendimmarrja morale;<br>mjedisi;<br>bashkëjetesa paqësore.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia:** diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Punë me gjithë klasën. Nxënësit/et shohin figurat dhe i komentojnë ato.
- Punë individuale. Ushtrimi 1. Nxënësit/et individualisht shkruajnë secilën pjesë të tregimit. Udhëzohen të përdorin fjalët ndihmëse dhe t'u përgjigjen pyetjeve.
- Pas shkrimit të secilës pjesë, nxënësit/et lexojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Pas përfundimit të tij tregimi lexohet i plotë.
- Diskutojnë nën drejtimin e mësueses, për karakteristikat që ka hyrja, zhvillimi dhe mbyllja e tregimeve. (Hyrja na paraqet personazhet, vendin, kohën e zhvillimit të ngjarjes. Zhvillimi tregon faktet se çfarë ndodh, problemin që del etj. Mbyllja tregon zgjidhjen /përfundimin e ngjarjes. Të gjitha këto karakteristika të secilës pjesë dalin nga analiza që i bëhet pjesëve të tregimit.)

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që iu bën të tjerëve;
- shkrimin e një tregimi të thjeshtë nisur nga disa ilustrime;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/es;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie:** Kopjoje tregimin e shkruar në klasë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Shkruaj një tregim<br>(ora II) | | **Fjalë kyçe**<br>tregim, hyrje, zhvillim, mbyllje | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Shkruan tregime të thjeshta .<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• Vlerëson punët e të tjerëve;<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një historie që ka lënë mbresa. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- foto, mjete shkrimi, fletë A4. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- të drejtat e njeriut;<br>- vendimmarrja morale;<br>- mjedisi;<br>- bashkëjetesa paqësore. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**
**Metodologjia**: hartë konceptesh, diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Hartë konceptesh. Pjesët e një tregimi, karakteristikat e çdo pjese. Nxënësit/et në grupe punojnë për këtë veprimtari së bashku.

- Punë individuale. Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të mendojnë për një histori që u pëlqen.
- Diskutojnë në dyshe me shokun/shoqen pse e kanë zgjedhur pikërisht këtë histori. Pastaj punojnë individualisht në fletore për shkrimin e saj, duke pasur parasysh pjesët e tregimit të diskutuara në orën e kaluar. Shkëmbejnë fletoret dhe bëjnë vlerësimin e punës së njëri-tjetrit.
- Me ndihmën e mësuesit/es bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore**.**

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- shkrimin e një historie të thjeshtë;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit/e;.
- shfaqjen e besimit dhe të vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një histori tjetër.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Frika<br>(ora I) | | **Fjalë kyçe**<br>frikë, e dobishme, gjëra të vogla, ndihmoj të rritem, kapërcej druajtjen, frika nga frika. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• Parashikon përmbajtjen e tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Tregon llojin e pjesës dhe karakteristika të saj.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>Nga se kemi frikë? | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>– teksti mësimor;<br>– informacione nga interneti;<br>– foto,mjete shkrimi, fletë A4. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- vendimmarrja morale;<br>- bashkëjetesa paqësore. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** stuhi mendimesh, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën, lapsat në mes.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Stuhi mendimesh. Nga se kemi frikë? Nxënësit/et thonë se cilat gjëra i frikësojnë dhe mësuesi/ja i shkruan ato në tabelë.
- Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të parashikojnë përmbajtjen e tekstit, duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit, të cilat i shkruan në tabelë: *frikë, e dobishme, gjëra të vogla, ndihmoj të rritem, kapërcej druajtjen.*
- Ai/ajo udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit në paragrafë. Nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që u duken më interesante, më të rëndësishme.

- Mësuesja fton në diskutim nxënësit/et për punimin e fjalorit dhe pyetjeve rreth përmbajtjes.
- Lexohet pjesa zinxhir.
- Në rubrikën "Lexoj dhe kuptoj" gjejnë përgjigjen e duhur. Diskutojnë me gjithë klasën detyrën e bërë.
- Lapsat në mes. Të vendosur në formë rrethore nxënësit/et diskutojnë për gjërat nga të cilat nuk kanë frikë dhe diskutojnë për ngjarje të ndryshme nga jeta e tyre që kanë lidhje me to (mësuesi/ja i udhëzon të kenë parasysh stuhinë e mendimeve dhe frikërat e personazheve të pjesës). Çdo nxënës/e pasi përfundon së thëni mendimin e tij/saj vendos lapsin në mes të tavolinës. Mund të lexohet ndonjë kuriozitet për frikën. Mësuesja merr një laps të rastësishëm dhe pyet se çfarë ka thënë i zoti i lapsit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie:** Paraqit me vizatim një gjë nga e cila frikësohesh.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Frika(ora II)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>frikë, e dobishme, gjëra të vogla, ndihmoj të rritem, kapërcej druajtjen, frika nga frika.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br><br>Ndërveprimi me tekstin e nxënësit/et për të interpretuar problemin e frikës dhe për të gjykuar atë ç'ka kjo pjesë përcjell.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti;<br>- mjete shkrimi, fletë A4.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>vendimmarrja morale;<br>bashkëjetesa paqësore.</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** rrjeti i diskutimit, ditar dypjesësh, diskutim, bisedë, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**

- Mësuesja organizon klasën në grupe dyshe. Ata/ato plotësojnë një ditar dypjesësh (fragmenti që i ka pëlqyer dhe komenti përkatës).
- Tregohet përmbajtja e pjesës në dyshe e më pas disa nxënës/e e tregojnë atë që të dëgjojë gjithë klasa. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Tek rubrika"Shkruaj" nxënësit/et vendosin shenjën te gjërat që i frikësojnë.
- Diskutim për pyetjet e rubrikës"Reflektoj". Nxënësit/et ndajnë me njëri-tjetrin përvojat rreth leximit.
- Rrjeti i diskutimit. A duhet të kemi frikë ? Çdo dyshe shkruan arsyet që mbështesin secilën nga përgjigjet. Shtojnë argumentet pasi bashkohen me dyshen tjetër dhe dalin në një qëndrim përfundimtar.

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që u bën të tjerëve;
- tregimin e përmbajtjes;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij/saj

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Dhelpra dhe rrushtë | **Fjalë kyçe** |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së fabulës;<br>- tregon shkurtimisht përmbajtjen e fabulës, duke e ilustruar me detaje nga dëgjimi;<br>- shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të fabulës;<br>- veçon detaje interesante gjatë të dëgjuarit tyre;<br>- shfaq vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave. | **Situata e të nxënit**<br><br>Dëgjimi dhe tregimi i një fabule.<br>Interpretimi i saj. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor;<br>- magnetofon, CD, foto;<br>- mjete shkrimi, fletë A4. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>vendimmarrja morale;<br>bashkëjetesa paqësore. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve**

**Metodologjia:** stuhi mendimesh, dëgjim, lojë më role, diskutim, bisedë, punë në çift, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve/eve**
- Veprimtari me gjithë klasën. Mësuesi/ja fton nxënësit/et për të bërë stuhi mendimesh për fabulat. Nxënësit/et thonë ç'dinë për fabulat.
- Bëhet dëgjimi i fabulës "Dhelpra dhe rrushtë". Diskutohet rreth ndjesisë që nxënësit/et përjetuan gjatë dëgjimit të saj (zërat e personazheve-dhelpra dhe autori; muzika që shoqëron zërat e tyre etj.).
- Hapen librat dhe nxënësit/et lexojnë në heshtje fabulën. Diskutohet rreth përmbajtjes së saj duke u mbështetur edhe në pyetjet e ushtrimit 1. Nxënësit/et argumentojnë qëndrimin e tyre në lidhje mesazhin që kjo fabul përcjell.
- Në dyshe nxënësit/et ndajnë rolet. Lexojnë fabulën sipas roleve dhe e interpretojnë atë (njëri bëhet autori dhe tjetri dhelpra).Vlerësojnë njëri-tjetrin për këtë veprimtari.
- Nxënësit/et tregojnë fabulën.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së gazmoreve
- tregimin shkurtimisht të përmbajtjes së gazmoreve duke e ilustruar me detaje
- shprehjen e përjetimeve dhe emocioneve që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të gazmoreve
- veçimin e detajeve interesante gjatë të dëgjuarit tyre.
- Shfaqjen e vullnetit dhe besimit gjatë kryerjes së detyrave
  - Mënyrën e bashkëpunimit në grup dhe vlerësimin që i bëjnë nxënësit/et njëri-tjetrit.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Sekretet e vogla të babagjyshit<br>(ora I)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>sekrete, babagjysh, i veshur me të kuqe, llupës, mjekra, organizimi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• Parashikon përmbajtjen e tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Tregon llojin e pjesës dhe karakteristika të saj.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke punuar me tekstin nxënësit/et diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë tekstin;<br>rreth interpretimeve të tyre në lidhje me leximin e librave;<br>rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo pjesë tek nxënësit/et.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es;<br>- teksti mësimor.<br>- informacione nga interneti, foto, revista, mjete shkrimi A4.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave<br>Të drejtat e njeriut</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve<br>- Metodologjia: diskutim, stuhi mendimesh, lexim dhe mendim i drejtuar, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve/eve<br>Paraprakisht nxënësit/et kanë kërkuar e gjetur informacione për Babagjyshin e Vitit të Ri.<br>- Stuhi mendimesh. Ç'dini për Babagjyshin e Vitit të Ri? Nxënësit/et thonë ato që dinë rreth tij.<br>- Lexim dhe mendim i drejtuar: Mësuesja udhëzon nxënësit/et për leximin e tekstit të ndarë në 4 pjesë. Për secilën prej tyre, nxënësit/et nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, punojnë me fjalorin, u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes dhe bëjnë parashikime për pjesën në vazhdim. Mësuesja kërkon të argumentojnë parashikimin e bërë.<br>- Lexohet pjesa zinxhir.<br>- Lexohen materiale që nxënësit/et kanë gjetur nga burime të ndryshme.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;<br>- vlerësimin që u bën të tjerëve;<br>- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.<br><br>Detyrë shtëpie: Shkruaj ndonjë sekret tjetër të Babagjyshit.</td></tr>
</table>

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe<br>komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Sekretet e vogla të babagjyshit (ora II) | | **Fjalë kyçe**<br>sekrete, babagjysh, i veshur me të kuqe, llupës, mjekra, organizimi. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Nxënësi/ja:<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin.<br>• Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin . | | **Situata e të nxënit**<br>Babagjyshi i Krishtlindjeve | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/et;<br>- teksti mësimor;<br>- informacione nga interneti, foto, revista, mjete shkrimi A4. | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>- artet;<br>- teknologji dhe TIK;<br>- shoqëria dhe mjedisi.<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.<br>Të drejtat e njeriut. | |
| • Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi, fletëA4<br>– magnetofon dhe CD | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Lojë , Lexo përmblidh në dyshe**,** Diskutim, Bisedë,Pesëvargësh, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën, Harta e personazhit, Imagjinatë e drejtuar.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Imagjinatë e drejtuar: mësuesja fton nxënësit të mbyllin sytë , vendos muzikë të lehtë në sfond dhe i kërkon të mendojnë sikur do të kenë pranë një shok me nevoja të veçanta (nuk sheh, ecën me karrocë, nuk flet, nuk dëgjon etj) Nxënësit në dyshe thonë se si do të vepronin në raste të tilla.
- Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit nëpërmjet leximit zinxhir.
- Lexo përmblidh në dyshe: Njëri nxënës lexon një paragraf dhe tjetri e përmbledh me
- 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafin në vazhdim.
- Nxënësit tregojnë brendinë e pjesës me fjalët e tyre.
- Harta e personazhit për Dean. Nxënësit shkruajnë dy cilësi dhe ilustrojnë me pjesë nga teksti cilësitë e shkruara.
- Punohet rubrika "Reflektoj". Luajnë në dyshe duke shpikur shenja të ndryshme.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit
- mendimet që jep rreth tekstit
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet

**Detyrë shtëpie: Provo të miqësohesh me një fëmijë me nevoja të veçanta.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Mbiemri (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>Mbiemra, cilësi, lidh, | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• dallon fjalët që tregojnë cilësi të emrit<br>• lidh enmrat me mbiemrat<br>• shkruan mbiemra për emra të dhënë<br>• paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>• demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | | **Situata e të nxënit**<br>Manipulim me mbiemra | |

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto, | Artet, Shoqëria dhe mjedisi, |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Diskutim, Rishikim në dyshe, Tryeza e rrumbullakët, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh: Fjalë që tregojnë cilësi. Nxënësit punojnë për veprimtarinë në grupe. Lexojnë punët e tyre. Diskutojnë nën drejtimin e mësueses për fjalët që tregojnë cilësi. Emërtohen këto fjalë si mbiemra. Lexojnë dhe diskutojnë më pas rubrikën“Mbaj mend“.
- Rishikim në dyshe: Punohen ushtrimet 1, 2dhe3. Në ushtrimin 1 nxënësit lidhin emrat me mbiemrat e duhur, ndërsa në ushtrimet 2,3 për çdo emër shkruajnë nga një mbiemër.
- Tryeza e rrumbullakët: Nxënësit sipas grupeve të vendosur në formë rrethore shkruajnë nga një mbiemër në fletë në formë fizarmonike. Lexohen në grupe mbiemrat e shkruar. Vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lidhjen e emrave me mbiemrat
- shkrimin e mbiemrave për emra të dhënë
- dallimin e mbiemrave
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

**Detyrë shtëpie:**Shkruaj emra dhe mbiemra si në ushtrimin 2.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore**<br>Mbiemri(ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>Mbiemra, cilësi, lidh, |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• lidh emrat me mbiemrat<br>• shkruan mbiemra për emra të dhënë<br>• gjen mbiemrat në një tekst të dhënë<br>• paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>• demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | **Situata e të nxënit**<br>Manipulim me mbiemra |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, , Shoqëria dhe mjedisi, |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Rishikim në dyshe, Shkëmbe një problemë, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh- mbiemri-nxënësit në dyshe japin mendime për mbiemrin të cilat mësuesja i shkruan. Nxënësit, përsëri në dyshe shkruajnë sa më shumë mbiemra. Lexojnë punën e bërë e vlerësojnë njëri-tjetrin.

- Rishikim në dyshe: Punohen ushtrimet 4 dhe 5. Në ushtrimin 4 nxënësit përjashtojnë mbiemrat e gabuar, ndërsa në ushtrimin 5 nënvizojnë mbiemrat. Shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe diskutojnë me gjithë klasën mënyrën se si kanë punuar.
- Shkëmbe një problemë: Secili nxënës shkruan nga një fjali ku të përdorin një mbiemër. Shkëmbejnë etiketat në dyshe dhe gjejnë mbiemrin. Vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lidhjen e emrave me mbiemrat
- shkrimin e mbiemrave për emra të dhënë
- dallimin e mbiemrave
- paraqitjen dhe komunikimin e lirshëm dhe të saktë të mendimit të tij;
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në në grup.

**Detyrë shtëpie:**Ushtrimi 6.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Këpuca e vjetër (ora e parë)** | **Fjalë kyçe**<br>Këpucë,mrekulli, qytet I çuditshëm,gjigant |
| **Rezultatet e të nxënit**<br><br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | **Situata e të nxënit**<br><br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën,<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me fantazinë në këtë pjesë<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi,fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit të imagjinojnë një këpucë të madhe, shumë të madhe, gjigante. Shtron pyetjen: Përse mund të shërbejë ajo? Nxënësit japin mendimet e tyre.
- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.
- Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.
- Diskutohet për llojin e tekstit (tregim fantastik) dhe 2-3 karakteristika të tij (personazhe jorealë, ngjarje që nuk mund të ndodhin në jetën e përditshme etj)
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.

- Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.
- Nxënësit kryejnë njërën prej veprimtarive (ngjyrosin këpucën ose krijojnë objekte me materiale të riciklueshme).

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Këpuca e vjetër** (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>klub noti, ndeshje me porta në ujë, mbështet, pushime, | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin sipas roleve.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Tregon se cilët janë personazhet e preferuara.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | | **Situata e të nxënit**<br><br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën,<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me fantazinë në këtë pjesë<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi,fletëA4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Lojë në role, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja organizon klasën në grupe. Ajo ndan rolet në çdo grup (dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës). Më pas nxënësit në treshe luajnë sipas roleve.
- Ata tregojnë për personazhin që u pëlqen më shume duke argumentuar preferencën e tyre.
- Tregohet përmbajtja në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Nxënësit kryejnë njërën prej veprimtarive (ngjyrosin këpucën ose krijojnë objekte me materiale të riciklueshme).
- Diskutim për pyetjet e rubrikës“Reflektoj“. Nxënësit ndajnë me njëri-tjetrin mendimin rreth pyetjeve duke e argumentuar atë.
- Plotësohet rubrika “Shkruaj“, Ushtrimi 1.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij

**Detyrë shtëpie:** Rubrika”Shkruaj” ushtrimi 2

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Semafori zbavitet (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Semafor, ngjyra, rregull, kryqëzim, trafik</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për teksti</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me semaforin,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– foto, mjete shkrimi, fletëA4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.<br>• Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.<br>• Diskutohet për llojin e tekstit (tregim fantastik) dhe 2-3 karakteristika të tij (personazhe jorealë, ngjarje që nuk mund të ndodhin në jetën e përditshme etj)<br>• Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.<br>• Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.<br>• Shënojnë më shenjat e vërtetë, e gabuar fjalitë tek rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Shkëmbejnë librat e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>– mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>– vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>– tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>– tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.<br>– lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>– pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Semafori zbavitet (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Semafor, ngjyra, rregull, kryqëzim, trafik</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| • Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin fantastik.<br>• Tregon se cilët janë personazhet e preferuara.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | rreth interpretimit të tyre në lidhje me semaforin, rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto, mjete shkrimi,fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Stuhi mendimesh, Lexim përmbledhje në dyshe, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- **S**tuhi mendimesh me gjithë klasën- Mësuesja paraqet në foto/video një situatë trafiku në kryqëzim. Ajo shkruan në tabelë mendimet e nxënësve.
- Nxënësit lexojnë me paragrafë- lexo, përmblidh në dyshe.
- Tregohet përmbajtja e pjesës. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Diskutim për pyetjet e rubrikës“Reflektoj“. Nxënësit ndajnë me njëri-tjetrin përvoja nga situata të ngjashme.(trafiku me të cilin ndeshen çdo ditë)
- Plotësohet rubrika “Shkruaj“, Ushtrimi 1.
- Improvizohet në klasë një situatë e ngjashme. Nxënësit marrin nga një rol për të interpretuar.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e përmbajtjes
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Unë i respektoj rregullat(ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>respektoj, rregulla, këshilla, semafor, kryqëzim | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan këshilla për mënyrën e ecjes në rrugë.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit<br>• Vlerëson punët e të tjerëve<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Improvizim i kalimit në udhëkryq | |

<table>
<tr>
<td>Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi fletë A4 ,semaforë prej kartoni,</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi<br>Bashkëjetesa paqësore</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Stuhi mendimi, Diskutim, Bisedë, Rishikim në dyshe, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>- Stuhi mendimi: Nxënësit punojnë në grupe e shkruajnë për rregullat e ecjes në rrugë. Prezantohet puna sipas grupeve.<br>- Mësuesja prezanton temën dhe nxënësit komentojnë figurat.<br>- Ushtrimi 1-Nxënësit vendosin numra në përshtatje me figurat e semaforit në të djathtë të ushtrimit. Nxënësit diskutojnë për kryerjen e ushtrimit dhe rregullat në semafor.<br>- Rishikim në dyshe: Ushtrimi 2 – Nxënësit shkruajnë tri këshilla për kalimin e rrugës.<br>- Shkëmbejë librat e bëjnë qortime të thjeshta për gabimet drejtshkrimore që mund të kenë bërë.<br>- Improvizohet një udhëkryq dhe nxënësit ecin në të sipas grupeve. Shokët e grupeve të tjera e shkruajnë rregullën përkatëse.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>- shkrimin e këshillave për mënyrën e ecjes në rrugë.<br>- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>- Bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore.<br>- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit<br>- vlerësimin e punës së të tjerëve<br>- bashkëpunimin në grup për kryerjen detyrës.<br>Detyrë shtëpie: shkruaj dhe dy këshilla të tjera për kalimin e rrugës</td>
</tr>
</table>

<table>
<tr>
<td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td>
<td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td>
<td>Klasa 2</td>
<td>Data</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Tema mësimore<br>Unë i respektoj rregullat(ora e dytë)</td>
<td colspan="2">Fjalë kyçe<br>respektoj, rregulla, këshilla, semafor, kryqëzim</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Shkruan këshilla për mënyrën e ecjes në rrugë.<br>• Shkruajnë mbylljen e një tregimi sipas imagjinatës së tyre.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit<br>• Vlerëson punët e të tjerëve<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td>
<td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Semafori</td>
</tr>
</table>

<table>
<tr><td>Burimet dhe materialet didaktike<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi fletë A4,</td><td>Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi<br>Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Stuhi mendimi, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Shkrim i lirë: Nëse do të isha një semafor....Nxënësit shkruajnë 2-3 fjali sipas imagjinatës. Lexohen shkrimet e tyre.<br>• Punë individuale: nxënësit punojnë për ushtrimin 3. Lexojnë pjesën dhe në fletore shkruajnë një mbyllje tjetër për historinë. Diskutojnë në dyshe, e më pas me gjithë klasën për mbylljet që i kanë bërë historisë.<br>• Ushtrimi 4 bëhet individualisht në fletore.<br>• Shkëmbejnë fletoret e bëjnë qortime të thjeshta për gabimet drejtshkrimore që mund të kenë bërë. Lexojnë disa nxënës shkrimet e tyre.<br>Vlerësimi bëhet për:<br>– mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>– vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>– shkruan histori / mbyllje të tyre<br>– respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit<br>– bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore.<br>– shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit<br>– vlerësimin e punës së të tjerëve<br>• bashkëpunimin në grup për kryerjen detyrës.<br>Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dordoleci (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Dordoleci, aventurë, magjistari I Ozit, Qyteti I Smeraldeve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për teksti</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me aventurën e Doroteas.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– Libri “Magjistari i Ozit”, foto, mjete shkrimi,- fletëA4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Imagjinatë e drejtuar,Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Imagjinatë e drejtuar- mësuesja fton nxënësit të mbyllin sytë dhe i tregon për Dorotean që stuhia e fuqishme e erës e çoi në botën magjike të Ozit/lexon paragrafin e parë në tekst.</td></tr>
</table>

- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe dhe imagjinata e tyre
- Lexim, mendim i drejtuar. Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Diskutojnë rreth përmbajtjes së paragrafit dhe bëjnë parashikime për paragrafët që pasojnë. Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.
- Diskutohet për llojin e tekstit (tregim fantastik) dhe 2-3 karakteristika të tij (personazhe jorealë, ngjarje që nuk mund të ndodhin në jetën e përditshme etj)
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa në heshtje për ta kuptuar më mirë.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Shfletojnë librat që kanë marrë me vete dhe diskutojnë rreth tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dordoleci (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Dordoleci, aventurë, magjistari i Ozit, Qyteti i Smeraldeve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin sipas roleve.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin fantastik.<br>• Tregon se cilët janë personazhet e preferuara.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me aventurën e Doroteas.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>Libri "Magjistari I Ozit", foto, mjete shkrimi, fletëA4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: lojë në role, lexo-përmblidh në dyshe, Harta e personazheve, Diskutim, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>- Mësuesja orienton nxënësit për një „lexim-përmblidhje në dyshe' të tekstit.<br>- Plotësohet tabela e rubrikës „lexoj dhe kuptoj" Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e plotësimit të tabelës.<br>- Tregohet përmbajtja në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.<br>- Punë në dyshe "Harta e personazheve". Nxënësit shkruajnë dy cilësi për Dorotean dhe Dordolecin dhe pjesët ilustruese nga teksti për secilën cilësi.<br>- Prezantojnë punët e tyre dhe i diskutojnë me gjithë klasën.</td></tr>
</table>

- Mësuesja organizon klasën në grupe treshe. Ajo ndan rolet në çdo grup (dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës). Më pas nxënësit në treshe luajnë sipas roleve.
- Diskutim për pyetjet e rubrikës“Reflektoj“.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e përmbajtjes
- përshkrimin e personazheve;
- lojën me role
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Përshkruajmë një personazh fantastik (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>Personazh, fantastik, karakteristika, përshkruaj | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Përshkruan një personazh fantastik.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit<br>• Vlerëson punët e të tjerëve<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br><br>Libra fantastikë, përshkrimi i një personazhi fantastik duke u mbështetur në pamjen e karakterin e tij. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto, libra fantas-tikë,” Magjistari i Ozit“ | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Stuhi mendimesh, Bisedë, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Stuhi mendimesh- Personazhe fantastikë. Nxënësit shkruajnë në grup çfarë u vjen në mëndje për një personazh fantastik si dhe emra të personazheve fantastikë që njohin.

Lexojnë në heshtje pjesën e shkëputur nga“Magjistari i Ozit“. Diskutohet pak për librin e ndalen tek personazhet e tij.

Në dyshe diskutojnë për karakteristikat e Dordolecit tek ushtrimi i parë dhe punojnë në libër për përshkrimin e tij.

Tryezë e rrumbullakët: Të vendosur në një tryezë rrethore nxënësit shkruajnë nëse Dordoleci është personazh i vërtetë apo fantastik duke dhënë vetëm një argument për këtë gjë. Lexohen shkrimet e gjithsecilit. Bëjnë qortime të thjeshta drejtshkrimore.

Shkrim i shpejtë: Zgjidhni njërin prej personazheve fantastikë që do të dëshironit të ishit. Shkruaj 2-3 fjali për këtë.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- përshkrimin e një personazhi fantastik
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

| |
|---|
| - bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore.<br>- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit<br>- vlerësimin e punës së të tjerëve<br>- bashkëpunimin në grup për kryerjen detyrës<br>**Detyrë shtëpie:** Listo disa personazhe fantastikë nga librat që ke lexuar. Shkruaj nga 2 karakteristika për secilin. |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Përshkruajmë një personazh fantastik (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>Personazh, fantastik, karakteristika, përshkruaj | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Përshkruan një personazh fantastik<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit<br>• Vlerëson punët e të tjerëve<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br><br>Improvizim:Ardhja e një personazhi fantastik në klasë. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,libra fantastikë," Magjistari i Ozit" | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** Imagjinatë e drejtuar,Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
- **J**anë udhëzuar nxënësit që të vishen me rroba sipa**s** personazheve fantastikë të preferuar.
  Imagjinatë e drejtuar: Krijohet mjedisi i përshtatshëm për këtë veprimtari. Nëse unë do të isha…
  Shkruajnë përshkrimin për personazhin që pëlqejnë më shumë me 1-2 fjali. Lexohen në dyshe punët e nxënësve.
- Ushtrimi 3 punohet individualisht. Për secilën cilësi të dhënë gjejnë e shkruajnë pjesën ilustruese nga teksti. Lexojnë e diskutojnë detyrën në dyshe.
- Ushtrimi 4. Nxënësit zgjedhin njërin prej personazheve në figurë. Grupohen në grupe sipas personazhit të zgjedhur. Në fillim diskutojnë në grup për përshkrimin e tij dhe më pas punojnë individualisht në fletore.
- Shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin e qortojnë gabimet drejtshkrimore.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- përshkrimin e një personazhi fantastik
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit
- bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore.
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit
- vlerësimin e punës së të tjerëve
- bashkëpunimin në grup për kryerjen detyrës

**Detyrë shtëpie:** Krijo një personazh fantastik sipas imagjinatës e përshkruaje.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Gjinia e mbiemrit (ora e parë)** | **Fjalë kyçe**<br>Mbiemër, gjini, femërore, mashkullore |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore.<br>Lidh mbiemrat me emrat sipas gjinisë.<br>Paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | **Situata e të nxënit**<br>Manipulim me mbiemra për të përcaktuar gjininë e tyre. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– mjete shkrimi , fletëA4, fisha me emra dhe mbiemra të të dy gjinive | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi, |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Rishikim në dyshe, Shkëmbe një problemë, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja ka përgatitur fisha me emra njerëzish të shoqëruar me mbiemra: vajzë e vogël, djalë i gjatë etj.
- Nxënësit punojnë në dyshe për ti grupuar në dy grupe sipas gjinisë në mënyrë intuitive. Diskutojnë për të nxjerrë rregullin për përcaktimin e gjinisë së mbiemrave.
- Diskutohet rasti i dhënë në libër dhe lexohet rregulli.
- Rishikim në dyshe: Punohet ushtrimi 1 individualisht. Shkruhen emrat sipas mbiemrave të dhënë dhe shkruajnë gjininë e tyre. Shkëmbehen librat me shokët në dyshe. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Rishikim në dyshe: Punohet ushtrimi 2 individualisht. Nxënësit lidhin emrat me mbiemrat dhe i grupojnë në tabelë sipas gjinisë. Shkëmbehen librat me shokët në dyshe. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Shkëmbe një problemë: Për këtë ushtrim nxënësit punojnë në grupe. Secili nga anëtarët e grupit shkruan në një etiketë nga një emër të shoqëruar me mbiemër. Etiketat shkëmbehen me grupin fqinjë të cilët kanë për detyrë t'i grupojnë ato në dy grupe

(të gjinisë femërorë dhe të gjinisë mashkullore). Prezantohet puna dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e gjinisë së mbiemrit.
- dallimin e mbiemrave të gjinisë femërore nga ata mashkullore.
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime.
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 5 mbiemra të gjinisë femërore dhe 5 emra të gjinisë mashkullore.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Gjinia e mbiemrit (ora e dytë)** | **Fjalë kyçe**<br>Mbiemër, gjini, femërore, mashkullore |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>Tregon gjininë e mbiemrit.<br>Dallon emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore.<br>Lidh mbiemrat me emrat sipas gjinisë.<br>Paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | **Situata e të nxënit**<br>Manipulim me mbiemra për të përcaktuar gjininë e tyre. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, fletëA4, fisha me emra dhe mbiemra të të dy gjinive | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi, |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Rishikim në dyshe, Dil rrotull fol rrotull, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Dil rrotull, fol rrotull: Mësuesja i fton nxënësit të gjejnë gjininë e disa mbiemrave që ka shkruar në tabelë. (lule e bukur, kopsht i vogël, diell i nxehtë, dollap i lartë) Mendojnë për pak minuta. Nxënësit ngrihen në këmbë dhe ecin në një vend të hapur në klasë derisa mësuesi përplas duart. Ndalojnë e flasin me shokun që kanë ngjitur për gjininë e mbiemrave të mësipërm.

- Rishikim në dyshe: Punohet ushtrimi 3,4 individualisht. Në ushtrimin 3 gjejnë e korrigjojnë mbiemrat e vendosur gabim, ndërsa te ushtrimi 4 gjejnë mbiemrat në tekstin e dhënë. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Punë në grup: Nxënësit shkruajnë në etiketa të veçanta nga dy emra dhe mbiemra. I vendosin duke i ngjitur etiketat në një tabelë kartoni të përgatitur më parë sipas modelit:

| gjinia femërore | gjinia mashkullore |
|---|---|
| | |

Çdo grup prezanton punën e tij. Vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

- Prezantohet puna dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e gjinisë të mbiemrit në mënyrë intuitive.
- dallimin e mbiemrave të gjinisë femërore nga ata mashkullore.
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime.
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj dy fjali ku të përdorësh mbiemra të gjinisë femërore dhe gjinisë mashkullore.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Peshku dhe miu (ora e parë)** | **Fjalë kyçe**<br>Peshku, miu, tokë, det, algë, koral |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me historitë fantastike<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.
- Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Punohen pyetjet tek rubrika "Lexoj dhe kuptoj".
- Ditari dypjesësh – Nxënësit kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën e cila u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje, nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Peshku dhe miu (ora e dytë)** | **Fjalë kyçe**<br>Peshku, miu, tokë, det,algë, koral |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin sipas roleve.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet fantastikë.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td>Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me historitë fantastike<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td>Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4</td><td>Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Lojë në role, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Harta e personazheve, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>- Mësuesja organizon klasën në grupe treshe. Ajo ndan rolet në çdo grup (dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës). Më pas nxënësit në treshe lexojnë/luajnë sipas roleve.<br>- Tregohet përmbajtja në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.<br>- Punë në dyshe “Harta e personazheve”. Nxënësit shkruajnë dy cilësi për personazhet dhe pjesët ilustruese nga teksti për secilën cilësi.<br>- Prezantojnë punët e tyre dhe i diskutojnë me gjithë klasën.<br>- Diskutim për pyetjet e rubrikës“Reflektoj“. Nxënësit ndajnë me njëri-tjetrin përvoja nga jeta e tyre.<br>- Plotësohet rubrika”Shkruaj”. Nxënësit krahasojnë punën me njëri-tjetrin dhe e vlerësojnë atë.<br>- Vlerësimi bëhet për:<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>- tregimin e përmbajtjes<br>- përshkrimin e personazheve;<br>- lojën me role<br>- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Misteri i hënës (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Mister, hënë, smog,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me ndotjen dhe mbrojtjen e ajrit,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
</table>

| Burimet dhe materialet didaktike | Lidhja me fushat e tjera |
|---|---|
| – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– foto, mjete shkrimi, fletëA4 | Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Mjedisi<br>Të drejtat e njeriut |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.
- Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Shënojnë numrat pranë çdo fjalie tek rubrika "Lexoj dhe kuptoj", duke i renditur fjalitë sipas radhës së ngjarjeve. Shkëmbejnë librat e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore**<br>**Misteri i hënës** (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>Mister, hënë, smog, |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin fantastik.<br>• Tregon se cilët janë personazhet e preferuara.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me ndotjen dhe mbrojtjen e ajrit,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– foto, mjete shkrimi, fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Mjedisi<br>Të drejtat e njeriut |

| |
|---|
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br><br>**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Harta e personazheve, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve**<br>- Tregohet përmbajtja në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.<br>- Punë në dyshe “Harta e personazheve”. Nxënësit shkruajnë dy cilësi për Martinën dhe pjesët ilustruese nga teksti për secilën cilësi.<br>- Prezantojnë punët e tyre dhe i diskutojnë me gjithë klasën.<br>- Diskutim për pyetjet e rubrikës“Reflektoj“. Nxënësit ndajnë me njëri-tjetrin përvoja nga noti apo sporte të tjera me të cilat merren.<br><br>**Vlerësimi bëhet për:**<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>- tregimin e përmbajtjes<br>- përshkrimin e personazheve;<br>- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij<br><br>**Detyrë shtëpie:** Rubrika”Shkruaj” |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Numri i mbiemrit (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>Numri i mbiemrit, njëjës, shumës, | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Tregon numrin e emrit në mënyrë intuitive.<br>• Dallon mbiemrat e numrit njëjës nga ata të numrin shumës.<br>• Shoqëron emrat me mbiemrat sipas numrit.<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | | **Situata e të nxënit**<br>Manipulim me mbiemra për të përcaktuar numrin e tyre. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- fisha me mbiemra të numrit njëjës dhe shumës, mjete shkrimi, fletë A4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi, | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Rishikim në dyshe, Shkëmbe një problemë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja ka përgatitur fisha me mbiemra në numrin njëjës dhe në numrin shumës.
- Nxënësit punojnë në dyshe për ti grupuar në dy grupe sipas numrit në mënyrë intuitive. Diskutojnë për të nxjerrë rregullin për përcaktimin e numrit të mbiemrave.
- Diskutohet rasti i dhënë në libër dhe lexohet rregulli.
- Rishikim në dyshe:Punohet ushtrimi 1 individualisht. Lidhen me shigjetë emrat me mbiemra dhe shkruhen në tabelën e dhënë sipas numrit njëjës dhe numrit shumës. Shkëmbehen librat me shokët në dyshe. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Rishikim në dyshe:Punohet ushtrimi 2 individualisht. Nxënësit kthejnë emrat dhe mbiemrat e dhenë nga numri njëjës në numrin shumës. Shkëmbehen librat me shokët në dyshe. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Shkëmbe një problemë: Për këtë ushtrim nxënësit punojnë në grupe. Secili nga anëtarët e grupit shkruan në një etiketë nga një emër dhe mbiemër në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Etiketat shkëmbehen me grupin fqinjë, të cilët kanë për detyrë t'i grupojnë etiketa në dy grupe sipas numrit.
- Prezantohet puna dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e numrit të mbiemrit në mënyrë intuitive.
- dallimin e mbiemrave të numrit njëjës dhe numrit shumës.
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime.
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

**Detyrë shtëpie:** Gjej 3 mbiemra të numrit njëjës dhe 3 mbiemra të numrit shumës.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Numri i mbiemrit(ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Numri i mbiemrit, njëjës, shumës,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Tregon numrin e mbiemrit.<br>• Dallon mbiemrat e numrit njëjës nga ata të numrin shumës.<br>• Kthen mbiemrat nga numri njëjës tek numri shumës.<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Manipulim me mbiemra për të përcaktuar numrin e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- fisha me mbiemra të numrit njëjës dhe shumës, mjete shkrimi ,fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, , Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Diskutim, Rishikim në dyshe, Shkrim i shpejtë, Shkëmbe një problemë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.</td></tr>
</table>

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Shkrim i shpejtë: Mësuesja i fton nxënësit që sipas dysheve të shkruajnë sa më shumë mbiemra në numrin njëjës dhe në numrin shumës. Më pas në grup ata i grupojnë sipas numrit.
- Rishikim në dyshe:Punohet ushtrimi 3,4, individualisht. Nxënësit kthejnë mbiemrat nga numri njëjës në numrin shumës,ndërsa në ushtrimin 4 gjejnë mbiemrat dhe i vendosin në tabelë. Përcaktojnë gjininë dhe numrin e tyre. Shkëmbehen librat me shokët në dyshe. Diskutojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Punë në grup: Nxënësit shkruajnë në etiketa të veçanta nga dy mbiemra (njëri në numrin njëjës e tjetrin në numri shumës). I vendosin duke i ngjitur etiketat në një tabelë kartoni të përgatitur më parë sipas modelit:

| numri njëjës | numri shumës |
|---|---|
| | |

- Prezantohet puna dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e numrit të mbiemrit në mënyrë intuitive.
- dallimin e mbiemrave të numrit njëjës e shumës.
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime.
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj dy mbiemra të numrit njëjës dhe dy mbiemra të numrit shumës. Ndëro fjali me to.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Në një planet të çuditshëm (ora e parë)** | **Fjalë kyçe**<br>Planet, Kristal, luspa, zilkë |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për teksti | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me historitë fantastike<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh me gjithë klasën "Planet i çuditshëm". Mësuesja shkruan në tabelë mendimet e nxënësve.
- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.
- Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.

| |
|---|
| • Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.<br>• Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.<br>• Shënojnë me shenjat e vërtetë, e gabuar fjalitë tek rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Shkëmbejnë librat e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br>• Ditari dypjesësh – Nxënësit kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën e cila u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje, nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre.<br>**Vlerësimi bëhet për:**<br>– mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>– vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>– lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>– tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>– tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.<br>– lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>– pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Në një planet të çuditshëm (ora e dytë)** | | **Fjalë kyçe**<br>Planet, Kristal, luspa, zilkë | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin sipas roleve.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin fantastik.<br>• Tregon se cilët janë personazhet e preferuara.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me historitë fantas-tike<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– foto, mjete shkrimi, fletëA4, informacione nga interneti | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi, Teknologji dhe Tik,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Mjedisi | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br><br>**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve**<br>– Udhëzohen nxënësit për leximin e pjesës me paragrafë - Pyet sërish: nxënësit lexojnë tekstin me paragrafë. Diskutojnë në dyshe: njëri nxënës bën pyetje rreth informacioneve në tekst. Nxënësi tjetër i përgjigjet pyetjeve. Në paragrafin tjetër ndërrojnë rolet.<br>– Tregohet përmbajtja në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.<br>– Diskutim për kërkesat e rubrikës"Reflektoj". Nxënësit plotësojnë ato në tekst. Krahasojnë dhe vlerësojnë punët e njëri-tjetrit.<br>**Vlerësimi bëhet për:**<br>– mënyrën e bashkëpunimit në grupe. | | | |

| |
|---|
| - vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>- tregimin e përmbajtjes<br>- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij |

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Një çadër e çuditshme</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Çadër e çuditshme,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit<br>- tregon shkurtimisht përmbajtjen e tregimit duke e ilustruar me detaje nga dëgjimi<br>- shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të tregimit<br>- veçon detaje interesante gjatë të dëgjuarit tyre.<br>- shfaq vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Dëgjimi I një tregimi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi, fletë A4<br>- CD, magnetofon</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>• Metodologjia: stuhi mendimesh,"dëgjim-mendim i drejtuar", lojë më role, diskutim, punë në çift,punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>Veprimtari me gjithë klasën. Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te dëgjimi i titullit, muzikës që e shoqëron, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.<br>• Bëhet dëgjimi i pjesës së parë të tregimit. Diskutohet rreth ndjesisë që nxënësit përjetuan gjatë dëgjimit të saj.(zërat e personazheve; muzika që shoqëron këto zëra etj)ndalet te përmbajtja e pjesës që dëgjuan. Diskutohet rreth përmbajtjes së pjesës dhe parashikimit të vazhdimit të ngjarjes. Vazhdohet kështu me të gjithë pjesët e tregimit deri në fund.<br>• Hapen librat dhe nxënësit lexojnë në heshtje tregimin.<br>• Në dyshe e më pas me gjithë klasën, nxënësit diskutojnë rreth pyetjeve të ushtrimit 4.<br>• Në dyshe nxënësit ndajnë rolet. Lexojnë tregimin sipas roleve dhe e interpretojnë atë (njëri bëhet autori dhe tjetri djali).Vlerësojnë njëri-tjetrin për këtë veprimtari.<br>• Nxënësit tregojnë historinë..<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tregimit<br>- tregimin shkurtimisht të përmbajtjes së tregimit duke e ilustruar me detaje<br>- shprehjen e përjetimeve dhe emocioneve që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të tregimit<br>- veçimin e detajeve interesante gjatë të dëgjuarit tyre.<br>- Shfaqjen e vullnetit dhe besimit gjatë kryerjes së detyrave<br>Mënyrën e bashkëpunimit në grup dhe vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.</td></tr>
</table>

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Takim I papritur (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>Tregim fantastik, hyrje, zhvillim, mbyllje | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan tregime të thjeshta nisur nga disa ilustrime.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• Vlerëson punët e të tjerëve;<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një tregimi duke parë figurat. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br><br>**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Bisedë, Punë individuale, Punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve**<br>• Stuhi mendimesh-tregimi- nxënësit japin mendime për ç'ka dinë për tregimet. Mësuesja e drejton diskutimin te karakteristikat që ka hyrja, zhvillimi dhe mbyllja e tregimeve.<br>• Punë me gjithë klasën- Nxënësit shohin figurat dhe i komentojnë ato.<br>• Punë individuale-Ushtrimi 1. Nxënësit individualisht shkruajnë secilën pjesë të tregimit. Mësuesja udhëzon të përshkruajnë personazhet fantastikë duke shfrytëzuar përvojën tek përshkrimi i personazheve fantastikë.<br>• Pas shkrimit të secilës pjesë, nxënësit lexojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br>• Lexohet tregimi i plotë pas përfundimit të tij. Nxiten që nxënësit të vlerësojnë shpirtin krijues e imagjinatën.<br><br>**Vlerësimi bëhet për:**<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>- shkrimin e një tregimi të thjeshtë nisur nga disa ilustrime<br>- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit<br>- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit<br><br>**Detyrë shtëpie:** Shkruaje tregimin në fletore. | | | |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Takim i papritur(ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>Tregim fantastik, hyrje, zhvillim, mbyllje | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan tregime të thjeshta.<br>• Respekton gjatë shkrimit pjesët e tregimit (hyrje-zhvillim-mbyllje) | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një historie që u ka lënë mbresa. | |

<table>
<tr><td>

- Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- Vlerëson punët e të tjerëve;
- Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

</td><td></td></tr>
<tr><td>

**Burimet dhe materialet didaktike**

- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit
- teksti mësimor
- foto, mjete shkrimi, fletëA4

</td><td>

**Lidhja me fushat e tjera**
Artet, Shoqëria dhe mjedisi,
**Lidhja me temat ndërkurrikulare**
Të drejtat e njeriut
Vendimmarrja morale
Mjedisi
Bashkëjetesa paqësore

</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia**: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja paraqet një video të shkurtër ose foto që tregojnë një histori me personazhe fantastikë. Diskutohet rreth saj. Mësuesja kujdeset që nxënësit të dallojnë pjesën hyrëse e mbyllëse të historisë. (edhe zhvillimin)
- Punë individuale: Mësuesja i fton nxënësit të mendojnë për një histori fantastike që u pëlqen. Diskutojnë me shokun në dyshe pse e kanë zgjedhur pikërisht këtë histori. Pastaj punojnë individualisht në fletore për shkrimin e saj duke patur parasysh pjesët e tregimit të diskutuara orën e kaluar. Shkëmbejnë fletoret dhe bëjnë vlerësimin e punës së njëri-tjetrit. Lexohen disa nga shkrimet e nxënësve.
- Me ndihmën e mësueses bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore**.**

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shkrimin e një historie fantastike të thjeshtë
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një histori tjetër.

</td></tr>
</table>

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">

**Tema mësimore**
Lexim jashtë klase
**(sipas zgjedhjes së mësueses)**

</td><td colspan="2">

**Fjalë kyçe**

</td></tr>
<tr><td colspan="2">

**Rezultatet e të nxënit**

- Lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj**.**
  **(sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesja)**
- Përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive.

</td><td colspan="2">

**Situata e të nxënit**
Leximi i librave jashtëklase

</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesja)**<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferu-ara.<br>• Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar.<br>• Shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit<br>• Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nx-ënësit<br>- libra jashtëklase | **Lidhja me fushat e tjera**<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare** |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Prezantimi i titullit të librit dhe autori.
- Leximi i pjesës.
- Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj.
- Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.
- Tregimi i brendisë së pjesës.
- Personazhet dhe cilësitë e tyre.
- Mesazhi që përcjell pjesa.
- Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.
- Ilustrim i pjesës me vizatim.

Vlerësimi bëhet për rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.

Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do zgjedhë mësuesja për të punuar.

# *Moduli 5*

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br><br>Shqiponja | **Fjalë kyçe**<br>shqiponjë, flamur, çerdhe |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>• tregon elementet e vjershës si: strofa, vargu;<br>• parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth vjershës;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet. | **Situata e të nxënit**<br><br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për mënyrën se si ata e kuptojnë poezinë, për interpretimin e tyre në lidhje me flamurin shqiptar, rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi tek nxënësit. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;<br>- teksti mësimor;<br>- mjete shkrimi, A4, mjete vizatimi. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Edukimi atdhetar |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** Lexo, përmblidh në dyshe, diskutim, bisedë, lojë në role, punë në çift, punë në grup, punë individuale

**Veprimtaritë e nxënësve**
Mësuesja orienton nxënësit të shohin figurën, të lexojnë titullin dhe të bëjnë parashikimin për përmbajtjen e vjershës duke diskutuar në dyshe. Nxënësit tregojnë parashikimet e tyre.
Lexohet vjersha në heshtje. Nxënësit tregojnë ndryshimet e përmbajtjes së vjershës dhe parashikimit që i kanë bërë.
Punë në dyshe: Nxënësit duke punuar në dyshe lexojnë dhe e përmbledhin çdo strofë me 1fjali. Njëri prej nxënësve lexon dhe tjetri përmbledh. Ndërrohen rolet pas çdo strofe.
Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”. Nxënësit rendisin fjalitë përmbledhëse sipas radhës së kryerjes së veprimeve.
Punohet rubrika “Reflektoj” dhe ngjyroset flamuri në figurë.
Nxënësit qarkojnë rrokjet e fundit të secilit varg në strofën e fundit dhe tregojnë që këto rrokje janë të njëjta, gjë e cila përbën dhe rimën e saj.

**Vlerësimi bëhet për:**
diskutimet rreth mënyrës se si ata e kuptojnë poezinë;
rreth interpretimeve të tyre në lidhje me poezinë;
rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi;
vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit dhe mënyrën e bashkëpunimit në grup.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Shpata e Skënderbeut (ora e parë)** | **Fjalë kyçe**<br>shpatë, mjeshtër, farkë, teh |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën; dhe rreth interpretimit të tyre në lidhje me informacionet që kanë për Skënderbeun dhe armët e tij, rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;<br>- teksti mësimor;<br>- foto të Skënderbeut dhe të armëve të tij. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Edukimi atdhetar |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Parashikim me terma paraprakë, Ditari dypjesësh**,** Diskutim, Lexim, mendim i drejtuar, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit të ndërtojnë një tregim të shkurtër ku të përdorin 4 fjalë të cilat janë paraqitur në tabelë. (Skënderbeu, shpata, mjeshtri, e fortë) disa prej nxënësve lexojnë tregimet e tyre.
- Lexim dhe mendim i drejtuar: Mësuesja udhëzon nxënësit për leximin e tekstit të ndarë në pjesë. (pjesa e parë- ...Eja me mua, pjesa e dytë-...deri në fund). Për secilën prej tyre, nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, punojnë me fjalorin, u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes dhe bëjnë parashikime për pjesën në vazhdim. Mësuesja kërkon të argumentojnë parashikimin e bërë.
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Shënojnë më shenjat e vërtetë, e gabuar fjalitë te rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Shkëmbejnë librat e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Ditari dypjesësh – Nxënësit kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën e cila u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje, nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre .
- Nxënësit ndajnë me shokët informacionet që kanë në lidhje me Skënderbeun dhe armët që ai ka përdorur.

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;

- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;
- tregon si e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet;
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.

**Detyrë shtëpie**: Vizato shpatën e Skënderbeut.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shpata e Skënderbeut (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>shpatë, mjeshtër, farkë, teh</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;<br>• jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën;<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me informacionet që kanë për Skënderbeun dhe armët e tij, rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;<br>- teksti mësimor;<br>- foto të Skënderbeut dhe të armëve të tij.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Edukimi atdhetar</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>• Metodologjia: Lexo përmblidh në dyshe, Diskutim, Bisedë,Lojw me role, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>- Mësuesja organizon klasën në grupe treshe. Ajo ndan rolet në çdo grup (dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës). Më pas nxënësit në treshe luajnë sipas roleve.<br>- Punë në dyshe “Harta e personazheve”. Nxënësit shkruajnë nga një- dy cilësi për 2 personazhet e pjesës dhe pjesët ilustruese nga teksti për secilën cilësi. Prezantojnë punët e tyre dhe i diskutojnë me gjithë klasën.<br>- Lexo përmblidh në dyshe: Njëri nxënës lexon një paragraf dhe tjetri e përmbledh me 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafin në vazhdim.<br>• Nxënësit tregojnë brendinë e pjesës me fjalët e tyre.<br>• Punohet rubrika “Reflektoj”e cila zhvillohet si bisedë ku nxënësit ndajnë informacionet e tyre në lidhje me historitë e Skënderbeut.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit;
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit;
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit;
- mendimet që jep rreth tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shkruajmë për Skënderbeun (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>fjalë, plotëso, përshkruaj, portret, shpatë, përkrenare, kalë,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• shkruan duke plotësuar me fjalë ndihmëse tekstin e dhënë;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përshkrimi i Skënderbeut.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga internet, foto</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
- **Metodologjia:** Hartë koncepti**,** Tryezë e rrumbullakët, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**
Nxënësit kanë sjellë informacione nga interneti, foto pikturash dhe skulpturash të Heroit Kombëtar Skënderbeut. Këto materiale i shfrytëzojnë në veprimtarinë e mëposhtme.
- Nxënësit në grup ndërtojnë një "Hartë koncepti" për Skënderbeun (portretin, veshjen dhe mburojat, karakterin etj).
- *Punë individuale*- Ushtrimi 1. Në këtë ushtrim nxënësit lexojnë e plotësojnë tekstin me fjalët ndihmëse .
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
- Tryezë e rrumbullakët- nxënësit të vendosur në formë rrethi shkruajnë njëri pas tjetrit nga një fjali për Skënderbeun në një fletë A4 të palosur në formë fizarmonike. Lexojnë fjalitë e shkruara sipas grupeve.

**Vlerësimi bëhet për:**
- plotësimin e tekstit me fjalë ndihmëse;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 3 fjali për Skënderbeun.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Shkruajmë për Skënderbeun (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>fjalë, plotëso, përshkruaj, portret, shpatë, përkrenare, kalë | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>- përshkruan portretin e Skënderbeut duke iu përgjigjur pyetjeve;<br>- përshkruan objekte duke u nisur nga figurat;<br>- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>- vlerëson punët e të tjerëve;<br>- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Përshkrimi i Skënderbeut duke u nisur nga fotot e tij.<br>Përshkrimi i objekteve, armëve dhe kalit të Skënderbeut. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga internet, foto | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** Lojë, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë individuale, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
- *Lojë*- Nxënësit kanë sjellë informacione nga interneti, foto pikturash dhe skulpturash të Heroit Kombëtar Skënderbeut. Këto materiale i shfrytëzojnë në përshkrimin me pesë fjalë që do t'i bëjnë njërit prej objekteve që ka mbajtur Skënderbeu ose kalit të tij. Shkruajnë fjalët përshkruese, por nuk shkruajnë emrin e objektit apo kalit. Shkëmbejnë fletët në dyshe për të gjetur emrin e asaj që ka përshkuar shoku.

Ushtrimi 2-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit përshkruajnë portretin e Skënderbeut duke iu përgjigjur pyetjeve.
Ushtrimi 3- Edhe në këtë ushtrim nxënësit punojnë individualisht për të shkruar fjali për: shpatën, përkrenaren dhe kalin e Skënderbeut.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun. Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka

**Vlerësimi bëhet për:**
- Përshkrimin e figurës së Skënderbeut
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie:** Bëj përshkrimin e Skënderbeut me 4-5 fjali.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br><br>Kryefjala e fjalëve</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br><br>Atdhe, kryefjala, ylber</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• tregon elementet e vjershës si: strofa, vargu;<br>• diskuton rreth përmbajtjes së vjershës;<br>• shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth dashurisë për atdheun;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për mënyrën se si ata e kuptojnë poezinë, për interpretimin e tyre në lidhje me dashurinë që kanë për atdheu, rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi tek nxënësit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;<br>- teksti mësimor;<br>- mjete shkrimi, A 4, mjete vizatimi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Edukimi atdhetar</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim i njohurive paraprake, bisedë, lojë, punë në çift, punë në grup, punë individuale<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>Mësuesja paraqet fjalën “ATDHE” të shkruar në tabelë dhe fton nxënësit të shprehin mendimet e tyre lidhur me këtë fjalë. Shkruhen mendimet e nxënësve në tabelë.<br>Mësuesja prezanton titullin e vjershës dhe udhëzon nxënësit të lexojnë në heshtje atë. Ata diskutojnë në dyshe rreth fjalëve të reja, përmbajtjes së vargjeve dhe mesazhit që ajo përcjell.<br>Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj” nën drejtimin e mësueses. Nxënësit nënvizojnë fjalët që autori mori shkronjat e para; përcaktojnë fjalën që u formua nga bashkimi i tyre dhe tregojnë me se e krahason autori Atdheun.<br>Punohet rubrika “Reflektoj”. Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe pastaj me gjithë klasën për të shpjeguar grupin e fjalëve “ si ylber shkëlqeu”.<br>Përfundohet me një lojë në grup: nxënësit do të shkruajnë në etiketa fjalë që fillojnë me shkronjat e fjalës Atdheu. Shkronjën e parë do e dallojnë me një ngjyrë tjetër.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
diskutimet rreth mënyrës se si ata e kuptojnë poezinë;
rreth interpretimeve të tyre në lidhje me dashurinë për atdheun;
rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi;
vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit dhe mënyrën e bashkëpunimit në grup.

**Detyrë shtëpie:** Rubrika “Shkruaj”

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br><br>Parqet kombëtare (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br><br>Park kombëtar, zonë natyrore, mirëmbaj, rregulla, revistë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<ul><li>lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante;</li><li>pyet për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose fakteve që jepen për parqet kombëtare;</li><li>rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë pjesën;</li><li>tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar duke iu përgjigjur pyetjeve.</li><li>lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet etj.</li></ul></td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br><br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për mënyrën se si ata e bëjnë lidhjen e tekstit me jetën e tyre të përditshme, për interpretimin e tyre në lidhje me parqet kombëtare, për informacionet dhe kuriozitetet e sjella nga nxënësit për parqet kombëtare.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;<br>- teksti mësimor;<br>- mjete shkrimi, revista, foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Stuhi mendimesh, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë me gjithë klasën.<br><br>Veprimtaritë e nxënësve<ul><li>Janë porositur nxënësit me parë që të sjellin revista të ndryshme. Mësuesja fton nxënësit të shfletojnë revistat. Diskutohet me ta rreth informacioneve që paraqesin disa prej revistave.</li><li>Mësuesja prezanton temën e mësimit. Stuhi mendimesh: Parqet kombëtare- Nxënësit diskutojnë në grupe dyshe dhe tregojnë ç’dinë për parqet kombëtare.</li><li>Orientohen nxënësit të lexojnë pjesën me paragrafë. Nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe pjesët që i duken më interesante. Diskutojnë me njëri tjetrin rreth informacionit që lexojnë në çdo</li></ul></td></tr>
</table>

paragraf. Njëri nxënës bën pyetje dhe tjetri i përgjigjet. Pas diskutimit në dyshe ndajnë me gjithë klasën informacionet e tekstit në lidhje me parqet kombëtare.

- U lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë.
- Lexohet pjesa zinxhir nga nxënësit sipas paragrafëve.
- Punohet rubrika **“Lexoj dhe kuptoj”** .
- Nxiten nxënësit për të treguar përshtypjet e tyre nëse kanë vizituar ndonjë park kombëtar.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- pyetjet që bëjnë për t’u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre.

**Detyrë shtëpie:** Nxënësit do të sjellin në klasë informacione, kuriozitete për parqet kombëtare të marra nga revista të ndryshme ose interneti.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br><br>Parqet kombëtare (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Park kombëtar, zonë natyrore, mirëmbaj, rregulla, revistë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• lexon tekstin joletrar;<br>• tregon që e ka kuptuar tekstin duke iu përgjigjur pyetjeve;<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet etj;<br>• tregon rregullat që duhen zbatuar në një park kombëtar;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.</td><td colspan="2">Situata e të nxëni<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për mënyrën se si ata e bëjnë lidhjen e tekstit me jetën e tyre të përditshme, për interpretimin e tyre në lidhje me parqet kombëtare, për informacionet dhe kuriozitetet e sjella nga nxënësit për parqet kombëtare.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit;<br>- teksti mësimor;<br>- mjete shkrimi, revista, foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim, Lexo përmblidh në dyshe, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.</td></tr>
</table>

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësimi nis me leximin e detyrës që nxënësve iu dha në orën e mëparshme (nxënësit do të lexojnë informacione, kuriozitete për parqet kombëtare)
- *Punë në çift*- Lexo përmblidh në dyshe- Nxënësit në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ata konfirmojnë ato që kanë mësuar një orë më parë por edhe kanë mundësi të përdorin lloje të ndryshme të të menduarit.
- *Punë në grupe*-Nxënësit zgjedhin disa prej rregullave në tekst që duhen zbatuar në parqet kombëtare. Nxënësit kontrollojnë dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Ata diskutojnë në grup për disa prej parqeve kombëtare të vendit tonë. Paraqesin mendimet e tyre para klasës.
- Punohen dy pyetjet e para të rubrikës **"Reflektoj".**

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit joletrar;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Përemri vetor (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>përemër vetor, unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Dallon përemrat vetorë: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato.<br>• Gjen në fjali përemrat vetorë.<br>• Përdor ne fjali përemrat vetorë.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përdormi i përemrave vetorë në një situatë të dhënë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, etiketa me peremra vetorw, agnetofon, C</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë individuale, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
Paraprakisht mësuesja ka përgatitur etiketa me përemrat vetorë dhe pyetje të cilat kërkojnë përgjigje duke përdorur përemrat vetorë. P.sh çfarë po dëgjon ti? Unë...

- Në magnetofon vendos një pjesë muzikore. U shpërndan grupeve etiketat me pyetje.

çfarë po dëgjon ti? çfarë po dëgjoj unë? çfarë po dëgjon ai/ajo? etj.
Nga përgjigjet e nxënësve mësuesja veçon përemrat vetor ë dhe i radhit në tabelë.

- Diskutohet ana kuptimore e përemrave vetorë dhe dilet në përfundimin se përemrat vetorë zëvendësojnë emrat e njerëzve, të kafshëve ose të sendeve në fjali. Diskutohet rreth shembujve të dhënë në libër.
- Ushtrimi 1-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit lidhin përemrat vetorë me grupet e fjalëve.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun. Diskutojnë rreth figurës në të djathtë të ushtrimit. Mësuesja e drejton diskutimin rreth rëndësisë që ka mbjellja e pemëve.
- Mësuesja kërkon që të përdorin në fjali përemrat vetorë.
- Mësuesja i fton nxënësit të nënvizojnë përemrat vetorë tek pjesa “Shpata e Skënderbeut”. Lexohen përemrat vetorë që kanë gjetur.

**Vlerësimi bëhet për:**
- dallimin e përemrat vetorë: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato;
- gjetjen në fjali të përemrave vetorë;
- mënyrën e bashkëpunimit në çift ;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie:** Gjej dhe kopjo 3 fjali në të cilat të jenë përdorur përemrat vetorë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Përemri vetor (ora e dytë ) | | **Fjalë kyçe**<br>përemër vetor, unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• zëvendëson emrat me përemrat vetorë: unë, ti, ai, ajo, ne, ju, ata, ato;<br>• gjen në fjali përemrat vetorë;<br>• ndërton fjali me përemra vetorë;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Ndërrimi i fjalive duke përdorur përemra vetorë. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga interneti | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Shkëmbe një problemë, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë individuale, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësimi fillon me shkëmbimin e fletoreve të detyrave të shtëpisë dhe gjetjen e përemrave vetorë tek fjalitë që ka kopjuar shoku.
- Ushtrimi 2- Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit zëvendësojnë emrat me të kuqe me përemra vetorë.
- Ushtrimi 3- Punë individuale. Plotësojnë me përemra vetorë fjalitë e paplota që janë dhënë. Mësuesja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e fjalisë e të vendosin përemrin vetor më pas.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun për kryerjen e ushtrimeve.
- *Shkëmbe një problemë*- Punë në dyshe. Secili nga nxënësit shkruan nga 2 përemra vetorë në një fletë A4. Shkëmbejnë fletët me shokun dhe ndërtojnë fjali me këto 2 përemra. Kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- zëvendësimin me përemrat vetorë të emrave;
- gjetjen në fjali të përemrave vetorë;
- ndërtimin e fjalive me përemrat vetorë;
- mënyrën e bashkëpunimit në çift;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie:** Ndërto 6-8 fjali duke përdorur përemrat vetorë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Udhëtoj në vendin tim (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>përshkrim, vende, qytet i gurtë, vend malor, qytet bregdetar, vizitoj. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• shkruan duke plotësuar me fjalë ndihmëse tekstin e dhënë;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Pamje nga vendet turistike të Shqipërisë. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga internet, foto | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
Nxënësit kanë sjellë informacione nga interneti,foto nga vende të ndryshme turistike të vendit. Këto materiale i shfrytëzojnë në veprimtarinë e mëposhtme.

- Mësuesja i fton nxënësit të mbyllin sytë dhe të kujtojnë një udhëtim në një vend që u ka pëlqyer shumë. Ata shkruajnë 2-3 fjali për këtë vend. Udhëzohen nxënësit të diskutojnë në grup këtë vend duke veçuar atë që i ka pëlqyer më shumë dhe pse i ka mbetur në mendje.
- Paraqitet tema nga mësuesja dhe nxiten nxënësit të diskutojnë rreth saj duke u mbështetur edhe në fotot që kanë sjellë.
- *Punë individuale*- Ushtrimi 1. Në këtë ushtrim nxënësit lexojnë e plotësojnë tekstin me fjalët ndihmëse. Lidhin përshkrimet me figurat e vendeve të përshkruara.
- Nxënësit plotësojnë përshkrimin me gojë duke u nisur nga përvojat e tyre gjatë vizitave që mund të kenë bërë në këto vende.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
- *Punë individuale* –Zgjidhni njërin prej vendeve që do të donit të vizitonit nga ato që u përshkruan në ushtrimin 1, dhe shkruaj pse të pëlqen ta vizitosh.
- U tregojnë njëri –tjetrit në dyshe punën e bërë.

**Vlerësimi bëhet për:**
- plotësimin e tekstit me fjalë ndihmëse;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 3 fjali për një nga vendet e përshkruara në ushtrimin 1, që ke dëshirë të vizitosh.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Udhëtoj në vendin tim (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>përshkrim, vende, qytet i gurtë, vend malor, qytet bregdetar,vizitoj</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• plotëson përshkrimin me fjalë mungesore;<br>• përshkruan vendet që ka vizituar sipas modelit të gatshëm;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Pamje nga vendi ynë</td></tr>
</table>

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4,<br>informacione nga internet, foto | Artet, Teknologji dhe TIK,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Nxënësit kanë sjellë foto të vendeve që ata kanë vizituar. Ua tregojnë grupit duke shkruar 2-3 fjali që e karakterizojnë atë vend.
- Ushtrimi 2- Punë individuale. Në këtë ushtrim nxënësit lexojnë e plotësojnë tekstin me fjalët ndihmëse.
- Nxënësit plotësojnë përshkrimin me gojë duke u nisur nga përvojat e tyre gjatë vizitave që mund të kenë bërë në këtë qytet.
- Ushtrimi 3-Punë individuale. Nxënësit përshkruajnë një vend që kanë vizituar, duke iu përgjigjur pyetjeve. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
- Bëjnë korrigjimin e gabimeve drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin e vendeve që ka vizituar;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie:** Përshkruaj një vend që ke vizituar dhe të ka pëlqyer.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore** | **Fjalë kyçe** |
|---|---|
| Deti, dielli dhe hëna (ora e parë) | Dielli, deti, hëna, vërshoi |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të | **Situata e të nxënit**<br><br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë rreth mënyrës se si ata e kuptojnë tekstin, rreth interpretimeve të tyre në lidhje me historinë e detit, diellit dhe hënës, rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo pjesë te nxënësit. |

| | |
|---|---|
| kuptuar më mirë tekstin;<br>• pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• tregon llojin e pjesës dhe 2-3 tipare të saj;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të reja për të;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- libra jashtëklase, mjete shkrimi | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut,<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Lexim- mendim i drejtuar, Bisedë, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli dhe ilustrimet e tekstit.
- Lexim dhe mendim i drejtuar: Mësuesja udhëzon nxënësit për leximin e tekstit të ndarë në pjesë. Për secilën prej tyre, nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, punojnë me fjalorin, u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes dhe bëjnë parashikime për pjesën në vazhdim. Mësuesja kërkon të argumentojnë parashikimin e bërë.
- Diskutohet për llojin e pjesës dhe karakteristikat e saj (përrallë, personazhe jonjerëzore, fund i lumtur).
- Në grupe bisedojnë rreth fundit të pjesës dhe lidhjen e saj me jetën reale.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e tregimit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që u pëlqejnë më shumë;
- pyetjet që bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- shfaqjen e besimit dhe vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë.

**Detyrë shtëpie**: Kopjo pjesën që të pëlqen dhe komentoje.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Deti, dielli dhe hëna (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>Dielli, deti, hëna, vërshoi | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• lexon pjesën sipas roleve;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet | | **Situata e të nxënit**<br><br>Lojë në role e pjesës. | |

| | |
|---|---|
| dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara;<br>• luan me role pjesën;<br>• shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- libra jashtëklase, mjete shkrimi, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriu<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimi, Lojë me role, Diskutim, Harta e personazheve, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh me gjithë klasën: Deti, dielli, hëna. Mësuesja shkruan në tabelë mendimet e nxënësve.
- Lexohen detyrat e shtëpisë në të cilat janë kopjuar fragmente nga pjesa dhe nxënësit bëjnë komentet e tyre.
- Mësuesja organizon klasën në grupe. Ajo ndan rolet në çdo grup dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës.
- Nxënësit lexojnë me zë sipas roleve. Më pas luajnë sipas roleve.
- Tregohet përmbajtja e pjesës në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Punë në dyshe “Harta e personazheve”. Nxënësit shkruajnë nga dy cilësi për personazhet e pjesës dhe pjesët ilustruese nga teksti për secilën cilësi.
- Prezantojnë punët e tyre dhe i diskutojnë me gjithë klasën.
- Nxënësit diskutojnë për rolin e personazheve në jetën reale, lidhjen që kanë me jetën e tyre duke treguar rëndësinë e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- tregimin e përmbajtjes;
- përshkrimin e personazheve;
- lojën me role;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij.

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj një mbyllje tjetër për historinë e detit, diellit dhe hënës.

| Fusha | Lënda | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|

<table>
<tr><td>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Gjuha shqipe</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Folja (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>folje, veprim, pyetje, çfarë bën?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• dallon foljet si fjalë që tregojnë veprim;<br>• gjen foljet në fjali duke përdorur pyetjen “ç’bën?”;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Dallimi i foljeve në fjali.<br>Përdorimi i pyetjes “ç’bën?” për të dalluar foljet.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë,Punw individuale, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën, Tryezë e rrumbullakët<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Mësuesja fton nxënësit të kryejnë veprimtari të ndryshme sipas dëshirës. Drejton pyetjen:<br>-çfarë po bën?<br>• Nxënësit tregojnë veprimin që bëjnë. I drejtojnë të njëjtën pyetje njëri-tjetrit. Bashkë me mësuesen nxjerrin përfundimin se folja tregon një veprim që kryhet. Atë e gjejnë me pyetjen: “Çfarë bën?”<br>• Ushtrimi 1-Punë individuale- Në këtë ushtrim nxënësit gjejnë foljet pasi bëjnë pyetjen:”çfarë bën?” dhe i qarkojnë ato.<br>• Ushtrimi 2- Edhe në këtë ushtrim nxënësit punojnë individualisht për të shkruar tri veprime të paraqitura në figurë (shpjegon, vlerëson, gatuan, përkëdhel, kujdeset etj.).<br>• Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun. Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.<br>• Tryezë e rrumbullakët- nxënësit të vendosur në formë rrethore shkruajnë me anë të një fjalie një veprim që bëjnë në jetën e tyre të përditshme në një fletë A4. Kërkojnë nga shokët të gjejnë dhe qarkojnë foljen.<br>• Pasi nxënësit gjejnë foljet i diskutojnë ato që kanë shkruar në grup.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- dallimin e fjalëve që tregojnë veprim;<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;<br>- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;<br>- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;<br>- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br><br>Detyrë shtëpie: Shkruaj 5 folje. Ndërto fjali me dy prej tyre.</td></tr>
</table>

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | Lënda<br>**Gjuha shqipe** | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore**<br>Folja (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>folje, veprim, pyetje, çfarë bën? |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• dallon fjalët që tregojnë veprim;<br>• plotëson fjalitë me foljen e duhur;<br>• përdor foljet në fjali;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | **Situata e të nxënit**<br>Përdorimi i foljeve në situata reale |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, etiketa me folje | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lojë, Diskutim, Bisedë, Punë individuale, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën, Shkëmbe një problemë.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit të luajnë një lojë. Grupet fqinje luajnë me njëri-tjetrin. Njeri anëtar i grupit vendos në kokë një etiketë në të cilën shkruhet një folje të cilën ai nuk e ka parë. Pjesëtarët e tjerë të grupit përpiqen t'ia tregojnë me gjeste këtë folje. Jepen vetëm tri mundësi për ta gjetur. Vazhdohet me pjesëtarët e tjerë të grupit . Fiton lojën ai grup që ka gjetur më shumë folje.
- Ushtrimi 3-Punë individuale. Në këtë ushtrim nxënësit plotësojnë fjalitë me foljen e duhur Ushtrimi 4- Edhe në këtë ushtrim nxënësit punojnë individualisht për të plotësuar fjalitë me folje duke iu përgjigjur pyetjes.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun. Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.
- Shkëmbe një problemë- listojnë 5 folje sipas grupeve dhe i shkëmbejnë fletët me grupet fqinje. Me foljet ndërtojnë nga një fjali. Grupet vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e fjalëve që tregojnë veprim;
- plotësimin e fjalive me foljen e duhur;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- përdorimin e foljeve në fjali;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 5 folje. Ndërto fjali me to.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

<table>
<tr><td>Tema mësimore<br>Vjeshta</td><td>Fjalë kyçe<br>Dergjem, rreptë, udhët</td></tr>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit<ul><li>tregon elementet e vjershës si: strofa, vargu;</li><li>parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;</li><li>shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth vjershës;</li><li>lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</li></ul></td><td>Situata e të nxënit<br><br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për mënyrën se si ata e kuptojnë poezinë, për interpretimin e tyre në lidhje me stinën e vjeshtës, rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi tek nxënësit.</td></tr>
<tr><td>Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, A 4, mjete vizatimi</td><td>Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Edukimi mjedisor</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** Lexo, përmblidh në dyshe, diskutim, bisedë, lojë në role, punë në çift, punë në grup, punë individuale

**Veprimtaritë e nxënësve**
- Mësuesja orienton nxënësit të shohin figurën, të lexojnë titullin dhe të bëjnë parashikimin për përmbajtjen e vjershës duke diskutuar në dyshe. Nxënësit tregojnë parashikimet e tyre.
- Lexohet vjersha në heshtje. Nxënësit tregojnë ndryshimet e përmbajtjes së vjershës dhe parashikimit që i kanë bërë.
- Punë në dyshe-Nxënësit duke punuar në dyshe lexojnë dhe e përmbledhin çdo strofë me 1fjali. Njëri prej nxënësve lexon dhe tjetri përmbledh. Ndërrohen rolet pas çdo strofe.
- Punohet rubrika ”Lexoj dhe kuptoj”. Ndalet te karakteristikat e vjeshtës që dalin në vargje dhe fjalët e autores për të përshkruar këtë stinë.
- Punohet rubrika “Reflektoj”.
- Nxënësit qarkojnë rrokjet e fundit të secilit varg në strofën e fundit dhe tregojnë që këto rrokje janë të njëjta, gjë e cila përbën dhe rimën e saj.

**Vlerësimi bëhet për:**
- diskutimet rreth mënyrës se si ata e kuptojnë poezinë;
- rreth interpretimeve të tyre në lidhje me poezinë;
- rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo poezi;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit dhe mënyrën e bashkëpunimit në grup.

**Detyrë shtëpie:** Rubrika “Shkruaj”.

| **Fusha** | **Lënda** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| Gjuhët dhe komunikimi | **Gjuha shqipe** | | |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Stinët përmes pikturave (ora e parë ) | **Fjalë kyçe**<br>stinë, pikturë, ngjyrë, e bukur, me lule, me dritë, gjallëri |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• përshkruan stinët që paraqiten nëpërmjet pikturave dhe vizatimeve;<br>• shkruan fjalët që tregojnë ardhjen e çdo stine;<br>• shkruan të paktën dy fjali për çdo stinë;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | **Situata e të nxënit**<br>Përshkrimi i stinëve të ndryshme duke shqyrtuar pikturat ku ato paraqiten. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, piktura të natyrës në stinë të ndryshme, etiketa, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë individuale, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Paraprakisht nxënësit janë porositur të sjellin peizazhe nga natyra në vizatim, pikturë. Sipas grupeve diskutojnë rreth tyre. Secili grup prezanton njërën prej tyre duke përshkruar stinën të cilën paraqet ky peizazh. Nxënësit shkëpusin fjalë që u pëlqejnë nga përshkrimet e shokëve dhe i shkruajnë në etiketa. Këto etiketa vendosen në një kënd të veçantë të klasës ku nxënësit mund t'i përdorin në ushtrimet në vazhdim.

Ushtrimi 1-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit shikojnë pikturat dhe emërtojnë stinët.

Ushtrimi 2- Shkruajnë fjalët që tregojnë ardhjen e çdo stine. Mund të shfrytëzojnë edhe fjalët e shkruara në veprimtarinë e parë.

Ushtrimi 3- Edhe në këtë ushtrim nxënësit punojnë individualisht për të shkruar nga dy fjali për çdo stinë. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun. Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përshkrimin e stinëve duke u mbështetur në pikturat ku ato paraqiten;
- shkrimin e fjalëve dhe fjalive që përshkruajnë stinët;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj 3 fjali për stinën tënde të preferuar duke u mbështetur te një pikturë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

<table>
<tr>
<td>Tema mësimore<br>Stinët përmes pikturave (ora e dytë )</td>
<td>Fjalë kyçe<br>stinë, pikturë, ngjyrë, e bukur, me lule, me dritë, gjallëri, e ftohtë, bardhësi</td>
</tr>
<tr>
<td>Rezultatet e të nxënit:<br>• përshkruan stinët duke përdorur fjalët ndihmëse;<br>• përshkruan stinët duke veçuar elementë të pikturave ku ato paraqiten;<br>• përshkruan stinën që i pëlqen;<br>• respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td>
<td>Situata e të nxënit<br>Përshkrimi i stinëve të ndryshme duke shqyrtuar pikturat ku ato paraqiten.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, piktura të natyrës në stinë të ndryshme, CD, magnetofon</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td>
</tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë individuale, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**
Nxënësit ngjyrosin lulet tek ushtrimi 4 dhe më pas diskutojnë rreth tyre(ngjyrat, kombinim e tyre, stinën në të cilën çelin, bukurinë, etj). Në magnetofon vendoset kënga stinët.
Ushtrimi 5-*Punë individuale*. Në këtë ushtrim nxënësit zgjedhin njërën nga pikturat dhe përshkruajnë stinën që paraqitet në të. Për këtë gjë nxënësit shfrytëzojnë modelin gjysmë të gatshëm si dhe fjalët ndihmëse.
Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun. Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.
Punojnë për të vizatuar një stinë që u pëlqen dhe e përshkruajnë me 3-4 fjali. Kjo detyrë mund të përfundohet edhe në shtëpi.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përshkrimin e stinëve duke u mbështetur në pikturat ku ato paraqiten;
- mënyrën e bashkëpunimit në çift ;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Luleshqerra (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Krekosem, gardh, adhuroj, laureshë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• parashikon përmbajtjen e tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për mënyrën se si ata e bëjnë lidhjen e tekstit me jetën e tyre të përditshme, për interpretimin e tyre në lidhje sjelljen e Laureshës, dhe luleve të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Parashikim me terma paraprakë,Lapsa në mes, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja shkruan në tabelë këto fjalë: luleshqerra, lauresha, zgjodhi, lulet e tjera. Kërkon nga nxënësit të ndërtojnë një histori të shkurtër me tre-katër fjali ku të përdorin fjalët e dhëna.
- Mësuesja I njeh nxënësit me temën dhe i fton të parashikojnë përmbajtjen e tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe.
- Ajo udhëzon nxënësit për leximin e tekstit në paragrafë. Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme.
- Mësuesja fton në diskutim nxënësit për punimin e fjalorit dhe pyetjeve rreth përmbajtjes. Ata bëjnë parashikime për vazhdimin e pjesës.
- Lexohet pjesa zinxhir.

*Lapsat në mes*: Të vendosur në formë rrethore nxënësit diskutojnë për pyetjen: “A duhet t’i vlerësojmë të tjerët vetëm nga pamja e jashtme?” të rubrikës “Reflektoj”. Çdo nxënës pasi përfundon së thëni mendimin e tij, vendos lapsin në mes të tavolinës. Mësuesja merr një laps të rastësishëm dhe pyet se çfarë ka thënë i zoti i lapsit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrës shtëpie**: Paraqit me vizatim një luleshqerrë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Luleshqerra (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>Krekosem, gardh, adhuroj, Laureshë |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet;<br>• mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për mënyrën se si ata e bëjnë lidhjen e tekstit me jetën e tyre të përditshme, për interpretimin e tyre në lidhje sjelljen e Laureshës, dhe luleve të tjera. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>mjete shkrimi, fletë A4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Ditari dypjesësh, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Fillohet me një lexim zinxhir të pjesës.
- Mësuesja organizon klasën në grupe dyshe. Ata do plotësojnë një ditar dypjesësh (fragmenti që i ka pëlqyer dhe komenti përkatës).
- Tregohet përmbajtja e pjesës në dyshe e më pas disa nxënës e tregojnë atë që të dëgjojë gjithë klasa. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Tek rubrika "Shkruaj" nxënësit vendosin veten në vend të laureshës dhe tregojnë zgjedhjen që do bëjnë. Ata shpjegojnë zgjedhjen e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- tregimin e përmbajtjes;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore**
Diktim

**Fjalë kyçe**
diktim, rregulla drejtshkrimore, qortim

**Rezultatet e të nxënit:**
- shkruan një tekst me të diktuar;
- përdor shenjat e pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë);
- përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë;
- përdor drejt shkronjën e madhe për emra të përveçëm;
- shkruan drejt mbiemrat duke i përshtatur intuitivisht me numrin gjininë e emrave që përcaktojnë;
- shkruan saktë foljet në përshtatje me përemrat vetorë;
- bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;

**Situata e të nxënit**
**Diktimi**

**Burimet dhe materialet didaktike**
- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit
- fletore, mjete shkrimi

**Lidhja me fushat e tjera**

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Diskutim, Punë individuale
**Veprimtaritë e nxënësve**
- Stuhi mendimesh: Mësuesja fton nxënësit për të treguar rregullat drejtshkrimore që dinë (fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalisë,shkronja e madhe për emrat e njerëzve, vendeve etj.).
- Mësuesja dikton pjesën.
- Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësueses.
- Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar përsëri saktë.

**Detyrë shtëpie:** Mësoni dy paragrafët e fundit përmendësh nga pjesa “Luleshqerra “ dhe bëjeni vetëdiktim.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Lexim jashtëklase</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Libër, autori, titulli, personazhet, tipare, ilustrime</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>• lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj.;<br>• përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• krahason poezinë me gjëegjëzën, përrallën me tregimin;<br>• tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>• shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br><br>Leximi i librave jashtëklase</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- libra jashtëklase</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Prezantimi i titullit të librit dhe autori.<br>• Leximi i pjesës.<br>• Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj.<br>• Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.<br>• Tregimi i brendisë së pjesës.<br>• Personazhet dhe cilësitë e tyre.<br>• Mesazhi që përcjell pjesa.<br>• Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.<br>• Ilustrim i pjesës me vizatim.<br>• Vlerësimi për leximin e poezisë, përrallës etj.;</td></tr>
</table>

- Përcaktimin e dy-tre tipare të tyre;
- Përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazheve dhe tregimin e personazheve të preferuara;
- tregimin se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;
- krahasimin e poezisë me gjëegjëzën, përrallën me tregimin;
- tregimin e interesit dhe dëshirës për të lexuar;
- shfaqjen e besimit dhe vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit;
- ndarjen me të tjerët tw përvojave tw tij rreth leximit;

**Projekti 3 (4 orë)**

| **PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Titulli i projektit** | Revista jonë | | **Kohëzgjatja** | 1 orë gjuhë shqipe (lexojmë) |
| | | | | 1 orë gjuhë shqipe (lexojmë) |
| **Lënda**: Gjuha shqipe | | Mësuesi: | | 1 orë gjuhë shqipe (flasim) |
| | | | | 1orë gjuhë shqipe (dëgjojmë) |
| **Lidhja fushat e tjera:** | Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës | | Klasa: | E dytë |
| Ideja e projektit | Fëmijët pëlqejnë të lexojnë libra e revista. Shumëllojshmëria e informacionit dhe e pjesëve letrare apo jo letrare tek revistat bëjnë që ata t'i lexojnë ato me dëshirë. Gjithashtu revistat i përdorin si burime informacioni në lëndë të ndryshme. Krijimi i një reviste nga vetë nxënësit do të ishte interesante, sepse kjo revistë do të përmbushte të gjitha interesat e fëmijëve për të hulumtuar, lexuar e krijuar. Në këtë projekt nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese për të kërkuar e gjetur informacione e pjesë letrare të ndryshme, aftësitë për të krijuar në gjini të ndryshme(proze poezi, arte) dhe aftësi bashkëpunuese . | | | |
| Ngjarjet hyrëse që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve | Dëshira për të hulumtuar dhe krijuar e lexuar shfrytëzohen si nxitje për zotërimin e disa kompetencave. | | | |
| **Kompetencat kyçe që zhvillohen** | Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. | x | Kompetenca personale | x |
| | Kompetenca e te menduarit | x | Kompetenca qytetare | x |
| | Kompetenca e të nxënit | x | Kompetenca digjitale | x |
| | Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin. | x | | |
| **Temat e njohurive kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit** | (shkruhen tema mësimi pjesë nga të cilat zgjedhin nxënësit për t'i paraqitur në revistë) | | | |
| | | | | |
| **Rezultatet e të nxënit** | - nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme;<br>- ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit;<br>- shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, u | | | |

<table>
<tr><td></td><td colspan="5">përgjigjet pyetjeve;<br>- pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij;<br>- demonstron siguri, kur flet në klasë;<br>- përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit;<br>- lidh pjesën që lexon me përvoja personale;<br>- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;<br>- tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje dhe ilustrime;<br>- lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera;<br>- bën gjykime të thjeshta rreth tekstit;<br>- përdor gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla si: foto dhe piktura;<br>- pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë;<br>- demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>- demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.</td></tr>
<tr><td rowspan="5">Metodologjia</td><td rowspan="5">(Individuale, në grup ose e gjithë klasa)</td><td>Diskutim</td><td>x</td><td>Hulumtim</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Bisedë</td><td>x</td><td></td><td>x</td></tr>
<tr><td>Punë në grup</td><td>x</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Lexim I drejtuar</td><td>x</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>x</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="3">Burimet e nevojshme</td><td>Njerëzit e përfshirë</td><td colspan="4">Mësuesi, nxënësit, prindërit, nxënës të klasave të tjera</td></tr>
<tr><td>Mjetet:</td><td colspan="4">bllok shënimesh, foto, fletëA4, karton, letra me ngjyra, ngjitës, gërshërë, lapustila, figura të ndryshme</td></tr>
<tr><td>Materiale dhe burime</td><td colspan="4">libra për fëmijë, revista për fëmijë, informacione nga interneti</td></tr>
<tr><td>Pyetja kërkimore</td><td colspan="5">Si mund të ndërtojmë revistën e klasës sonë?</td></tr>
<tr><td>Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit.</td><td colspan="5">Mësuesja i ka udhëzuar nxënësit të vëzhgojnë revista të ndryshme për fëmijë dhe të listojnë lloje të ndryshme rubrikash dhe tekstesh që gjenden në to. Gjithashtu me anë të bisedave të lirshme me njëri –tjetrin të zbulojnë interesat e tyre dhe të shokëve për të lexuar, krijuar, luajtur.<br>Gjuhë shqipe<br>• Nxënësit kanë sjellë revista të ndryshme për fëmijë. Duke punuar sipas grupeve mund të lexohen rubrika të ndryshme që zgjojnë interesin e nxënësve. Diskutojnë në grup rreth pyetjeve që mësuesja ka përgatitur për të drejtuar punën e nxënësve:<br>- A ju pëlqejnë revistat? Pse?<br>- Cilat janë rubrikat që ju tërheqin më shumë?<br>- Ju pëlqejnë të lexoni tregime, përralla, vjersha apo kuriozitete në to?<br>- Ku mund t'i gjeni informacionet dhe pjesët letrare për revistën e klasës suaj?<br>- Cilat janë aktivitet dhe ngjarjet më të rëndësishme që mund të pasqyroni nga jeta juaj e përditshme?<br>• Mësuesja udhëzon nxënësit që sipas grupeve të punojnë për një pjesë të caktuar të revistës. Çdo grup sipas ndarjes së detyrave bën përzgjedhjen dhe pasqyrimin:<br>- e pjesëve letrare (poezi, përralla, tregime, gjëegjëza etj.)</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td></td><td colspan="8">
- pjesëve joletrare (informacione për kafshët, gjithësinë, botën bimore, vendet turistike etj).<br>
- e ngjarjeve nga jeta e klasës së tyre.<br>
- e udhëzimeve për lojëra të ndryshme.<br>
- e krijimeve të shokëve (prozë, poezi e arte) etj.<br>
• Secili grup bën prezantimin e punës së tij.<br>
• Me ndihmën e mësueses dhe të një grupi nxënësish bëhet redaktimi i revistës.<br>
• Bëhet fotokopja në disa kopje e revistës dhe shpërndarja edhe në klasa të tjera të shkollës.<br>
• Merren mendime të nxënësve të ndryshëm nëpërmjet një pyetsori të cilin nxënësit e ndërtojnë me ndihmën e mësueses.<br>
(A ju pëlqeu revista jonë?<br>
Cila prej rubrikave ju pëlqeu më shumë?<br>
Çfarë do të donit të kishte tjetër në revistën tonë? Etj.)<br>
• Përcaktojnë detyrat në të ardhmen për numrin tjetër të revistës së tyre.
</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Produktet kryesore</td><td>Në grup:</td><td colspan="7">Revista e klasës</td></tr>
<tr><td>Individualisht</td><td colspan="7"></td></tr>
<tr><td rowspan="2">Vendi dhe pjesëmarrësit e prezantimit</td><td>Shkollë</td><td>x</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Klasë</td><td>x</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td rowspan="3">Vlerësimet</td><td>Vlerësimet formuese (Gjatë projektit)</td><td colspan="2">Vlerësimi bëhet për:<br>
- pyetjet, përgjigjet, shprehjet e mendimit, ndjenjave dhe emocioneve të tij, si dhe diskutimin në grupe për tema që i interesojnë<br>
- demonstrimin e pavarësisë së mendime dhe veprime.<br>
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;<br>
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup</td><td></td><td colspan="3"></td><td></td></tr>
<tr><td>Vlerësime përmbledhëse (Në fund të projektit)</td><td colspan="2">Realizimin e revistës së klasës.</td><td></td><td colspan="3">Vlerësim i prindërve</td><td></td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2"></td><td></td><td colspan="3">Vlerësimi i nxënësve të</td><td></td></tr>
</table>

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | klasave të tjera | |
| Buxheti | Buxheti i detajuar Përse? Nga kush? | | | Në bashkëpunim me prindërit mund të shpenzohet një fond prej 2000 lekësh për blerjen e materialeve të ndryshme dhe letrave, lapustilave me ngjyra, për fotokopjen e revistës. | |

## TEST

**Pse kërkon të bëhesh bletë?**

Thotë vogëlushja Letë:

-Kam dëshirë të bëhem bletë.

Të shëtit në çdo pranverë,

Nëpër lulet plot me erë.

Dhe në prill, dhe në maj

Të bëj mjaltë për kalamaj.

Kam dëshirë më në fund

Që të kem edhe një … thumb.

Kush flet fjalë të pahijshme,

A shkel lulet në lulishte,

Unë prapa e gjurmoj,
Cëk !
Më thumbin ta thumboj!

***Tasim Gjokutaj***

**Qarko përgjigjen e saktë.**

1. Pjesa e mësipërme është: a) vjershë; b) përrallë; c) fabul. (1 pikë)
2. Ajo ka: a) 5 strofa; b) 12 strofa; c) 6 strofa. (1 pikë
3. Leta kishte dëshirë të bëhej: a) lule; b) flutur; c) bletë. (1 pikë)
4. Mjaltin do ta bënte në muajt: a) prill, maj; b) prill, qershor; c) maj, qershor. (1 pikë)
5. Cilët do të donte të thumbonte me thumb “bleta” Letë? (2 pikë)

______________________________________________________________

**6. Shkruaj një cilësi për personazhin e vjershës. Ilustroje me vargje ku tregohet kjo cilësi.**
Cilësia ___________ vargjet lustruese _________________________________________
(2 pikë)

**7. Në pjesën e mësipërme gjej dhe shkruaj:**

një emër të përgjithshëm ________________________
një emër të përveçëm __________________________ (2 pikë)

**8. Përcakto e shkruaj në tabelë gjininë e numrin e emrave të mëposhtëm:**

| **Emri** | **Gjinia** | **Numri** |
|---|---|---|
| thumb | | |
| lulet | | |

(4 pikë)

**9. Gjej mbiemrin, numrin dhe gjininë e tij në grupin e fjalëve: fjalë të pahijshme**

| Mbiemri | Gjinia | Numri |
|---|---|---|
| | | |

(3 pikë)

10. **Ndërro një fjali duke përdorur një përemër vetor.** (1 pikë)

**11. Nënvizo foljet në fjalinë:**
Kush flet fjalë të pahijshme,
a shkel lulet në lulishte,
Unë prapa e gjurmoj … (3 pikë)

**12. Lidh përemrat vetorë me foljet:**

| | |
|---|---|
| Ata | mësoni |
| Ne | luajnë |
| Ju | tregomë |
| Ti | hap |

(4 pikë)

**13. Shkruaj duke përdorur imagjinatën:**

Sikur të isha një bletë…

(5 pikë)

| Vlerësimi | AP | ANP | AK | ASHK | ASH |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-6 | 7-13 | 14-20 | 21-26 | 27-29 |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Dje, sot, nesër (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>veprimi,folja, kryhet, kohë të ndryshme, dje, nesër, sot | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>• dallon kohën e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti kohë: dje-sot-nesër;<br>• bën lidhjen e veprimit me kohën kur ai kryhet;<br>• përcakton kohën e foljeve në fjali;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Tregimi i ngjarjeve të ndodhura apo që priten të ndodhin në kohë të ndryshme. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë me gjithë klasën, Shkëmbe një problemë.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja paraqet një foto të një veprimtarie që ka bërë klasa ditë më parë. Kërkon nga nxënësit në dyshe të ndërtojnë një ose dy fjali për të. I shkruan në tabelë. Veçohet folja (ngjyroset ose qarkohet). Mësuesja orienton nxënësit të rindërtojnë fjalitë (fjalinë) duke menduar që veprimtaria po ndodh tani. Përsëri shkruan fjalinë dhe veçon foljen. Veprohet njëlloj për rastin që veprimtaria pritet të ndodhë më pas. Për secilin rast mësuesja fton nxënësit të fokusohen tek format e të njëjtës folje në kohë të ndryshme. Nxirret përfundimi se veprimi kryhet në kohë të ndryshme dhe se format e foljeve ndryshojnë sipas kohës kur kryhet veprimi. Lidhen foljet me treguesin kohor (dje, sot, nesër).
- Ushtrimi 1-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit lidhin me vijë veprimin me kohën kur është kryer dhe ngjyrosin foljet si modeli.
- Ushtrimi 2- edhe në këtë ushtrim nxënësit punojnë individualisht për të shënuar me shenjën përkatëse kohën kur kryhet veprimi në tabelë.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
- Shkëmbe një problemë-Punë në dyshe. Çdo nxënës shkruan një fjali duke përdorur një folje. Shkëmbejnë fjalinë me shokun e bankës i cili do gjejë foljen dhe kohën kur ndodh veprimi.

**Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e kohës së kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti kohë: dje-sot-nesër;
- bërjen e lidhjes së veprimit me kohën kur ai kryhet;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një folje. Vendose në kohë të ndryshme.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dje, sot, nesër (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>veprimi, folja, kryhet, kohë të ndryshme, dje, nesër, sot</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>• vendos foljet në kohën e kërkuar;<br>• ndërton fjali me foljen në kohën e kërkuar; sipas konceptit kohë: dje-sot-nesër;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Vendosja e foljeve në kohë të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, etiketa</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën, Shkëmbe një problemë.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja orienton nxënësit sipas grupeve të shkruajnë secili në një etiketë njërën prej foljeve që ka shkruar te detyrat e shtëpisë në kohën që mësuesja cakton për grup. Vendosen këto folje në një tabelë të përgatitur nga mësuesja.

| Dje | sot | nesër |
|---|---|---|
| | | |

- Secili grup prezanton punën e tij
- Ushtrimi 3-*Punë individuale*. Në këtë ushtrim nxënësit shkruajnë foljen sipas kohës kur kryhet veprimi (kur folja është me ngjyrë jeshile ajo do të vendoset në kohën e shkuar, etj.) Ata do shkruajnë të plota fjalitë e formuara.
- Ushtrimi 4- Nxënësit punojnë individualisht për të plotësuar tabelën duke shkruar fjalitë me folje në kohën e duhur.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
- Punë në dyshe-Nxënësit punojnë në dyshe për të gjetur nga një folje për secilën kohë të mësuar tek paragrafi i tretë te përralla "Luleshqerra" dhe të ndërtojnë fjali të tjera me këto folje.

**Vlerësimi bëhet për:**

- vendosjen e foljeve në kohën e kërkuar;
- ndërtimin e fjalive me foljen në kohën e kërkuar sipas konceptit kohë: dje-sot-nesër;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj nga 2 folje për secilën kohë dhe ndërto fjali me to.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dëbora dhe lulebora (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Mantel, boçe, kapardisem</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• parashikon përmbajtjen e tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë rreth mënyrës se si ata e kuptojnë tekstin, rreth interpretimeve të tyre në lidhje me ngjarjen, rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo pjesë tek nxënësit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>informacione nga interneti, foto, revista, enciklopedi, mjete shkrimi A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Njohja e kulturave<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Diskutim, lexim-mendim i drejtuar, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>- Mësuesja paraqet foto të luleborës. Fton nxënësit të flasin për të. I shkruan mendimet e tyre në një organizues grafik në tabelë.<br>- Lexim dhe mendim i drejtuar: - Prezanton temën dhe nxit nxënësit të bëjnë parashikime rreth përmbajtjes së pjesës. Mësuesja udhëzon nxënësit për leximin e tekstit të ndarë në pjesë. Për secilën pjesë, nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, punojnë me fjalorin, u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes dhe bëjnë parashikime për pjesën në vazhdim. Mësuesja kërkon të argumentojnë parashikimin e bërë.<br>- Lexohet pjesa zinxhir.<br>- Plotësohet një ditar dypjesësh ku nxënësit në një anë të tabelës shkruajnë fragmentin që u pëlqen dhe në anën tjetër shkruajnë argumentin se pse zgjodhën atë fragment.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;</td></tr>
</table>

- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie:** Rubrika "Shkruaj".

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Dëbora dhe lulebora (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>Mantel, boçe, kapardisem |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin;<br>• mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë rreth interpretimeve të tyre në lidhje me ngjarjen, rreth gjykimeve për atë që përcjell kjo pjesë tek nxënësit. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>informacione nga interneti, foto, revista, mjete shkrimi A4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Njohja e kulturave<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Dil rrotull fol rrotull,Leximin pwrmbledhje ne dyshe, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- *Dil rrotull fol rrotull*- Nxënësit ecin në një hapësirë të klasës deri sa mësuesi përplas duart. Nxënësit ndalojnë dhe i tregojnë ose lexojnë shokut emrat e luleve që kanë shkruar në detyrën e shtëpisë dhe ngjyrën për çdo lule.
- Lexim përmbledhje në dyshe: në dyshe nxënësit ndajnë rolet . Njëri lexon paragrafin e parë dhe shoku e përmbledh. Ndërrohen rolet në paragrafin në vazhdim.
- Punohet individualisht rubrika "lexoj dhe kuptoj".
- Tregohet brendia e pjesës .
- Punohet në dyshe pyetja e dytë e rubrikës"Reflektoj". Nxënësit ndërtojnë një mbyllje tjetër për ngjarjen.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;

| |
|---|
| - vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;<br>- tregimin e përmbajtjes;<br>- leximin e pjesës;<br>- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij. |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Mëngjes në fshat (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>bregore, gëmushë, sherbelë, uji i ftohtë i burimit, fermë, cicërimat e ëmbla të zogjve, natyrë | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>• lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;<br>• tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin;<br>• i përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet;<br>• pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | | **Situata e të nxënit**<br>Shëtitje imagjinare në fshat | |
| - **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto të mjediseve të fshatit e natyrës,<br>- foto personale | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br><br>**Metodologjia:** Imagjinatë e drejtuar, Ditari dypjesësh, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve**<br>• Imagjinatë e drejtuar-Krijohen kushtet për realizimin e kësaj veprimtarie. Mbyllen perdet, fiken dritat, vendoset muzikë në sfond, nxënësit mbyllin sytë dhe ulin kokat dhe mësuesja lexon pasazhe nga pjesa "Mëngjes në fshat", duke zëvendësuar personazhin e pjesës me vetë nxënësit: Ju po i ngjiteni bregores prapa shtëpisë dhe po shkoni te koteci i pulave. Qentë po luajnë me pulat, ndërsa ju vazhdoni të ecni përmes kopshtit të madh të perimeve, ku misri i gjelbër është bërë më i gjatë se ju...<br>• Lihen nxënësit të imagjinojnë e vazhdojnë përshkrimin sipas imagjinatës së tyre. Këtë gjë e ndajnë me shokun në dyshe.<br>• Shohin figurën e tekstit përshkruajnë dhe komentojnë në dyshe. Më pas, lexohet pjesa. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë.<br>• Tregohet për llojin e tekstit (tregim) dhe 2-3 karakteristika të tij (personazhe realë, ngjarje që mund të ndodhin në jetën e përditshme etj.) | | | |

- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Punohet me gjithë klasën rubrika "Lexoj dhe kuptoj".
- Ditari dypjesësh – Nxënësit kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën e cila u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje, nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante;
- dhënien e përgjigjeve të duhura rreth përmbajtjes;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre;
- pranimin e ideve të të tjerëve për tekstin.

**Detyrë shtëpie**: Vizato si e imagjinon ti peizazhin e kësaj pjese.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Mëngjes në fshat (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>Bregore, gëmushë, sherbelë, uji i ftohtë i burimit, fermë, cicërimat e ëmbla të zogjve, natyrë |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin;<br>• tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit;<br>• jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato;<br>• lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet; | **Situata e të nxënit**<br>Tregimi i përvojave nga qëndrimi pranë natyrës. |
| - **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto të mjediseve të fshatit e natyrës, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lapsat në mes, Diskutim, Lexo përmblidh në dyshe, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

*Lapsat në mes*- Nxënësit në grupet e tyre tregojnë përvojat e tyre nga qëndrimet në natyrë (fshat, vende turistike, kampingje etj). Vendosin lapsin e vet pasi mbarojnë së treguari përvojën e tyre në mes të

tavolinës dhe vazhdon të flasë nxënësi tjetër derisa mbarojnë të gjithë nxënësit.

- Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit nëpërmjet leximit zinxhir.
- Lexo përmblidh në dyshe: Njëri nxënës lexon një paragraf dhe tjetri e përmbledh me 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafin në vazhdim.
- Nxënësit tregojnë brendinë e pjesës me fjalët e tyre.
- Punohet rubrika “Reflektoj”.
- *Vija e vlerës*-Për pyetjen e parë për nxënësit grupohen në dy grupe dhe secili nxënës jep argumentet e tij për jetesën në qytet apo fshat. Nxënësit mund të ndryshojnë mendim dhe të shkojnë në grupin tjetër.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit;
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit;
- mendimet që jep rreth tekstit;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie**: Rubrika “Shkruaj”.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Unë jam (ora e parë )</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>jam, je, është, jemi, jeni, janë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>• lidh foljen jam (në kohën e tashme) me përemrat vetorë;<br>• dallon foljen jam në fjali;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përdorimi i foljes jam në kohën e tashme në situata të improvizuara.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4 , etiketa me pyetje</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
Paraprakisht mësuesja ka përgatitur etiketa me pyetjet:
Kush je ti?; Ku jam unë?; Ku është ai/ajo?; Ku jeni ju?; Ku jemi ne?; Si janë ata/ato?
Nxënësit punojnë në grupe për të kthyer përgjigje pyetjeve . Në përfundim të punës dalin në përfundimin se folja jam është vendosur në forma të ndryshme.
Ushtrimi 1-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit lidhin me shigjetë përemrat me foljen jam.
Kontrollojnë punën me njëri-tjetrin.
Ushtrimi 2-Nxënësit punojnë individualisht për gjetjen e foljes jam dhe nënvizimin e saj.
Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
*Tryezë e rrumbullakët*-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore plotësojnë në fletën në formë fizarmonike zgjedhimin e foljes jam të përgatitur nga mësuesja.
Unë ______
Ti ______
Ai ______
Ajo ______
Ne ______
Ju ______
Ata ______
Ato ______
Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën. Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**
- lidh foljen jam (në kohën e tashme) me përemrat vetorë;
- dallon foljen jam në fjali;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie:** Përdor në fjali, foljen jam.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Unë jam (ora e dytë ) | | **Fjalë kyçe**<br>jam, je, është, jemi, jeni, janë | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• plotëson fjalitë me foljen jam;<br>• përdor në fjali foljen jam;<br>• vlerëson punët e të tjerëve;<br>• bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Përdorimi i foljes jam në fjali. | |

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| • njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4 | Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim,Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
Mësuesja shpërndan etiketat e përdorura orën e parë të mësimit me pyetjet: Kush je ti?; Ku jam unë?; Ku është ai/ajo?; Ku jeni ju?; Ku jemi ne?; Si janë ata/ato?
Nxënësit punojnë në grupe për t'u kthyer përgjigje pyetjeve. Përforcohet fakti që folja jam është vendosur në forma të ndryshme. në kohën e tashme.
Shkëmbehen fletoret e detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit dhe gabimet diskutohen me gjithë klasën.
Ushtrimi 3-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit plotësojnë fjalitë me foljen e duhur.
Ushtrimi 4-Nxënësit punojnë individualisht për shkrimin e tri fjalive duke përdorur foljen jam në forma të ndryshme.
Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
*Tryezë e rrumbullakët*-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore ndërtojnë fjali duke përdorur foljen jam në kohën e tashme.
Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përdorimin në fjali të foljes jam në kohën e tashme;
- plotësimin e fjalive me foljen jam;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie:** Ndërto fjali me foljen jam në kohën e tashme.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Qyteti dhe fshati | | **Fjalë kyçe**<br>qyteti, fshati, natyra, gjelbërimi, hapësirat, bimët, kafshët, zhurmat, banesat,<br>punët që bëhen në fshat/qytet | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>• diskuton rreth fshatit dhe qytetit;<br>• pyet e përgjigjet, rreth fshatit dhe qytetit;<br>• tregon ndryshimet midis fshatit dhe qytetit;<br>• përshkruan qytetin/fshatin e vet;<br>• demonstron siguri, kur flet në klasë;<br>• përdor gjatë prezantimeve të tij edhe | | **Situata e të nxënit**<br>Përshkrimi, krahasimi i qytetit dhe fshatit | |

| | |
|---|---|
| elemente të tilla si: foto dhe piktura;<br>• përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit;<br>• është aktiv në diskutime, në punë në grup;<br>• shfaq iniciativë ose nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për fshatin dhe qytetin. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga internet, foto nga qytete dhe fshatra të ndryshëm | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh,Vija e vlerës, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Paraprakisht mësuesja i ka porositur nxënësit të gjejnë foto, piktura dhe informacione të tjera nga revistat, librat, interneti për fshatin dhe qytetin.

Stuhi mendimesh-punë në grupe. Mësuesja i fton nxënësit të bëjnë stuhi mendimesh disa grupe për fshatin dhe grupet e tjera për qytetin.

Lexohen punët e nxënësve sipas grupeve.

Ushtrimi 1-Mësuesja i fton të shohin fotot që janë dhënë në libër por edhe foto që kanë sjellë vetë dhe paraqiten pamje qytetesh dhe fshatrash. Në fillim flasin në dyshe rreth fotove dhe më pas me gjithë klasën.

Ushtrimi 2-3 - Shkëmbe në dyshe. Mësuesja udhëzon që për ushtrimet 2 dhe 3 të punojnë në dyshe , njëri nxënës liston shkurtimisht në një fletë A4 gjërat që di për qytetin, ndërsa tjetri gjërat që di për fshatin. Shkëmbejnë fletët dhe shtojnë gjëra të tjera nëse kanë për të shtuar. Lexohen e diskutohen me gjithë klasën. Pasi lexon një dyshe të tjerët shtojnë gjera të tjera që shokët nuk i kanë shkruar.

Ushtrimet 4,5,6 diskutohen me gjithë klasën. Mësuesja i udhëzon nxënësit që të nxisin njëri-tjetrin nëpërmjet pyetjeve për të thënë mendimin e tyre dhe ta argumentojnë atë.

Ushtrimi ç punohet individualisht në libër për të shkruar emrat e të vegjëlve të kafshëve dhe shkëmbehen librat në dyshe pasi përfundojnë.

Ushtrimi 8-Vija e vlerës. Nxënësit ndahen në dy grupe sipas zgjedhjes së tyre se ku iu pëlqen të jetojnë(në qytetet apo në fshat). Vendosen përballë njëri-tjetrit të ndarë nga një vijë imagjinare. Nxënësit japin argumentet e tyre për zgjedhjen e bërë, por kanë të drejtë edhe të ndryshojnë grupin nëse binden nga argumentet që japin shokët.

**Vlerësimi bëhet për:**

- diskutimet, pyetjet, përgjigjet, shprehjet e mendimeve, ndjenjave dhe emocioneve rreth fshatit dhe qytetit;
- demonstrimin e sigurisë, kur flet në klasë;
- përdorimin gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla si: foto dhe piktura;
- përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit;
- të qenit aktiv në diskutime, në punë në grup;
- shfaqjen e iniciativës ose nxitjes së të tjerëve të bashkëbisedojnë për fshatin dhe qytet.

**Detyrë shtëpie:** Bëj një album me foto nga fshatra ose qytete.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Gjyshi im</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>gjysh, fshat, qytet, shtëpi , kopsht, pemë, fruta , perime, ajër të pastër, lule, tabela, ndërtesa , rrugë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Tregon njohuritë paraprake që ka rreth përmbajtjes së tekstit që dëgjon (fshati dhe qyteti)<br>• U përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;<br>• Shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të tregimit.<br>• Lidh pjesën e dëgjuar me përvojat e tij ose me pjesë që i ka lexuar në tekste të tjera.<br>• Bën gjykime të thjeshta rreth tekstit.<br>• Luan në role pjesën e dëgjuar.<br>• Veçon disa detaje interesante (muzika që shoqëron rrëfimin, zëri i personazheve etj.) gjatë të dëgjuarit.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Vëzhgimi për pak minuta i një pjese të qytetit/fshatit (afër shkollës)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga interneti</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia:Lapsat në mes Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Paraprakisht mësuesja i fton nxënësit të dalin në një mjedis jashtë shollës dhe për 5-6 minuta të vëzhgojnë sa më shumë detaje nga ajo pjesë e qytetit/fshatit që shohin. Këtë gjë e përdor gjatë diskutimit të tregimit që do dëgjojnë .<br>• Mësuesja fton nxënësit të dëgjojnë tregimin pjesë-pjesë dhe u tërheq vëmendjen për të veçuar edhe detaje si muzikën, zërin e personazheve etj.</td></tr>
</table>

- Pasi dëgjohet pjesa e parë e tregimit dhe u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes së pjesës, diskutojnë për fjalët e reja, nxënësit parashikojnë vazhdimin e tregimit. Diskutimi i përmbajtjes bëhet me gjithë klasën.
- Dëgjohet pjesa e dytë e tregimit, diskutojnë për fjalët e reja, u përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes. Mësuesja u drejton pyetje dhe rreth vëzhgimit që bënë jashtë shkollës duke u ndalur tek detaje si:zhurmat, lëvizjet, ndërtesat, njerëzit etj.
- Për të ndërtuar një mbyllje tjetër nxënësit punojnë në grupe. Ata diskutojnë dhe shkruajnë në grup për një mbyllje tjetër. Lexojnë dhe diskutojnë për punën e bërë.
- Nënvizojnë në libër individualisht fjalët që përshkruajnë fshatin dhe punët që kryhen atje.
- Ushtrimi 5-Lapsat në mes. Nxënësit sjellin përvojat e tyre në lidhje me temën duke i thënë në grup. Ai që tregon përvojën e tij vendos lapsin në mes dhe vazhdojnë të tjerët. Nxënësi që nuk ka për të treguar diçka thotë “Pas” dhe vazhdon radha. Kur mbarojnë të gjithë, mësuesja merr një laps të rastësishëm dhe i zoti i lapsit e tregon për gjithë klasën historinë e tij.
  - Luajnë në role tregimin që dëgjuan sipas grupeve.……

  Sjellin përvojat e tyre në lidhje me138

**Vlerësimi bëhet për:**

- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;
- shprehjen e përjetimeve dhe emocioneve që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të tregimit.
- lidhjen e pjesës së dëgjuar me përvojat e tij
- bërjen e gjykimeve të thjeshta rreth tekstit.
- lojën në role të pjesës së dëgjuar.
- veçimin e disa detajeve interesante (muzika që shoqëron rrëfimin, zëri i personazheve etj.) gjatë të dëgjuarit.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Të duam natyrën (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>natyrë, fëmijëri, parqe<br>hapësira të gjelbra, pemë, mbjellja, kopsht, mjedisin, pasuri</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Shpreh mendimet personale rreth pjesës që lexon.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Kujdesi për lulet e klasës/shkollës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| - foto, informacione nga interneti, enciklopedi, fletëA4 | **Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimi, Diskutim, Bisedë, Ditari dypjesësh, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Paraprakisht mësuesja ka porositur nxënësit të kenë marrë mjete për tu bërë shërbime luleve që kanë në klasë apo në oborrin e shkollës. Lihen nxënësit për disa minuta të bëjnë këtë veprimtari.

Mësuesja fton nxënësit të mendojnë për natyrën dhe lidhjen që kanë me të.

Bëjnë stuhi mendimesh për natyrën .

Shohin figurën e tekstit dhe përshkruajnë dhe komentojnë në dyshe. Më pas lexohet pjesa .

Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë.

- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- U përgjigjen pyetjeve të rubrikës "Lexoj dhe kuptoj".
- Ditari dypjesësh – Nxënësit kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën e cila u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje, nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- komentin për ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit
- lidhjen pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.

**Detyrë shtëpie**: Vizato një pamje nga natyra që të ka ngelur në mëndje.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Të duam natyrën (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>natyrë, fëmijëri, parqe<br>hapësira të gjelbra, pemë, mbjellja, kopsht, mjedisin, pasuri |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | **Situata e të nxënit**<br>Mbjellja e një bime. |

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, informacione nga libra apo interneti, mjete për të mbjellë bimë në vazo apo në lulishten e shkollës | Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lexo, përmblidh në dyshe, Diskutim, Bisedë, Punë individuale, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën

**Veprimtaritë e nxënësve**

Paraprakisht mësuesja i ka udhëzuar të marrin mjete për të mbjellë bimë (lule, fidanë) dhe gjithashtu kuriozitete, informacione në lidhje me natyrën.

- Mësimi fillon me një bisedë me gjithë klasën të drejtuar nga mësuesja ku nxënësit flasin për natyrën dhe rëndësinë që ka ajo në jetën e njeriut. Mund të lexohen fakte, kuriozitete të ndryshme që nxënësit i kanë gjetur nga hulumtimi i tyre.
- Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit nëpërmjet leximit zinxhir.
- Lexo përmblidh në dyshe : Një nxënës lexon një paragraf dhe tjetri e përmbledh me 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafin në vazhdim.
- Punohet rubrika "Reflektoj"e cila zhvillohen si bisedë ndërmjet nxënësve. Mësuesja nxit nxënësit të sjellin argumente duke u mbështetur në përvojën e tyre.
- Kryhet veprimtaria për mbjelljen e bimëve në vazo apo në lulishte. Ndiqen udhëzimet e dhëna në libër.

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit
- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit
- ndarjen me të tjerët të përvojave rreth leximit
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit
- mendimet që jep rreth tekstit
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet

**Detyrë shtëpie**: Rubrika "Shkruaj".

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore** | **Fjalë kyçe** |
|---|---|
| Letër shoqes (ora e parë ) | letër, pjesët e letrës, përgjigje, mjedis, mbrojtje, zbukuroj |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan një letër të thjeshtë drejtuar një shoku ose një shoqeje.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit. | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një letre. |

| | |
|---|---|
| • Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, letra të ndryshme | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia**: Hartë koncepti, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Hartë koncepti-Punë në grupe. Nxënësit ndërtojnë "Hartë koncepti" për letrën (pjesët e letrës, kujt ia dërgojmë, postën që përdorim etj).
- Ushtrimi 1-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësi t lexojnë letrën dhe nënvizojnë veprimet që kryejnë fëmijët në grup.
- Ushtrimi 2- Nxënësit punojnë individualisht për t'i kthyer përgjigje letrës së Drinit, duke treguar se çfarë do të bëjë me shokët për të zbukuruar mjedisin e shkollës ose të lagjes.
- Shkëmbejnë fletoret në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
- Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shkrimin e një letre të thjeshtë drejtuar një shoku ose një shoqeje;
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit;
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses;
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një letër për të treguar edhe ti veprimtaritë që ke bërë me shokët për ruajtjen e mjedisit.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Letër shoqes (ora e dytë ) | | **Fjalë kyçe**<br>letër, pjesët e letrës, përgjigje, mjedis, mbrojtje, zbukuroj | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan një letër të thjeshtë drejtuar një shoku ose një shoqeje.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve. | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një letre. | |

| | |
|---|---|
| • Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe TIK, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia**: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Nxënësit shkëmbejnë fletoret e detyrave të shtëpisë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin për shkrimin e letrës sipas strukturës së saj, saktësinë drejtshkrimore dhe brendinë. Bëhen korrigjime me ndihmën e mësueses.
- Ushtrimi 3- përpara se të punohet ushtrimi zhvillohet një diskutim me gjithë klasën për ndihmën që kanë nevojë nga nxënësit më të rritur me qëllim mirëmbajtjen e këndit sportiv. Kujtohet struktura e letrës dhe nxënësit punojnë individualisht për shkrimin e saj.
- Shkëmbejnë fletoret në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
- Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.

**Vlerësimi bëhet për:**
- shkrimin e një letre të thjeshtë drejtuar një shoku ose një shoqeje
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një letër drejtuar banorëve të planetit për ruajtjen e mjedisit.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Diktim | | **Fjalë kyçe**<br>diktim, rregulla drejtshkrimore, qortim, | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan një tekst me të diktuar<br>• Përdor shenjat e pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë).<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe për emra të përveçëm.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një teksti me të diktuar. | |

| | |
|---|---|
| ndihmën e mësueses. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- fletore, mjete shkrimi | **Lidhja me fushat e tjera** |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Diskutim, Punë individuale

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh: Mësuesja fton nxënësit për të treguar rregullat drejtshkrimore që dinë (fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalisë, shkronja e madhe për emrat e njerëzve, vendeve etj.)
- Mësuesja dikton pjesën.
- Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësueses.
- Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar përsëri saktë.

**Detyrë shtëpie:**
Mësoni tri fjali përmendësh nga pjesa " Sekrete të vogla të Babagjyshit" dhe bëjeni vetëdiktim.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br><br>Si të mbash një ditar sekret (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>ditar, personal, kujtime, përjetime, ndjenja, aktivitete | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin joletrar.<br>• Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>• Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. | | **Situata e të nxënit**<br>Mbajtja e një ditari personal | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, ditar personal | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Vendimmarrja morale | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Rrjetë diskutimi, Lexo përmblidh në dyshe, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësimi nis me leximin e detyrës me shkrim që nxënësve iu dha në orën e mëparshme (leximi bëhet me dëshirën e nxënësit).

- *Punë në çift*- Lexo përmblidh në dyshe Nxënësit në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ata konfirmojnë ato që kanë mësuar një orë më parë por edhe kanë mundësi të përdorin lloje të ndryshme të të menduarit.
- Punohet rreth rubrikës “Reflektoj” Nxënësit u përgjigjen pyetjeve the japin preferencat e tyre në lidhje me personalizimin e ditarit të tyre.
- *Punë në dyshe*-Për pyetjen e dytë tek kjo rubrikë përdoret “Rrjetë diskutimi”. Çdo dyshe shkruan të paktën një argument për secilën anë. Lexohen argumentet dhe dilet në një qëndrim.
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit
- Nxënësit nisin të shkruajnë një fletë ditari. Kjo punë mund të përfundojë në shtëpi.

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.
- leximin e tekstit joletrar.
- leximin e tekstin joletrar.
- interesin dhe dëshirën për të lexuar pjesën.
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Katër shoqe (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>shoqe, dhembje fyti (bajamet), shtatlartë, gështenjë, biondë, bishtalec, ndrojtur, flokëkuqe, e përsosur, e fortë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Lojë: Gjej shokun nga përshkrimi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">- Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto të shokëve/shoqeve</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Lojë, Lexo përmblidh në dyshe, Diskutim, Bisedë, Diagram Venit, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Lojë në dyshe: Nxënësit zgjedhin njërin prej shokëve të klasës për ta përshkruar ,por pa thënë emrin. Shoku tjetër mundohet të gjejë për cilin bëhet fjalë. Ndërrohen rolet.
- Lexohet pjesa nga të gjithë nxënësit nëpërmjet leximit zinxhir.
- Lexo përmblidh në dyshe: Njëri nxënës lexon një paragraf dhe tjetri e përmbledh me 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafin në vazhdim.
- Nxënësit tregojnë brendinë e pjesës me fjalët e tyre.
- Punohet rubrika "Reflektoj", e cila zhvillohen si bisedë ndërmjet nxënësve për pyetjen e parë.
- Diagram Veni: Nxënësit zgjedhin dy prej vajzave të tregimit dhe shkruajnë të përbashkëtat dhe të veçantat. Diskutohet për punën e bërë.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit
- mendimet që jep rreth tekstit
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet

**Detyrë shtëpie**: Bëj një pesëvargësh për shokun/shoqen tënde.

# Moduli 6

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Milingonat dhe gjinkalla (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Milingonat, frytet e punës, qetësi gjinkallë, këndoj<br>LEXO</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<ul><li>Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit</li><li>Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.</li><li>Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.</li><li>Përcakton dy-tre tipare të fabulave.</li><li>I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.</li><li></li></ul></td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>A duhet t’i pranojmë shokët siç janë?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: “ Parashikim me terma paraprakë“, diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br><br>Mësuesja prezanton mësimin dhe duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit (Milingonat, frytet e punës, qetësi gjinkallë,këndoj) nxënësit bëjnë parashikim e përmbajtjes. Këtë parashikim ia tregojnë shokut në dyshe.<ul><li>Ajo udhëzon nxënësit për leximin e tekstit në heshtje. Më pas, diskutojnë në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës.</li><li>Po në dyshe tregohet ndryshim i fabulës nga parashikimi.</li><li>Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme.</li><li>Lexohet pjesa zinxhir.</li><li>Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, u lihet kohë nxënësve ta rilexojnë pjesën.</li><li>Diskutohet në dyshe për llojin e tekstit të lexuar dhe 2-3tipare të tij (fabul, personazhet kafshë, morali del në fund të saj)</li><li>Në rubrikën“Lexoj dhe kuptoj“gjejnë alternativën e duhur. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë njëri-tjetrin .</li><li>Sjellin përvoja nga jeta e tyre që lidhet me temën dhe i diskutojnë.</li></ul></td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**

- parashikimin e përmbajtjes së pjesës
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të
- tregimin e llojit të pjesës
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie** :Gjej një fabul tjetër me të njëjtët personazhe.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Milingonat dhe gjinkalla (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>Milingonat, frytet e punës, qetësi gjinkallë, këndoj |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.<br>• Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.<br>Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa. | **Situata e të nxënit**<br>Diskutim i situatave kur në klasë kanë ndodhur ngjarje që lidhen me fabulën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Lexim me role, Diagrami i Venit, diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës.
- Lexohet fabula sipas roleve: milingonat, gjinkalla, autori
- Më pas sipas dysheve tregojnë përmbajtjen e fabulës.
- Në dyshe punojnë për plotësimin e Diagramit të Venit. Për dy personazhet e pjesës shkruajnë

cilësitë e përbashkëta dhe ato të ndryshme. Prezantojnë punë dhe mësuesja ndërton një diagram në tabelë duke u mbështetur tek puna e nxënësve.

- Zhvillohet diskutim me gjithë klasën për rubrikën"Reflektoj". Gjejnë mesazhin e duhur që i përkon kësaj fabule. Tregojnë qëndrimin e tyre në lidhje me shembuj nga jeta e tyre .

**Vlerësimi bëhet për:**

- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role
- përshkrimin e personazheve
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij të leximit rreth temës.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj sipas imagjinatës. Nëse do të isha personazh I kësaj fabule do të doja të isha…

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Unë kam (ora e parë ) | | **Fjalë kyçe**<br>kam, ke, ka, kemi, keni, kanë | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lidh foljen kam me përemrat vetorë.<br>• Përshtat foljen kam në fjali.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.<br>• | | **Situata e të nxënit**<br>Përdorimi i foljes kam në kohën e tashme në situata të improvizuara. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>• teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

**Paraprakisht mësuesja ka përgatitur etiketa me pyetjet**:

çfarë ke ti?; çfarë kam unë?; çfarë ka ai/ajo?; çfarë keni ju?; çfarë kemi ne?; çfarë kanë ata/ato?

Nxënësit punojnë në grupe për t'i kthyer përgjigje pyetjeve . Në përfundim të punës dalin në përfundimin se folja kam është vendosur në forma të ndryshme të kohës së tashme.

Ushtrimi 1-Punë individuale - Në këtë ushtrim nxënësit lidhin me shigjetë përemrat me foljen kam.

Ushtrimi 2-Nxënësit punojnë individualisht për shkrimin e foljes kam në fjalitë e dhëna.

Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.

Tryezë e rrumbullakët-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore plotësojnë në fletën në formë fizarmonike zgjedhimin e foljes kam të përgatitur nga mësuesja.

Unë ______
Ti ______
Ai ______
Ajo ______
Ne ______
Ju ______
Ata ______
Ato ______

Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**

- Lidhjen e foljes kam me përemrat vetorë.
- Dallimin e foljes kam në fjali.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 4 fjali me foljen kam në kohën e tashme.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Unë kam (ora e dytë ) | | **Fjalë kyçe**<br>zgjedhim, koha e tashme, kam, ke, ka, kemi, keni, kanë | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Dallon foljen kam në fjali.<br>• Përdor në fjali foljen kam në kohën e tashme.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Përdorimi i foljes kam në fjali në kohën e tashme. | |

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| • njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, | Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Mësimi fillon me shkëmbimin e fletoreve të shtëpisë. Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit dhe gabimet diskutohen me gjithë klasën.

Ushtrimi 3-Punë individuale- Në këtë ushtrim nxënësi gjejnë e qarkojnë foljen kam.

Ushtrimi 4-Nxënësit punojnë individualisht për shkrimin e fjalive rreth figurës së dhënë duke përdorur foljen kam në forma të ndryshme të kohës së tashme.

Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.

Tryezë e rrumbullakët - Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore ndërtojnë fjali duke përdorur foljen kam në kohën e tashme.

Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përdorimin në fjali të foljes kam në kohën e tashme.

- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.
- respektimin e përpjekjet individuale dhe ato në grup.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie:** Ndërto fjali me foljen kam.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Zogu dhe djali | | **Fjalë kyçe**<br>zog, zuri, djalë, mëma, fole, lëshoi | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Tregon elementet e vjershës si: strofa, vargu.<br>• Parashikon rreth përmbajtjes së vjershës duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• Lexon vjershën me intonacionin e duhur. | | **Situata e të nxënit**<br><br>Si duhet të sillemi me më të vegjlit, më të dobëtit, të pambrojturit? | |

- Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth vjershës .
- Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet e vjershës.
- Lidh vjershën me përvoja nga jeta e vet.

**Burimet dhe materialet didaktike**
- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit
- teksti mësimor

libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4

**Lidhja me fushat e tjera**
Artet, Shoqëria dhe mjedisi

**Lidhja me temat ndërkurrikulare**
- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrja morale
- Mjedisi
- Bashkëjetesa paqësore

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** Parashikim me terma paraprakë, Diskutim, Lexo - përmblidh në dyshe, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
- Mësuesja shtron pyetjen: Si duhet të sillemi me më të vegjlit, më të dobëtit, të pambrojturin? Kësaj pyetje do i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës .
- Mësuesja shkruan në tabelë fjalët kyçe: zog, zuri, djalë, lëshoi.
- Nxënësit shohin figurën, lexojnë titullin dhe fjalët kyçe dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e vjershës duke punuar në dyshe. I shkruajnë parashikimet e tyre në fletë. Nxënësit lexojmë parashikimet e tyre.
- Lexohet vjersha në heshtje. Nxënësit tregojnë ndryshimet e përmbajtjes së vjershës dhe parashikimit që kanë bërë.
- Diskutohet me gjithë klasën për llojin e pjesës dhe 2-3 karakteristika (vjershë, shkruhet në vargje, përbëhet nga strofa, rrokjet e fundit të vargut ngjajnë me rrokjet e fundit të vargjeve të tjera)
- Punë në dyshe-Nxënësit duke punuar në dyshe lexojnë dhe e përmbledhin çdo strofë me 1-2 fjali. Njëri prej nxënësve lexon dhe tjetri përmbledh. Ndërrohen rolet pas çdo strofe.
- Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj".
- Individualisht nxënësit bëjnë gjetjen e alternativës së duhur.
- Punë në dyshe-Harta e personazheve. Për personazhin e vjershës gjenden dy cilësi dhe ilustrohen me vargje nga vjersha këto cilësi.
- Punohet rubrika "Reflektoj". Nxënësit mbajnë qëndrim ndaj veprimit të djalit. Lidhen ngjarje të ndryshme nga jeta e përditshme me vjershën.
- Në përfundim, dalin në një përgjigje të përbashkët për pyetjen e shtruar nga mësuesja në fillim të mësimit.

**Vlerësimi bëhet për:**
- dallimin e elementeve të vjershës si: strofa, vargu etj.
- parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth fabulës .
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazheve të fabulës.
- lidhjen e pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.
- vlerësimin që nxënësit i bëjnë njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Nënvizo fjalët që mbarojnë me të njëjtën rrokje në dy strofat e para.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dreri (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Dre, brirë, këmbë, i shëmtuar, luan, vërsul, ngatërroj<br>LEXOJ</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit.<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• Përcakton dy-tre tipare të fabulave.<br>•</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Improvizimi i një situate ku nxënësve u duhet të zgjedhin midis të bukurës dhe të vlefshmes.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: “Parashikim me terma paraprakë”, diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Mësuesja fton nxënësit të zgjedhin ndërmjet një mjeti që mund tu mungojë atë ditë (gomë, laps, ngjyra) dhe një lodre të preferuar. Diskutohen zgjedhjet e bëra.<br>• Mësuesja prezanton mësimin dhe duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit (Dre, brirë, këmbë, I shëmtuar, luan, vërsul, ngatërroj) nxënësit bëjnë parashikim e përmbajtjes. Këtë parashikim ia tregojnë shokut në dyshe.<br>• Ajo udhëzon nxënësit për leximin e tekstit në heshtje. Ata diskutojnë rreth përmbajtjes së pjesës.<br>• Po në dyshe tregohet ndryshim i fabulës nga parashikimi.<br>• Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme.<br>• Lexohet pjesa zinxhir.<br>• Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, u lihet kohë nxënësve ta rilexojnë pjesën.<br>• Diskutohet në dyshe për llojin e tekstit të lexuar dhe 2-3tipare të tij (fabul, personazhet kafshë, morali del në fund të saj)<br>• Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj“ gjejnë alternativën e duhur. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë njëri-tjetrin .<br>• Sjellin përvoja nga jeta e tyre që lidhet me temën dhe i diskutojnë.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
- parashikimin e përmbajtjes së pjesës
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të
- tregimin e llojit të pjesës
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Gjej një fabul tjetër të ngjashme me fabulën "Dreri".

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dreri (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Dre, brirë, këmbë, i shëmtuar, luan, vërsul, ngatërroj</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<ul><li>Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.</li><li>Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.</li><li>Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</li><li>Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.</li><li>Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa.</li></ul></td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Ngjarje nga jeta që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra me fabula,mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore<br>- Vendimmarrja morale</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Lexim me role, Harta e personazheve, diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<ul><li>Mësuesja fton nxënësit t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës.</li><li>Lexohet fabula sipas roleve: dreri, autori</li><li>Më pas sipas dysheve tregojnë përmbajtjen e fabulës.</li><li>Luajnë në role pjesën.</li></ul></td></tr>
</table>

- Në dyshe punojnë për plotësimin e Hartës së personazheve. Për personazhin e pjesës shkruajnë dy cilësi dhe për çdo cilësi kopjojnë fragmentin në të cilin del kjo cilësi.
- Zhvillohet diskutim me gjithë klasën për rubrikën "Reflektoj". Gjejnë mesazhin e duhur që i përkon kësaj fabule dhe e konkretizojnë mesazhin e fabulës me shembuj nga jeta e tyre .

**Vlerësimi bëhet për:**

- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role
- përshkrimin e personazheve
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij të leximit rreth temës.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj një mbyllje tjetër për fabulën.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Unë shkruaj, lexoj, mësoj (ora e parë )</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>folje, shkruaj, lexoj, mësoj</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Përshtat foljet që mbarojnë me –j në fjali.<br>• Zgjedhon foljet shkruaj, lexoj, mësoj sipas modelit të dhënë.<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përdorimi i foljeve shkruaj, lexoj, mësoj në situata të improvizuara.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4,</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Paraprakisht mësuesja ka përgatitur etiketa me pyetjet për foljet që mbarojnë me –j.

Çfarë shkruan/ lexon/ mëson ti?; Çfarë shkruaj/ lexoj/ mësoj unë?; Çfarë shkruan /lexon/ mëson ai/ajo?; Çfarë shkruani/ lexoni/ mësoni ju?; Çfarë shkruajmë/ lexojmë/ mësojmë ne?; Çfarë shkruajnë/ lexojnë/ mësojnë ata/ato?

Nxënësit punojnë në grupe për t'u kthyer përgjigje pyetjeve. Gjatë diskutimit me mësuesen dalin në përfundimin se foljet e tipit: shkruaj, lexoj, mësoj janë vendosur në forma të ndryshme të kohës së tashme.

Ushtrimi 1 - Punë individuale - Në këtë ushtrim nxënësit lidhin me shigjetë përemrat me foljet shkruaj, lexoj, mësoj.

Ushtrimi 2 - Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin sipas modelit të tabelës me foljen kërkoj . Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.

Tryezë e rrumbullakët-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore plotësojnë në fletën në formë fizarmonike zgjedhimin e njëjës prej foljeve: mësoj, shkruaj, lexoj, fshij, etj të përgatitur nga mësuesja.

Unë ______
Ti ______
Ai ______
Ajo ______
Ne ______
Ju ______
Ata ______
Ato ______

Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**

- Përshtatjen e foljeve shkruaj, lexoj, mësoj në fjali.
- Kalimin në forma të ndryshme të këtyre foljeve
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie:** Përdor në fjali foljen shkruaj, lexoj në kohën e tashme.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Unë shkruaj, lexoj, mësoj (ora e dytë ) | | **Fjalë kyçe**<br>Folje, shkruaj, lexoj, mësoj | |
| **Rezultatet e të nxënit** | | **Situata e të nxënit** | |

| | |
|---|---|
| • Përzgjedh foljen e duhur duke e përshtatur në fjali.<br>• Përdor në fjali foljen shkruaj, lexoj, mësoj në kohën e tashme.<br>• Plotëson fjalitë me folje që mbarojnë me –j.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | Përdorimi i foljeve shkruaj, lexoj, mësojnë fjali në kohën e tashme. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4. | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:**Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
Mësimi fillon me shkëmbimin e fletoreve të shtëpisë. Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit dhe gabimet diskutohen me gjithë klasën.
Ushtrimi 3-Punë individuale- Në këtë ushtrim nxënësit plotësojnë fjalitë me dy folje sipas modelit të dhënë.
Ushtrimi 4-Nxënësit punojnë individualisht për vendosjen e foljes në formën e duhur duke e përshtatur në fjali.
Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
Tryezë e rrumbullakët-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore ndërtojnë fjali duke përdorur foljet vrapoj, mbaj, laj, gjej në kohën e tashme.
Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përdorimin në fjali foljeve lexoj, shkruaj, mësoj etj në kohën e tashme.
- Përzgjedhjen e foljes së duhur duke e përshtatur në fjali.
- Plotësimin e fjalive me folje që mbarojnë me –j.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie:** Ndërto fjali me foljet laj, mbaj, tregoj, luaj në kohën e tashme.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Një tigër i vogël (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>macja, kafshë shtëpiake, sytë<br>mustaqet, ndiejë, lozonjare</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë pjesën<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Lidhja e fëmijëve me macen ose kafshë të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra, enciklopedi, revista me informacione për macen, informacione nga interneti, mjete shkrimi, fletë A4,</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Vendimmarrja morale<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Hartë koncepti, Role të specializuara në diskutim, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën<br><br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Janë porositur nxënësit me parë që të kërkojnë e të gjejnë materiale, kuriozitete për macet. Tregojnë histori personale te tyre apo familjarëve që lidhen me macet.<br>• Ndërtohet" Hartë koncepti" për macet duke punuar sipas grupeve.<br>• Mësuesja prezanton temën e mësimit.<br>• Lihen nxënësit që të lexojnë pjesën në heshtje. U lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë. Nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe pjesët që i duken më interesante.<br>• Punë në grup- Role të specializuara në diskutim.<br>Nxënësit marrin nga një rol për të cilin bien dakord bashkërisht.<br>- Gjetësi i citimeve duhet të zgjedhë një pjesë nga teksti që mendon se është më interesantja.<br>- Hulumtuesi i cili ka për detyrë të japë informacione të tjera për macet.<br>- Bërësi i pyetjeve duhet të shkruajë pyetje që dëshiron ta diskutojë me të tjerët.<br>- Gjetësi i fjalëve i cili duhet të gjeje fjalë të reja, për të diskutuar për kuptimin e tyre.<br>- Ilustruesi duhet të bëjë ilustrimin e një maceje.<br>- Gjurmuesi ka për detyrë të gjejë vendet ku jetojnë llojet e ndryshme të maceve.<br>• Pasi përfundojnë veprimtarinë brenda grupit, bëjnë prezantim të punës së tyre.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
- leximin e tekstit joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregimin e interesit dhe dëshirës për të lexuar tekstin.
- respektin ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.
- pyetjet qe bën për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- lidhjen e pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tyre
- mënyrën e bashkëpunimit në grup
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit.

**Detyrë shtëpie**: Gjeni kuriozitete të tjera për macet.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Një tigër i vogël (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>macja, kafshë shtëpiake, sytë mustaqet, ndiejë,lozonjare</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin joletrar.<br>• Tregon brendinë e pjesës;<br>• Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Lidhja e fëmijëve me macen ose kafshë të tjera.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra, enciklopedi, revista me informacione për macen , informacione nga interneti, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik,Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Vendimmarrja morale<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Lexo përmblidh në dyshe, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Lexohen detyrat e shtëpisë. Tregohen histori të nxënësve të cilat lidhen me macen.<br>• Punë në çift- Lexo përmblidh në dyshe- Nxënësit në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ata konfirmojnë ato që kanë mësuar një orë më parë po dhe kanë mundësi të të përdorin lloje të ndryshme të të menduarit.</td></tr>
</table>

- Punohet rubrika "Reflektoj". Nxënësit japin mendimet dhe shprehin dëshirat e tyre për të patur një mace si dhe për tu kujdesur për të.
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit

**Vlerësimi bëhet për:**
- leximin e tekstin joletrar.
- tregimin e brendisë së pjesës.
- pranimin e ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre .
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj sipas imagjinatës "Sikur të kisha një mace....."

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Kafshët shtëpiake (ora e parë )</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>kafshë, shtëpiake, përshkruaj, skedë, kujdes</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Përshkruan kafshë shtëpiake sipas modelit.<br>• Shkruan pyetje për kafshët shtëpiake.<br>• Përshkruan kafshë shtëpiake të dashura për të.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.<br>•</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përshkrimi i kafshëve shtëpiake</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga interneti</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Shkrim i lirë, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>Shkrim i lirë-Mësuesja i fton nxënësit të shkruajnë për kafshën shtëpiake që kanë ose dëshirojnë të kenë. Lexohen në çift punët e bëra. Në diskutimet në çift nxënësit argumentojnë zgjedhjet e tyre për kafshët shtëpiake.</td></tr>
</table>

- Mësuesja orienton nxënësit që nëse kanë pyetje për shokët rreth kafshëve shtëpiake që ata mbajnë në shtëpi, t'i shkruajnë në një fishë dhe t'i ngjisin në një tabelë të veçantë që është vendosur në një cep të klasës dhe quhet"Tabela e pyetjeve".
- Ushtrimi 1- Në këtë ushtrim nxënësit lexojnë skedën e plotësuar për qenin. Diskutohet me gjithë klasën kjo skedë dhe arrihet në përfundimin se për të plotësuar skedën dhe për ta përshkruar një kafshë në fillim japim të dhënat e saj (emrin, moshën, racën), vazhdohet me përshkrimin e jashtëm të kafshës dhe në fund përshkruhet sjellja dhe marrëdhëniet që këto kafshë kanë me njeriun.
- Ushtrimi 2- Në këtë ushtrim nxënësit punojnë individualisht për të plotësuar skedën duke u mbështetur në ushtrimin e parë dhe diskutimet që bënë rreth tij.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun. Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.
- Lexohen pyetjet të vendosur tek"Tabela e pyetjeve" dhe nxënësit që kanë një përgjigje për këto pyetje u përgjigjen atyre.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përshkrimin e kafshëve shtëpiake të dashura për ta
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie:** Përshkruaj një kafshë shtëpiake.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Kafshët shtëpiake (ora e dytë )</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>kafshë, shtëpiake, përshkruaj, skedë, kujdes</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Përshkruan kafshë shtëpiake sipas modelit.<br>• Përshkruan kafshë shtëpiake të dashura për të.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përshkrimi i kafshës shtëpiake të parapëlqyer.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga interneti</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | - Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve:**

- Lexohen detyrat e shtëpisë duke i shkëmbyer fletoret në dyshe. Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.
- Ushtrimi 3- Në këtë ushtrim nxënësit vizatojnë dhe përshkruajnë sipas modelit, kafshën e tyre të parapëlqyer .
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun. Me ndihmën e mësueses bëhen korrigjimet drejtshkrimore nëse ka.
- U jepet një detyrë me shkrim: Nëse do të isha një kafshë shtëpiake do të doja të isha...
- Lexohen nga çdo nxënës në dyshe shkrimet dhe bëhen korrigjimet drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin e kafshëve shtëpiake të dashura për ta
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie:** Përshkruaj kafshën që do të doje ta kishe në shtëpinë tënde .

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Majmuni dhe gjirafa (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>Gjirafë, e bukur, mendjemadhe, majmun, jap një mësim, palmë, frutat, kap | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• Përcakton dy-tre tipare të fabulave.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të. | | **Situata e të nxënit**<br>Përrallat e fundit që kanë lexuar. | |

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra me përralla ,mjete shkrimi, fletë A4 | Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Vendimmarrja morale<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** " Parashikim me terma paraprakë", diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit të sjellin në kujtesë përrallat që kanë lexuar së fundmi. Për 2-3 minuta i tregojnë shokëve në dyshe për to.
- Mësuesja prezanton mësimin dhe duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit (gjirafë, e bukur, mendjemadhe, majmun, jap një mësim, palmë. frutat, kap) nxënësit bëjnë parashikim e përmbajtjes. Këtë parashikim ia tregojnë shokut në dyshe.
- Ajo udhëzon nxënësit për leximin e tekstit në heshtje, ata diskutojnë rreth përmbajtjes.
- Po në dyshe tregohet ndryshim i përrallës nga parashikimi i bërë.
- Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme. Punohet fjalori për shpjegimin e fjalëve.
- Lexohet pjesa zinxhir.
- Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, u lihet kohë nxënësve ta rilexojnë pjesën.
- Diskutohet në dyshe për llojin e tekstit të lexuar dhe 2-3tipare të tij . (përrallë, personazhet kafshë, fund i lumtur)
- Në rubrikën "Lexoj dhe kuptoj" gjejnë alternativën e duhur. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë njëri-tjetrin .
- Sjellin përvoja nga jeta e tyre që lidhet me mendjemadhësinë dhe i diskutojnë.

**Vlerësimi bëhet për:**

- parashikimin e përmbajtjes së pjesës
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të
- tregimin e llojit të pjesës
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Gjej një përrallë tjetër me kafshë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore** | **Fjalë kyçe** |
|---|---|
| Majmuni dhe gjirafa (ora e dytë) | Gjirafë, e bukur, mendjemadhe, majmun, jap një mësim, palmë, frutat, kap |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.<br>• Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.<br>• Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa. | **Situata e të nxënit**<br>Si sillemi me shokët tanë? |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra me përralla, mjete shkrimi, fletë A4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Vendimmarrja morale<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Lexim me role, Harta e personazheve diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës.
- Lexohet përralla sipas roleve: gjirafa, autori
- Më pas sipas dysheve tregojnë përmbajtjen e përrallës.
- Në dyshe punojnë për plotësimin e Hartës së personazheve. Për dy personazhet e pjesës shkruajnë dy cilësi dhe për çdo cilësi kopjojnë fragmentin në të cilin del kjo cilësi.
- Zhvillohet diskutim me gjithë klasën për rubrikën"Reflektoj". Gjejnë mesazhin e duhur që i përkon kësaj përralle dhe e konkretizojnë mesazhin e përrallës me shembuj nga jeta e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role
- përshkrimin e personazheve
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij të leximit rreth temës.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj një mesazh tjetër për përrallën.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Unë hap, vendos, mbjell (ora e parë ) | | **Fjalë kyçe**<br>folje, hap, vendos, mbjell | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Përshtat foljet hap, vendos, mbjell me përemrat në fjali.<br>• Zgjedhon foljet hap, vendos, mbjell<br>Sipas modelit të dhënë.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | **Situata e të nxënit**<br>Përdorimi i foljeve hap, vendos, mbjell në situata të improvizuara. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:**Diskutim, Bisedë, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
Paraprakisht mësuesja ka përgatitur etiketa me pyetjet për foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore (folje të zgjedhimit të dytë). Improvizohen situata dhe nxënësit u përgjigjen pyetjeve:
Çfarë hap, vendos, mbjell ti?; Çfarë hap/ vendos/ mbjell unë?; Çfarë hap/vendos/mbjell ai/ajo?; Çfarë hapni/ vendosni/mbillni ju?; Çfarë hapim/ vendosim/mbjellim ne?; Çfarë hapin/ vendosin/ mbjellin ata/ato?
Nxënësit punojnë në grupe për t'u kthyer përgjigje pyetjeve . Në përfundim të punës dalin në përfundimin se foljet e tipit: hap, vendos, mbjell janë vendosur në forma të ndryshme të kohës së tashme.
Ushtrimi 1-Punë individuale - Në këtë ushtrim nxënësit lidhin me shigjetë përemrat me pjesën tjetër të fjalisë duke i përshtatur përemrat me foljet e tipit : hap, vendos, mbjell.
Ushtrimi 2-Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin sipas modelit të tabelës me foljen hap
Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
Tryezë e rrumbullakët-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore plotësojnë në fletën në formë fizarmonike zgjedhimin e njërës prej foljeve: hap, vendos, mbjell
etj të përgatitur nga mësuesja.
Unë ______
Ti ______
Ai ______
Ajo ______
Ne ______
Ju ______
Ata ______
Ato ______
Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën. Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**
- përshtatjen e foljeve të tipit: hap, vendos, mbjell me përemrat vetorë në fjali.
- Zgjedhimin e foljeve sipas modelit
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie:** Përdor në fjali foljen hap, mbjell në kohën e tashme.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Unë hap, vendos, mbjell (ora e dytë )</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>folje, hap, vendos, mbjell</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Përdor në fjali foljen hap, vendos, mbjell në kohën e tashme.<br>• Plotëson fjalitë me foljet hap, vendos, mbjell duke I përshtatur ato.<br>• Përzgjedh formën e duhur të foljes për ta përshtatur në fjali.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përdorimi i foljeve hap, vendos, mbjell në fjali në kohën e tashme.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4,</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:<br><br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve:<br>Mësimi fillon me shkëmbimin e fletoreve të shtëpisë. Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit dhe gabimet diskutohen me gjithë klasën.<br>Ushtrimi 3-Punë individuale - Në këtë ushtrim nxënësit plotësojnë fjalitë me dy folje sipas modelit të dhënë.<br>Ushtrimi 4-Nxënësit punojnë individualisht për vendosjen e foljes në formën e duhur duke e përshtatur në fjali.<br>Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.<br>Tryezë e rrumbullakët-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore ndërtojnë fjali duke përdorur folje kap, mbyll, humb në kohën e tashme.<br>Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>• përdorimin në fjali foljeve hap, vendos, mbjell etj. në kohën e tashme.<br>• mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>• vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br><br>Detyrë shtëpie: Ndërto fjali me foljet mbjell, mbyll, heq në kohën e tashme.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Arushët dhe dhelpra (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>arush, djathë, ndaj barabar,dhelpër<br>kafshoj, copë,qesh<br>LEXOJ</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit.<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• Përcakton dy-tre tipare të fabulave.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Diskutim I situatave kur në klasë mund të ketë ndodhur një grindje.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: “Parashikim me terma paraprakë”, diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve:<br>• Mësuesja fton nxënësit të sjellin në kujtesë momente kur mund të jenë ndodhur në një grindje me shokët. Se si janë ndier, çfarë kanë pësuar nga kjo grindje do ta tregojnë gjatë orës së mësimit.<br>• Mësuesja prezanton mësimin dhe duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit (arush, djathë, ndaj barabar, dhelpër, kafshoj, copë, qesh) nxënësit bëjnë parashikim e përmbajtjes. Këtë parashikim ia tregojnë shokut në dyshe.<br>• Ajo udhëzon nxënësit për leximin e tekstit në heshtje e me paragrafë. Ata do të diskutojnë rreth përmbajtjes së pjesës.<br>• Po në dyshe tregohet ndryshim i fabulës nga parashikimi.<br>• Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme.<br>• Lexohet pjesa zinxhir.<br>• Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, u lihet kohë nxënësve ta rilexojnë pjesën.<br>• Diskutohet në dyshe për llojin e tekstit të lexuar dhe 2-3tipare të tij (fabul, personazhet kafshë, morali del në fund të saj)<br>• Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” gjejnë alternativën e duhur. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë njëri-tjetrin .<br>• Sjellin përvoja nga jeta e tyre që lidhet me temën dhe i diskutojnë.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
- parashikimin e përmbajtjes së pjesës
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të
- tregimin e llojit të pjesës
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Arushët dhe dhelpra (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>arush, djathë, ndaj barabar, dhelpër<br>kafshoj, copë, qesh<br>LEXOJ</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon sipas roleve pjesën.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.<br>• Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.<br>• Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Diskutim i situatave kur në klasë mund të ketë ndodhur një grindje.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Lexim me role, Harta e personazheve, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Mësuesja fton nxënësit t’i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës.<br>• Lexohet fabula sipas roleve: arushët, dhelpra, autori<br>• Luajnë fabulën në role.<br>• Më pas sipas dysheve tregojnë përmbajtjen e fabulës.<br>• Në dyshe punojnë për plotësimin e Hartës së personazheve. Për dy personazhet e pjesës shkruajnë dy cilësi dhe për çdo cilësi shkruajnë fragmentin në të cilin del kjo cilësi në tekst.</td></tr>
</table>

- Zhvillohet diskutim me gjithë klasën për rubrikën “Reflektoj”. Gjejnë mesazhin e duhur që i përkon kësaj fabule dhe e konkretizojnë mesazhin e fabulës me shembuj nga jeta e tyre .

**Vlerësimi bëhet për:**
- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role
- përshkrimin e personazheve
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij të leximit rreth temës.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj një këshillë për arushët.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Përmbledhja e përrallës (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>përmbledhje, përrallë, pjesë, personazhe,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Përmbledh shkurtimisht me 1-2 fjali pjesë të përrallës.<br>Shkruan përmbledhjen e përrallës .<br>Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>Vlerëson punët e të tjerëve.<br>Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përmbledhje përrallash</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, libra me përralla.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim për njohuritë paraprake, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>Diskutim për njohuritë paraprake- mësuesja paraqet në tabelë fjalën “Përralla” dhe fton nxënësit të thonë ç’u vjen në mendje. Mësuesja shkruan mendimet e nxënësve në tabelë.<br>Nxënësit janë porositur paraprakisht të sjellin libra me përralla.<br>Mësuesja i fton nxënësit që në grup të prezantojnë titujt e përrallave dhe të zgjedhin një prej përrallave që duan të dëgjojnë. Ai nxënës që e ka lexuar e tregon shkurt në mënyrë të përmbledhur përrallën.<br>Ushtrimi 1-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit diskutojnë rreth figurave ilustruese të përrallës dhe përmbledhin shkurt secilën pjesë të saj. Përmbledhja për secilës pjesë bëhet me 1-2 fjali të shkurtra. Pas çdo përmbledhje bëhet shkëmbimi i librave në dyshe dhe korrigjimi i gabimeve me ndihmën e mësueses.<br>Ushtrimi 2-Punë individuale. Nxënësit shkruajnë përmbledhjen e plotë të përrallës.<br>Bëjnë korrigjimin e gabimeve drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
- shkrimin përmbledhjes së përrallës nisur edhe nga ilustrimet
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj përmbledhjen e një përralle që të pëlqen.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Përmbledhja e përrallës (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>përmbledhje, përrallë, pjesë, personazhe</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Përshkruan personazhet e përrallës.<br>Krahason personazhet e përrallës.<br>Shkruan përmbledhjen e një përralle.<br>Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>Vlerëson punët e të tjerëve.<br>Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përshkrim i personazheve të përrallave</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, libra me përralla</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve:<br>• Nxënësit janë porositur paraprakisht të sjellin libra me përralla.<br>• Mësuesja i fton nxënësit që në dyshe të zgjedhin një prej personazheve të një përralle që u ka ngelur në mëndje. Përshkruhen personazhet .<br>• Ushtrimi 3-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit përshkruajnë personazhet e përrallës“Kali dhe bualli”. Mësuesja i orienton nxënësit se përshkrimi i secilit personazh duhet filluar nga të dhënat e tij, përshkrimi fizik, karakteri, sjellja etj .<br>• Pasi përfundohet puna bëhet shkëmbimi i librave në dyshe dhe korrigjimi i gabimeve drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Diagrami i Venit -Në dyshe nxënësit ndërtojnë diagramin e Venit për cilësitë e personazheve të përrallës.<br>• Plotësohet një diagram në tabelë duke u mbështetur në punën e nxënësve.<br>• Mësuesja paraqet para çdo grupi një përrallë të ilustruar me figura. Ajo kërkon të shkruajnë përmbledhjen e saj sipas modelit që ndoqën në përrallën “Kali dhe bualli”. Çdo përfaqësues grupi lexon përmbledhjen e përrallës.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**

- përshkrimin e personazheve të përrallës
- shkrimin e përmbledhjes së përrallës
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie:** Nga përrallat që ke lexuar zgjidh dhe përshkruaj personazhin tënd të preferuar.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Dhia dhe ujku</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>dhia, majë malit, ujku, ngjitet, ha</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Parashikon rreth përmbajtjes së fabulës duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• Lexon fabulën.<br>• Interpreton fabulën.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth fabulës .<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet e fabulës.<br>• Lidh fabulën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>A duhet t'u besojmë të panjohurve?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Vendimmarrja morale<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Parashikim me terma paraprakë, Lexo, përmblidh në dyshe, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Mësuesja shtron pyetjen : A duhet t'u besojmë të panjohurve? Kësaj pyetje do i japin përgjigje në pjesë të ndryshme të orës.<br>• Mësuesja shkruan në tabelë fjalët kyçe: dhia, majë malit, ujku, ngjitet, ha</td></tr>
</table>

- Nxënësit shohin figurën, lexojnë titullin dhe fjalët kyçe dhe bëjnë parashikimin për përmbajtjen e vjershës duke punuar në dyshe. I shkruajnë parashikimet e tyre në fletë. Nxënësit lexojnë parashikimet e tyre.
- Lexohet fabula në heshtje. Nxënësit tregojnë ndryshimet e përmbajtjes së saj dhe parashikimit që i kanë bërë.
- Diskutohet me gjithë klasën për llojin e pjesës dhe 2-3 karakteristika. (fabul, personazhe kafshë, mbyllet me një moral)
- Punë në dyshe-Nxënësit duke punuar në dyshe lexojnë dhe e përmbledhin çdo strofë me 1-2 fjali. Njëri prej nxënësve lexon dhe tjetri përmbledh. Ndërrohen rolet pas çdo strofe.
- Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj"
- Individualisht nxënësit bëjnë gjetjen e alternativës së duhur.
- Punë në dyshe-Harta e personazheve. Për personazhin e vjershës gjenden dy cilësi dhe ilustrohen me vargje nga fabula këto cilësi.
- Punohet rubrika "Reflektoj" nëpërmjet saj del morali i fabulës: Të mos i besojmë asnjëherë të panjohurve. Nga ky mesazh lindin diskutime për ngjarje të ndryshme nga jeta e përditshme.

**Vlerësimi bëhet për:**

- dallimin e elementet të fabulës si: strofa, vargu.
- parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;
- leximin e fabulës
- shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth fabulës .
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazheve të fabulës.
- lidhjen e pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.
- vlerësimin që nxënësit i bëjnë njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Nënvizo foljet te fabula.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Foljet ha, pi, fle (ora e parë )</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>folje, ha, pi, fle</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lidh foljet ha, pi, fle më përemrat vetorë.<br>• Zgjedhon foljet ha, pi, fle<br>në kohën e tashme sipas modelit të gatshëm.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përdorimi i foljeve ha, pi, fle në kohën e tashme, në situata të improvizuara.</td></tr>
</table>

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| • njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, | Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Paraprakisht mësuesja ka përgatitur etiketa me pyetjet për foljet ha, pi, fle që mbarojnë me zanore (folje të zgjedhimit të tretë). Improvizohen situata dhe nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

Çfarë bën ti?; Çfarë bëj unë?; Çfarë bën ai/ajo?; Çfarë bëni ju?; Çfarë bëjmë ne?; Çfarë bëjnë ata/ato?

Nxënësit punojnë në grupe për t'u kthyer përgjigje pyetjeve . Në përfundim të punës dalin në përfundimin se foljet e tipit: ha, pi, fle janë vendosur në forma të ndryshme të kohës së tashme .

Ushtrimi 1-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit lidhin me shigjetë përemrat me pjesën tjetër të fjalisë duke i përshtatur përemrat me foljet e tipit : ha, pi, fle

Ushtrimi 2-Nxënësit punojnë individualisht për plotësimin sipas modelit të tabelës me foljen di .

Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.

Tryezë e rrumbullakët-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore plotësojnë në fletën në formë fizarmonike zgjedhimin e njërës prej foljeve: ha, pi, fle

etj të përgatitur nga mësuesja.

Unë ______
Ti ______
Ai ______
Ajo ______
Ne ______
Ju ______
Ata ______
Ato ______

Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**
- lidhjen e foljeve ha, pi, fle me përemrat vetorë
- zgjedhimin e foljeve të tipit: ha, pi, flenë kohën e tashme.
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.
- respektimin e përpjekjet individuale dhe ato në grup.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie:** Zgjedho foljen ha, di në kohën e tashme.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Foljet ha, pi, fle (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>folje, ha, pi, fle |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Vendos formën e duhur të foljeve ha, pi, fle në fjali.<br>• Përdor në fjali foljen ha, pi, fle në kohën e tashme.<br>• Plotëson fjalitë me folje që mbarojnë me zanore.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | **Situata e të nxënit**<br>Përdorimi i foljeve ha, pi, fle në fjali në kohën e tashme. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**
Mësimi fillon me shkëmbimin e fletoreve të shtëpisë. Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit dhe gabimet diskutohen me gjithë klasën.
Mësuesja shpërndan etiketa me folje që mbarojnë me –j, me bashkëtingëllore dhe me zanore. Nxënësit do formojnë fjali me foljen që i bie në etiketë.
Ushtrimi 3-Punë individuale Në këtë ushtrim nxënësit plotësojnë fjalitë me dy folje ha, pi sipas modelit të dhënë**.**
Ushtrimi 4-Nxënësit punojnë individualisht për vendosjen e foljes në formën e duhur duke e përshtatur në fjali.
Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë veten dhe shokun.
Ushtrimi 5-Tryezë e rrumbullakët-Punë në grupe. Nxënësit të vendosur në formë rrethore ndërtojnë fjali duke përdorur foljet ***pi, di, bie, fle, zë, vë,*** në kohën e tashme.
Pasi përfundojnë të gjithë anëtarët e grupit e hapin fletën . Lexojnë punën e bërë dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Vlerësimi bëhet për:**
- Vendosjen në formën e duhur të foljeve ha, pi, fle në fjali.
- përdorimin në fjali foljeve të tipit ha, pi, fle, zë etj në kohën e tashme.
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve.
- respektimin e përpjekjet individuale dhe ato në grup.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie:** Ndërto fjali me foljet ha, zë, bie në kohën e tashme.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Në anën e kafshëve (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>kuisje, qenush, pëllumb ,pulëbardhë, mbeturina, mbretëreshës së botës, gjurmë, ndot, Tokë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<ul><li>Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.</li><li>Diskuton rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit.</li><li>I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit .</li><li>Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.</li></ul></td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Si e dëmton njeriu mjedisin?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>informacione nga libra, revista, interneti, për ndotjen, foto, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Vendimmarrja morale<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<ul><li>Mësuesja shtron pyetjen: “Si e dëmton njeriu mjedisin?” nxënësit japin përgjigjet e tyre të cilat mësuesja i shkruan në tabelë.</li><li>Mësuesja prezanton temën dhe udhëzon nxënësit për leximin e pjesës me paragrafë. Pas leximit të çdo paragrafi nxënësit diskutojnë rreth fjalëve të reja, përmbajtjes, dhe informacioneve që dalin nga teksti për të plotësuar përgjigjet e pyetjes në tabelë. Diskutohen këto me gjithë klasën.</li><li>Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, u lihet kohë nxënësve ta rilexojnë pjesën.</li><li>Lexohet pjesa zinxhir.</li><li>Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” plotësojnë fjalitë e dhëna duke u mbështetur tek teksti. Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit njëri-tjetrin .</li></ul>Vlerësimi bëhet për:<br>- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante<br>- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br><br>Detyrë shtëpie: Kopjo fjalitë në të cilat tregohet dëmi që i kishin bërë njerëzit natyrës.</td></tr>
</table>

| **Fusha** Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda** Gjuha shqipe | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

**Tema mësimore**
Në anën e kafshëve (ora e dytë)

**Fjalë kyçe**
kuisje, qenush, pëllumb ,pulëbardhë, mbeturina, mbretëreshës së botës, gjurmë, ndot, Tokë.

**Rezultatet e të nxënit**

- Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.
- Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.
- Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.
- Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.
- Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa.
- Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.

**Situata e të nxënit**
Çdo të bënit ju për të mbrojtur tokën?

**Burimet dhe materialet didaktike**

- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit
- teksti mësimor

informacione nga libra, revista, interneti, për ndotjen, foto, mjete shkrimi, fletë A4

**Lidhja me fushat e tjera**
Artet, , Shoqëria dhe mjedisi

**Lidhja me temat ndërkurrikulare**

- Të drejtat e njeriut
- Vendimmarrja morale
- Mjedisi
- Bashkëjetesa paqësore

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës.
- Lexohet pjesa sipas roleve: Sara, Maksi, mbretëresha e botës, autori
- Luajnë pjesën në role.
- Më pas nxënësit tregojnë përmbajtjen duke u mbështetur tek fjalitë e radhitura në rubrikën "Lexoj dhe kuptoj „.
- Zhvillohet diskutim me gjithë klasën për rubrikën"Reflektoj". Konkretizojnë mesazhin e pjesës që duhet të dalë nga ky diskutim(Bota është e çmuar për ne, duhet ta mbrojmë.)me shembuj nga jeta e tyre .
- Mësuesja shton pyetjen: Çdo të bënit ju për të mbrojtur Tokën?.
- Duke punuar në grupe nxënësit bëjnë një poster. Secili prej tyre do të shkruajë nga një fjali,se si mund ta mbrojë mjedisin. **VEPRIMTARI** 161
- Prezantojnë punën e bërë në grup e vlerësojnë njëri-tjetrin .

**Vlerësimi bëhet për:**

- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role

- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij të leximit rreth temës.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj dy veprime që bën ti për të mbrojtur mjedisin.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Në kopshtin zoologjik (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>nxënës, vizitoj, kopsht zoologjik, kafshë, punonjës i kopshtit, pyetje, mendime</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Shkruan 2-3 fjali për kopshtin zoologjik.<br>• Shkruan pyetje rreth tij.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve;<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Përvoja nga vizita në kopshtin zoologjik.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto të kafshëve të ndryshme, të kopshteve zoologjike, informacione dhe kuriozitete për to.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Zhvillohet bisedë për vizitat që mund të kenë bërë në kopshtin zoologjik, për dokumentarët që mund të kenë parë në televizion apo për ato që mund të kenë lexuar nga libra e revista. Pas bisedës mësuesja i fton të listojnë në një fletë, 3 -5 gjëra që u kanë ngelur në mëndje. I lexojnë në dyshe ato që kanë shkruar.<br>• Nxënësit lexojnë individualisht tekstin e dhënë .<br>• Duke u mbështetur edhe në bisedën që bënë në fillim dhe listimin e gjërave që u kanë ngelur në mëndje nga vizita në kopshtet zoologjike, nxiten nxënësit të bëjnë dy pyetje për punonjësin e kopshtit zoologjik dhe t'i shkruajnë ato në fisha. Pyetjet vendosen në "Tabelën e pyetjeve".<br>• Nxënësit do të shkruajnë mendimin e tyre për kopshtin zoologjik- u.2.<br>• Rishikim në dyshe-Pasi përfundojnë punën shkëmbejnë librat më njëri-tjetrin në dyshe dhe vlerësojnë punën e tyre.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
- Shkrimin për kopshtin zoologjik dhe pyetjeve rreth tij.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- bërjen e qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit dhe shpirtit krijues gjatë procesit të të shkruarit;
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 2 emra kafshësh që kë parë në kopshtin zoologjik dhe nga një pyetje për secilën .

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Në kopshtin zoologjik (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>nxënës, vizitoj, kopsht zoologjik, kafshë, punonjës i kopshtit,pyetje, mendime</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Paraqet me anë të një shkrimi të shpejtë kujdesin që do tregonin për kopshtin zoologjik.<br>• Shkruan një ngjarje me kafshë duke plotësuar modelin e dhënë.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Çfarë do të bënit ndryshe nëse do të kujdeseshit për kafshët e kopshtit zoologjik?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto të kafshëve të ndryshme, të kopshteve zoologjike, informacione dhe kuriozitete për to.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Mësuesja shtron pyetjen: Çfarë do të bënit ndryshe nëse do të kujdeseshit ju për kafshët e kopshtit zoologjik? Nxënësit plotësojnë një shkrim të shpejtë për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje. Ia lexojnë njëri-tjetrit shkrimet dhe më pas disa nxënës i lexojnë për gjithë klasën ato.</td></tr>
</table>

- Pas leximeve të shkrimeve të lira mësuesja i fton të punojnë ushtrimin 3 në libër.
- Ushtrimi 3 -Punë individuale. Shkruajnë një ngjarje me kafshë, duke plotësuar fjalitë e dhëna . Lexohen disa prej punëve nga nxënësit.
- Rishikim në dyshe-Pasi përfundojnë punën shkëmbejnë librat më njëri-tjetrin në dyshe dhe vlerësojnë punën e tyre.
- Bëhen korrigjime drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.

**Vlerësimi bëhet për:**

- shkrimin për kopshtin zoologjik dhe mendime rreth tij.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit;

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj 2 fjali për ndryshimet që do të bëje në kopshtin zoologjik të Tiranës.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Secili në vendin e tij! (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br><br>Bishti i gjarprit, koka e gjarprit<br>I vjen në majë të hundës ,u pengua, ulëriti, la veten ta udhëhiqte</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• Përcakton dy-tre tipare të fabulave.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Histori nga jeta e tyre kur kanë dëgjuar të tjerët dhe kanë gabuar.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** “lexim-mendim i drejtuar” diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja prezanton temën dhe kërkon nxënësit të bëjnë parashikim e përmbajtjes duke u mbështetur edhe në ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit. Këtë parashikim ia tregojnë shokut dhe gjithë klasës.
- Ajo udhëzon nxënësit për leximin e tekstit në paragrafë dhe në heshtje. Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme. Diskutojnë në dyshe për fjalët e reja, përmbajtjen dhe bëjnë parashikime për paragrafin ne vazhdim.
- Në përfundim të punimit të gjithë tekstit, u lihet kohë nxënësve ta rilexojnë pjesën.
- Lexohet pjesa zinxhir.
- Diskutohet në dyshe për llojin e tekstit të lexuar dhe 2-3tipare të tij . (fabul , personazhet kafshë, morali del në fund të saj)
- Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” radhitin fjalitë e dhëna sipas radhës së kryerjes së veprimeve.
- Shkëmbejnë librat në dyshe dhe vlerësojnë njëri-tjetrin .

**Vlerësimi bëhet për:**

- parashikimin e përmbajtjes së pjesës
- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të
- tregimin e llojit të pjesës
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Shkruaji të renditura drejt fjalitë tek rubrika “Lexoj dhe kuptoj”.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Secili në vendin e tij! (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Bishti i gjarprit, koka e gjarprit, i vjen në majë të hundës, u pengua, ulëriti, la veten ta udhëhiqte</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>Lexon pjesën me role<ul><li>Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.</li><li>Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.</li><li>Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.</li><li>Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve.</li><li>Jep gjykimin e vet në lidhje me problemin që trajton pjesa.</li></ul></td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Histori nga jeta e tyre që lidhet me mesazhin e pjesës .</td></tr>
</table>

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>libra me fabula, mjete shkrimi, fletë A4 | Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>– Të drejtat e njeriut<br>– Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lexim me role, diskutim, bisedë, punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja fton nxënësit t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit në dyshe rreth përmbajtjes së pjesës.
- Lexohet fabula sipas roleve: Bishti i gjarprit, koka e gjarprit, autori
- Interpretohet pjesa sipas roleve.
- Përshkruajnë me fjalë të thjeshta personazhet duke punuar në grup.
- Më pas të tregojnë përmbajtjen duke u mbështetur tek fjalitë e radhitura në rubrikën"Lexoj dhe kuptoj".
- Zhvillohet diskutim me gjithë klasën për rubrikën"Reflektoj". Konkretizojnë mesazhin e fabulës me shembuj nga jeta e tyre .

**Vlerësimi bëhet për:**

- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role
- përshkrimin e personazheve
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij të leximit rreth temës.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie** :Kopjo paragrafin e fundit dhe shkruaj komentin tënd.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore**<br>Përralla (ora e parë) | **Fjalë kyçe**<br>përrallë, hyrje, zhvillim, mbyllje |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan përrallën nisur nga disa ilustrime.<br>• Shkruan përrallën duke plotësuar modelin gjysmë të gatshëm.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit;<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një përralle duke parë figurat. |

| | |
|---|---|
| • Vlerëson punët e të tjerëve;<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4, libra me përralla | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Punë me gjithë klasën- Nxënësit shohin figurat dhe i komentojnë ato. Kujtojnë tri pjesët e përrallës: hyrja, zhvillimi dhe mbyllja .
  (Hyrja na paraqet personazhet , vendin dhe kohën e papërcaktuar. Zhvillimi tregon rrjedhën e ngjarjeve. Mbyllja tregon përfundimin e saj zakonisht të lumtur.)
- Punë individuale-Ushtrimi 1. Nxënësit individualisht shkruajnë secilën pjesë të përrallës duke u mbështetur tek figurat e dhëna dhe modeli gjysmë i gatshëm.
- Pas shkrimit të secilës pjesë, nxënësit lexojnë e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Lexohet në dyshe përralla e plotë pas përfundimit të saj.
- Me ndihmën e mësueses bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shkrimin e një përralle të thjeshtë nisur nga disa ilustrime
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj përrallën të plotë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Përralla (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>përrallë, hyrje, zhvillim, mbyllje | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan një përrallë të thjeshtë duke u mbështetur tek ilustrimet. | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një historie që u ka lënë mbresa. | |

| | |
|---|---|
| • Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve;<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Mjedisi<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia**: Pema e mendjes**,** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Punë individuale: Mësuesja i fton nxënësit të kujtojnë përrallën "Iriqi dhe mollët".
- Shohin figurat dhe në dyshe ia tregojnë njëri-tjetrit me gojë përrallën.
- Pastaj punojnë individualisht në fletore për shkrimin e saj duke patur parasysh pjesët e përrallës të diskutuara orën e kaluar (hyrja, zhvillimi, mbyllja) si dhe fjalët apo shprehjet që përdoren në fillim dhe në fund të përrallës.
- Shkëmbejnë fletoret dhe bëjnë vlerësimin e punës së njëri-tjetrit.
- Me ndihmën e mësueses bëhen qortimet e gabimeve drejtshkrimore**.**

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shkrimin e një përralle mbështetur tek figurat
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie**: Shkruaj një përrallë tjetër.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Në muzeun e dinozaurëve (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>dinozaur, muze e dinozaurëve, vizitorë kureshtje, Tiranozauri.<br>Brontozaur, Stegozaur Stirakozaur.<br>Prontozauri. | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për | | **Situata e të nxënit**<br>Çfarë dimë për dinosaurët? | |

| | |
|---|---|
| fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• Parashikon përmbajtjen e tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit;<br>• Tregon llojin e pjesës dhe karakteristika të saj.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Lidh pjesën që lexon me filma që ka pare për dinozaurët. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi, fletë A4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br><br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh-Çfarë dini për dinozaurët? Nxënësit thonë ato që dinë dhe shkruhen në tabelë nga mësuesja.
- Mësuesja i fton nxënësit të parashikojnë përmbajtjen e tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyçe të tekstit të cilat i shkruan në tabelë: dinozaur, muze i dinozaurëve, vizitorë, kureshtje.
- Ajo udhëzon nxënësit për leximin e tekstit në heshtje. Nxënësit nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe fjalitë që i duken më interesante, më të rëndësishme. Diskutojnë me njëri-tjetrin rreth përmbajtjes së tekstit.
- Tregojnë llojin e pjesës duke argumentuar me karakteristikat që i përkojnë tregimit.
- Lexohet pjesa zinxhir.
- Mësuesja fton në diskutim nxënësit për punimin e fjalorit .
- Në rubrikën“Lexoj dhe kuptoj“u përgjigjen pyetjeve.
- Duke u mbështetur në filmat që kanë parë për dinozaurët bëjnë një vizatim .

**Vlerësimi bëhet për:**

- leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante
- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet
- tregimin e llojit të pjesës
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

**Detyrë shtëpie**: Gjeni figura me dinozaur për të bërë një album në klasë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Në muzeun e dinozaurëve (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>dinozaur, muze e dinozaurëve, vizitorë kureshtje, Tiranozauri.<br>Brontozaur, Stegozaur Stirakozaur.<br>Prontozauri. |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Lidh pjesën që lexon me filma që ka pare për dinozaurët.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | **Situata e të nxënit**<br>Bërja e një albumi me lloje të ndryshme dinozaurësh |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>informacione nga interneti, foto, mjete shkrimi, fletë A4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lojë me role**,** Stuhi mendimesh, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Mësuesja i ka udhëzuar nxënësit të marrin informacione të ndryshme për dinozaurët dhe të gjejnë foto të tyre.

- Mësuesja organizon klasën në grupe treshe. Ajo ndan rolet në çdo grup(autori,Liza, babi i Lizës )dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës. Më pas nxënësit në treshe luajnë sipas roleve.
- Tregohet përmbajtja e pjesës në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Për pyetjet e rubrikës“Reflektoj“ nxënësit punojnë në grupe . Lexojnë dhe thonë informacione për dinozaurët dhe kohën kur kanë jetuar ata.
- Po sipas grupeve nxënësit bëjnë një album me foto. Çdo grup prezanton punën e tij duke e shoqëruar dhe me informacione të ndryshme që kanë diskutuar më parë .

**Vlerësimi bëhet për:**

- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij të leximit rreth temës.
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Respektojmë rregulla</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>muze kafshësh, i emocionuar, kureshtarë rregull, vizitë, bllok, interesant, zë i ulët, prek, sende të ekspozuara.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<ul><li>Tregon njohuritë paraprake që ka për rregullat në muze e bibliotekë.</li><li>Tregon disa rregulla që duhen zbatuar në muze e bibliotekë.</li><li>Krahason rregullat që duhen zbatuar në muze e bibliotekë.</li><li>Shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të tregimit.</li><li>Lidh pjesën e dëgjuar me përvojat e tij.</li><li>Bën gjykime të thjeshta rreth zbatimit të rregullave në ambiente publike.</li><li>Veçon disa detaje interesante (muzika që shoqëron rrëfimin, zëri i personazheve etj.) gjatë të dëgjuarit.</li></ul></td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Rregullat në ambiente të ndryshme.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<ul><li>njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga interneti</li></ul></td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia:Stuhi mendimesh, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<ul><li>Imagjinatë e drejtuar- mësuesja fton nxënësit të mbyllin sytë dhe të mendojnë sikur ndodhen në muzeun e çokollatave, ku po ju shfaqen shumë objekte ne forma të ndryshme të ndërtuara prej çokollate. Pasi hapin sytë mësuesja kërkon të përshkruajnë emocionet që përjetuan gjatë vizitës imagjinare në muzeun e çokollatës si dhe sjelljet e tyre gjatë kësaj vizite.</li><li>Mësuesja fton nxënësit të dëgjojnë historinë dhe u tërheq vëmendjen për të veçuar edhe detaje si muzikën që shoqëron rrëfimin, zërin e lexuesit etj.</li><li>Pasi dëgjohet pjesa thonë rregullat që mbajtën mend. Shtojnë edhe rregulla të tjera duke argumentuar domosdoshmërinë e tyre. Sjellin kuriozitete që dinë rreth muzeve të tillë.</li><li>Dëgjojnë rregullat që duhet të ndjekin në bibliotekë. Diskutohen raste nga jeta e tyre kur i kanë zbatuar apo jo ato. Mbajnë qëndrime e përcaktojnë detyra.</li><li>Duke përdorur diagramin e Venit nxënësit në dyshe shkruajnë cilat rregulla janë të përbashkëta dhe të veçanta në këto ambiente.</li><li>Mësuesja i fton nxënësit të listojnë disa rregulla që zbatojnë në shkollë, kinema, rrugë etj.</li></ul></td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**

- shprehjen e përjetimeve dhe emocioneve që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të tregimit.
- lidhjen e pjesës së dëgjuar me përvojat e tij
- bërjen e gjykimeve të thjeshta rreth tekstit.
- veçimin e disa detajeve interesante (muzika që shoqëron rrëfimin etj.) gjatë të dëgjuarit.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Kafshët dhe shpendët shtëpiakë | | **Fjalë kyçe**<br>kafshë, shpendë, kafshët shtëpiake, ushqim, kujdes, veteriner, strehë | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Dallon kafshët shtëpiake midis kafshëve të tjera.<br>• Diskuton për kujdesin që i nevojitet kafshëve shtëpiake.<br>• Krahason kafshët shtëpiake me kafshët e tjera.<br>• Përshkruan kafshën shtëpiake të preferuar.<br>• Pyet, përgjigjet dhe shpreh mendimet për kafshët shtëpiake.<br>• Shpreh ndjenjat dhe lidhjen që ka me këto kafshë.<br>• Përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit.<br>• Është aktiv në diskutime, në punë në grup.<br>• Shfaq iniciativë ose nxit të tjerët të bashkëbisedojnë për fshatin dhe qytetin. | | **Situata e të nxënit**<br>Diskutimi për kafshët shtëpiake. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>• njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>teksti mësimor, mjete shkrimi, fletë A4, informacione nga internet, foto të kafshëve, kafshë të cilat I mbajnë në shtëpi | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>- Të drejtat e njeriut<br>- Mjedisi<br>- Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Lapsat në mes, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Paraprakisht mësuesja i ka porositur nxënësit të gjejnë foto dhe informacione nga revistat, librat, interneti për kafshët shtëpiake. Nxënësit prezantojnë fotot dhe informacionet e marra. Nxiten nxënësit t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit.
- Ushtrimi1- Nxënësit punojnë në dyshe për këtë ushtrim. Ata tregojnë emrin e secilës kafshë.
- Ushtrimi 2-Duke diskutuar me gjithë klasën tregojnë kafshët që mund të mbahen në shtëpi. Shënojnë me shenjën e dhënë.
- Ushtrimi3-Diskutimi vazhdon për nevojat që kanë këto kafshë dhe kujdesin që kërkojnë ato.
- Ushtrimi 4-Për të gjetur ndryshimet dhe të përbashkëtat e kafshëve shtëpiake nga ato të egra nxënësit ndërtojnë diagramin e Venit duke punuar në dyshe. Mësuesja ndërton një diagram në tabelë me të dhënat që i japin nxënësit (ndryshimet ndërmjet tyre janë se për të parat kujdeset njeriu, ndërsa kafshët e egra nuk e kanë këtë kujdes, etj.)
- Lexohet situata dhe nxënësit lihen të lirë të hamendësojnë çfarë mund t'i ketë ndodhur Arbrit dhe thonë një këshillë për secilën nga situatat.
- Ushtrimi 5- Lapsat në mes. Mësuesja udhëzon nxënësit që në fillim të thonë llojin e kafshës, racën nëse ka, të përshkruajnë pamjen dhe në fund tregojnë argumentet se pse kanë bërë këtë zgjedhje. Pasi tregojnë me shokun pranë zgjedhjet e përshkrimin e tyre , nxënësit vendosin lapsin në mes të tavolinës . Pasi mbarojnë të gjithë pjesëtarët e grupit , mësuesja kap një laps të rastësishëm dhe I zoti I lapsit përshkruan kafshën që ka përzgjedhur.

**Vlerësimi bëhet për:**

- diskutimet, pyetjet, përgjigjet, shprehjet e mendimeve, ndjenjave dhe emocioneve për kafshët dhe shpendët shtëpiake
- përdorimin gjatë prezantimeve të tij edhe elemente të tilla si: foto kuriozitete
- përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit
- të qenit aktiv në diskutime, në punë në grup.
- shfaqjen e iniciativës ose nxitjes së të tjerëve të bashkëbisedojnë për fshatin dhe qytet

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br><br>A e dini se? (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Bletët ,insektet nektarin mjaltin. Koshere, bletërritës, pickoj, qeni, këlysh race<br>Gorillë, nëna të përkushtuara, foshnja e gorillës, e dashur, e dhembshur, pastron, e ushqen, e mbron, peshqit, luspa,pendë për të notuar, velëzat, peshkaqenët</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br><br>Informacione dhe kuriozitete për kafshët.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| • Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë.<br>• Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar duke iu përgjigjur pyetjeve.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, libra për kafshët, informacione nga interneti | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lojë, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve:**

Janë porositur nxënësit më parë që të sjellin kuriozitete për kafshët.

- Lojë-Punë në grup. Nxënësit në grupe zgjedhin të lexojnë një prej kurioziteteve të sjella . Ata e lexojnë pa ia thënë emrin e kafshës për të cilët bëhet fjalë. Grupet e tjera gjejnë kafshën për të cilën bëhet fjalë.
- Mësuesja prezanton temën e mësimit.

- Lihen nxënësit që të lexojnë pjesën me paragrafë. Nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe pjesët që i duken më interesante. Diskutojnë me njëri tjetrin rreth informacionit që lexojnë në çdo paragraf. Sqarohen fjalët e reja duke përdorur fjalorin.
- U lihet kohë ta rilexojnë për ta kuptuar më mirë.
- Lexohet pjesa zinxhir nga nxënësit sipas paragrafëve.
- Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj". U përgjigjen pyetjeve .

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e tekstit joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- përgjigjet e pyetjeve për përmbajtjen.
- nënvizimin e pjesëve më të rëndësishme ose pjesëve që i pëlqejnë më shumë .
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre

**Detyrë shtëpie**: Gjeni kuriozitete të tjera për këto kafshë.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br><br>A e dini se? (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Bletët, insektet nektarin mjaltin. Koshere, bletërritës, pickoj, qeni, këlysh race,<br>Gorillë, nëna të përkushtuara, foshnja e gorillës, e dashur, e dhembshur, pastron, e ushqen, e mbron, peshqit, luspa, pendë për të notuar, velëzat, peshkaqenët</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin joletrar.<br>• Tregon shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë.<br>• Lidh pjesën që lexon me ato që ka lexuar dhe me përvoja personale<br>• Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>• Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br><br>Informacione dhe kuriozitete për kafshët.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, libra për kafshët, informacione nga interneti</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br><br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim, Bisedë,Rrjet diskutimi, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Mësimi nis me leximin e detyrës që nxënësve iu dha në orën e mëparshme<br>• Punë në çift- Lexo përmblidh në dyshe- Nxënësit në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ata konfirmojnë ato që kanë mësuar një orë më parë por edhe kanë mundësi të përdorin lloje të ndryshme të të menduarit.<br>• Punohet rreth rubrikës “Reflektoj“. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të kësaj rubrike duke bërë lidhjen e pjesës me përvoja të tyre dhe me ato që kanë lexuar për këto kafshë .<br>• Punojnë individualisht për rubrikën “Shkruaj”. Nxënësit shkruajnë nga një fjali për gorillat, bletët, qentë, peshqit.<br>• Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.</td></tr>
</table>

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e tekstit joletrar
- leximin e tekstin joletrar.
- interesin dhe dëshirën për të lexuar pjesën.

**Detyrë shtëpie:** Shkruaj kuriozitete për kafshë të ndryshme.

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Diktim</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>diktim, rregulla drejtshkrimore, qortim,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Shkruan një tekst me të diktuar<br>• Përdor shenjat e pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë).<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe për emra të përveçëm.<br>• Shkruan në vetën dhe kohën e duhur foljet duke i përshtatur ato në fjali.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Diktimi</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- fletore, mjete shkrimi</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Stuhi mendimesh, Diskutim, Punë individuale,<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Stuhi mendimesh:Mësuesja fton nxënësit për të treguar rregullat drejtshkrimore që dinë .(fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalisë,shkronja e madhe për emrat e njerëzve, vendeve etj)<br>• Mësuesja dikton pjesën.<br>• Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësueses.<br>• Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar përsëri saktë .<br><br>Detyrë shtëpie: Mësoni dy paragrafët e fundit përmendësh nga pjesa “Secili në vendin e vet“ dhe bëjeni vetëdiktim.</td></tr>
</table>

# Moduli 7

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Kompjuteri dhe televizori** | **Fjalë kyçe**<br>Kompjuter, televizor, internet,filma vizatimorë, emisione për fëmijë |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Përqendrohet në çështjet kryesore, kur flet për kompjuterin dhe televizorin.<br>• Përshkruan emisionin e preferuar duke përzgjedhur fjalorin e duhur gjatë të folurit.<br>• Mban qëndrim ndaj veprimeve të veta dhe të shokëve në lidhje me kompjuterin dhe televizorin.<br>• Zbaton rregullat e të folurit gjatë punës në grupe të vogla<br>• Është aktiv në diskutime, në punë në grup. | **Situata e të nxënit**<br>Diskutime për<br>mënyrën se si ndikon kompjuteri dhe televizori në jetën e tyre të përditshme,<br>për interpretimin e tyre në lidhje me kohën që harxhojnë për kompjuterin e televizorin. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave<br>Të drejtat e njeriut<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metodologjia:** Stuhi mendimesh Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Vija e vlerës, Lapsat në mes, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh –Punohet në grup. Tre grupe në klasë do të shkruajnë mendimet e tyre për kompjuterin, ndërsa grupet e tjera do të shkruajnë për televizorin. Nxënësit shkruajnë ato që u vijnë në mëndje në lidhje me kompjuterin dhe televizorin. Prezantojnë punët e tyre para klasës.
- Mësuesja orienton nxënësit të lexojnë situatat e paraqitura në tekst. Diskutojnë në dyshe dhe me pas me gjithë klasën për pyetjet në tekst dhe pyetje të tjera që ato kanë në lidhje me situatat.
- Lapsat në mes: Për ushtimin1do të përdorët kjo teknikë me qëllim që nxënësit ta ndajnë kohën e diskutimit në mënyrë të drejtë.
- Ushtrimi 1-Diskutohet rreth pyetjeve në libër. Mësuesja i orienton të shprehen qartë me fjali të plota dhe jo të gjata duke u përqendruar tek çështjet kryesore. Ndalet në përshkrimin e disa prej lojërave që fëmijët luajnë në kompjuter.
- Ushtrimi 2, -Në këtë ushtrim do të flasin për rregullat që respektojnë gjatë kohës që kalojnë në kompjuter dhe televizion.
- Ushtrimi 3, -Nxënësit flasin rreth preferencave të tyre që lidhen me programet televizive.
- Vija e vlerës:Nxitet diskutim për të kaluar kohë më shumë në televizor apo me kompjuter. Nxënësit pozicionohen midis nxënësve që pëlqejnë e luajnë kryesisht me kompjuter dhe atyre që pëlqejnë televizionin sipas një vije imagjinare. Secili jep argumentet e tij dhe merr pozicionin që i përshtatet asaj që mendon.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- përqendrimin në çështjet kryesore, kur rrëfen kompjuterin dhe televizorin.
- zbatimin e rregullave të të folurit gjatë punës në grupe të vogla
- përzgjedhjen e fjalorit të duhur gjatë të folurit
- të qenit aktiv në diskutime, në punë në grup.
- shfaqjen e iniciativës për të bashkëbiseduar për kompjuterin dhe televizorin.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Tregim me ilustrime (ora e parë) | **Fjalë kyçe**<br>tregim, ilustrim, fjalë ndihmëse, radhë veprimesh, |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Rendit saktë pjesët e tregimit.<br>• Shkruan tregimin duke iu përgjigjur pyetjeve dhe duke përdorur fjalë ndihmëse.<br>• Shkruan tregime të thjeshta nisur nga disa ilustrime.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i një tregimi duke parë figurat. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Hartë koncepti, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Tryezë e rrumbullakët, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Nxënësit në grup ndërtojnë një Hartë koncepti për tregimin(tiparet e tregimit, pjesët e tregimit**).**
- Punë me gjithë klasën- Nxënësit shohin figurat dhe i komentojnë ato duke krijuar një ide paraprake për tregimin dhe për renditjen e duhur të pjesëve të tregimit.
- Punë individuale-Ushtrimi 1. Nxënësit në dyshe punojnë pyetjet për secilën pjesë dhe individualisht plotësojnë me fjalët ndihmëse çdo pjesë të tregimit. Diskutojnë në dyshe mënyrën e plotësimit, bëjnë qortimet e mundshme dhe në përfundim Vendosin numrat nga 1-4 sipas radhës së veprimeve. (Ushtrimi 2)
- Në grup lexohet zinxhir tregimi sipas numrave të vendosur.
- Tryezë e rrumbullakët:Shkruaj çfarë do t'i dërgoje me postë elektronike mamit nëse do ishte në vend të Dorianit. Nxënësit i përgjigjen pyetjes me shkrim. Ata i shkruajnë me radhë përgjigjet e tyre në fletë A4 të palosur në forme firzamonike. Lexojnë sipas grupeve përgjigjet e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shkrimin e një tregimi të thjeshtë nisur nga disa ilustrime
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie: Shkruaj nga një fjali për çdo paragraph të tregimit.**

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Tregim me ilustrime (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>tregim, ilustrim, fjalë ndihmëse, radhë veprimesh,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Shkruan tregime të thjeshta nisur nga disa ilustrime.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Shkrimi i një tregimi</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4,</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>• Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br><br>• Nxënësit në grup dyshe lexojnë detyrat e shtëpisë dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br>• Individualisht nxënësit kopjojnë tregimin. Mësuesja udhëzon nxënësit që kopjimin ta bëjnë sipas paragrafëve duke lënë kryeradhë në fillim të secilit prej tyre.<br>• Shkëmbejnë fletoret në dyshe dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.<br>• Mësuesja ka përgatitur ilustrime për një tregim tjetër (aq ilustrime sa grupe janë). I paraqet dhe diskutojnë rreth tyre. Sipas grupeve tërheqin me short njërin prej ilustrimeve dhe punojnë për të shkruar tregimin. Në fund përfaqësuesit e grupeve lexojnë tregimin e krijuar.<br>• Vlerësojnë punën e grupeve.<br>Vlerësimi bëhet për:<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>- shkrimin e një tregimi të thjeshtë nisur nga disa ilustrime<br>- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit<br>- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit<br>Detyrë shtëpie: Shkruani një tregim të shkurtër dhe ilustrime të thjeshta.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Historia e orës (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Orë, lavjerrës, shpik, matje e kohës</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth informacioneve që kanë sjellë për historinë e orës</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| • Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë pjesën<br>• Nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë.<br>• Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar duke iu përgjigjur pyetjeve.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tyre etj. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– foto, mjete shkrimi, fletëA4, informacione nga interneti<br>– lloje të ndryshme orësh | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Njohja e kulturave<br>Të drejtat e njeriut |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Bisedë, Punë në çift, Lexim i drejtuar, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh -Ora- Nxënësit punojnë në grupe dhe shkruajnë në fletë çfarë u vjen në mendje për orën. Grupet prezantojnë punën e tyre.
- Mësuesja prezanton temën dhe fton nxënësit të komentojnë figurat.
- Lexim i drejtuar: Lihen nxënësit që të lexojnë pjesën sipas paragrafëve. Nënvizojnë fjalët që nuk i kuptojnë dhe pjesët që i duken më interesante. Sqarohen fjalët e reja duke përdorur fjalorin. Mësuesja drejton pyetje për secilin paragraf.
- Lexohet pjesa zinxhir nga nxënësit sipas paragrafëve.
- Punohet ushtrimi 1 i rubrikës "Lexoj dhe kuptoj". Nxënësit në dyshe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e tekstit joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- pyetjet që bëjnë për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- përgjigjet e pyetjeve për përmbajtjen.
- nënvizimin e pjesëve më të rëndësishme ose pjesëve që i pëlqejnë më shumë.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Historia e orës** (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>Orë, lavjerrës, shpik, matje e kohës | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>- Lexon tekstin joletrar.<br>- Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;<br>- Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit.<br>- Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth informacioneve që kanë sjellë për historinë e orës | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– foto, mjete shkrimi, fletëA4<br>– lloje të ndryshme orësh | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Njohja e kulturave<br>Të drejtat e njeriut | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Imagjinatë e drejtuar, Lexo përmblidh në dyshe, Rrjet diskutimi, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Nxënësit ftohen nga mësuesja të imagjinojnë sikur orët nuk ekzistojnë dhe ata duhet të shkojnë në shkollë, në klubin e notit, në bibliotekë, etj. Më pas diskutojnë për zgjidhjet e mundshme në një situatë të tillë.
- Punë në çift - Lexo përmblidh në dyshe - Nxënësit në dyshe lexojnë çdo paragraf dhe e përmbledhin me 1-2 fjali. Ata konfirmojnë ato që kanë mësuar një orë më parë por edhe kanë mundësi të përdorin lloje të ndryshme të të menduarit.
- Punohet rreth rubrikës “Reflektoj“ Punë në grupe – Rrjet diskutimi-nxënësit do të diskutojnë rreth pyetjes: A është i rëndësishëm përdorimi i orës? Ata japin argumente për përgjigjen e pyetjes dhe diskutojnë për të dalë në një përfundim të përbashkët.
- Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- Leximin e tekstit joletrar.
- Tregimin e interesit dhe dëshirës për të lexuar;
- Ndarjen me të tjerët të përvojave të tij.
- Pranimin dhe respektin ndaj ideve të të tjerëve.

**Detyrë shtëpie:** Vizato orën që do doje të kishe.

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Plani ditor(ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>plan ditor, kohë , veprimtari,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• i përgjigjet pyetjeve për një plan të thjeshtë të regjimit ditor.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Studimi i grafikut të planit ditor</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4,</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Vendimmarrja morale</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
- **Metodologjia:** Hartë koncepti, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**
- Hartë koncepti: Nëpër grupe nxënësit ndërtojnë hartë koncepti për planin ditor (veprimtaritë që bëhen në pjesë të ndryshme të ditës, kohën, vendin etj).
- Prezantohet tema dhe punojnë në grupe dyshe për të kuptuar e zbërthyer grafikun për të dhënat që na tregohen nëpërmjet tij në ushtrimin1.
- Ushtrimi 2 bëhet individualisht. Nxënësit shkruajnë kohëzgjatjen e veprimtarive që bën djali duke iu përgjigjur pyetjeve me fjali të plota. Shkëmbejnë fletoret për të kontrolluar saktësinë e përgjigjeve dhe drejtshkrimin e tyre.
- Punë në grupe: Nxënësit kanë detyrë për t'i sugjeruar Eneas veprimtari të tjera dhe kohëzgjatjen e tyre. Prezantojnë punët me shkrim sipas grupeve.

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- përgjigjet e pyetjeve për një plan të thjeshtë të regjimit ditor.
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie: Shkruaj veprimtaritë që bën ti ndryshe nga Enea**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Plani ditor (ora e dytë)** | | **Fjalë kyçe**<br>plan ditor, kohë , veprimtari, | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Harton një plan të thjeshtë të regjimit ditor.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Plani ditor | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4, | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Vendimmarrja morale | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
- **Metodologjia:** Tryezë e rrumbullakët Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**
- Tryezë e rrumbullakët: Nxënësit vendosen në mënyrë rrethore. Secili nxënës shkruan njërën prej veprimtarisë ditore që pëlqen dhe kohën e saj. Hapet letra në formën e fizarmonikës dhe lexohen në grup.
- Ushtrimi 3 punohet individualisht . Nxënësit ngjyrosin grafikun sipas veprimtarive që bëjnë. Mund të shtojnë veprimtari të tjera përveç atyre të dhëna në model. Plotësojnë fjalitë për grafikun e tyre. Shkëmbejnë fletoret për të kontrolluar saktësinë e përgjigjeve dhe drejtshkrimin e tyre.
- Ushtrimi 4 lihet detyrë shtëpie për tu plotësuar ditë pas dite.

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- hartimin e planit ditor
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Njëra pas tjetrës(ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Pafajësi, sinqeritet</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit .<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për :<br>mënyrën se si ata e kuptojnë pjesën,<br>interpretimin e tyre në lidhje me me ngrënien e çokollatave,<br>mënyrën se si ata e bëjnë lidhjen e pjesës me jetën e tyre të përditshme,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi fletë A4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi<br>Bashkëjetesa paqësore</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimi**,** Lexim i drejtuar, Bisedë, Ditari dypjesësh, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

Veprimtaritë e nxënësve
- Mësuesja drejton pyetjen: A ju pëlqejnë çokollatat? Nxënësit diskutojnë përgjigjen e pyetjes me shoku që kanë pranë dhe pastaj me gjithë klasën.
- Prezantohet tema e mësimit. Shohin figurën e tekstit, përshkruajnë dhe komentojnë në dyshe.
- Lexim i drejtuar: mësuesja fton nxënësit të lexojnë pjesën sipas paragrafëve. Për secilin paragraf nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe fjalë e fjali që u pëlqejnë .Mësuesja drejton pyetje për secilin paragraf. Bëjnë parashikime për përmbajtjen e paragrafit pasues.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”në të cilën nxënësit zgjedhin përgjigjen e saktë tek alternativat për brendinë e pjesës.
- Ditari dypjesësh – Nxënësit kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën e cila u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje, nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre .

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- komentin për ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit
- lidhjen pjesën që lexon me përvoja nga jeta e vet.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Njëra pas tjetrës** (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>Pafajësi, sinqeritet | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin sipas roleve.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhin.<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë për :<br>mënyrën se si ata e kuptojnë pjesën,<br>interpretimin e tyre në lidhje me ngrënien e çokollat-ave,<br>mënyrën se si ata e bëjnë lidhjen e pjesës me jetën e tyre të përditshme, | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi fletë A4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi<br>Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lexim në role, Rrjet diskutimi, Bisedë, Punë individuale, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësimi fillon me bisedën rreth cilësive të personazhit. Nxënësit demonstrojnë me pjesë nga teksti ku tregohen ato cilësi.
- Mësuesja organizon klasën në grupe. Ajo ndan rolet në çdo grup (dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës). Më pas nxënësit në treshe lexojnë/luajnë sipas roleve.
- Nxënësit tregojnë brendinë e pjesës me fjalët e tyre. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Rrjet diskutimi-A duhet të hamë shumë çokollata?-nxënësit argumentojnë përgjigjet e tyre pro / kundër dhe diskutojnë deri sa bien në një mendim të përbashkët.
- Në dyshe nxënësit diskutojnë rreth pyetjes së rubrikës "Reflektoj".

**Vlerësimi bëhet për:**

- bashkëpunimin në grupe dhe vlerësimin e njëri-tjetrit
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit
- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin të tekstit
- ndarjen me të tjerët të përvojave rreth leximit
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e tekstit
- mendimet që jep rreth tekstit
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet

**Detyrë shtëpie:** Rubrika "Shkruaj"

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Numërorët (ora I) | | **Fjalë kyçe**<br>Numëror, shkruaj me fjalë, | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Dallon numërorët 1-20 si fjalë që tregojnë sasi.<br>• Shkruan numërorët me fjalë në fjali.<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup | | **Situata e të nxënit**<br>Lojë me numërorë | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4,etiketa me numërorë me fjalë | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare** | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lojë**,** Diskutim, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Lojë: Loja e kungulleshkave. Nxënësit luajnë me“ Lojën e kungulleshkave“. Në mes të çdo grupi janë etiketat me numërorë aq sa janë anëtarët e grupit. Ata zgjedhin një etiketë me numëror. Luhet loja për 5-6 min.
- Ushtrimi 1. Nxënësit lexojnë numërorët e me ndihmën e mësueses arrijnë në konkluzionin se fjalët që tregojnë numra quhen numërorë. Ata bëjnë përgjithësime
  për shkrimin e numërorëve deri në 20 (numrat: dy, tre, katër, njëzet shkruhen pa –ë në fund , të tjerët shkruhen me –ë në fund)
- Ushtrimi 2-Nxënësit shkruajnë me fjalë numërorët e dhënë me numra në fjali.
- Tryezë e rrumbullakët: Secili nxënës i grupit shkruan nga një fjali ku të ketë përdorur të paktën një numëror. Qortojnë njëri-tjetrin pasi lexojnë të gjitha fjalitë e grupit të tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- dallimin e numërorëve 1-20 si fjalë që tregojnë sasi.
- shkrimin e numërorëve me fjalë në fjali.
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- Respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup

**Detyrë shtëpie: Shkruaj tri fjali duke përdorur numërorët 1-20.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Numërorët (ora II) | | **Fjalë kyçe**<br>Numëror, shkruaj me fjalë, | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Dallon numërorët 1-20 si fjalë që tregojnë sasi.<br>• Shkruan numërorët me fjalë në fjali.<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime; | | **Situata e të nxënit**<br>Ushtrime manipuluese me numërorë. | |

| | |
|---|---|
| • Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nx-ënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4,etiketa me numërorë me fjalë | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare** |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Lojë, Diskutim,Shkëmbe një problemë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Punë në grupe: Nxënësit grupojnë mjete të ndryshme shkrimi në tavolinë dhe bëjnë një grafik për numrin e tyre. Ata shkruajnë me fjalë numërorin përkatës.

| Mjetet | Numri/numërori që tregon numrin e tyre |
|---|---|
| | |
| | |

Prezantojnë punën e tyre.

- Ushtrimet 3, 4. Nxënësit plotësojnë një tabelë të ngjashme me atë që plotësuan në grup. Shkëmbejnë librat e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.
- Shkëmbe një problemë:Nxënësit sipas grupeve shkruajnë 2-3 fjali ose një tekst të shkurtër ku të përdorin sa më shumë numërorë. Shkëmbejnë fletët me grupet fqinjë dhe nënvizojnë numërorët. Vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- dallimin e numërorëve 1-20 si fjalë që tregojnë sasi.
- shkrimin e numërorëve me fjalë në fjali.
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- Respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup

**Detyrë shtëpie: Shkruaj tri fjali duke përdorur numërorët 1-20.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**A e ka fajin pasqyra?** (ora e parë) | **Fjalë kyçe**<br>Pasqyrë, lyrë, stepem, përqesh, |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon vjershën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë vjershën.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së vjershës.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për vjershën. | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë :<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë vjershën,<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me mënyrën e të ngrënit,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi fletë A4 | Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Veprimtaria e leximit të drejtuar, Ditari dypjesësh**,** Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja prezanton temën e vjershës dhe nxit mendimet e nxënësve në lidhje me përmbajtjen e saj. Shohin figurën e tekstit; e përshkruajnë dhe komentojnë në dyshe.
- Veprimtaria e leximit të drejtuar. Mësuesja udhëzon nxënësit për leximin e vjershës strofë pas strofe. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe vargun(fjalinë) që u pëlqejn më shumë. Mësuesja drejton pyetje rreth përmbajtjes dhe kërkon të bëjnë parashikime për strofën tjetër.
- Diskutohet për llojin e tekstit(vjershë) dhe 2-3 karakteristika të tij(strofa, vargje, rimë)
- Lexohet vjersha zinxhir sipas strofave.
- Shënojnë më shenjat e vërtetë, e gabuar fjalitë tek rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Shkëmbejnë librat e vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e vjershës dhe shënimet që mban *për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.*
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë vjershën.
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për vjershën.

**Detyrë shtëpie: Të mësojnë vjershën përmendësh.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| **Tema mësimore**<br>**A e ka fajin pasqyra?** (ora e dytë) | **Fjalë kyçe**<br>Pasqyrë, lyrë, stepem, përqesh, |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur vjershën.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e vjershës.<br>• Interpreton role vjershën.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë :<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë vjershën,<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me mënyrën e të ngrënit,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi, fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lojë me role, Lexo përmblidh në dyshe**,** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**
- Lexohet vjersha nga të gjithë nxënësit nëpërmjet leximit zinxhir. Recitojnë vjershën.
- Lexo përmblidh në dyshe: Njëri nxënës lexon një strofë dhe tjetri e përmbledh me
- 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për strofën në vazhdim. Plotësojnë tabelën:

| Strofa | Fjalia përmbledhëse |
|---|---|
| I | .................................. |

- Nxënësit tregojnë brendinë e vjershës me fjalët e tyre.
- Harta e personazhit për Tosin. Nxënësit shkruajnë dy cilësi për Tosin dhe ilustrojnë me pjesë nga teksti cilësitë e shkruara.
- Punohet rubrika “Reflektoj”.
- Mësuesja e ndan klasën në grupe me nga tre nxënës. Ndan rolet dhe nxënësit interpretojnë vjershën sipas roleve.

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e rrjedhshëm dhe me intonacionin të vjershës
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazhit
- tregimin e brendisë duke respektuar strukturën e vjershës
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e vet

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Lojë në tryezë (ora e parë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Shkrin gazit, prishet mendja,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë :<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën,<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me fantazinë e Lolës në këtë pjesë<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Diskutim, Lexim i drejtuar, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Mësuesja fton nxënësit të imagjinojnë sikur janë ulur në tavolinë për të ngrënë dhe mami ka gatuar ushqimin e tyre të preferuar. Nxënësit tregojnë ç’panë me sytë e mendjes.</td></tr>
</table>

- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.
- Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.
- Diskutohet për llojin e tekstit (tregim ) dhe 2-3 karakteristika të tij (personazhe realë, ngjarje që mund të ndodhin në jetën e përditshme etj)
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj" ku nxënësit shënojnë përgjigjen e saktë.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Lojë në tryezë (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>klub noti, ndeshje me porta në ujë, mbështet, pushime,</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin sipas roleve.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Tregon se cilët janë personazhet e preferuara.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë :<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën,<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me sjelljen në tryezë<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: Lojë në role, Diskutim, Rrjeti i diskutimit, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>- Mësuesja organizon klasën në grupe. Ajo ndan rolet në çdo grup (dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës). Më pas nxënësit në treshe luajnë sipas roleve.<br>- Ata tregojnë për personazhin që u pëlqen më shume duke argumentuar preferencën e tyre.<br>- Tregohet përmbajtja në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.<br>- Rrjet diskutimi për pyetjen e parë të rubrikës "Reflektoj". Nxënësit ndajnë me njëri-tjetrin mendimin rreth pyetjes duke e argumentuar atë. Në fund ata dalin në një përfundim të përbashkët për përgjigjen.<br>- Punohen edhe pyetjet e tjera të rubrikës "Reflektoj".<br>- Plotësohet rubrika "Shkruaj".<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.</td></tr>
</table>

- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e përmbajtjes
- lojën me role
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Numërori | **Fjalë kyçe**<br>Numërori, si fjalë e vetme, -ë fundore |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>- Shkruan me fjalë numërorët 1-20.<br>- Përdor saktë numërorët në fjali.<br>- Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>- Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>- Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i numrit të sendeve ,objekteve në klasë |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4, | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare** |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Diskutim, Shkrim i shpejtë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Punë në dyshe: mësuesja i udhëzon nxënësit që të bëjnë inventarin e mjeteve mësimore dhe objekteve që ndodhen në klasë. Nxënësit vëzhgojnë ambientin e klasës dhe punojnë për detyrën e përcaktuar. Prezantojnë punën e ndalet diskutimi tek drejtshkrimi i numërorëve.
- Punohen ushtrimet 1-4 në libër individualisht dhe në dyshe shkëmbehen librat për të vlerësuar punën e njëri-tjetrit
- Ushtrimi1-Nxënësit shkruajë numërorët me fjalë. Lexohet rregulla e shkrimit të tyre.
- Ushtrimi 2-Plotësojnë tekstin me numërorin që duhet.
- Ushtrimi3-U përgjigjen pyetjeve duke shkruar me fjalë numërorin.
- Ushtrimi 4 –Korrigjohen gabimet tek shkrimi i numërorëve
- Shkrim i shpejtë: Shkruhen sa më shumë numërorë me fjalë në një kohë të limituar të cilën e përcakton mësuesja. Nxënësit në dyshe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shkrimin drejt të numërorëve
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- Respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup

**Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Dua syze (ora e parë)** | **Fjalë kyçe**<br>Syze, okulist, shndrit |
| | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për teksti | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me funksionin dhe përdorimin e syzeve,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto, mjete shkrimi, fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh me gjithë klasën- Mësuesja paraqet në foto lloje të ndryshme syzesh. Ajo shkruan në tabelë mendimet e nxënësve.
- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.
- Më pas lexohet pjesa me paragrafë. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.
- Diskutohet për llojin e tekstit (tregim) dhe 2-3 karakteristika të tij (personazhe realë, ngjarje që mund të ndodhin në jetën e përditshme etj)
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Punohet rubrika "Lexoj dhe kuptoj". Diskutohen pyetjet rreth përmbajtjes.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Dua syze** (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>Syze, okulist, shndrit | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Interpreton pjesën në role.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet e pjesës.<br>• Tregon se cilët janë personazhet e preferuara. | | **Situata e të nxënit**<br><br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me funksionin dhe përdorimin e syzeve,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |

| | |
|---|---|
| • Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto, mjete shkrimi, fletëA4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lexim në role, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja organizon klasën në grupe. Ajo ndan rolet në çdo grup (dhe kërkon nga nxënësit të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës). Më pas nxënësit në treshe lexojnë/luajnë sipas roleve.
- Tregohet përmbajtja e pjesës. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Ata tregojnë për personazhin që u pëlqen më shume duke argumentuar preferencën e tyre.
- Diskutim për pyetjet e rubrikës“Reflektoj“. Nxënësit ndajnë me njëri-tjetrin përvoja nga situata të ngjashme (zgjidhja e situatës ndryshe).

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e përmbajtjes
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij
- interpretimin në role

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Frutat (ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>Fruta, vitamina, fruta të thata, lëndë minerale, energji | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë pjesën<br>• Nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë.<br>• Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar duke iu përgjigjur pyetjeve.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tyre etj. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me vlerat e frutave,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me këtë temë<br>rreth informacioneve që kanë sjellë për frutat. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto,mjete shkrimi, fletë A4<br>- fruta të ndryshme | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave<br>Të drejtat e njeriut | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Bisedë, Pyet sërish, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja paraqet foto, një video (2 minuta) ku paraqiten fruta të ndryshme.
- Mësuesja i fton nxënësit të komentojnë foton/videon.
- Prezantohet tema e mësimit. Udhëzohen nxënësit për leximin e pjesës me paragrafë.(çdo pjesëz mund të trajtohet si paragraf) Pyet sërish: nxënësit lexojnë tekstin me paragrafë. Diskutojnë në dyshe: njëri nxënës bën pyetje rreth informacioneve në tekst. Nxënësi tjetër i përgjigjet pyetjeve. Në paragrafin tjetër ndërrojnë rolet.
- Lexohet pjesa zinxhir nga nxënësit sipas paragrafëve.
- Punohet rubrika"Lexoj dhe kuptoj". Nxënësit shënojnë me shenjat përkatëse fjalitë e sakta dhe të gabuara.
- Nxënësit lexojnë informacionet që kanë sjellë për frutat.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e tekstit joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- pyetjet që bëjnë për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.
- përgjigjet e pyetjeve për përmbajtjen.
- nënvizimin e pjesëve më të rëndësishme ose pjesëve që i pëlqejnë më shumë .
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre

**Detyrë shtëpie: Shkruaj emrat e frutave që të pëlqejnë.**

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Frutat (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Fruta, vitamina, fruta të thata, lëndë minerale, energji</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon tekstin joletrar duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së tekstit ose rreth fjalëve të panjohura për të.<br>• Rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë pjesën<br>• Nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë.<br>• Tregon që e ka kuptuar tekstin e lexuar duke iu përgjigjur pyetjeve.<br>• Lidh pjesën që lexon me përvoja nga jeta e tyre etj.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me vlerat e frutave,<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me këtë temë<br>rreth informacioneve që kanë sjellë për frutat.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave<br>Të drejtat e njeriut</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Bisedë, dy të vërteta dhe një gënjeshtër, Diagram Veni, Lexo përmblidh në dyshe, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Dy të vërteta dhe një gënjeshtër.- Nxënësit punojnë individualisht për 2-3 minuta dhe shkruajnë dy të vërteta dhe një gënjeshtër për frutat. Në dyshe diskutojnë për të gjetur të vërteta dhe gënjeshtrat.
- Lexo përmblidh në dyshe: Njëri nxënës lexon një paragraf dhe tjetri e përmbledh me 1-2 fjali. Ndërrohen rolet për paragrafin në vazhdim. Plotësojnë tabelën:

| Paragrafi | Fjalia përmbledhëse |
|---|---|
| I | ................................. |

- Punohet rubrika "Reflektoj". Nxënësit në grupe do të krahasojnë një nga çiftet e frutave të dhënë në këtë rubrikë duke i paraqitur në Diagram Veni. Prezantojnë punën para klasës dhe tregojnë vlerat e secilës frutë. Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- leximin e tekstit joletrar
- interesin dhe dëshirën për të lexuar pjesën.
- lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre .

**Detyrë shtëpie:** Rubrika "Shkruaj" **.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Fjalë me kuptim të njëjtë ose të përafërt**<br>**(ora e parë)** | | **Fjalë kyçe**<br>fjalë me kuptim të njëjtë, fjalë me kuptim të përafërt, sinonime**,** | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shoqëron fjalët sinonime në një grup fjalësh të dhëna<br>• Gjen fjalë sinonimike për një grup fjalësh të dhëna<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup | | **Situata e të nxënit**<br>Lojë fjalësh me fjalë sinonime. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4,figura për fjalë që kanë sinonime | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br>- Metodologjia: Lojë ,Diskutim, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve**<br>• Lojë : Mësuesja fton nxënësit në lojë fjalësh. Paraqet me figurë një send objekt,veprim dhe nxënësit thonë me radhë nga një emërtim të ndryshëm. Loja zhvillohet midis 2 nxënësve. Fiton ai që thotë sa më shumë fjalë. | | | |

- Prezantohet tema e mësimit. Nga studimi i rastit të dhënë në libër dhe i rasteve të tjera nga loja, dilet në rregullën e shkruar.
- Ushtrimet 1, 2. Nxënësit punojnë në libër për të lidhur fjalët e dhëna sipas kuptimit të afërt apo të ngjashëm në ushtrimin 1 dhe gjejnë fjalë sinonimike me fjalët e dhënë në ushtrimin 2. Shkëmbejnë librat e kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.
- Tryezë e rrumbullakët: Secili nxënës shkruan nga një çift me fjalë sinonime në letrën e palosur në formë fizarmonike dhe pasi përfundojnë lexojnë çiftet e sinonimeve.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shoqërimin e fjalëve sinonime në një grup fjalësh të dhëna
- gjetjen e fjalëve sinonimike për një grup fjalësh të dhëna
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup

**Detyrë shtëpie: Gjej 3 çifte fjalësh sinonime.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Fjalë me kuptim të njëjtë ose të përafërt (ora e dytë)** | | **Fjalë kyçe**<br>fjalë me kuptim të njëjtë, fjalë me kuptim të përafërt, sinonime, | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Gjen fjalë sinonimike për një grup fjalësh të dhëna.<br>• Zëvendëson në një tekst disa fjalë me sinonimet e tyre .<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | | **Situata e të nxënit**<br>Gjetja e fjalëve sinonime | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4, figura për fjalë që kanë sinonime | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:**Shkrim i shpejtë**,** Diskutim,Shkëmbe një problemë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Shkrim i shpejtë: Mësuesja fton nxënësit të shkruajnë sa më shumë fjalë sinonime.
- Lexohen fjalët e shkruara.
- Ushtrimet 3,4 Nxënësit punojnë në libër për të gjetur fjalët sinonime më fjalët e ngjyrosura në tekstin e dhënë në ushtrimin3. Ngjyrosin fjalët sinonime me të njëjtën ngjyrë në ushtrimin 4. Shkëmbejnë librat e kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.
- Shkëmbe një problemë:Secili grup shkruan 5 fjalë që kanë sinonime. I shkëmben me grupin fqinjë dhe gjejnë sinonimet e fjalëve. Vlerësojnë punën e grupeve fqinje.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- gjetjen e fjalëve sinonimike për një grup fjalësh të dhëna
- zëvendësimin në një tekst të disa fjalëve me sinonimet e tyre
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup

**Detyrë shtëpie: Gjej nga fjalori i gjuhës shqipe fjalë sinonime. (Me ndihmën e prindërve)**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Këshillat e zonjës Mollë (ora e parë)** | | **Fjalë kyçe**<br>Llupës, zonja mollë, kripëra minerale, muskuj, yndyrat | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me kujdesin për një të ushqyer të shëndetshëm<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- materiale nga interneti, foto, mjete shkrimi,fletëA4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Imagjinatë e drejtuar,Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja prezanton temën dhe fton nxënësit të mendojnë rreth saj. Diskutohen në grup dhe me gjithë klasën mendimet e nxënësve. Vërehet dhe komentohet në dyshe figura e tekstit.
- Udhëzohen nxënësit për leximin e pjesës me paragrafë.(çdo pjesëz mund të trajtohet si paragraf) Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u pëlqejnë më shumë. Pyet sërish: nxënësit lexojnë tekstin me paragrafë. Diskutojnë në dyshe: njëri nxënës bën pyetje rreth informacioneve në tekst. Nxënësi tjetër i përgjigjet pyetjeve. Në paragrafin tjetër ndërrojnë rolet.
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa në heshtje për ta kuptuar më mirë.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Punohen dhe diskutohen pyetjet e rubrikës "lexoj dhe kuptoj".

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.

| |
|---|
| - tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.<br>- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet. |

<table>
<tr><th>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</th><th>Lënda<br>Gjuha shqipe</th><th>Klasa 2</th><th>Data</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Këshillat e zonjës Mollë (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Llupës, zonja mollë, kripëra minerale, muskuj,yndyrat</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me kujdesin për një të ushqyer të shëndetshëm<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- materiale nga interneti, foto, mjete shkrimi, fletëA4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>Metodologjia: lojë në role, lexo-përmblidh në dyshe, Imagjinatë të drejtuar, Rrjet diskutimi, Diskutim, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>- Mësuesja orienton nxënësit për një „Imagjinatë të drejtuar”- ata mendojnë me sy mbyllur sikur kanë takuar zonjën Mollë dhe po bisedojnë me të. Disa prej nxënësve do të tregojnë bisedën që kanë bërë me zonjën Mollë.<br>- Vazhdohet me një„lexim-përmblidhje në dyshe“ të tekstit. Plotësohet tabela për çdo këshillë të zonjës Mollë:<br><br><table><tr><td>Këshillat e zonjës Mollë</td><td>Fjalia përmbledhëse</td></tr><tr><td>I</td><td>.................................</td></tr></table><br>- Mësuesja organizon klasën në grupe dyshe. Ajo ndan rolet në çdo grup dhe improvizon një takim të personazhit më zonjën Mollë dhe bisedën e tyre. Më pas nxënësit në dyshe luajnë sipas roleve.<br>- Rrjet diskutimi për pyetjen e rubrikës“Reflektoj“. Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre dhe bien dakord për një përgjigje të përbashkët<br><br>Vlerësimi bëhet për:<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>- Leximin rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur të tekstit.<br>- Mendimet e argumentuara rreth tekstit<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij</td></tr>
</table>

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Ndodhi personale | | **Fjalë kyçe**<br>ndodhi personale, laptop, videoprojektor, klasë, teknologji | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore<br>• me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>**Diskutimi i një ndodhie personale** | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Shkrim i lirë, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Rrjet diskutimi, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Shkrim i lirë- Mësuesja i fton nxënësit të kujtojnë histori të tyre që kanë lidhje me teknologjinë (laptop, kompjuter, lojëra elektronike etj). I tregojnë shokëve në dyshe për to. Shkruajnë 2-3 fjali rreth saj.
- Prezantohet tema e mësimit dhe nxënësit lexojnë shkrimin e Leas. Mësuesja i drejton nxënësit të vërejnë pjesët e strukturës së ngjarjes (hyrja-paragrafi i parë; zhvillimi-paragrafi i dytë, mbyllja –paragrafi i tretë) Diskutojnë e rikujtojnë karakteristikat e secilës pjesë të strukturës së ngjarjes. Pastaj diskutojnë për përmbajtjen e saj.
- Në ushtrimin e dytë nxënësit shtojnë dy rregulla për ushqimin. Shkëmbejnë librat dhe qortojnë gabimet drejtshkrimore.
- Rrjet diskutimi:Mësuesja shkruan ne tabelë pyetjen:"Duhet të përdorim laptopin dhe videoprojektorin në orën e mësimit?" Shkruajnë përgjigjet e tyre në dyshe dhe shtojnë dhe përgjigjet e shokëve nëse kanë argumente shtesë. Në fund të diskutimit dalin në një mendim të përbashkët.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- hartimin e planit ditor
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie: Shkruaj një ndodhi të ngjashme më 3-4 fjali.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Ndodhi personale | | **Fjalë kyçe**<br>ndodhi personale, laptop, videoprojektor, klasë, teknologji | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan histori e përvoja personale<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Ndodhi në klasë | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4,<br>- laptop dhe videoprojektor | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br><br>• **Metodologjia:** Shkrim i shpejtë, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>**Veprimtaritë e nxënësve**<br>Shkrim i shpejtë: Nxënësit shkruajnë përse e pëlqejnë përdorimin e videoprojektorit gjatë orës së mësimit me 1-2 fjali.<br>Ushtrimi 3, shkruajnë dy fjali në lidhje me përdorimin e teknologjisë në klasë dhe vazhdojnë me ushtrimin 4, në të cilin shkruajnë për një ditë kur është përdorur kompjuteri në klasën e tyre. Shkëmbejnë fletoret me njëri-tjetrin dhe qortojnë gabimet drejtshkrimore. Diskutojnë nëse janë ndjekur rregullat e strukturës së shkrimit të një ngjarjeje nga shokët.<br>**Vlerësimi bëhet për:**<br>- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.<br>- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit<br>- shkrimin e një ndodhie personale<br>- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit<br>- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit<br>**Detyrë shtëpie: Shkruaj një ndodhi të ngjashme me 5 fjali.** | | | |

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Fjalë me kuptim të kundërt (ora e parë)** | | **Fjalë kyçe**<br>fjalë me kuptim të kundërt,antonime | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shoqëron fjalët antonimike në një grup fjalësh të dhëna<br>• Gjen antonimet për një grup fjalësh të dhëna<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup | | **Situata e të nxënit**<br>Lojë fjalësh me fjalë antonimike. | |

| **Burimet dhe materialet didaktike** | **Lidhja me fushat e tjera** |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4,figura për fjalë që kanë sinonime | Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** Lojë, Diskutim, Tryezë e rrumbullakët, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Lojë : Mësuesja fton nxënësit në lojë fjalësh. Paraqet me figurë një send objekt,veprim dhe nxënësit thonë me radhë antonimin e tyre. Loja zhvillohet midis 2 nxënësve. Fiton ai që gjen më shpejtë antonimin.
- Prezantohet tema e mësimit. Nga studimi i rastit të dhënë në libër dhe i rasteve të tjera nga loja, dilet në rregullën e shkruar.
- Ushtrimet 1, 2. Nxënësit punojnë në libër për të lidhur fjalët e dhëna sipas kuptimit të kundërt në ushtrimin 1 dhe gjejnë fjalë antonimike me fjalët e dhënë në ushtrimin 2. Shkëmbejnë librat e kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.
- Tryezë e rrumbullakët: Secili nxënës shkruan nga një çift me fjalë antonimike në letrën e palosur në formë fizarmonike. Pasi përfundojnë lexojnë çiftet e antonimeve.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shoqërimin e fjalëve antonimike në një grup fjalësh të dhëna
- gjetjen e fjalëve antonimike për një grup fjalësh të dhëna
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime;
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve;
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup

**Detyrë shtëpie: Gjej 3 çifte fjalësh antonimike.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Fjalët me kuptim të kundërt(ora e dytë)** | | **Fjalë kyçe**<br>fjalë me kuptim të kundërt, antonimet | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Gjen fjalë antonimike për një grup fjalësh të dhëna.<br>• Zëvendëson në një tekst disa fjalë me antonimet e tyre .<br>• Demonstron pavarësi në mendime dhe veprime.<br>• Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.<br>• Respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup. | | **Situata e të nxënit**<br>Gjetja e fjalëve antonimike | |

| Burimet dhe materialet didaktike | Lidhja me fushat e tjera |
|---|---|
| - njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nx-ënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4,figura për fjalë që kanë sinonime | Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:**Shkrim i shpejtë**,** Diskutim,Shkëmbe një problemë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Shkrim i shpejtë: Mësuesja fton nxënësit të shkruajnë sa më shumë fjalë antonimike. Lexojnë në dyshe çiftet e fjalëve.
- Ushtrimet 3,4 Nxënësit punojnë në libër për të gjetur fjalët antonimike me njëra-tjetrën..
- Në ushtrimin4 plotësojnë fjalëkryqin duke shkruar antonimet e fjalëve të dhëna. Shkëmbejnë librat e kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.
- Shkëmbe një problemë:Secili grup shkruan 5 fjalë që kanë antonime. I shkëmben me grupin fqinjë dhe gjejnë sinonimet e fjalëve. Vlerësojnë punën e grupeve fqinjë.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- gjetjen e fjalëve antonimike për një grup fjalësh të dhëna
- zëvendësimin në një tekst të disa fjalëve me antonimet e tyre
- demonstrimin e pavarësisë në mendime dhe veprime
- demonstrimin e besimit dhe vullnetit në arritjen e rezultateve
- respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup

**Detyrë shtëpie: Gjej 2 çifte antonimesh e krijo fjali me to.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Shëndeti i mbretit (ora e parë)** | | **Fjalë kyçe**<br>Mbret, dembel, njeri i mençur,pasuri, shëndet | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.<br>• I përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | | **Situata e të nxënit**<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me shëndetin e tepërt, aktivitetin fizik<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- material nga internet, foto, mjete shkrimi, fletëA4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Lexim i drejtuar, Ditari dypjesësh, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Prezantohet tema e mësimit. Shohin figurën e tekstit, përshkruajnë dhe komentojnë në dyshe atë.
- Mësuesja fton nxënësit të bëjnë parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet e tekstit dhe fjalët kyçe.
- Lexim i drejtuar: Mësuesja fton nxënësit të lexojnë pjesën sipas paragrafëve. Për secilin paragraf nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe fjalë e fjali që u pëlqejnë. Mësuesja drejton pyetje për secilin paragraf dhe nxit nxënësit të bëjnë parashikime për përmbajtjen e paragrafit pasues.
- Diskutojnë për ndryshimet nga parashikimi që bënë.
- Punohet me fjalorin për të kuptuar fjalët e reja.
- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Punohet rubrika “Lexoj dhe kuptoj”në të cilën nxënësit zgjedhin përgjigjen e saktë tek alternativat për brendinë e pjesës.
- Ditari dypjesësh – Nxënësit kopjojnë në njërën anë të tabelës pjesën e cila u ka pëlqyer apo që u ka bërë përshtypje, nga ana tjetër shkruajnë komentin e tyre.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.
- tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin.
- tregon se e ka kuptuar brendinë duke dhënë përgjigjet e duhura.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin

<table>
<tr><td>Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi</td><td>Lënda<br>Gjuha shqipe</td><td>Klasa 2</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore<br>Shëndeti i mbretit (ora e dytë)</td><td colspan="2">Fjalë kyçe<br>Mbret, dembel, njeri i mençur,pasuri, shëndet</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur tekstin.<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet.<br>• Tregon se cilët janë personazhet e preferuara.<br>• Tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Jep mendime rreth tekstit duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit<br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata e kuptojnë pjesën<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me shëndetin e tepërt, aktivitetin fizik<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- foto, mjete shkrimi, fletëA4</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare<br>Mjedisi, Të drejtat e njeriut</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Lexohet pjesa zinxhir sipas paragrafëve.
- Punë në dyshe "Harta e personazheve". Nxënësit shkruajnë dy cilësi për personazhet dhe pjesët ilustruese nga teksti për secilën cilësi. Përcaktojnë personazhin e preferuar duke shpjeguar zgjedhjen e tyre.
- Prezantojnë punët e tyre dhe i diskutojnë me gjithë klasën.
- Tregohet përmbajtja në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin për mënyrën e të treguarit.
- Diskutim për pyetjet e rubrikës"Reflektoj".
- Nxënësit duke diskutuar me njëri-tjetrin bëjnë lidhjen e pjesës me përvoja nga jeta e tyre.
- Diskutohet me gojë kërkesa e rubrikës"Shkruaj". Kjo detyrë do punohet me shkrim në shtëpi.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e përmbajtjes
- përshkrimin e personazheve;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Rosak topolaku (ora e parë)** | **Fjalë kyçe**<br>Rosak topolak, skenë, teatër kukullash, aktorë,imito |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së pjes*ë*s<br>- tregon shkurtimisht përmbajtjen e historisë duke e ilustruar me detaje nga dëgjimi<br>- shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të tregimit<br>- veçon detaje interesante gjatë të dëgjuarit tyre.<br>- shfaq vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave. | **Situata e të nxënit**<br><br>Dëgjimi/shikimi i një pjese teatrale. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi, fletë A4 | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** stuhi mendimesh, diskutim, punë në çift,punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

Stuhi mendimesh- teatër kukullash- nxënësit do japin mendimet e tyre të cilat mësuesja i shkruan në një organizues grafik në tabelë.

Veprimtari me gjithë klasën- Mësuesja fton nxënësit të shikojnë e dëgjojnë pjesën teatrale "Rosak topolaku". (nëse nuk ka mundësi për ta dëgjuar ose parë të incizuar pjesën, mësuesja ua lexon atë) Ajo i tregon nxënësve se pasi pjesa të mbarojë do të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj.

Punohet U. 1,2. Pyetjet e ushtrimit 2 nxënësit do i diskutojnë në fillim në dyshe dhe pastaj me gjithë klasën.

Pasi i përgjigjen pyetjeve rreth përmbajtjes do të tregojnë shkurtimisht ngjarjen duke shprehur edhe emocionet që përjetuan gjatë dëgjimit.

Në dyshe e më pas me gjithë klasën, nxënësit diskutojnë rreth pyetjeve të ushtrimit 3,4.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së teatrit
- tregimin shkurtimisht të përmbajtjes së teatrit duke e ilustruar me detaje
- shprehjen e përjetimeve dhe emocioneve që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të teatrit
- veçimin e detajeve interesante gjatë të dëgjuarit tyre.
- Shfaqjen e vullnetit dhe besimit gjatë kryerjes së detyrave

Mënyrën e bashkëpunimit në grup dhe vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit .

**Detyrë shtëpie:** Mësuesja u ndan rolet nxënësve dhe tekstin të cilin duhet të interpretojnë. Ata do përgatiten për interpretimin e pjesës.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Rosak topolaku** | | **Fjalë kyçe**<br>Rosak topolak, skenë, teatër kukullash, aktorë, imito | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>- interpreton në role pjesën<br>- shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të tregimit<br>- veçon detaje interesante gjatë të dëgjuarit tyre.<br>- shfaq vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave. | | **Situata e të nxënit**<br>Interpretimi i pjesës teatrale. | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- informacione nga interneti, foto,mjete shkrimi, fletë A4 | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Vendimmarrja morale<br>Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

- **Metodologjia:** lojë më role, diskutim, bisedë, punë në çift,punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Bëhet dëgjimi i pjesës së parë të tregimit. Diskutohet rreth ndjesisë që nxënësit përjetuan gjatë dëgjimit të saj.(zërat e personazheve; muzika që shoqëron këto zëra etj)ndalet te përmbajtja e pjesës që dëgjuan. Diskutohet rreth përmbajtjes së pjesës. Një grup nxënësish do të interpretojnë pjesën e parë të teatrit.
- Vazhdohet kështu me të gjithë pjesët e tjera deri në fund.

**Vlerësimi bëhet për:**

- përgjigjet e pyetjeve rreth përmbajtjes së teatrit
- tregimin shkurtimisht të përmbajtjes së teatrit duke e ilustruar me detaje
- shprehjen e përjetimeve dhe emocioneve që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të teatrit
- veçimin e detajeve interesante gjatë të dëgjuarit tyre.
- Shfaqjen e vullnetit dhe besimit gjatë kryerjes së detyrave

Mënyrën e bashkëpunimit në grup dhe vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit .

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Gjëegjëza për ushqimet (ora e parë)** | | **Fjalë kyçe**<br>Gjëegjëza,fruta, pipiruq, cipëhollë | |

| Rezultatet e të nxënit | Situata e të nxënit |
|---|---|
| • Lexon gjëegjëzat duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjëra që i duken interesante.<br>• Tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë gjëegjëzat.<br>• Gjen përgjigjet për secilën gjëegjëzë.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin. | Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata i kuptojnë gjëegjëzat<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me vlerat e frutave<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>– njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– material nga internet, foto, mjete shkrimi, fletë A4<br>– libra me gjëegjëza | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Mjedisi<br>Të drejtat e njeriut |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Diskutim, Stuhi mendimesh, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh-gjëegjëza-Mësuesja fton nxënësit të japin mendime për gjëegjëzat. Mendimet e tyre shkruhen në tabelë në një organizues grafik.
- Mësuesja prezanton temën dhe udhëzon nxënësit të lexojnë gjëegjëzat një e nga një. Gjatë leximit nxënësit nënvizojnë fjalët e reja dhe pjesët që u bëjnë përshtypje më shumë. Diskutojnë në dyshe për përgjigjen e gjëegjëzës, duke treguar fjalën, fjalinë që u ndihmoi ta gjenin. Tregojnë përgjigjet në grup e më pas me gjithë klasën. I shkruajnë ato në tekst.
- Nxënësit në dyshe do të tregojnë gjëegjëza. Njëri tregon dhe tjetri gjen përgjigjen. Ndërrojnë rolet.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shënimet për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante gjatë leximit.
- lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.
- pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin

**Detyrë shtëpie: Shkruaj një gjëegjëzë, por jo përgjigjen e saj.**

| Fusha<br>Gjuhët dhe komunikimi | Lënda<br>Gjuha shqipe | Klasa 2 | Data |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>**Gjëegjëza për ushqimet** (ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>Gjëegjëza, fruta, pipiruq, cipëhollë | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur gjëegjëzat.<br>• Gjen përgjigjet për gjëegjëzat.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet.<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstin.<br>• Shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën e mësuesit.<br>• Jep mendime rreth gjëegjëzave duke i argumentuar ato.<br>• Lidh pjesën me përvoja nga jeta e vet | | **Situata e të nxënit**<br><br>Duke ndërvepruar me tekstin nxënësit diskutojnë:<br>rreth mënyrës se si ata i kuptojnë gjëegjëzat<br>rreth interpretimit të tyre në lidhje me vlerat e frutave<br>rreth gjykimeve për ngjarje nga jeta e përditshme që lidhen me temën. | |

| Burimet dhe materialet didaktike | Lidhja me fushat e tjera |
|---|---|
| – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– teksti mësimor<br>– foto, mjete shkrimi, fletëA4 | Artet, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Mjedisi<br>Të drejtat e njeriut |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Lojë, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Mësuesja kërkon të këmbejnë fletoret e detyrave të shtëpisë. Duhet të lexojnë gjëegjëzën që shoku ka shkruar në shtëpi dhe të gjejnë përgjigjen e saj duke treguar se çfarë i ndihmoi për të gjetur atë përgjigje.
- Mësuesja shpërndan nëpër grupe një fletë A 4 ku ka shkruar 2-3 gjëegjëza. Nxënësit diskutojnë në grup për zgjidhjen e tyre. Më pas, u tregojnë gjithë klasës si është përgjigjja për gjëegjëzat dhe si e gjetën atë përgjigje.
- Nxënësit do të krijojnë gjëegjëza për një frutë që i pëlqen. Ata do mendojnë dy cilësi që ka ai frut, do i shkruajnë ato dhe do këmbejnë fletët me njëri tjetrin. Nxënësit i tregojnë gjëegjëzat e tyre në grup dhe më pas me gjithë klasën.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- tregimin e përmbajtjes
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|

| Tema mësimore | Fjalë kyçe |
|---|---|
| Diktim | **drejtshkrim, diktim shkronjë e madhe, shenjë pikësimi, ndarje në fund të rreshtit, numërorët,** |

| Rezultatet e të nxënit | Situata e të nxënit |
|---|---|
| • Shkruan një tekst me të diktuar<br>• Përdor shenjat e pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë).<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë.<br>• Përdor drejt shkronjën e madhe për emra njerëzish, vendesh.<br>• Ndan saktë fjalët në fund të rreshtit<br>• Shkruajnë saktë numërorët.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses. | Shkrimi i një pjese me të diktuar |

| Burimet dhe materialet didaktike | Lidhja me fushat e tjera |
|---|---|
| – njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>– fletore , mjete shkrimi | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimesh, Diskutim, Punë individuale**,**

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimesh:Mësuesja fton nxënësit për të treguar rregullat drejtshkrimore që dinë. (ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalisë,shkronja e madhe për emrat e njerëzve, vendeve, shkrimin e numërorëve etj)

- Mësuesja dikton pjesën.
- Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësueses.
- Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar përsëri saktë **.**

**Detyrë shtëpie:** Mësoni 2 fjali përmendësh nga pjesa "Shëndeti i mbretit " dhe bëjeni vetëdiktim.

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Pushimet verore(ora e parë) | | **Fjalë kyçe**<br>tregim, ilustrim, fjalë ndihmëse, radhë veprimesh**,** | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan një kartolinë sipas një modeli të dhënë<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i kartolinës për pushimet verore | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4, kartolina | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi<br>Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Stuhi mendimi, Tryezë e rrumbullakët, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.

**Veprimtaritë e nxënësve**

- Stuhi mendimi-Kartolina: nxënësit punojnë në grupe për të shkruan ato që u vijnë në mëndje për kartolinën. Lexojnë punët e tyre sipas grupeve.
- Ftohen nxënësit të shohin e komentojnë figurën.
- Ushtrimi 1- Lexojnë modelin e dhënë të kartolinës dhe në dyshe diskutojnë për strukturën e shkrimit të kartolinës.
- Ushtrimi 2-Nxënësit shkruajnë një kartolinë për Kaltrinën. Mësuesja i udhëzon të shkruajnë sipas strukturës së kartolinës së dhënë në ushtrimin e mësipërm.
- Shkëmbejnë librat e diskutojnë për punën e njëri-tjetrit në dyshe.
- Tryezë e rrumbullakët: Nxënësit shkruajnë me radhë tek një fletë në formën e fizarmonikës urime që shkruhen në kartolina. Lexohen sipas grupeve punët e shokëve.

**Vlerësimi bëhet për:**

- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shkrimin e një kartoline
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie: Shkruaj një kartolinë për pushimet verore.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Pushimet verore(ora e dytë) | | **Fjalë kyçe**<br>tregim, ilustrim, fjalë ndihmëse, radhë veprimesh**,** | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Shkruan një kartolinë për pushimet verore.<br>• Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore<br>• me ndihmën e mësueses.<br>• Shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të të shkruarit.<br>• Respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit.<br>• Vlerëson punët e të tjerëve.<br>• Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. | | **Situata e të nxënit**<br>Shkrimi i kartolinës për mbarimin e vitit shkollor | |
| **Burimet dhe materialet didaktike**<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- teksti mësimor<br>- mjete shkrimi, Fletë A4, kartolina | | **Lidhja me fushat e tjera**<br>Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi,<br>**Lidhja me temat ndërkurrikulare**<br>Të drejtat e njeriut<br>Mjedisi<br>Bashkëjetesa paqësore | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

**Metodologjia:** Shkrim i lirë, Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.
**Veprimtaritë e nxënësve**

- Shkrim i lirë –Pushimet:Nxënësit u lihet kohe 5-10 minuta për të shkruar sa me shumë për pushimet verore ose dimërore. Lexojnë punët e tyre në dyshe. Vlerësojnë njëri-tjetrin.
- Ushtrimi 3-Nxënësit shkruajnë një kartolinë për shokun/shoqen. Mësuesja i udhëzon të shkruajnë sipas strukturës së kartolinës së dhënë në ushtrimin e parë.
- Shkëmbejnë librat e diskutojnë për punën e njëri-tjetrit në dyshe.

**Vlerësimi bëhet për:**
- mënyrën e bashkëpunimit në grupe.
- vlerësimin që i bëjnë nxënësit njëri-tjetrit
- shkrimin e një kartoline
- bërjen e qortimeve të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.
- shfaqjen e besimit, vullnetit gjatë procesit të të shkruarit
- respektimin e rregullave drejtshkrimore gjatë të shkruarit

**Detyrë shtëpie: Shkruaj një kartolinë për pushimet.**

| **Fusha**<br>Gjuhët dhe komunikimi | **Lënda**<br>**Gjuha shqipe** | **Klasa 2** | **Data** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore**<br>Lexim jashtëklase<br>**(sipas zgjedhjes së mësueses)** | | **Fjalë kyçe** | |
| **Rezultatet e të nxënit**<br>• Lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj**.** **(sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesja)**<br>• Përcakton dy-tre tipare të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive. | | **Situata e të nxënit**<br>Leximi i librave jashtëklase | |

<table>
<tr>
<td>• sipas pjesës që do ketë zgjedhë mësuesja)<br>• Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferu-ara.<br>• Tregon interes dhe dëshirë për të lexuar.<br>• Shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit<br>• Ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit<br>• Pranon dhe tregon respekt ndaj ideve të të tjerëve për tekstet që lexojnë.</td>
<td></td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet dhe materialet didaktike<br>- njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit<br>- libra jashtëklase</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br><br>• Metodologjia: Diskutim, Bisedë, Punë në çift, Punë në grup, Punë me gjithë klasën.<br>Veprimtaritë e nxënësve<br>• Prezantimi i titullit të librit dhe autori .<br>• Leximi i pjesës.<br>• Pyetje për llojin e pjesës dhe brendinë e saj.<br>• Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.<br>• Tregimi i brendisë së pjesës.<br>• Personazhet dhe cilësitë e tyre.<br>• Mesazhi që përcjell pjesa.<br>• Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.<br>• Ilustrim i pjesës me vizatim.<br>Vlerësimi bëhet për rezultatet që u arritën gjatë kësaj ore.<br><br>Shënim: Disa rubrika të kësaj ore nuk janë plotësuar, pasi ato ndryshojnë në varësi të pjesës që do zgjedhë mësuesja për të punuar.</td>
</tr>
</table>

# Projekti 3 (4 orë)

<table>
<tr><th colspan="6">PLANIFIKIMI METODIK I PROJEKTIT</th></tr>
<tr><td>Titulli i projektit</td><td colspan="2">Teatri u kukullave<br>“Keci që s’bëri detyrat”<br>1 orë gjuhë shqipe<br>(Të lexuarit)</td><td colspan="2">Kohëzgjatja</td><td>1 orë gjuhë shqipe<br>(Të lexuarit)</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Lënda: Gjuha shqipe</td><td rowspan="2"></td><td rowspan="2">Mësuesi:</td><td colspan="2"></td><td>1 orë gjuhë shqipe<br>(Të lexuarit)</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td><td>1orë gjuhë shqipe<br>(Të folurit)</td></tr>
<tr><td>Lidhja fushat e tjera:</td><td colspan="3">Artet, Teknologji dhe Tik, Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Klasa:</td><td>E dytë</td></tr>
<tr><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td>Ideja e projektit</td><td colspan="5">Fëmijët pëlqejnë të lexojnë libra e të shohin teatër me kukulla. Kështu që bashkohen këto dy pjesë (libri dhe teatri) në një projekt që do jetë nxitje e mëtejshme për të lexuar dhe për tu argëtuar duke krijuar . Në këtë projekt nxënësit përdorin aftësitë hulumtuese për të kërkuar e gjetur pjesë nga librat që kanë lexuar aftësitë krijuese për t’i përshtatin e për t’i interpretuar në një teatër kukullash .</td></tr>
<tr><td>Ngjarjet hyrëse që frymëzojnë kërkimin dhe angazhimin e nxënësve</td><td colspan="5">Dëshira për tu argëtuar duke marrë kënaqësi nga leximi, nga shfaqjet për fëmijë (teatri i kukullave dhe shfaqje të tjera) shfrytëzohen si nxitje për zotërimin e disa kompetencave.</td></tr>
<tr><td rowspan="4">Kompetencat kyçe që zhvillohen</td><td>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.</td><td>x</td><td colspan="2">Kompetenca personale</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Kompetenca e te menduarit</td><td>x</td><td colspan="2">Kompetenca qytetare</td><td>x</td></tr>
<tr><td>Kompetenca e të nxënit</td><td>x</td><td colspan="2" rowspan="2">Kompetenca digjitale</td><td rowspan="2">x</td></tr>
<tr><td>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.</td><td>x</td></tr>
<tr><td rowspan="4">Temat e njohurive kryesore lëndore të cilat do të rimerren në sajë të projektit</td><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td></td></tr>
</table>

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Rezultatet e të nxënit | • pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të .<br>• nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme<br>• ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit<br>• shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, u përgjigjet pyetjeve<br>• pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij<br>• demonstron siguri, kur flet në klasë<br>• përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit<br>• lidh pjesën që lexon me përvoja personale<br>• luan me role pjesën<br>• paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimet e tij;<br>• demonstron pavarësi në mendime dhe veprime;<br>• demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;<br>• respekton përpjekjet individuale dhe ato në grup | | | | |
| Metodologjia | (Individuale, në grup ose e gjithë klasa) | Diskutim | x | Hulumtim | x |
| | | Bisedë | x | | x |
| | | Punë në grup | x | | |
| | | Lexim I drejtuar | x | | |
| | | Lojë me role | x | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| Burimet e nevojshme | Njerëzit e përfshirë | Mësuesi, nxënësit, prindërit, | | | |
| | Mjetet: | maska për personazhet,bllok shënimesh,foto videoprojektor, karton letër, lapustila, CD, magnetofon, skenë e improvizuar | | | |
| | Materiale dhe burime | libra për fëmijë ,libri: " Kush e hëngri akulloren?" filmime nga shfaqje me kukulla | | | |
| | | | | | |
| Pyetja kërkimore | Si mund të luajmë teatër për kukulla? | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përmbledhja e çështjeve, investigimi, kërkimi dhe zgjidhja e problemit. | Mësuesja i ka udhëzuar nxënësit të marrin informacione në lidhje me teatrin e kukullave dhe pjesë nga këto shfaqje.<br>**Gjuhë shqipe**<br>• Nxënësit kanë sjellë libra dhe në videoprojektor shfaqen pjesë të ndryshme nga shfaqje për kukulla. Nxitet diskutimi për librat dhe teatrin e kukullave. Analizohen librat dhe shfaqjet me kukulla Përgjatë diskutimeve mësuesja e orienton diskutimin tek lidhja e këtyre dy gjinive me njëra-tjetrën.<br>• Lexohet përralla në vargje “Keci që s’bëri detyrat” . Nëpërmjet leximit të drejtuar diskutohet përmbajtja e kësaj përralle dhe fjalët e reja.<br>• Nxënësit të ndarë nëpër grupe me aq nxënës sa janë edhe personazhet e përrallës ndajnë rolet (autori, keci, dhia Shytë,baba Cjapi, mama dhia, pula , viçi, zogu etj) dhe përgatiten duke e lexuar sipas roleve përrallën .<br>• Secili nxënës e mëson përmendësh dhe ta interpretojë pjesën e tij të rolit. Bëhen shumë prova në të cilat nxënësit përmirësojnë lojën e tyre në role.<br>• Me ndihmën e prindërve bëhet e mundur improvizim I një skene,  përgatitja e maskave të personazheve të përrallës dhe vija melodike që do të shoqërojë shfaqjen<br>• Të ftuar janë prindër, mësues e drejtues të shkollës dhe nxënës të klasave të tjera.<br>• Jepet shfaqja .<br>• U jepet mundësi nxënësve të përgatisin intervista të shkurta për shokët e tyre.<br>• Nëpërmjet intervistave të thjeshta “aktorët” dhe spektatorët e shfaqjes pyeten për personazhin që interpretuan, lojën në role, lidhjen e kësaj pjese me jetën e tyre mesazhin e shfaqjes. | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| Produktet kryesore | Në grup: | Teatri i kukullave”Keci që s’bëri detyrat” | | | | | | |
| | Individualisht | Loja e personazhit të tyre | | | | | | |
| Vendi dhe pjesëmarrësit e prezantimit | | x | | | | | | |
| | Klasë | x | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| Vlerësimet | Vlerësimet formuese (Gjatë projektit) | Vlerësimi bëhet për;<br>- interpretimin e rolit që kanë<br>- gjykimin argumentet idetë rreth temës.<br>- shprehjen saktë dhe kuptueshëm të mendimit.<br>- bashkëpunimi në grup | | | | | | |
| | Vlerësime përmbledhëse (Në fund të projektit) | Realizimin e teatrit të kukullave | | | | | | |
| | | | | Vlerësim i prindërve | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| Buxheti | Buxheti i detajuar Përse? Nga kush? | | | Në bashkëpunim me prindërit mund të shpenzohet një fond prej 2000 lekësh për blerjen e materia-leve të ndryshme dhe letrave, ta-bakëve dhe lapus-tilave me ngjyra për maskat dhe skenën. | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

“Keci që s’bëri detyrat”
Doli dielli, hyri hëna..
-Cohu, kecush!-i thotë nëna
-Cohu gjumash!- i thotë babi.
Keci s tundet nga krevati.
Ora për shkollë afrohet,
keci nis e ankohet:
-O lele po më dhëmb gishti,
më dhemb veshi,
më dhemb.... bishti!
U nxeh cjapi mjekërhollë:
-Shpejt, dembel,
nisu në shkollë!
Nisi keci prapë ankimet:
-Si të shkoj, s’kam bërë mësimet!
Ju s’e dini se c’pësoi,
qe mësimet s’i mësoi.
Unë e di, në dëshironi,
ktheni fletën ta mësoni....
Nëna dhi e shqetësuar,
Mjekë Shyten ka njoftuar.
Erdhi mjekja,djersë e tëra,
me ilace, me gjilpëra.
Pas vizitës, mjekja tha:
-Kec Larushi dhembje s’ka,
një sëmundje tjetër del.
Me sa duket, është dembel.
Dje, si hëngri dreken,
edhe ëmbëlsirën,
na u mbyll në dhomë
të bënte detyrën.
Penën shpejt e kapi,
fletoren e hapi,
hapi abetaren,
celi dhe dritaren.
Ndoshta s’i mësohet
se erdhi pranvera,
pa i ikën mendja
në kodra në ferra.

Ngaqë nuk i rrihej,
detyrën sa nisi,
i bëri dy njolla,
dy faqe i grisi...
Ja, përtej dritares,
ulur mbi një tel,
na paska qëndruar
një zog harabel.
Sa e pa, kecushit
i qeshi fytyra:
“Do të ve harabelin të më bëjë detyrat”.
-Hyr brenda, pse rri jashtë?
Kam dëshire të lozim bashkë.
-Ci,ci,ci ti e di, s’mund të lozim ne tani.
Ule kokën, lexo, shkruaj, bëj mësimet, pastaj luajm’!
-Harabel-o, ci,ci,ci, a m’i bën detyrat ti?
Harabeli u zemërua:
-S’të vjen turp, kështu c’më thua?!
Rrahu krahët u largua...
Nën dritare shkon një vic.
- Vic,o vic, mu,mu,mu, eja lozim tok këtu!
-Kec i vogël, ti e di, s’mund të lozim ne tani.
Ule kokën, lexo, shkruaj,
bë mësimet, pastaj luajm’!
- O vicok, të kam shok,
a mi bën detyrat sot?
Edhe vici u zemërua:
-S’të vjen turp, kështu c’më thua?!
Nxitoi këmbët u largua...
Në oborr, mbi një shul,
qenka ulur, gjyshja pule.
I thotë keci pulës-gjyshe:
-Fute këmbën pak në shishe...
-Ka,ka,ka c’janë këto?!
Shume poshtë veten e ule,
pranon shkrim me këmbë pule?
-Nëse s’shkruan dot me këmbë,
zgjate sqepin shkul një pendë!
Shkul një pende nga më të mirat
edhe shpejt më bej detyrat!
Gjyshe pula u zemërua:
-S’të vjen turp, kështu c’më thua?!
Kot po lutesh, o kecush,
detyrat s’t’i bën askush!....
Erdhi mbrëmja pa kuptuar,
keci ngeli pa mësuar.
Pasi,priti, priti shumë,
hëngri darkën,
ra në gjumë.
Tak-tak-tak!- dera troket,
mendon keci: “Kush të jetë?!”
-Jam postieri, hape shpejt,
sjell një zarf me tri vula:
“Harabeli”, “Vici”, “Pula”.
Keci zarfin shpejt e mori,

mua letrën nuk ma nxori.
Unë prita, u vonova,
po dot letrën s'e lexova.
Ende nuk e kam mësuar.... .....
Kush e di....
Çfarë i kane shkruar?!

# ROSAK TOPOLAKU

- **Mami Rosakut:** - Ky është liqeni, liqeni ku do të pushojmë ne, vogëlushi im i dashur.
- **Rosak topolaku:** - O sa qejf o mama do të notojmë së bashku në liqen do të thahemi në diell, do bëjmë lodra në rërë.
- **Mami:** - Do të luajmë, veç duhet të kesh mendjen të mos largohesh shumë nga unë, është hera e parë që del nga foleja dhe krahët nuk të janë forcuar akoma
- *rosaku* – po pse moj mama unë tani u rrita
- **Mami:** – Je akoma i vogël, I vogël dhe akoma i pa ditur.
- *Rosaku* –Mama çfarë duhet të di unë që të quhem i ditur?
- **Mami:** – Shumë e shumë gjëra rosaku im i vogël, sot ti nuk di as se cili je vetë.
- *Rosaku* – e di moj mama si se di unë jam rosak topolaku
- **Mami:** - po mirë a mund të më thuash ti, sa sy, sa këmbë, sa krahë, sa pupla shumëngjyrëshe ke, ë.. rosak?
- *Rosaku* po mirë mi thuaj ti mama sa sy, sa këmbë sa krahë kam
- **Mami:** - Eja këtu zogu im i vogël ti ke dy sy ,dy krahë të vegjël,dy këmbë topolake e shumë e shumë pupla të bukura
- *Rosaku* - unë kam dy sy, dy këmbë, dy krahë e shumë pupla. Shiko mama sa shpejt i mësova ë.. tani jam i ditur apo jo
- **Mami:** – po kur u bërë kaq i ditur ti, ti sapo mësove disa gjëra për veten tënde rosak
- *Rosaku* – urra-urra unë jam i ditur, jam i ditur
- **Mami:** - Mos fol marrëzira rosak dhe mos u largo shumë nga liqeni; më dëgjon, unë po gatuaj drekën
- *Rosaku* – Mirë mami shko, -( rosaku këndon) "jam rosaku topolaku kam dy sy, dy krahë dhe dy këmbë, kam pupla ngjyrë të arta natyrisht kam dhe një nënë, sa shumë di, sa shumë di - jam rosaku topolaku e kam mendjen si flori" (vjen breshka)
- *Breshka* – rosak, mos u frikëso rosak topolak nuk më njeh, po jam unë, jam breshka, breshka mo breshka
- *Rosaku* – eh breshka eh tani mund të them se unë e dija që më parë se ti je breshka e si mos e dija kur unë jam i ditur shumë
- *Breshka* – eja këtu! Një vogëlush si ti nuk duhet të mburret shumë
- *Rosaku* – po pse ou po unë jam i ditur di për shembull se ti je breshka e se ke dy sy, dy këmbë dy krahë e shumë pupla
- *Breshka* – ah ç'më bërë të qesh me gjithë shpirt more rosak topolak. vetëm në ëndërr mund të shohësh një breshkë të tillë me krahë e me pupla hë, mëso shumë i dituri rosak, rosak topolak se unë kam dy sy katër këmbë dhe një zhguall, ja zhguall apo samar si i thonë ndryshe; e kuptove tani
- *Rosaku* – e mirë e kuptova e… tani besoj se mësova më shumë e… vetëm rosat e rosakët kanë dy sy dy krahë dy këmbë e shumë pupla kurse të tjerët , dale, breshka paska zhguall mirë mirë e kuptova e kuptova
- *Breshka* – e.. e.. ky rosak duhet të mësojë shumë, do ti them mikut tim iriqit ti bëjmë një lojë për kokë të lojës për shembull… jo jo do të shkoj vetë të bisedoj me iriqin po nga të shkoj ah jo jo hë mo nga të shkoj më thoni, ja ja po shkoj këndej
- *Rosaku - he*..e.. tani, tani di shumë gjëra ( rosaku këndon) "breshka breshka e shëmtuar katër këmbë dhe një zhguall sa i ditur jam mak-mak-mak mendje
  ndrituri rosak"
- *Lepurushi* (vjen pa pritur ) gol.. i
- *Rosaku* – hë mo se më trembe kush je ti
- *Lepurushi* ha- ha ha unë jam lepurushi këmbë era dhe e di pse më thonë kështu sepse unë vrapoj u..u..u

si era

- *Rosaku* – o pse mi thua gjithë këto, unë e dija që je lepurushi këmbëera edhe s'ka si mos e dija kur unë jam i ditur shumë
- *Lepurushi* – ha-ha ashtu ë.. po mirë na thuaj ndonjë gjë të mençur që di kjo koka jote
- *Rosaku* - posi po ja ti je lepurushi dhe quhesh këmbëera
- *Lepurushi* – po, se ta thashë unë
- *Rosaku* – dhe ke dy sy dhe katër këmbë dhe ke një si zhguall apo si i thonë ndryshe samar
- *Lepurushi* – ha ha ç'më bëre të mbaj barkun me dorë ha ha ha
- *Rosaku* – mos fol kështu se pastaj të zemërohem unë
- *Lepurushi* – po jo more rosak jo more rosak i vogël, lepurushët nuk kanë zhguall unë kam dy sy du veshë katër këmbë dhe lëkurën me push; ja e shikon sa të butë e kam, duhet të mësosh se nuk ditke gjë fare
- *Rosaku* – posi posi nuk di, dhe atë që nuk e dija e mësova shumë mirë ou tani u bëra i ditur
- *Lepurushi* – pa më shiko mua më shiko mua i kam mustaqet y..y një pash
- *Rosaku* – pse paske dhe mustaqe
- *Lepurushi* – posi posi e pra i kam një pash dhe them se nuk di shumë gjëra; o.. tani mirë u pafshim se më presin lepurushët e vegjël… unë po i hipi varkës më mirë ti dal më shkurt
- *Lepurushi* – këndon: " o rosak rosak i gjorë ti na mburresh kot më kot, varkëza nuk është vapor deti jo s' kalohet me not - varkëza nuk është vapor deti jo s'
- kalohet me not
- *rosaku* – e pra posi lepurushi mustaqe madh që s'di gjë fare (këndon): "porsi unë kaq të ditur syri jonë nuk ka parë jam një kokë e madhe e ndritur si të isha shkencëtar"
- *iriqi* – hi.. hi.. do luaj pak me këtë rosak topolakun siç më tha breshka edhe sdi gjë fare edhe mburret shumë shkencëtar, tungjatjeta shkencëtar
- *rosaku* – mos u afro, mos u afro i.. i.. qenke shumë i frikshëm dhe i shëmtuar
- *iriqi* – mos u tremb shkencëtar unë jam gjarpri të gjitha kafshët më kanë xhan hii.. hii…
- *rosaku* – gjarpri! Gjarpri unë e di që ti je gjarpri
- *iriqi* – a.. nga e di ti që jam gjarpri
- *rosaku* – se ti ke dy sy , katër këmbë edhe lëkurë më push
- *iriqi* – hi.. hi.. lëkurë me push po vdes nga të qeshurit hi.. hi.. nuk i sheh ti gjithë këto gjemba që kam mbi kurriz dhe thua që jam I ditur
- *rosaku* – i.. gjarpër i keq gjarpër i shëmtuar
- *iriqi* – gjarpër I keq ë.. , gjarpër I shëmtuar ë ( I afrohet rosakut me gjembat dhe I plas tullumbacen që kishte në dorë)
- *rosaku* – e.. çfar bën më çave topin e.. e.. me ato gjembat e tua o gjarpër I keq , gjarpër i keq
- *iriqi* – gjarpër i keq, gjarpër i keq , hi. Hi.. u kënaqa sot kam bërë teatër po shkoj ti tregoj breshkës hi.. hi..
- *rosaku – pop o* sa i keq qenka gjarpri më shpoi dhe topin edhe dorën. Mirë që iku se shpëtova. ( hyn gjarpri ) Dale ç'të jetë ky litar, dale sa i bukur unë nuk kam parë kurrë një kafshë të tillë apo shpend, ehu e ku ta di unë (e prek me dorë ) ej o mik zgjohu mos fli
- *gjarpri* – kush je ti që po më zgjon nga gjumi ë..
- *rosaku* – jam rosaku topolaku
- *gjarpri* – qofsh shëndosh afrohu afrohu pak nuk më njeh mua
- *rosaku* – jo nuk të njoh, unë kam parë kafshë të vogla e të mëdha edhe shpendë kam parë po kështu si ty nuk më kanë zënë sytë cili je ti
- *gjarpri* – unë jam gjarpri, gjarpri gojë mjalti
- *rosaku* – gjarpri! oh po çuditem sepse me gjarprin unë sapo u ndava dhe ai ishte krejt ndryshe nga ti
- *gjarpri* – qenke rosak i lezetshëm; po mirë po si ishte ai gjarpri yt?
- *rosaku* – po ja ishte kështu gati i rrumbullakët dhe me gjemba edhe shiko si më çpoi më çau edhe topin
- *gjarpri* – gjarpër i rrumbullakët me gjemba; kuptova, kuptova ai nuk është gjarpër por iriq, iriq i keq
- *rosaku* – iriqi! Opopo sa i vështirë që ishte me shpoi topin; ty të dua të kam shok dhe jo atë iriqin e shëmtuar me gjemba si gjilpërë
- *gjarpri* – nuk ka kafshë më të urtë se unë; nga ato që më the unë kuptova se ti je shumë i ditur bile ti je më i dituri i të gjithë shpendëve po afrohu afrohu edhe pak
- *rosaku* – mirë e the, tani unë di shumë gjëra mësova që ti je gjarpri gjuhë mjalti që ked y sy katër këm-

bë dhe nuk ke gjemba si të iriqit

- *gjarpri* – mos u nxito rosak ç'thua unë paskam këmbë, pa hë gjeji dhe mi trego
- *rosaku* – o nuk e di se ku i ke
- *gjarpri* – nuk e di sepse unë nuk kam këmbë dhe se ti nuk e di se une kam edhe një gojë të madhe sa mund të të përpij ty me gjithë pupla
- *rosaku* – o nënë, nënë rosë nënë më ndihmo gjarpri
- *iriqi* – *(*e kap gjarprin) eja këtu more gjarpër hileqar
- *gjarpri* – hileqar je ti, ti që gënjeve rosakun
- *iriqi* – ti je hileqar, unë desha të luaja kurse ti doje ta haje (dhe e vret gjarprin)
- *rosaku* – ë ngordhi
- *iriqi* – mos u shqetëso vogëlush kaq e pati edhe gjarpri gjuhë helm
- *rosaku* – faleminderit shumë o iriq se më shpëtove jetën
- *iriqi* – s'ka gjë s'ka gjë
- *rosaku* – ngaqë nuk di asgjë të mirët i quaja të këqij kurse të këqijtë të mirë, veç një gjë nuk kuptova pse më the që ishe gjarpri
- *iriqi* – epo unë me breshkën deshëm të bënim një lojë sepse ti,
- *rosaku* – sepse unë mburresha
- *iriqi* – e.. sepse ti - mburreshe ca ti; s'ka gjë në plazh jemi do bëjmë ndonjë lojë
- *rosaku* – do bëjmë po më çfarë të luajmë ti topin ma cave me çfarë do të luajmë tani?
- *iriqi* – mos u mërzit ja po vjen breshka me një top merrë është i yti

*Rosaku breshka dhe iriqi këndojnë :*

*Që të jesh rosak i ditur jo nuk është kaq e thjeshtë lepuri ka push të ndritur .... Dhe iriqi plot me gjemba është i mirë dhe kryelartë kurse gjarpëri ka helm dhe pse hiqet gojëmjaltë …………………*

# Vonesa

Edi u kthye i gëzuar nga shkolla. Kishte marrë dy yje, një në lëndën e matematikës e një në lëndën e edukatës. Donte t'ia tregonte sa më parë gjyshes së tij që e donte shumë. Me siguri ajo do të gëzohej e do t'i përgatiste ëmbëlsirën e tij të preferuar.
Edi hyri në shtëpi, por gjyshja nuk ndodhej.
I mërzitur që nuk e gjeti gjyshen në shtëpi, Edi hodhi çantën mbi krevatin e dhomës së tij.Çanta iu hap. Tre libra dhe dy fletore dolën nga çanta e ranë mbi tapet. Këpucët i zbathi sa andej –këndej, kurse këmishën e pantallonat i la në dysheme. Pa e vrarë mendjen doli nga dhoma dhe hëngri drekën me uri.
Të nesërmen në mëngjes ,sapo u zgjua, filloi të bëhej gati për në shkollë. Me shpejtësi futi librat në çantë , po nuk po gjente fletoren e gjuhës. E kishte lënë tek rafti I bibliotekës. Filloi të vishej . Këmisha dhe pantallonat ishin të zhubrosura. Gjeti njërën këpucë ndërsa tjetra ishte zhdukur. Po ku vallë? Ishte poshtë krevatit . "Sa po vonohem! "-mendoi Edi i shqetësuar.
Qarko përgjigjen e saktë.

1. Pjesa e mësipërme është: a)tregim b) përrallë c) fabul. (1 pikë)

2. Edi ishte i gëzuar sepse: a) gjyshja I kishte përgatitur drekë të shijshme
   b) gjyshja I kishte përgatitur ëmbëlsirën e tij të preferuar c) kishte marrë dy yje në shkollë. (1 pikë)

3. Gjyshja a) nuk ndodhej në shtëpi b) u kënq nga notat e Edit c) nuk ia kishte përgatitur drekën (1 pikë)

4. Edi a) I vendosi rrobat e tij me shumë kujdes a) I hodhi rrobat e tij andej-këndej
   c) ndihmoi mamin të vendoste rregull në shtëpi . (1 pikë)

5. Në mëngjes Edi a) u vesh menjëherë, b) u vonua sepse rrobat ishin vendosur pa rregull
   c) u zgjua me vonesë (1 pikë)

6. Rendit fjalitë sipas radhës:
   Gjyshja nuk ndodhej në shtëpi.
   Edi u kthye I gëzuar nga shkolla.
   Edi u vonua për në shkollë nga rrëmuja që kishte krijuar.
   Edi i hodhi rrobat e tij pa kujdes. (4 pikë)

7. Shkruaj dy cilësi për personazhin e pjesës. Ilustroje me fjalinë ku tregohet kjo cilësi.
   cilësia ___________ fjalia lustruese ________________________________________
   Cilësia ____________ fjalia ilustruese ________________________________________ (4 pikë)

8. Shkruaj një mbyllje për pjesën e mësipërme. (2pikë)

   ________________________________________________________________________
   ________________________________________________________________________
   ________________________________________________________________________

9. Shkruaj 3 folje nga pjesa e mësipërme.

   _________________________ _________________________ _________________________
   (2 pikë)

10. Shkruaji fjalitë sipas modelit (2 pikë)
    Edi del nga dhoma. Ai hyn në shtëpi ,por gjyshja nuk ndodhet.
    Unë ………..nga dhoma . Ju ………..në shtëpi, por gjyshja nuk ndodhet. (2 pikë)

11. Nënvizo numërorët në fjalinë:
    Tri libra dhe dy fletore dolën nga çanta e ranë mbi tapet . (2 pikë)

12. Korrigjo numërorët e shkruar gabim
    Një mbëdhjetë______________________________
    Njëzetë____________________________ (2 pikë)

13. Gjej një fjalë tjetër me kuptim të ngjashëm për fjalët:
    I gëzuar _____________
    Tryezë ________________ ( 2 pikë)

14. Gjej një fjalë tjetër me kuptim të kundërt për fjalët blu :
    Ishte poshtë krevatit. ________________________________
    Pa e vrarë mendjen doli nga dhoma. ______ _________________ ( 2 pikë)

15. Shkruaj një ndodhi personale të ngjashme me tregimin.

    ________________________________________________________________________
    ________________________________________________________________________
    ________________________________________________________________________
    ________________________________________________________________________

    (5 pikë)

| Vlerësimi | AP | ANP | AK | ASHK | ASH |
|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 0-7 | 8-14 | 15-21 | 22-28 | 29-32 |